




TË TJERËT PËR ISLAMIN

Ajni Sinani

Ajni Sinani

TË TJERËT PËR ISLAMIN



Forumi Rinor Islam
1427/2006

Përgatiti:

Ajni Sinani

Recensent:

Nexhat S. Ibrahim

Muhammed Jusufi

Redaktore gjuhësore:

Mimoza Sinani

Korrektor:

Agim Abazi

Kopertinën e punoi:

Jusuf Salii

Botues:

Forumi Rinor Islam



Bul. Krste Misirkov QT "Mavrovka", Lamela C 2/15 1000, Shkup

Tel&fax: ++ 389 (2) 3233 659;

www.fri.org.mk

E-mail: info@fri.org.mk

Shtypi:

Print ISM

Brigada II Maqedonase lok. 22, 1000 Shkup

Tel./Fax. (02) 26 22 393; 26 22 360

Falënderim

Me rastin e përfundimit të këtij libri, me mirësinë e All-lahut, falënderim meriton familja për durimin dhe përkrahjen e treguar. Falënderoj të gjithë ata, që kanë kontribuar që libri të marrë këtë formë.

I drejtohem All-lahut për falje dhe mëshirë, sepse vetëm mëshira e Tij mund t'i mbulojë të gjitha mangësitë njerëzore. Lus All-lahun e Madhërishëm që munda dhe kontributi ynë të peshojë krahun e djathtë të peshores së veprave tona, në jetën e pasosur. Amin.

PARATHËNIA E BOTUESIT

Mileniumi i tretë muslimanët i vuri para detyrave dhe angazhimeve të mëdha, të cilat erdhën si rezultat të ndodhive me përmasa globale dhe ndikim të paparashikueshëm, jo vetëm në kampin islam, por edhe në rrjedhat e gjithmbarshme jetësore, të cilat hapen në arenën botërore dhe qarqet intelektuale e politike dilema, divergjenca dhe paragjykime, të cilat lidheshin drejtpërdrejtë me muslimanët, fenë dhe misionin e personalitetin e Pejgamberit të fundit të njerëzimit, i cili mori epitetin profeti i muslimanëve, edhe pse ai u dërgua për gjithë botët.

Vlerësimet e njerëzve dhe objektivi i kritikës e vlerësimit të tyre për ngjarjet, fetë, njerëzit dhe misionet, mori karaktere dhe mbajti anë të ndryshme, duke filluar nga ato objektive, deri te ato ekstreme, tendencioze dhe komprometuese.

Muslimanët u vunë para sprovave të mëdha, sepse u desh që sherret që i bënë tjerët, t'i përballojnë këta.

Kështu, lojërat politike të qarqeve ekstremiste, u desh t'i menaxhojnë muslimanët në terrenet e tyre, edhe pse kurrë nuk i kërkuan dhe as që i simpatizuan.

U derdh një energji e madhe për ta bindur botën se mesazhi dhe platforma islame, të cilën e barti Muhammedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], si hallkë e fundit e lajmëtarëve të Zotit, i dërguar për mbarë njerëzit, thirr në paqe dhe mirëkuptim, kreativitet dhe energji pozitive, zhvillim dhe përparim të gjithmbarshëm njerëzor, e jo në ekstremizëm, fanatizëm dhe injorim të vlerave reale.

Reathanat e rënda të krijuara pas ngjarjeve të 11 Shtatorit, nuk lejuan që të gjitha kokat të mendojnë lirshëm dhe të krijojnë opinione reale për kulturën dhe botën islame, jo me fajin e vet, por si rezultat i një fushate të menduar mire dhe të furishme për të bërë ndryshim thelbësor në perceptimin e konfiguracionit religjioz, kulturor dhe politik ndërkombëtar, ku konceptet

për botën islame dhe civilizimin islam, do të evoluojnë skajshmërisht në kahje negative dhe në drejtime rigoroze të formimit të lidhjeve dhe qëndrimeve me këtë provenience kulturore dhe religjioze.

Tezat të cilat u sajuan nga qarqe të dyshimta të avancimit të mirëqenies reale njerëzore dhe ngritjes së urave të bashkëpunimit e njohjes mes popujve, në vend të mbjelljes së ferrave të urrejtjes në botë dhe trazimit të qetësisë së njeriut, gjetën behane të mjaftueshme që t'i paraqesin muslimanët si bartës së idesë së konfliktit në mes civilizimeve, të cilën e promovoi në kohën më të re Huntigtoni, dhe me këtë të bëjnë satanizimin e tyre në sytë e botës.

Në perspektivën e një bote komunikative dhe një mentaliteti të qëndrueshëm paqësor të njeriut bashkëkohor, u desh të shtohet energjia në njoftimin e tjerëve me të vërtetat reale të kësaj feje madhore, qëndrimit të saj ndaj tjerëve, vizionit të saj për botën dhe njeriun e ardhmërinë e sojit njerëzor dhe shoqërisë, me qëllim që të sytë të kthehen kah burimi i pastër dhe i paturbulluar i saj - Kur'ani fisnik, i cili reflekton pozitivisht jo vetëm për ata që i besojnë atij, por edhe për mbarë botën dhe llojin njerëzor, përmes ndërtimit të platformës reale të qëndrimit të muslimanit ndaj botës, jetës, njeriut dhe Zotit. Në këtë formë, në mënyrë të natyrshme do të bëhen përmirësime të duhura në metodologjinë e qasjes dhe analizimit të fenomeneve, ashtu që për bazat nuk do të gjykohet në bazë të veprimeve të individëve, të cilat janë subjektive, por nga vetë postulatet e çimentuara me argumentet e qarta të burimet e fesë.

Edhe pse shoqëria muslimane, në veçanti komuniteti musliman ka participuar fuqishëm dhe me gjallëri të admirueshme në të gjitha iniciativat që kanë inkurajuar proceset pozitive në shoqëri, nuk e fituan hisen e duhur të objektivitetit nga tjerët, duke mos u kursyer nga vala e hidhërimit ndaj individëve apo grupacioneve të caktuara, të cilat ia dhanë të drejtën vetes, pa autorizim nga asnjë, që të tensionojnë raportet mes komuniteteve.

teve dhe të thirren në përplasje globale në mes palëve që u takojnë proveniencave të ndryshme kulturore dhe religjioze.

Në drejtim të nxitjes së proceseve të cilat synojnë të legalizojnë efektshmërinë e dialogut dhe mirëkuptimit mes njerëzve dhe shoqërive, si dhe thyerjen e suksesshme të paragjykimeve të cilat padrejtësisht janë sajuar kundër fesë dhe kulturës islame, Forumi Rinor Islam i Maqedonisë, ka ndërmarrë disa aktivitete të qëlluara konform kërkesave të objektivave të përcaktimit bashkëkohor të muslimanëve për zgjerimin e komunikimit me tjerët, të cilat kanë synuar ta kontestojë fuqishëm gjithë atë kapital të madh propaganda e të pavërteta që u deponua në historinë më të re të mendimit njerëzor, në raport me muslimanët.

Dialogu dhe komunikimi me njerëzit, është metodë adekuate që e mbështeti kjo organizatë në favorizimin e formimit të botëkuptimeve reale rreth Islamit, e jo atyre të ngarkuara nga muhabetet e medimeve dhe analistëve që shumë here dinë të jenë objektiv, apo jo të njohur mire me realitetin e çështjes.

Libri që e keni në duart tuaja, është një kontribut modest, por mjaft domethënës, i hapjes së mundësive të reja të dhe kanaleve të sigurt të komunikimit mes njerëzve dhe shoqërive, ku tentohet të tregohet se ne nuk kemi krijuar bindje të gabuar se gjithë tjerët na urrejnë, dhe se me këtë janë edhe të pa drejtë apo armiqësor ndaj nesh, por ne mburremi që kemi edhe shumë mendimtar të shquar të cilët kanë arritur ta njohin drejtë civilizimin islam dhe të thurin fjalë miradije për civilizimin islam dhe të dërguarin e Allahut, përkitazi me personalitetin e të cilit u bë një padrejtësi, duke u lejuar në emër të lirisë së mendimit dhe shprehjes, cenimi i figurës së tij markante, përmes karikaturave denigruese.

Lexuesi do të ketë rastin të lexojë fjalë madhore për civilizimin islam dhe për të Dërguarin e Allahut, të cilat fjalë nuk thuhën nga muslimanë, të cilët do të mund të neglizhoheshin me pretekstin se është e natyrshme të thonë kështu, por këto fjalë dalin nga personalitete të shquara jomuslimane, që besoj se do

ta ngjallin kërkimin e çdo lexuesi që të fitojë energji të duhur për të gjurmuar për të vërtetat e kësaj feje nga burimet e saj autentike.

Mr. Bashkim ALIU

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

*Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit të Përgjithshëm,
Mëshirëplotit*

PARATHËNIA E AUTORIT

Paqja, mëshira dhe bekimi i All-llahut të Madhërishëm qoftë për të Dërguarin e mëshirës, vulën e të gjithë pejgamberëve, Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], për familjen e tij të pastër, shokët e tij të nderuar dhe të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij sa të jetë jeta.

Shtimi befasues i bashkësisë muslimane arriti suksese të shumta, duke u shkaktuar frikë perëndimorëve nga superioriteti politik dhe ushtarak i muslimanëve. Në vitin 711, në Perëndim, muslimanët kaluan Ngushticën e Gjibraltarit, duke i vënë themelet kulturës grandioze “maure” të Andaluzisë. Po atë vit, morën Transaksoninë duke mundur

zhvillime të pasura dhe të mrekullueshme të Islamit, në Azinë Qendrore.

Në histori janë të rralla rastet, rreth të cilave ka pasur aq paragjykime dhe kontradikta, sikurse është rasti me fenë islame dhe me Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], Islamin, si fe të ardhur pas Krishterizmit, të krishterët mesjetarë evropianë, e kanë shikuar si herezi, prej nga rezultoi edhe prejardhja e mitit të vjetër për Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], si kardinal renegat. Te kjo fe e panjohur, ata shihnin ngjashmëri me paganizmin mesjetar. Në literaturën e shumtë, që është shkruar në Evropë rreth Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] s'ka asnjë vepër ku të kritikohen dhe të dënohen fyerjet dhe shpifjet që kanë përhapur armiqtë e Islamit, kundër personalitetit dhe mësimave të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], gjë që vërehet edhe sot e kësaj dite te disa individë dhe qarqe të caktuara, të cilët bëjnë propagandë kundër Islamit. Te shqiptarët, një propagandë të pandershme antiislame e ka bërë Pjetër Bogdan Maqedonasi, i pacipë, serbofil, i cili kishte injoruar territoret shqiptare dhe nuk i quante Iliri, Dardani, ose Kosovë, por "Mbretëri të Serbisë".

Bogdani, veten e quante "administrator të mbarë Mbretërisë së Serbisë" edhe emri i tij nuk ishte "Pjetër Bogdan Shqiptari", por "Pjetër Bogdan Maqedonasi". Dhe, si për ironi, shkenca shqiptare i dha një rëndësi të veçantë këtij mashtruesi, falsifikatori, gënjeshtari dhe shpirtligu. Me mësimet 'shkencore' të këtij të mjeri, janë frymëzuar edhe shumë kryqtarë prej të cilëve në kohën tonë bien në sy: E. Sedaj, Lush Gjergji, Shan Zefi, të cilët nuk lënë rast pa e sulmuar të vërtetën e amshueshme - Islamin. All-llahu i Madhërishëm e përmend çështjen e kundërshtarëve dhe mashtruesve të

Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në Kur'an, duke përkujtuar poshtërimin e tyre dhe lartësimin e emrit të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]: *"Dhe Ne, ta ngritëm lart famën tënde!"* (El-Inshirah: 4); *"Ne, vërtet të dhamë ty shumë të mira. Andaj, ti falu dhe prej kurban për hir të Zotit tënd! E s'ka dyshim se urrejtësi yt është farësosur".* (El-Kevther: 1-3)

Gjatë historisë pati shumë armiq, e megjithatë ata, ose i mbuloi pluhuri i harresës, ose vazhduan të përmenden për shembull të keq. Ndërkaq, emri i Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], vazhdoi të përmendet më shumë se emri i cilësdo krijese tjetër, kurse udhëzimi dhe drita hyjnore që ai solli, edhe sot e kësaj dite vazhdon të ndriçojë zemrat e pastra dhe fisnike të miliona, madje miliarda njerëzve, gjatë gjithë këtyre 14 shekujsh. Kështu, këtë gurrë të pashterrur, do të vazhdojnë ta shijojnë shpirtat e gjithë atyre njerëzve fisnikë dhe zemërpastër. Prandaj, është obligim dhe detyrë për çdo musliman, që jo vetëm të mos bie pre e këtyre shpifjeve dhe mashtrimeve, por me vendosmëri t'i demantojë të gjitha akuzat dhe shpifjet e rreme, kundër Islamit dhe Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].*

Ndërkaq, fatmirësisht, sot ekziston edhe një numër jo i vogël njerëzisht të shquar, që mbajnë një qëndrim objektiv, madje admirues dhe disa prej tyre kanë përqafuar edhe Islam-in, të cilët gjithnjë e më shumë po ndikojnë ndjeshëm në formimin e një opinioni objektiv në këtë drejtim. Përmes

* Në këtë drejtim preferoj që të lexohet: Nexhat S. Ibrahim, *Paragjykimet ndaj Islamit gjatë shekujve*, Zëri Islam, Prizren, 2000; Muhammed Pirraku, *Emri kombëtar i shqiptarëve nuk është dhunë islame*, Dituria Islame, Prishtinë, 1996, nr. 81-82 dhe artikuj të tjerë të këtij autori; Avdi Berisha, *Shtatzënia e një mashtrimi*, pa vit botimi.

fjalëve të tyre, ne kemi mundësi t'i përgënjeshtrojmë të gjitha shpifjet dhe akuzat e pabaza të bëra deri tani kundër Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe Islamit. Mjerisht, përderisa në njërin anë armiqtë e Islamit bëjnë propagandë neveritëse në mënyrë të vazhdueshme, që nga qendrat më të kulturuara deri në vendet më të largëta, në anën tjetër kundërpërgjigja e muslimanëve është sikurse 'një grimcë rëre në shkretëtirë'.

Duke përshkruar evoluimin e mendimit të evropianëve për Islamin, në mënyrë përmbledhëse, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen mbi disa paragjykime dhe mashtrime që mbizotërojnë edhe sot e kësaj dite në shumë qarqe, të cilat janë rezultat i mosnjohjes së mjaftueshme apo i shkrimeve tendencioze. Autorët e krishterë, shumica e të cilëve ishin priftërinj dhe ushqenin urrejtje ndaj Islamit, të cilët jo me qëllim që të jenë objektivë, por që të shtrembërojnë çdo gjë që ka të bëjë me Islamin, i kanë shërbyer propagandës kundër Islamit.**

Grekët dhe romakët e vjetër vetëm vetveten e konsideronin "të civilizuar", ndërsa çdo gjë të huaj, e sidomos çdo gjë që vinte nga Mesdheu, ata e etiketonin si "barbare" dhe "barbarizëm". Që nga ajo kohë, përbuzja e theksuar, më pak apo më tepër, ndaj racave të popujve evropianë - ka qenë një prej vijave të përhershme të civilizimit perëndimor. Asnjë fe në botë, s'është interpretuar në mënyrë aq tendencioze dhe s'janë adresuar aq shumë fyerje dhe mllef nga armiqtë e saj, sikurse ndodhi me fenë islame. Qysh nga fillimi, rreth Islamit dhe muslimanëve, ka pasur shkrime të panumërta

** Shih Osman Nuri Haxhiq, *Muhammed a.s. i Kur'an*, Osvrt na historiju islamske kulture, Zagreb, 1986, f. 23-25, të cilit i jemi referuar gjatë këtij shkrimi.

tendencioze dhe të njëanshme. Sulmet arritën apologjinë e tyre, sidomos kur Islami i kaloi kufijtë e shkretëtirës arabe dhe filloi të përhapet gjithandej me një shpejtësi të paparë.

Të krishterët, gjatë gjithë kohës në të kaluarën, u munduan që Islamin ta paraqesin si fe pagane, kurse muslimanët i konsideronin si paganë të pafe, që nuk i besonin Zotit. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] përshkruhej si një idhull, të cilin e adhuronin muslimanët. Madje disa kronistë, kishin shkruar aq larg me gënjeshtat dhe mashtrimet e tyre, sa të pretendonin se ai, (idhulli i Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]) ishte i ndërtuar prej ari dhe argjendi, në vendin e quajtur Kadisi, i hipur në një elefant dhe i vendosur në një xham mozaiku. Pa dyshim se këto shtrembërimi, në të shumtën e rasteve, janë rezultat i pasionit dhe aversionit, për pasojë kemi një pamje të mjegulluar, ku gënjeshtat paraqiten dhe duken si të vërteta.

Në shekullin e XII-të, kundërshtarët e Islamit i avancuan shpifjet e tyre në adresë të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], duke shkruar se ai s'është më 'idhulli' që adhurohet në Kadisi, por një kardinal heretik, që duke mos pasur mundësi të bëhej papë, themeloi një religjion të ri, që t'u hakmerrej kundërshtarëve. Në shekullin e XIII-të, gjatë një diskutimi, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] paraqitet si Anti-Krisht. Prandaj, lirisht, mund të përfundojmë se literatura e botuar në Perëndim mbi Islamin ishte dhe vazhdon të jetë sipërfaqësore, e paarritshme dhe e bazuar në interesa mesquine, nganjëherë edhe me levërdi, e shkruar me pretekste tendencioze dhe dashakeqe, pa vlerë të njëmendtë shkencore.

Ekzistojnë përjashtime, mirëpo ato janë të pakta. Edhe njerëz të shquar në Perëndim, ranë pre e këtyre mashtrimeve dhe shpifjeve mbi të Dërguarin e ndershëm të All-llahut. Danten, poetin e njohur italian, për pak sa nuk e gozhduan në kryq, duke e cilësuar si heretik, për të vetmin shkak se në veprën e tij “Komedia Hyjnore”, ai e kishte vendosur Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], në një vend të purgatorit së bashku me filozofët e vjetër. Për t’i shpëtuar dënimit, ai u detyrua që t’ia ndërronte vendin atij dhe ta vendoste atë në ferr, mes heretikëve.

Evropa, deri në përfundim të kryqëzatave, nuk vlerësoi asgjë pozitive tek Islami dhe Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Prandaj, periudha e kryqëzatave mund të konsiderohet jo vetëm kohë e luftërave kundër Islamit, por edhe e shpifjeve kundër tij. Kështu, të krishterët u munduan që t’ia mohojnë Islamit dhe Kur’anit fisnik burimin hyjnor, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] pejgamberinë dhe muslimanët t’i paraqesin si idhujtarë dhe heretikë. Mirëpo gjatë kryqëzatave Evropa pati mundësi të bie në kontakt të drejtpërdrejtë me botën islame, kontakt i cili deri atëherë ishte bërë në mënyrë indirekte, nëpërmjet priftërinjve dhe vizituesve të ‘varrit’ të Jezusit, të cilët si ‘shërbim ndaj fesë dhe Zotit’, paraqisnin së mbrapshti çdo gjë që në vete përmbante emblemën islame.

Kryqtarët e Evropës, krahas dëshpërimit të thellë për shkak të humbjeve, sollën me vete një frymë të re, e cila i detyroi armiqtë e Islamit, që në të ardhmen t’i modifikonin edhe më shumë sulmet dhe shpifjet e tyre. Ata e kuptuan se Lindja, që e panë me sytë e tyre, ishte plotësisht e kundërt me atë që u ishte treguar atyre. Në botën islame, ata në vend të bishave të egra takuan njerëz me kulturë dhe me një moral të

fortë, takuan njerëz të formuar dhe me një mirëqenie të lartë jetese. Në vend të idhullit 'Mahoma' prej ari, që ka fuqi të bëjë mrekulli, të cilin gjoja muslimanët e adhuronin në faltoret e tyre plot statuja, kryqtarët në Lindje, për çudi të tyre, takuan muslimanë që falen dhe luten në xhami, ku s'kishte as statuja dhe as fotografi, sikurse në kishat e tyre, që adhuronin një Qenie të padukshme dhe të mbinatyrshme, Zotin e Vetëm - All-llahun Fuqiplotë.

Kjo ndikoi mjaft në evoluimin e mendimit evropian për Islamin. Por, megjithatë, prangat e fanatizmit të trashëguar mesjetar dhe ndikimi i fuqishëm autokratik i Kishës, pengonin shprehjen e gjykimeve dhe të mendimeve të reja. Mirëpo, tashmë tregimi për 'idhullin' s'kishte më efekt. Duheshin imagjinuar dhe shpikur forma të tjera mashtrimesh. Është ironi, se paraqitësit e një imazhi të rremë për Islamin, ishin madje ata që pretendonin të ishin bartës të kulturës dhe civilizimit. Një pjesë e madhe e tyre, nuk arritën të largohen nga fanatizmi mesjetar, korruptimi mendor dhe intelektual, madje as në ditët tona. Verbëria e zemrës - sikurse thotë Kur'ani i shenjtë - dhe jo e syve, bëri që ata të ushqejnë urrejtje ndaj Islamit dhe të mos e shohin dritën hyjnore.

Shekujt kalonin, por paragjykimet për Islamin dhe Pejgamberin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] përhapeshin vazhdimisht, madje gjenin vend edhe në mesin e të shkolluarve. Deri në shekullin e XIX-të Evropa në të shprehurit e mendimit të saj për Islamin dhe Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ka qëndruar jashtë çdo norme dhe jashtë çdo kriteri shkencor. Edhe në shekullin e XIX-të, që u quajt shekulli i kritikës shkencore, ajo nuk arriti të lirohej plotësisht nga paragjykimet dhe akuzat mesjetare. Muhammedi [sal-

lall-llahu alejhi ve sel-lem] është akuzuar se kishte bërë plagjiat Dhiatën e Vjetër dhe të Re, në mënyrë që t'i forconte qëndrimet e tij dhe që t'u jepte atyre karakter shkencor. Se sa mund të ketë karakter shkencor Dhiata e Vjetër ose e Re është një temë në vete! Ky vizion nisej nga një zemërim i madh kundër Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], i cili me "profecinë e vet të rreme", e ndaloi qartë zhvillimin e njerëzimit drejt Krishterizmit të përgjithshëm. Në hulumtimet e të krishterëve, gati se është e dukshme se, Islami nuk mund të trajtohej si subjekt i thjeshtë i hulumtimit shkencor, por si i pandehur dhe i akuzuar para gjykatësve të vet.

Në veprat e orientalistëve të shekullit të XIX-të, nuk ndihet askund fryma e Islamit. Prandaj, veprat e tyre nga fusha islame dhe historia orientale, janë mjaft të cektë dhe sipërfaqësore. Edhe ata pak autorë evropianë, që dëshironin ta shkruanin biografinë e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], në mënyrë rreptësisht shkencore, nuk ia arritën dot qëllimit që ia vunë vetes. Autorët perëndimorë, që shkruan për Islamin ndikuan në kuptimin e gabuar të Islamit. Kjo shihet më së miri nga shkrimet e tyre, në të cilat kundërshtojnë njëri-tjetrin në mjaft gjëra, për shkak të mosnjohjes së tyre, ose për shkak se duke shtrembëruar faktet, fusin gjëra që nuk i përkasin Islamit, gjë që ka bërë që veprat e tyre të jenë mjaft kontradiktore. Përpyekjet e tyre të jashtëzakonshme dhe puna e madhe që kanë kryer, ka pasur një objektiv të qartë, atë të çoroditjes së njerëzve të thjeshtë e të pafajshëm, nën maskën e punimeve shkencore. Është në nderin e evropianëve, të cilët dëshirojnë të shkruajnë rreth Islamit, që ta bëjnë një gjë të tillë në mënyrë objektive.

Armiktë e Islamit, kanë bërë deklarata të pambështetura se Islami është përhapur me forcë, me mjete detyrimi dhe

përdorimin e shpatës. Suksesin e shpejtë dhe të paparë të Islamit, kryqtarët janë munduar që ta shpjegojnë nëpërmjet ekspansionizmit militarist, në vend të penetrimit shpirtëror kah e Vërteta. Nuk mund të ketë shpifje më të madhe se sa kjo thënie e pavërtetë. Përveç studimeve të hollësishme, veç njohjes së thellë dhe të gjithanshme të lëndës, nga evropiani kërkohet që të jetë plotësisht objektiv, të mos jetë tendencioz, dhe të mos ketë mosdisponim dhe antipati ndaj Islamit. Përndryshe vepra do të jetë sipërfaqësore, e njëanshme dhe tendencioze. Portretizimi i përgjithshëm, i cili në Perëndim ekziston mbi Islamin, është shembull tipik i prishjes së optikës së shkencës “akademike”.

Të shkruarit e njëanshëm dhe tendencioz është turp për autorin dhe shenjë e kapitullimit të shkencës. Edhe sot e kësaj dite jomuslimanët kanë një pasqyrë të zbehtë ndaj Islamit, Pejgamberit të Islamit dhe ithtarëve të tij. Kryesisht, këtë pasqyrim ua ofron propaganda misionare, e helmuar dhe e deformuar me të gjitha mundësitë dhe me të gjitha format e mundshme. Kjo gjë bën që njëri ndër qytetërimet dhe njëra ndër fetë më të pakuptuara të Evropës, të jenë gjithsesi feja islame dhe qytetërimi islam. Bibliotekat publike dhe librari-të e botës shekullariste, gëlojnë me botime që e paraqesin Kur’anin si një vepër të mendjes njerëzore, krijuar prej një “mashtuesi” të profecisë.

Rreth imazheve të pavërteta që u serviren amerikanëve edhe sot e kësaj dite mbi Islamin, Paul Frindley, thotë: “Imazhet e rreme të Islamit nga vegjëlja vazhduan të ruhen kaq gjatë në mendjen time, sa që sot nuk më bën përshtypje kur njihem me amerikanë të tjerë me keqpërfytyrime të ngjashme. Është për t’u habitur të mendosh mbi numrin tejet të madh të stereotipave dezinformues që kanë vijuar për Isla-

min, të pacenuara vit pas viti, nga orët e Shkollës së të Dielës në mbarë Amerikën. Miliona të rinj mund të kenë pranuar informacionet e rreme si të vërteta dhe, përgjatë viteve, ua kanë kaluar, të papërmirësuar, miliona njerëzve të tjerë”.*** Prandaj lirisht mund të themi se literatura e sotme e botuar në Perëndim, mbi Islamin është pa vlerë të njëmendtë shkencore. Ekzistojnë përjashtime, mirëpo ato janë të pakta.

Me qëllim që t’i demantoj, nëpërmjet fjalëve të vetë perëndimorëve të shquar, të gjitha akuzat, mashtrimet dhe shpifjet e rreme, kundër Islamit, Kur’anit fisnik dhe Pejgamberit të ndershëm, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], në favor të një opinionit objektiv dhe të drejtë për të vërtetën e amshueshme-Islamin, i përmblodha këto thënie të të huajve në këtë libër. Unë e di se një pjesë e besimtarëve, mbase, nuk kanë nevojë për këto dëshmi, sepse atyre u mjafton Kur’ani fisnik dhe Hadithi (fjalët e bekuara të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]), por ekziston një pjesë njerëzish, të cilët sikur i japin më shumë rëndësi një gjëje, nëse për atë përmendet deklarata e ndonjë mendimtari të shquar evropian.

Besoj, se këto dëshmi të dijetarëve objektivë perëndimorë dhe të konferencave dhe simpoziumeve botërore, janë dëshmi të mjaftueshme për ata që mendojnë drejtë dhe në mënyrë objektive, por që në një mënyrë a tjetër kanë rënë pre e një propagande të rreme kundër çdo gjëje që ka emblemen islame, që të braktisin të gjitha shpifjet dhe gënjeshttrat dhe të pranojnë pa kurrfarë hamendje dhe hezitimi Islamin

*** Paul Frindley, *Mjaft me heshtje, përballë imazhit të gabuar të Amerikës mbi Islamin*, korrik, Shkup, 2004, f. 22.

për Fe, Kur'anin për Fjalë të Zotit, dhe Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] për Pejgamber të Krijuesit të gjithë botëve - All-llahut të Madhërishëm. Edhe radhitja e kaptinave është bërë në këtë funksion dhe me këtë qëllim. Lexuesi, gjatë deklarimeve të ndryshme, do të lexojë edhe shprehje, në të cilat nganjëherë Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] përshkruhet si një njeri gjeni, mësues i madh, me aftësi të jashtëzakonshme, reformator, i cili arriti ta ndryshojë pamjen e botës dhe të ndryshojë rrjedhat e historisë.

Gjatë kësaj, duhet të kemi parasysh se një numër i autorëve në libër, gjithë të arriturat ia përshkruajnë gjenialitetit të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Edhe pse këta autorë thanë fjalë miradije dhe lavdërimi ndaj Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], megjithatë një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk arritën që të kuptojnë dhe të thonë të vërtetën qenësore për të - të qenit e tij i Dërguar i Zotit. Sigurisht se Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka qenë njeri me aftësi të jashtëzakonshme, mësues i madh, edukator, udhëheqës shpirtëror dhe profan, shembulli më i përkryer i gjithë gjinisë njerëzore, ka pasur gjenialitet të jashtëzakonshëm, por të gjitha këto veti dhe virtyte ishin si rezultat i pranimi të shpalljes nga Zoti.

Për ne muslimanët, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është Lajmëtar i dhe i Dërguari i fundit i All-llahut, i dërguar për të gjithë popujt dhe të gjitha kohërat, derisa të jetë jeta. Kjo është dhurata më e madhe dhe gradimi më i lartë që i dha Krijuesi, krijesës së tij më të përsosur dhe më të dashur, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Gjithë ato që bëri Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], për mbarë gjininë njerëzore, ardhja e të cilit qe mëshirë

për të gjitha krijesat, duhet kuptuar në kuadër të ndihmës hyjnore dhe pranimit të shpalljes nga All-llahu i Madhëri-shëm, dhe jo si rezultat i gjenialitetit dhe shpikjes së tij mendore.

Ajni Sinani

KAPITULLI I

PËR ISLAMIN

Johan Wolfgang von Goethe (Gëte)

Poeti më i madh i Evropës, lavdia e gjuhës gjermane dhe e jetës intelektuale. Edhe pse e kaloi jetën e tij në një vend jomusliman, ai pranoi dhe deklaroi se pajtohej me gjithë zemër me pohimin e dy dëshmime (Shehadetin): S'ka Zot tjetër veç All-llahut, Një dhe të Vetëm, dhe Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është i Dërguari dhe, njëkohësisht, vula e të gjithë të dërguarve të Tij. Veç të tjerash, ai thotë:

*"Çmenduri, secili në rastin e vet
Mendimin e tij të veçantë lëvdon!
Nëse Islam do të thotë nënshtrim ndaj Zotit
Ne jetojmë dhe vdesim në Islam".¹*

*"Dhe, kështu, na duhet të qëndrojmë brenda Islamit
(d.m.th.: në nënshtrim të plotë ndaj vullnetit të Zotit)..."²*

*"Më tepër nuk kam ç'të them, përveç asaj se, edhe këtu, unë
përpiqem të qëndroj në Islam".³*

¹ Këto fjalë, Gëte, i thotë në njëren nga poezitë e Divanit, (WA I 6, 128), shih: Shejh Abdulkadir Al Murabit, *Johann Wolfgang Von Goethe dhe 'Marrëdhëniet e tij me fenë islame'*, Tiranë, 2000, f. 15.

² Gëte i tha këto fjalë, pas një aksidenti që i ndodhi karrocës së tij (në korrik 1816). Ai e kuptoi se nuk do ta shihte më kurrë Marianne von Wilmer-in, me të cilën mendonte të martohej pas vdekjes së Kristjanës. (WA IV 27, 123), ibid, f. 20.

³ Të njëjtën gjë, ai thotë edhe në një letër drejtuar Zelter-it, më datë 20. 9. 1820, (WA IV 33, 132), ibid, f. 20.

“Këtu askush nuk mund të këshillojë njeri; secili duhet të vendosë vetë, se çfarë duhet të bëjë. Ne të gjithë jetojmë në Islam, pavarësisht nga forma që zgjedhim për të inkurajuar vetveten”.⁴

“Mbështetet... në çdo pikëpamje të arsyeshme fetare dhe është në Islam, të cilin ne, herët a vonë, të gjithë duhet ta pranojmë”.⁵

“Feja Muhamedane jep shembullin më të mirë për këtë”.⁶

“Ju e shihni se, këtij sistemi, nuk i mungon asgjë dhe se ne, me gjithë sistemet tona, nuk jemi aspak më të përparuar, madje askush nuk mund të shkojë më përpara... Ky sistem filozofik është një masë e shkëlqyer, të cilën njeriu mund ta aplikojë te vetvetja dhe te të tjerët, për të mësuar se në ç’nivel të virtutit shpirtëror jemi”.⁷

“Efesi për shumë vjet,

Nderon mësimin e profetit

Jezus. (Paqja qoftë mbi të Mirin!)”⁸

“Besimi në një Zot të vetëm është gjithmonë i efektshëm për ngritje shpirtërore, sepse ai tregon për njeriun, njëshmërinë brenda vetes”.⁹

⁴ Kur, më 1831, u shfaq një epidemi kolere, nga e cila vdiqën shumë njerëz, nëpërmjet një letre, Gëte e ngushëllon kështu një miken e tij, Louise Adele Schopenhauer: (më 19. 9. 1831, WA IV, 49, 87), ibid, f. 20.

⁵ Më 22. 12. 1820 Gëte i shkroi një letër falënderimi mikut të tij Wilemer, i cili i kishte dhuruar një libër me aforizma. Ai, mes tjerash, i kishte shkruar këto fjalë, (WA IV 34, 50), ibid, f. 21.

⁶ Si pjesëmarrës në Luftën e 1792 kundër Francës, Gëte shkruan, më 7-8 tetor 1792, se besimi në paracaktimin e gjithçkaje nga Zoti, gjen shprehjen e tij më të pastër në Islam, (WA I 33, 123), ibid, f. 21, 22.

⁷ Eckerman na njofton për një bisedë të tij me Gëten, më 11. 4. 1827, rreth metodës së edukimit të muslimanëve. Gëte e mbyll këtë diskutim me këto fjalë, Shejh Abdulkadir Al Murabit, op. cit., f. 22.

⁸ Gëte, këtu, e përshkruan Jezusin si profet, (WA I 6, 296), ibid, f. 9.

⁹ West-ostlichen Diwan, WA I 7, 42, ibid, f. 23.

“Herët a vonë, duhet të pranojmë Islamin, sepse ai pajtohet me arsyen”.¹⁰

“Nëse Islami është bindje ndaj Zotit, atëherë, të gjithë (lindim) jetojmë dhe vdesim në Islam”.¹¹

“Është shumë e çuditshme se si muslimanët fillojnë t’i edukojnë fëmijët e tyre. Ata e kalisin rininë e tyre, që në fillim, me bindjen se asgjë s’mund t’i godasë veç asaj që ia ka përcaktuar më parë Zoti, i Cili udhëheq në gjithçka dhe në çdo gjë. Kështu, ata janë të përgatitur gjatë gjithë jetës së tyre dhe pajtohen me fatin, dhe nuk u duhet pothuajse asgjë tjetër. E shihni, këtij mësimi nuk i mungon asgjë. Me gjithë sistemet tona edukative, ne nuk kemi shkuar aspak më tej, madje askush nuk ka mundësi të shkojë më tej”.¹²

Sipas Anemari Schimel, e cila është njëra nga njohëset më autoritative dhe më kompetente të Islamit në Evropë, Gëte ka mbetur tërë jetën i entuziazmuar me Islamin, ndoshta edhe për arsyen se Islami i ka pëlqyer, sepse Gëte kurrë nuk e ka pranuar idenë e kryqëzimit të Jezusit, as shëlbimin e tij dhe as ngarkesën e tij me mëkate njerëzore. Në Divanin e vet, ka mjaft qëndrime antikrishtere, nga pozita e besimit islam.¹³

Volteri

Filozof dhe shkrimtar i madh francez, thotë:

“Feja me të cilën erdhi Muhammedi, pa dyshim është më e lartë se Krishterizmi. Besimtarët muslimanë nuk janë sprovuar me mosbesimin, me të cilin janë testuar të krishterët, të

¹⁰ Hilmo Neimarlija, *Dug Geteu*, Islamska Misao, v. V. nr. 51, Mars, Sarajevë, 1983/1403, f. 41.

¹¹ Rozhe Garodi, *Gjallërimi Islamik*, Gjakovë, 1991, f. 1.

¹² Islamska Misao, Sarajevë, 1983, op. cit., f. 41.

¹³ Dituria Islame, Prishtinë, 1996, nr. 79, f. 28.

cilët, në fund, deklaruan: “Një Zot është në tresh, ndërsa trinia ka njësinë e njëshit”. Besimi në Një Zot të Vetëm, të Gjithëfuqishëm ka qenë në themel të Islamit. Ekzistimin e tij, Islami ia ka borxh liderit të tij dhe trimërisë së tij, ndërsa të krishterët përdorën shpatën dhe zjarrin për përhapjen e fesë së tyre. O Zot, Zot i Madh! Sikur këta popuj të Evropës t’i merrnin si model muslimanët! Nuk ka dyshim që Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka qenë njeri vërtet i madh. Në gjirin e virtyteve të tij dhe personalitetit paradogmatik ka kultivuar gjenerata madhështore. Ai ka qenë shtetas i urtë dhe i drejtë, i cili deri në fund ka realizuar revolucionin më të madh në historinë e njerëzimit”.¹⁴

“Luteri nuk është i denjë as t’ia zgjidhë lidhëzat e këpucëve Muhammedit”.¹⁵

“Përsëris se ata, që fenë islame e quajnë si fe me lakmi epshesh shtazore dhe një fe që i hap shteg plogështisë dhe papunësisë, janë të padijshëm, trundryshkur e mendjesëmurë. Këto pretendime, janë fare të pabaza dhe qëndrojnë shumë larg nga e vërteta. Edhe ata, që i pranojnë si ekzistuese këto, nuk e njohin aspak problemin.

O priftër e kallogjerë! Të gjithë ju, o burra klerikë! Në qoftë se urdhëroheni të mbani agjërim në muajin korrik, në qoftë se ju ndalohen vera që pini e bixhozi që lozni, nëse urdhëroheni të bëni pelegrinazh (haxh) në ranishtat e nxehta të Hixhazit (Arabisë), nëse vendoset të jepni dy e gjysmë për qind të të ardhurave tuaja për sadaka, dhe ju kërkohet të lëshoni 14 gra nga 18 që keni, e të mbani vetëm 4, a mund të

¹⁴ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, *Islami dhe Civilizimi Perëndimor*, Gjilan, 2004, f. 81.

¹⁵ Ibid, f. 82.

thoni për atë fe, që u bënë të tilla komunikime, se është fe lakmuese dhe epshesh shtazore?!¹⁶

Ndërkaq, në Dictionnaire Philosophique, IV, f. 319, ai thotë: “Vëllait tim musliman do t’i thosha: Feja jote, më duket një fe shumë e respektuar. Ti adhuron vetëm një Zot. Çdo vit, je i detyruar të japësh, si zekat, një të dyzetën e të ardhurave dhe ditën e Bajramit të bësh paqe me armiqtë. Priftërinjtë tanë, që shpifin tërë botën, ndoshta një mijë herë thanë se feja jote zuri vend, sepse është një fe që u drejtohet plotësisht kënaqësive. Të gjithë këta të mjerë kanë gënjyer. Feja jote është shumë fisnike”.¹⁷

Në “Fjalori Filozofik v. III”, kapitulli “Muslimanët”, Volteri thërret me nervozizëm:

“Ju them përsëri, analfabetë të marrë, vetëm të paditurve mund t’u thuhet se feja islame është sensuale dhe epsharake; për këtë, as që bëhet fjalë, ju kanë mashtruar sikurse edhe për shumë të tjera...

Lehtë është të shpifet, por unë e urrej shpifjen - thotë Volteri në fund të artikullit. Pasaktësitë duhet vazhdimisht të përgënjeshtrohen, sepse edhe kur e hedhim poshtë një mashtrim, gjithnjë gjendet dikush që do të risjellë atë. Mund të shkruhen shumë libra voluminozë me intrigat e pavërteta, me të cilat janë sulmuar muslimanët. Çdo gjë që është thënë për muslimanët, deri më sot, duhet hedhur në zjarr”.¹⁸

Leon Nikolajevič Tolstoi

¹⁶ Hajrullah Hoxha, *Akuzat kundër Islamit dhe vlerësimet pozitive të disa shkencëtarëve jomuslimanë*, Takvimi, Prishtinë, 1996, f. 119.

¹⁷ Dr. Beqir Topalloglu, *Gruaja në Islam*, Stamboll, 2000, f. 31.

¹⁸ Enver bin Tahir, *Volterova (Voltaire) tragedija “Muhamed ili fanatizam” i neka njegova kasnija djela*, Glasnik, nr. 4-6, prill- maj, Sarajevë, 1961, f. 264-267.

Shkrimtar i madh rus, në traktatin "Pejgamberi urtiplotë Muhammed", veç të tjerash, thotë:

"Muslimanët, në gjirin e Islamit, me abstenimin e tyre nga kjo botë kalimtare, me pastërtinë e jetës, fisnikërinë e qëllimeve, qartësinë e synimeve, me moral fisnik, karakter, thjeshtësi dhe pjekuri, i mahnitën njerëzit që gjendeshin rreth tyre.

Një prej vlerave të Islamit, është porosia që, të veprohet mirë me ithtarët e librave qiellorë, veçanërisht me priftërinjtë e krishterë...

Në fenë islame, lejohet që të lidhet martesë me femrat e krishtera dhe çifute, dhe ato gëzojnë të drejtën që ta mbajnë fenë e tyre".¹⁹

"Ligji, të cilin e ka sjellë Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], do të sundojë në botë, për arsye se është tërësisht në harmoni me natyrën, mendjen dhe mençurinë e njeriut".²⁰

Sarojini Naidu

Poete e famshme indiane, për Islamin thotë:

"Islami është feja e parë që predikoi dhe praktikoi demokracinë. Demokracia e Islamit mishërohet pesë herë në ditë, kur në xhami dëgjohet thirrja (ezani) dhe besimtarët grumbullohen për t'u lutur. Fshatari dhe mbreti gjunjëzohen përkrah njëri-tjetrit dhe dëshmojnë: Vetëm All-llahu është më i Madhi. Kam qenë e befasuar gjithnjë, nga ky bashkim i padukshëm, që i vëllazëron njerëzit me njëri-tjetrin".²¹

¹⁹ Muharrem Omerdiq, *Tolstoi për Islamin dhe Muhammedin a.s.*, Rinia Islame, Shkodër, nr. 10, nëntor, 1997, Rexhep 1418, f. 7-9

²⁰ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 148.

²¹ Pamfleti: *A e njihni këtë njeri*.

Në ligjëratën "The ideal of Islam", në "Speeches and Writing of Sarojini Naidu", Madras, 1918, f. 167, ajo thotë: "Me sa kam lexuar në Kur'an, mendoj se ndjenja e drejtësisë është një nga idealet më të mrekullueshme të Islamit. Ato parime dinamike të jetës, nuk janë mistike, por etikë dhe praktikë për sjelljet e përditshme në jetë dhe të përshtatshme për tërë botën".²²

"Një nga veçoritë dalluese dhe më kryesore të fesë së komunikuar dhe të përhapur nga Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], është fakti se ajo është larg çdo fanatizmi. Përkrahësit dhe pasuesit e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] futën nën sundimin e tyre Sicilinë, sunduan për shtatëqind vjet Spanjën e krishterë, por në asnjë kohë nuk i trazuan bashkëqytetarët gjatë ushtrimit të fesë së tyre dhe dogmave të saj. Muslimanët i kanë respektuar të krishterët, pasi libri i tyre (Kur'ani) i mëson që të sillen me butësi ndaj jomuslimanëve. Shërbimi ndaj njerëzimit është vepër me çka krenohet dhe lavdërohet çdo musliman. Islami kultivon dhe ruan bazat themelore të vëllazërimit të gjithmbarshëm të njerëzimit. Kur, njerëzimi ta pranojë këtë parim esencial dhe të veprojë sipas tij, atëherë do ta gëzojë lumturinë".²³

Mahatma Gandhi

"Në ditët e ngadhënjimit të tij, Islami ishte mjaft tolerant, gjë që shkaktoi admirim te të gjithë popujt. Kur në Perëndim sundonte errësira, në horizontin e lindjes, lindi një yll shkëlqyes, i cili shndriti dhe ngushëlloi botën, e cila rënkonte nga mjerimi. Hindusët duhet ta studiojnë Islamin me respekt, dhe atëherë kanë për ta dashur, ashtu si e dua unë".²⁴

²² Pamfleti: *Ç'thonë të tjerët për Islamizmin*.

²³ H. Hoxha, op. cit., f. 118.

²⁴ H. Hoxha, op. cit., f. 124.

Napoleon Bonaparti

Sipas Lakisit, një prej miqve të Napoleonit, në ishullin Sant Helen, tregon se kur Napoleoni jetonte në Egjipt, i mrekulluar pyeste:

“Si kanë mundur këta njerëz (muslimanët) të mposhtin aq shumë vende, duke i mbajtur nën kontroll?” Ky admirim, sipas Lakisit, ishte një nga shkaqet që Napoleoni kishte simpati të madhe për Islamin. N. Bonaparta thoshte: “Mendoj se do ta pranoj Islamin”.²⁵

Ogyst Konti

Pionier i shkollës së pozitivizmit, duke iu përgjigjur Togos, thotë:

“Togo do të kthehet në Islam vetvetiu edhe pse unë nuk e njoh Islamin, por unë flas për atë që e krijoi Islami. Kam vizituar Granadën dhe aty kam parë një art të bukur dhe arkitekturë të mrekullueshme. Prandaj, nuk është e mundur që, një fe, ta bëjë tërë atë që ka bërë Islami, dhe të mos studiohet hollësisht. Islami nuk e mohoi mendjen për asnjë moment, në realitet ai i dha asaj fuqi që të jetë e lirë, të mendojë, të shohë dhe të krijojë artin dhe arkitekturën e bukur. Prandaj, nëse është e domosdoshme që në kohën e sotme të kemi një fe, atëherë ajo fe nuk mund të jetë tjetër, veçse feja islame, sepse është e vetmja fe që i përgjigjet kohës së sotme”.²⁶

²⁵ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 117.

²⁶ Dr. Rushdi Fekkar, *Njeriu nuk ka arsye të jetë kryelartë*, Dituria Islame, Prishtinë, 1993, nr. 47. f. 19.

“Unë nuk pajtohem me ju, sepse ju e sulmoni fenë islame, pa pasur kurrfarë njohurish për të”.²⁷

Kolonel Enxhersal

Amerikan i njohur si afetar, thotë:

“Njëmijë vjet pas lindjes së Krishtit, muslimanët themeluan një shtet të madh, ngritën mësonjëtoje në qytetet mongole e tatave, në Iran, Irak, Siri, Egjipt, në Afrikën e Veriut, në Spanjë, etj. Muslimanët nuk ngritën vetëm mësonjëtoje (medrese), por ngritën edhe qendra vëzhgimesh astronomike, ku zhvilloheshin shkencat natyrore. Ata shpikën dhe bënë të qëndrueshme numrat, studiuat algjebërë, gjeometrinë dhe arritën të zgjidhin probleme të algjebërës së shkallës së tretë. Muslimanët janë treguar mjeshtër në shkencën e të maturit të tokës, kanë vizatuar hartat e yjeve, kanë treguar lëvizjet e tyre dhe i kanë emëruar ata me emra të ndryshëm, emra të cilët i mbajnë edhe sot e kësaj dite. Ata kanë rrëfyer për pjesëtimin e rruzullit tokësor, kanë përshkruar drejtimin e rrugës së Diellit e të Hënës dhe ndryshimin e natës dhe të ditës... Kanë shpikur vegla kimie dhe fizike, kanë përgatitur orë të ndryshme, kanë zbuluar balancuesin e orës, kanë bërë përparime në shkencën e kimisë, kanë operuar me azotin, me eterin, alkoolin dhe, përherë të parë, kanë ngritur spitale në botë.

Muslimanët kanë kuptuar bazat e shkencës, tërheqjen e trupave në natyrë dhe gjithashtu kanë studiuar edhe shkencën hidromekanike. Në optikë, kanë shpikur dhe kanë konstatuar se drita nuk perceptohet nga syri në sende, por nga sendet në sy. Përveç kësaj, muslimanët nga pambuku, lëku-

²⁷ Dr. Rushdi Fekkar, *Ardhmëria e njerëzimit në Islamizëm*, Dituria Islame, Prishtinë, 1995, nr. 73. f. 14.

ra, letra e çeliku, kanë punuar lëndë shumë të vlefshme e dobiprurëse...

Ata, që korrën sukseset e treguara nuk ishin të krishterët, por ishin pikërisht muslimanët, që ngritën universitete, që mbledhën të gjitha dorëshkrimet e veprat e vjetra, që zbuluan ligjet e natyrës dhe tërhoqën vërejtjen e mbarë botës mbi dituritë natyrore... Nuk duhet të harrojmë se, lavdia e vendosjes së themeleve të diturive bashkëkohore, i takon pasuesve të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Për asgjë, prej asaj që përfitojmë sot, nuk i detyrohemi as kishës, as krishterizmit".²⁸

H. G. Wels

Në "Historia e botës", f. 346. thotë:

"Islami është mendimi politik më universal, më i gjallë dhe më i shëndoshë që është realizuar, ndonjëherë, në botë. Ai i ofroi njerëzimit kushte shumë më të mira, se cilido sistem tjetër".²⁹

Z. Skot

Orientalist i shquar, në librin e tij "Historia e mbretërisë së perëndimit në Evropë", përveç të tjerash, shkruan:

"Duhet t'i admirojmë muslimanët dhe fenë e tyre, sepse në çdo qytet që hynë, ata sollën qetësi, siguri, pasuri, begati, paqe dhe lumturi. Ata rrëzuan idhujt e Qabes dhe zhdukën të ligat e trashëguara, gjatë tridhjetë shekujve... Muslimanët themeluan shtete, të cilat rrezatuan drejtësi për shekuj me radhë, ngritën qytete, ku i pajisnin njerëzit me dituri. Ata

²⁸ H. Hoxha, op. cit., f. 120-121.

²⁹ T. Nelaj, *Të huajt, jomuslimanët për Islamizmin, Kur'anin dhe Muhammedin a.s.*, Edukata Islame, Prishtinë, 1971, nr. 3. f. 32.

nxorën dhe përgatitën gjeni, që treguan se mendja njerëzore është pushtetplotë dhe se qëndron mbi gjësendet”.³⁰

Edmund Burke

Politikan i shquar anglez.

“Islami është fe e ndërtuar mbi themele të arsyeshme dhe është dërguar për cilindo, si për sunduesit, ashtu edhe për të varfrit, pra, për të gjithë njerëzit. Një shembull i tillë barazie është e pamundur të gjendet në ndonjë vend apo fe tjetër. Po të hyjmë në sferën e studimit e të vëzhgojmë Kur’anin me imtësi dhe hollësi, do të kuptojmë se sa i plotë dhe i lartë është ai. Herën e parë, Kur’ani e tërheq njeriun si magnet, më pas e mahnit, dhe më vonë nxit tek ai ndjenja respekti, duke e impresionuar thellë”.³¹

Herbert Hobohm (Aman Hobohm)

Intelktual që i ka shërbyer Misionit Diplomatik Gjerman, në pjesë të ndryshme të botës. Ka punuar edhe Atashe kulturor në Ambasadën Gjermane, në Riad. Në vitin 1941 ka pranuar Islamin. Ai ka thënë:

“Kam jetuar në sisteme të ndryshme të jetës dhe kam pasur mundësinë të studioj ideologji të ndryshme, por kam ardhur në përfundim se, asnjë nuk është aq perfekt, sa Islami. Asnjë nga sistemet, nuk ka një kod të plotë të një jete fisnike; vetëm Islami e ka atë dhe kjo është arsyeja pse njerëzit e mirë e pranojnë atë. Islami nuk është (vetëm) teorik, por është (edhe) praktik. Ai do të thotë ‘përrulje’ e plotë, përpara vullnetit të Zotit”.³²

³⁰ H. Hoxha, op. cit., f. 117.

³¹ Ibid, f. 115-116.

³² Pamfleti: *Shpata e Islamit*, botues Rinia dhe Kultura Islame, Tiranë, 1992

Profesor Hurgronje

“Lidhja e Kombeve, e themeluar nga Pejgamberi i Islamit, vendosi principet e unitetit internacional dhe vëllazërimin ndërnjerëzor, në baza kaq universale, saqë shërbeu si fanar ndriçues për kombet e tjera. Është fakt se, asnjë komb në botë, nuk mund të krahasohet me atë që Islami bëri gjatë realizimit të idesë të Lidhjes së Kombeve.

Bota nuk ka hezitur së ngrituri lart hyjni dhe individë, jeta dhe misioni i të cilëve kanë humbur nëpër legjenda. Çdo përpjekje e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], kishte për qëllim vetëm bashkimin e njerëzimit në adhurin e një Zoti të Vetëm. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ose pasuesit e tij, në çdo kohë, kurrë s’kanë pretenduar se kanë qenë pasardhës të Zotit, mishërues të Tij, apo se janë hyjnorë. Ai, përherë, ka qenë dhe e ka konsideruar veten e tij, vetëm si një emisar, i zgjedhur nga Zoti”.³³

Gaston Karr

Orientalist i njohur francez, në vitin 1913, në gazetën *Figaro*, ka shkruar një varg artikujsh mbi çështjet islame. Veç të tjerash, ai shkruan:

“Islami është fe e qindra miliona njerëzve. Sipas të gjithë atyre që e pasojnë, është një fe e cila ofron rrugëzgjdhjen e sigurt për mbarëvajtjen e shoqërisë njerëzore. Kur’ani që është Statusi themelor i kësaj feje moderne, përmban themelet (bazat), ku bota e qytetëruar, sot mbështetet aq fuqishëm, saqë mund të themi se ky qytetërim është formuar, duke u bazuar në rregullat e përhapura prej Islamit. Pikërisht, kjo fe largpamëse, i ka siguruar Evropës burimet e duhura, që

³³ Pamfleti: *A e njihni këtë njeri*.

nevojiten për zhvillimin e shoqërisë njerëzore. Edhe në qoftë se nuk ia njohim këtë cilësi dhe meritë të lartë Islamit, dhe në rast se nuk i detyrohemi, duhet ta pranojmë, pa asnjë dyshim, se kjo është e vërteta”.³⁴

Dr. Moris

Thotë: “Të krishterët e Bizantit, nga rruga pakrye e besimeve të kota në të cilën ishin futur, arriti t’i nxjerrë vetëm zëri që doli dhe u përhap nga shpella Hira e Arabisë Saudite, i cili solli fjalën hyjnore me përsosuri të lartë. Grekët nuk kanë mundur të dëgjojnë këtë zë, që u mësonte njerëzve besimin më të drejtë e më të pastër, një fe të lartë”.³⁵

Gat Frei Hexhins

Dijetar me famë, thotë:

“Në këtë fe, nuk ka ujë të bekuar, apo sende që të bëjnë t’i adhurosh, nuk ka idhuj, apo shenjtorë, nuk ka bindje të tilla të kota, si: Zoti ka nënë (apo bir), pretendime se pendimi është i pranueshëm në çastin kur njeriu jep shpirt, ose se me lutjet përgjëruese të të tjerëve, mund të pastrohen mëkatarët. Të tillat pretendime i kanë nënshtuar ata njerëz, që i kanë pranuar ato, duke i shndërruar ata në skllevër të prijësve të tyre fetarë”.³⁶

³⁴ H. Hoxha, op. cit., f. 122.

³⁵ Ibid, f. 117.

³⁶ Ibid, f. 117.

George Bush

Shkencëtar që ka jetuar para një shekulli, ka thënë:

“Asnjë revolucion në histori nuk ka sjellë aq ndryshime në botën e qytetëruar, sa ato, që rezultuan nga nxitja, përparimi dhe vendosja e Islamit”.³⁷

A. M. Lothrob Stoddard

Autor amerikan, në librin e tij “E sotmja e botës islame” që konsiderohet ndër veprat më të njohura, që ka trajtuar çështjet e botës islame, gjatë gjysmës së parë të shekullit të njëzetë, thotë:

“Ngritja e Islamit është mbase ngjarja më e çuditshme në historinë e njerëzimit. Duke buruar nga një vend dhe nga një popull, më parë fare të papërfillur, Islami, brenda një shekulli, u përhap në mbi gjysmën e rruzullit tokësor, duke zhdukur perandori të mëdha, duke përmbysur religjionet më të vjetra, duke reformuar shpirttrat e njerëzve dhe duke ndërtuar një botë të re - botën islame.

Sa më thellë ta shqyrtojmë këtë zhvillim, aq më i jashtëzakonshëm na duket ai. Religjionet e tjera të mëdha ia kanë hapur rrugën vetes ngadalë, me luftë të dhembshme, për të triumfuar, në fund, me ndihmën e mbretërve të fuqishëm, që patën përqafuar besimin e ri. Krishterizmi pati Konstandinin, Budizmi Asoken, ndërsa Zoroastrizmi Kirin, çdonjëri prej tyre lëshoi mbi religjionin e vet të zgjedhur, fuqinë kolosale të autoritetit profan. Kjo nuk ndodhi me Islamin. Duke lindur në një vend shkretinor, të banuar aty-këtu nga një popull nomad, më parë i pashquar në analet e

³⁷ Robert L. Gulick, Jr., *Muhammedi Edukator*, Stamboll, 1992, f. 6.

njerëzimit, Islami u sul përpara me një mbështetje të paktë njerëzore, kundrejt një superioriteti të madh material. Megjithatë, Islami triumfoi me lehtësi të çuditshme dhe disa gjenerata panë hënën e re të zjarrit, duke dalë fitimtare që nga Pirenejt deri në Himalaje, dhe që nga shkretëtira e Azisë Qendrore deri në shkretëtirat e Afrikës Qendrore”.³⁸

Andru Paterson

Shkrimtar amerikan i konvertuar në Islam, thotë:

“Kjo ka të bëjë me një keqkuptim të thellë të Islamit, sipas të cilit pretendohet se muslimanët adhurojnë pejgamberin Muhammed si një hyjni. Ata e shohin me respekt dhe nderojnë Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] si pejgamberin e fundit të Zotit, por nuk e adhurojnë atë. Në fakt, besimi në Një Zot të Vetëm qëndron në krye të pesë shtyllave të besimit dhe të përkatësisë islame”.³⁹

Dr. Ralf Braimabant

Një studiues dhe autor i njohur amerikan, në librin e vet: “The Nature and Structure of the Islamic World”, f. 76, shprehet:

“Sistemi islam i vlerave shfaqet më i kulluar, më i pacenuar se doktrinat e Krishterizmit, të cilat i referohen në shkallë të madhe mbretërimit të mitit dhe fanatizmit... Islami, në anën tjetër, është në një fazë dinamike dhe drithëruese zhvillimi. Në këtë çast të historisë, dinamikat dhe vlerat e përcaktuara qartë të Islamit kanë mundësinë për të shëruar ‘sëmundjen’ e botës perëndimore. Kjo mund të ndodhë vetëm nëse

³⁸ Pamfleti: *Ç’thonë të tjerët për Islamizmin*.

³⁹ Paul Frindley, *Mjaft me heshtje, përballë imazhit të gabuar të Amerikës mbi Islamin*, korrik, Shkup, 2004, f. 21.

imazhi i projektuar nga Islami në ekranin global dhe veprimet e muslimanëve në skenën botërore janë të përshtatura me parimet islame të paqes, drejtësisë dhe nderimit për jetën”.⁴⁰

William Beikër

Një ish-arkeolog në Lindjen e Mesme dhe profesor amerikan i historisë së lashtësisë, në librin e tij “Më shumë të përbashkëta se ç’mendoni: Ura mes Islamit dhe Krishterizmit”, për Islamin veç tjerash, shkruan:

“Shumë pak të krishterë e dinë se peygamberi Muhammed [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] besonte se Jezusi dhe Mojsiu ishin ndër përcjellësit më të rëndësishëm të shpalljes hyjnore për njerëzimin... Muslimanët e kanë për detyrë të ndjekin shembullin e mirë të përmendur më parë në Bibël... Ashtu siç besojnë të krishterët se Dhiata e Re është plotësim i Dhiatës së Vjetër të Judaizmit, ashtu dhe muslimanët besojnë se Islami dhe Kur’ani janë plotësimi përfundimtar i të dy librave dhe Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është Peygamberi i fundit dhe i Dërguar i Zotit”.⁴¹

Prof. K. S. Ramakrishna Raoi

“Problemi që të shkruaj këtë monografi është më i lehtë për mua, sepse ne në përgjithësi nuk ushqehemi me atë lloj historie të shtrembëruar. Madje, shumë herë, nuk është nevoja të humbet koha për ta keqparaqitur Islamin. Teza e përhapjes së Islamit me shpatë nuk dëgjohet nga qarqe, që ia

⁴⁰ Paul Frindley, op. cit., f. 31-32.

⁴¹ Paul Frindley, op. cit., f. 143-144.

vlen të përmenden. Tashmë dihet parimi islam: *Nuk ka shtrëngim në fe*".⁴²

Dr. Volter Meron

Teolog-peshkop, në predikimin e tij me titull "Rruga më e drejtë për paqe" të mbajtur në kishën e Pitsburgut, duke kritikuar Krishterizmin, për shkak se nuk i ka shërbyer siç duhet paqes, shprehet:

"Feja islame, libri i së cilës është Kur'ani, është fe e paqes, e sigurisë dhe qetësisë. Feja islame, besimtarët e së cilës quhen muslimanë, kërkon që njeriu të jetojë në paqe me Zotin e me njerëzit, në kushtet e qetësisë, të sigurisë dhe të krijojë marrëdhënie të ngrohta e reciproke. Edhe përshëndetja islame tregon paqe e siguri".⁴³

N. N. E. Bray

Në "Shiftin sands", Londër 1937, f. 16, thotë:

"Me themelimin e dispozitës së haxhxit në Mekke, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në të vërtetë, themeloi diçka më tepër se një detyrë të zakonshme fetare. Me këtë, ai mundësoi marrëdhënie të vazhdueshme dhe kontaktimin mes skajeve më të largëta të botës islame. Njeriu primitiv dhe i rëndomtë, prej Afrikës Qendrore këtu (në Qabe), gjatë dispozitave fetare mban një këmishë prej liri. Gjithashtu, edhe princi indian heq rrobat e tij prej mëndafshi dhe vesh po atë këmishë prej liri. Kështu, të gjithë ata janë të barabartë para Zotit. Në Mekke, ata takohen në frymën vëllazërore, e cila është frymë e pastër islame. Aty këmbejnë

⁴² Pamfleti: *Shpata e Islamit*.

⁴³ H. Hoxha, op. cit., f. 118.

mendime dhe kuvendojnë për vendet e tyre të largëta. Kur kthehen në atdheun e tyre, ata priten nga vendasit dhe miqtë e tyre, të cilët nga kureshtja dëshirojnë të dëgjojnë prej tyre, mbi atë që kanë parë dhe kanë përjetuar në Qabe. Edhe propaganda më e organizuar evropiane është e papërfillshme, përballë këtij organizimi gjigand, në bartjen dhe përhapjen e ideve”.⁴⁴

E. A. Powell

Në veprën “Lufta për pushtet në Azinë islamike”, thotë:
“Muslimanët kanë treguar tolerancë të tillë, para së cilës mund të turpërohen shumë popuj jomuslimanë”.⁴⁵

Mosinjor Duchene

Në studimet e tij mbi gjendjen e kishës në shekullit e VII-të në Siri, përmend kallëzimin e Mihailit sirian, i cili e përshkruan vrazhdësinë e egër, nën të cilën ishin të nënshtruar Jakobët, që nuk pranonin kishën unikale të Heraklitit dhe përshkrimin e depërtimit të muslimanëve arabë:

“Zoti hakmarrës, duke parë mizorinë e Romakëve, të cilët kudo sundonin në mënyrë barbare, duke shkretuar kishat tona, manastiret dhe duke na ndëshkuar pa mëshirë, dërgoi nga Jugu djemtë e Ismailit (arabët), që me ndihmën e tyre të na çlirojnë. Kjo ka qenë një fitore e madhe për ne, sepse, më në fund, shpëtuam dhe u çliruam nga tirania e rëndë romake, mizoria, urrejtja dhe nga zilia e tyre e pamëshirshme”.⁴⁶

⁴⁴ L.S.B. *Jomuslimanët për Muhammedin a.s.*, Takvimi, Sarajevë, 1970. f. 105 & 106.

⁴⁵ Dr. Fadlurrahman Ensar, *Personaliteti dhe karakteri i Pejgamberit të Zotit*, Takvimi, Prishtinë, 1993. f. 43.

⁴⁶ Rozhe Garodi, op. cit., f. 8.

K. M. Pannikar

Studiues i njohur indian, duke folur për ndikimin e besimit islam në njëshmërinë e Zotit, në mentalitetin e popullit indian dhe religjionet e tij, në "A Survey of Indian History", f. 132, thotë:

"Është e qartë dhe e konfirmuar se ndikimi i Islamit në religjionin hindus, ka qenë i thellë në këtë periudhë (islame). Ideja e adhurimit të Zotit të hindusët, i është borxh Islamit. Krerët e mendimit dhe të fesë, në këtë shekull, edhe pse i quanin hyjnitë e tyre me emra të ndryshëm, ftuan në adhurimin e Zotit dhe deklaruan se Zoti është Një, se (vetëm) Ai meriton të adhurohet dhe se prej Tij kërkohet shpëtim dhe lumturi. Ky ndikim, u manifestua në religjionet, të cilat u paraqiten në Indi në periudhën islame".⁴⁷

Dr. John Badeau

President i Universitetit Amerikan, në Kajro:

"Xhamia e Ibn Tulunit me thjeshtësinë e saj, është vendi ku dëshiroj t'i lutem Zotit dhe të ndjej në vetvete ndjenjën e afërsisë me Zotin".⁴⁸

Stanword Cobb

Në librin e tij "Zoti i dy Qabeve", f. 227, thotë:

"Më ishte lejuar të prezentoj në kryerjen e namazit në xhaminë Aja Sofia në Stamboll. Përsëritja e sexhdes, lutja dhe përkulja në namaz ka rëndësi të madhe. Gjatë kësaj, shqiptohen fjalë të caktuara në shenjë mirënjohjeje, duke e madhë-

⁴⁷ Ebul Hasen Ali en Nedevijj, *Islami, ndikimi i tij në civilizim dhe merita e tij për njerëzimin*, Shkup, 1421/2000, f. 23.

⁴⁸ Robert L. Gulick, op. cit., f. 82.

ruar All-llahun e Madhërishëm. Isha thellësisht i impresionuar me respektin, modestinë dhe përvuljen e besimtarëve. Kjo tejkalon gjithçka, që kisha shikuar në ndonjë kishë të krishtere, në kuptimin e sinqeritetit, të madhërimit, thellësisë së përjetimit dhe përkushtimit ndaj Zotit. Pas një kohe, kisha nderin që bashkë me disa të huaj të shikoj festimin e Lejletul-Kadrit, natës në të cilën Kur'ani i është shpallur Pejgamberit Muhammed [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Nga ballkoni, në një kënd, shikonim 5.000 besimtarë, të cilët e kishin stërmëbushur hapësirën e xhamisë Aja Sofia, duke kryer namazin e tyre dhe duke rënë përtokë në harmoni, ritëm dhe rend të përsosur. Shushurima me rastin e përkuljes së tyre, apo gjatë rënies në gjunjë, jehona e shuplakave të tyre, që lëshoheshin në dysheme para vetes, ngritja e tyre e përbashkët bënë që valët e qeta dhe të thella të nderimit të tyre, të përmbushin kupolën e gjerë dhe të ngrihet drejt lartësive qiellore. Pamja ishte madhështore, e pakrahasueshme, dinjitoze, përkulëse dhe shprehte kuptimin e lirisë individuale, demokracisë, barazisë, pamje e cila nuk lejonte kurrfarë diskriminimi personal apo klasor.

Aty e kam parë shitësin nomad të qilimave, duke qëndruar krah për krah me pashën në veshje të shkëlqyeshme, edhe atë pa frikë dhe nderime. Qëndronin bashkë, përkuleshin dhe binin në sexhde me përkushtimin më të madh. Kam parë zezakë të trashë dhe të "shëmtuar", duke qëndruar në namaz krah për krah me turqit më elegantë të Stambollit. Kjo ishte kështu, ngase Islami, që nga zanafilla ka përhapur vëllazërinë mes muslimanëve dhe këtë e ka mbajtur deri më sot".⁴⁹

⁴⁹ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 43, 44.

Isak Tajler

Kryetar i kishës anglikane, thotë:

“Feja islame është përhapur nga Marakeshi në Xhavë, nga Zanzibari deri në Kinë. Ajo në Afrikë po përhapet me një shpejtësi marramendëse. Feja islame po paraqitet si feja më e mirë për pastrimin moral të popujve të paqytetëruar dhe për përparimin e tyre. Feja e krishterë nuk e ka atë forcë.

Islami i ka kontribuar qytetërimit njerëzor më shumë se Krishterizmi. Në popujt ku ka depërtuar Islami, janë zhdukur shumë vese barbare, si: adhurimi i idhujve, ngrënia e mishit të njeriut, mbytja e foshnjave të gjalla dhe, në vend të tyre, janë sjellë virtyte të tilla të larta, si: pastërtia, dinjiteti, bujaria, etj.

Mikpritja të muslimanët konsiderohet, madje, si obligim fetar. Me shfaqjen e Islamit, filluan të zhduken veset e dëmshme të shoqërisë njerëzore, si: alkooli, kumari, etj. Islami e ngriti dhe lartësoi nderin e gruas dhe e bëri atë ndër obligimet më të shkëlqyeshme. Kurse sadakanë, të këshilluarit me njëri-tjetrin dhe dashurinë vëllazërore, i bëri prej obligimeve më të rëndësishme”.⁵⁰

W. Montgomery Watt

Në “Islam and Christianity Today” Londër, 1983, f. 9, thotë:

“Unë nuk jam musliman në kuptimin e rëndomtë, edhe pse shpresoj se jam ‘një musliman që i është dorëzuar Zotit’, por mendoj se shprehjet e ngulitura në Kur’an, dhe shprehjet e tjera të vizionit islamik, janë një thesar i madh i së vërtetës

⁵⁰ Ahmed Hamdi, *Mësimet Feje*, Tiranë, 2003, f. 248.

hyjnore, nga të cilat unë dhe oksidentalistët e tjerë mund të mësojmë akoma shumë”.⁵¹

Ignjacin Ulagi

Shkrimtar spanjoll, në librin e tij “Arabët nuk e pushtuan Spanjën”, thotë:

“Është plotësisht e sigurt se arabët, duke u mbështetur (vetëm) në mjetet e luftës, në mjeshtërinë dhe fuqinë ushtarake, s’do t’ia dilnin të bënin gjithë ato pushtime fantastike, dhe me përmasa aq të mëdha. Duhet besuar absolutisht se këto pushtime s’do të kishin mundur të arriheshin me shpatë. Arma më e fortë, në duart e arabëve, ka qenë Islami. Sukseset e arabëve janë arritur falë forcës së ideve të reja, besimit të ri, të cilin e bartnin ata, të cilat i përvetësonin dhe i bënin për vete njerëzit dhe popujt e tjerë. Në të vërtetë ata i ka pushtuar Islami, e jo arabët.

Islami, në Spanjë, përfaqësonte forcën gjeneruese, e cila i inspironte të gjithë njerëzit dhe i nxiste në aktivitete krijuese. Islami e ripërtëriu shoqërinë vendore, e liroi atë nga anarkia dhe prapambetja, duke e çuar drejt një bote më të mirë, botës të përparimit, kulturës, të drejtës sociale dhe humanizmit. Në kushte të këtilla, në truallin spanjoll, lindën forcat e reja krijuese, të cilat Islamin e konsideronin pjesë të pandashme të kulturës së tyre personale”.⁵²

Dr. Lendon Haris

Njëri prej misionarëve më të njohur në Afrikë, nga anglezi i mençur dr. Samuel Xhonson, citon këto fjalë:

⁵¹ Ç’thonë të tjerët për Islamin, Dituria islame, Prishtinë, 1991, nr. 22-23, f. 19. Pamfleti: Ç’thonë të tjerët për Islamizmin.

⁵² Shih: Glasnik, Sarajevë, nr. 9-10, shtator-tetor, 1970. f. 498.

“Vërtet Krishterizmi dhe Islami, në botën e besimit, janë dy fe që meritojnë respekt. Ndërkaq, çdo gjë, përveç këtyre dyjave, është barbarizëm”.⁵³

J. S. Schacht

Ka lindur në vitin 1902. Ka ligjëruar në shumë universitete gjermane, në universitetin e Oksfordit, të Lejdenit dhe të Kolumbisë. Është zgjedhur anëtar në shumë universitete dhe akademi botërore. Ka shkruar një numër librash për Islamin. Ai thotë:

“Ligji fetar i cili quhet Sheriat, është trashëgimia më e rëndësishme, që Islami i ka lënë botës. Sheriati islam dallon në mënyrë të qartë nga të gjitha format e ligjit. Është i domosdoshëm studimi i tij, në mënyrë që të mund të vlerësojmë fushëveprimin e tij të plotë, në mënyrë të mjaftueshme, të çështjeve ligjore. Sheriati islam është unik, ai është përmbledhje e urdhrave hyjnorë, që rregullojnë jetën e çdo muslimani, duke përfshirë të gjitha aspektet e jetës. Ai përmban dispozita të veçanta, që kanë të bëjnë me adhurimet (ibadetet) dhe ceremonitë fetare, ka edhe dispozita politike dhe ligjore.

Legjislacioni islam konsiderohet i përkryer, karakteri i tij është i veçantë, gjë që i jep të drejtën të quhet legjislacion fetar”.⁵⁴

Abdullah A. Hamilton

Politikan i njohur anglez. Më parë quhej Sir Carlz Eduard. Në vitin 1932 pranoi Islamin. Ai thotë:

⁵³ Dr. Imadudin Halil, *Kalu anil Islam*, Riad, 1412/1992. f. 248.

⁵⁴ Ibid, f. 203.

“Bukuria e Islamit, thjeshtësia dhe pastërtia e tij, më kanë tërhequr vazhdimisht, qysh nga koha e pjekurisë. Islami është fe progresive, e jo degresive. Nëse një njeri posedon tokë, dhe ai ka pasuri të caktuar dhe e ka lënë këtë tokë pa e punuar dhe nuk ka nevojë për të, nëse kalon një kohë e caktuar në këtë gjendje, pronësia e saj transferohet në mënyrë të natyrshme në pronë të përgjithshme. E drejta islame thekson se, pronësia e asaj toke kalon te dora e njeriut të parë, i cili e mbjell atë. Islami e udhëzon njeriun praktikisht në jetën e tij të përditshme, ndërkaq i ashtuquajturit krishterim bashkëkohor, i mëson ithtarët e vet tërthorazi rreth realitetit dhe që t’i luten Zotit vetëm të dielën, ndërkaq ditëve të tjera të javës, ata sillen në mënyrë të shfrenuar”.⁵⁵

J. Lal Nehro

Politikan nga India, thotë:

“Islami ishte gjeneratori dhe mendimi i zgjimit arab, i cili solli tek ithtarët e vet vetëbesim dhe kreativitet. Vetëbesimi dhe besimi i arabëve ishin dy gjëra të madhërishme. Islami atyre u solli edhe mesazhin e vëllazërimit, barazisë dhe drejtësisë në mes të gjithëve. Kështu në botë lindi parimi i ri demokratik. Krahësimi, mes mesazhit islam për vëllazërim dhe gjendjes së mjerueshme të Krishterizmit, na bënë të kuptojmë shkallën magjike të këtij mesazhi dhe të ndikimit të tij, jo vetëm mes arabëve, por edhe te të gjithë popujt, në vendet e të cilëve kanë hyrë arabët. Feja me të cilën ka përgëzuar Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e cila shquhet për lehtësi, qartësi, vëllazërim dhe barazi, gjeti përgjigje nga njerëzit e vendeve fqinje, sepse ata kishin përjetuar zullumin nga mbretërit autokratë dhe priftërinjtë

⁵⁵ Ibid, f. 249.

skllavërues. Njerëzit ishin lodhur nga sistemi i vjetër dhe kërkonin rrugëdalje në një sistem të ri, prandaj Islami ishte një rast i artë për ta, i cili ua përmirësoi atyre gjendjen dhe u largoi ankthin e shtypjes dhe padrejtësisë”.⁵⁶

Ludovik Dukstason

“Populli i Indisë, s’mund të ngrejë një qeveri të pavarur, pa larguar dhe evituar kontradiktat që janë pasojë e ndryshimeve fetare, nacionale dhe fisnore. Për të arritur këtë, këtij populli i duhet të shuajë grindjet dhe të pranojë parimet e barazisë, vëllazërimit dhe lirisë, parime këto, të cilat i predikon vetëm Islami”.⁵⁷

Dr. Laura Vecia Vaglieri

Orientaliste e famshme italiane, në “Apologia dell islamismo”, për Islamin, thotë:

“Në sajë të fesë islame, paganizmi, me të gjitha format e tij, u mposht. Vizioni i kozmosit, dispozitat fetare dhe traditat e jetës shoqërore, qenë liruar nga të gjitha lajthitjet, të cilat ishin degraduese, kurse mendimi njerëzor u lirua nga paragjykimet. Njeriu, më në fund, u bë i vetëdijshëm për identitetin e vet. Kështu, ai i përulë vetëm Krijuesit dhe Sunduesit të mbarë njerëzimit. Shpirti i tij u çlirua nga skllavëria. Vullneti njerëzor u lirua nga varësia ndaj vullnetit të njerëzve të tjerë, ose fuqive të tjera të ashtuquajtura misterioze. Priftërinjtë, mbrojtësit e rremë të mistereve, ndërmjetësuesit e ‘shpëtimit’, të gjithë ata, të cilët dëshironin të merrnin rolin e ndërmjetësuesit midis Zotit dhe njeriut, ata të cilët preten-

⁵⁶ Ibid, f. 248.

⁵⁷ Ahmed Hamdi, op. cit., f. 247.

donin se kanë pushtet mbi vullnetin e njerëzve, që të gjithë këta (mashtues) u rrëzuan nga piedestalet e tyre. Njeriu u bë vetëm shërbëtor i Zotit, kurse ndaj të tjerëve sillet sikurse i barabarti ndaj të barabartit. Më parë, njeriu vuante për shkak të dallimeve jo të drejta sociale. Islami simbolizon barazinë në mes njerëzve. Muslimani dallohet nga muslimani tjetër, jo prej prejardhjes së tij apo shkallës shoqërore, por vetëm prej shkallës së devotshmërisë, veprave të mira, moralit dhe cilësive intelektuale⁵⁸.

⁵⁸ Ulfe Aziz-us-Samed, *Islami dhe Krishterizmi*, Prizren, 1412/1992, f. 52.

Dr. Gustav Lebon

Mjek dhe historian francez, ka lindur në vitin 1841. Në librin e tij "Civilizimi arab", thotë:

"Parimi i barazisë, që është proklamuar në Evropë, ishte deklarativ e nuk ishte faktik, ndërkaq ai ishte i ngulitur thellë në natyrën e njerëzve të Lindjes... Muslimanët nuk njohin klasa sociale, ekzistenca e të cilave ka nxitur dhe akoma vazhdon të nxisë, revolucionet më të vrullshme në Perëndim. Në Lindje, ndërkaq, s'është fare vështirë të takosh shërbëtorin për bashkëshort të vajzës së padronit të tij ose gatin si udhëheqës me famë".⁵⁹

"Parimet morale në Kur'an janë shumë të larta, me to nuk mund të krahasohen parimet e të gjithë librave të mëparshëm fetarë... Ajo që është me rëndësi të rezytojme, është fakti i ndikimit të Islamit te popujt, të cilët i janë përgjigjur dispozitave të tij. Fetë, të cilat kanë ndikuar në shpirtrat e njerëzve, sikurse ka ndikuar Islami, janë të pakta. Nuk mund të gjejmë fe, e cila ia doli ashtu sikurse ia doli Islami, me ndikimin e tij të vazhdueshëm... Kur'ani është libër i legjislaturës, fesë, politikës dhe rregullave sociale. Dispozitat e tij zbatohen që prej dhjetë (e më shumë) shekujsh".⁶⁰

Ilse Lichtenstadter

Studiuese gjermane, ka studiuar shkencat islame dhe shkencat e gjuhës arabe, thotë:

"Muslimani bashkëkohor beson se Libri i tij i shpallur e lejon, madje e obligon atë, që t'i zgjidhë problemet e kohës në pajtim me fenë e tij. Kjo bindje nuk e pengon atë dhe as

⁵⁹ Dr. Jusuf el Kardavi, *Islamsko Pravo*, Sarajevë, 1989, f. 49.

⁶⁰ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 33.

nuk ia zvogëlon kureshtjen për njohjen e të arriturave të shkencës bashkëkohore. Sipas bindjes së muslimanit, veçoria e Kur'anit qëndron në faktin se ai konsiderohet si plotësues i librave të mëparshëm qiellorë, se pajtohet me ta në bazat e besimit, ndërkaq ndryshon prej tyre në cilësimin e përgjithshëm. Mesazhi i tij s'ka të bëjë me një kohë të caktuar, gjë që do të zhvleftësohej me kalimin e kohës, dhe as me një popull të caktuar, që do t'i përshtatej vetëm një populli, e jo edhe popujve të tjerë. Prej tij kërkohet që të jetë (çfarë është) i përhershëm, për çdo kohë dhe për çdo brez".⁶¹

Kardinali Quenge

Kryepeshkop austriak, thotë:

"Kurani fisnik na flet për njeriun dhe përpjekjet e tij për të arritur te Krijuesi, në këto vargje të qarta: *"Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon All-llahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhapë në te nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës, (në të gjitha këto), për një popull që ka mend ka argumente"*. (El-Bekare: 164)

Historia e religjionit në përgjithësi, kurse ajo e monoteizmit në veçanti, na tregon se vetëm besimi në një Zot është përgjigja e kënaqur për çdo pyetje, që ka të bëjë me origjinën e universit, krijimit dhe qëllimit të tyre. Jeta e njeriut s'mund të ketë për qëllim veçse Zotin e Vetëm. Religjioziteti i çdo njeriu të vetëdijshëm ose jo, burimin e ka te besimi në Zotin Një.

⁶¹ Ibid, f. 87.

Kishte monoteizëm, kur u shfaq Kur'ani. Ai monoteizmin e mori si rrugë për ithtarët e tij besimtarë. S'ka dyshim se, Gazaliu ka të drejtë, kur pohon se besimi vetëm në një Zot është qëllimi më i lartë i Kur'anit të Shenjtë.

Le ta themi hapur se monoteizmi është armik për secilin, i cili jetën e kësaj bote e shpall si normë për veten e tij. Kjo është një e vërtetë, e cila na skicon kufijtë e përgjegjësisë sonë. Preokupimi ynë, në këto ditë të vështira, është që ne t'i ndihmojmë njerëzit që t'i përgjigjen thirrjes së Zotit, që jetën e tyre ta sistemojnë sipas urdhrit dhe vullnetit të Tij. Kjo thirrje është përgjigje ndaj thirrjes së natyrshme (siç e quajnë muslimanët), e cila është e ngulitur në zemrën e çdo njeriu dhe është esenca e besimit në Zotin e Vërtetë dhe të Qartë. Ne, kështu, mbase bëjmë një hap vendimtar në vendosjen e monoteizmit mes njerëzve".⁶²

Volfred Cantwel Smith

Profesor i studimeve islame në Universitetin e Montrealit, ka shkruar disa libra për Islamin, më i njohuri ndër të cilët është "Islami në kohën bashkëkohore". Ai thotë:

"S'ka asnjë fe, e cila ithtarëve të saj i ka shpallur ndjenjën e krenarisë, sikurse ndjenja e cila e kaplon muslimanin, pa e ngarkuar atë artificialisht. Krenaria e muslimanit për fenë e tij është veti që haset te të gjithë muslimanët, pavarësisht nga nacionaliteti ose gjuha. Ndjenja e të qenit mirënjohës për përkatësinë e tyre islame, është një gjë, që haset te të gjithë muslimanët.

Perëndimi nuk do të arrijë ta kuptojë Islamin në mënyrë të drejtë, nëse nuk ia del të kuptojë se Islami është program jete, i cili ndikon në jetën e jashtme dhe të brendshme të

⁶² Ibid, f. 227-228.

besimtarit. Islami nuk përbëhet nga ide dhe bindje, për të cilat besimtari ose polemizon me mendjen e tij, ose i pranon ato në mënyrë të padiskutueshme. Mendimi nuk sjell dobi, nëse nuk shoqërohet me zhvillimin e jetës në shoqërinë islame dhe me përparimin e saj të jashtëm dhe të brendshëm”.⁶³

Dominik Sourdel

I cili është marrë me korrektimin e shumë librave arabe, thotë:

“Islami është feja monoteiste, me të cilën Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i biri i Abdullahut, e sihariqoi Gadishullin Persik, në shekullin e VII-të. Më pas, gjatë shekujve, Islami u përhap në të gjitha anët e globit. Muslimanët e besojnë këtë fe. Civilizimi islam është rezultat i kësaj feje.

All-llahu është Një, i Amshueshëm, askush s’është si Ai, është i Gjithëfuqishëm në çdo gjë... Kur’ani, e vërteton këtë monoteizëm, në shumë ajete, por më së qarti kjo shfaqet në suren 112, e cila është shumë e njohur dhe që konsiderohet ndër suret e para:

“Thuaj: Ai, All-llahu është Një! All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s’ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë”. (El-Ihlas: 1-4)

Besimi në Zotin Një është ai që, sipas muslimanëve, e dallon fenë islame rrënjësisht nga të gjitha fetë e tjera dhe nga Krishterizmi, i cili, besimin e tij në Trinitet, e sheh të pandashëm nga monoteizmi, duke e ngatërruar atë me elemente idhujtarie.

⁶³ Ibid, f. 198.

Nuk mund të mohohet fakti se, Islami ka kultivuar vlera të mirëfillta, veçanërisht norma morale me vlerë, sidomos në ato shoqëri që i janë përgjigjur thirrjes islame. Këto vlera, i gjejmë në urdhëresat që janë vazhdueshmëri e devotshmërisë, sikurse e përcakton ajeti kur'anor: *“Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t'i ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, Ditës së Gjykimit, engjëjve, librit, peygamberëve dhe pasurinë që e do ua jep të afërmeve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirim të robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zekatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit”*. (El-Bekare: 177)

Ndihma, mikpritja, fisnikëria, përmbushja e premtimit me individët e bashkësisë, drejtësia me të panjohurit dhe bindja e thellë, janë vlerat me të cilat veçohen muslimanët edhe sot e kësaj dite”.⁶⁴

G. E. Von Grunebaum

Është me origjinë austriake. Ka diplomuar në universitetin e Vjenës dhe të Berlinit. Ka ligjëruar në Universitetin e Çikagos, të Nju Jorkut dhe të Kalifornisë, më pas u bë kryetar për studime të Lindjes së Afërt në këtë Universitet. Ai thotë:

“Islami e bëri përgjegjës individin rreth së ardhmes së tij, për botën tjetër. Ai e avancoi përgjegjësinë individuale dhe morale dhe, në këtë drejtim, ai ka shkuar dukshëm përpara. Islami i ka dhënë rëndësi të veçantë çdo momenti të jetës së besimtarit...

Islami, me pohimin e tij se, çdo bashkësi patjetër duhet të zbatojë disa obligime bazë, të domosdoshme, kërkon nga

⁶⁴ Ibid, f. 198-199.

çdo individ musliman, domosdoshmërinë e rregullimit politik. Ndërsa arabët e injorancës mendonin në kuadër të familjes ose fisit, ndërkaq, muslimani, fillon të mendojë sipas të kuptuarit shoqëroro-politik, të mbështetur mbi bazën e besimit, prandaj qe caktuar që në fund të dominojë në botë. Njerëzit, nuk ndaheshin më në fise të ndryshme, por në njerëz besimtarë dhe jobesimtarë, dhe qe e nevojshme që kjo ndarje të vazhdojë madje edhe pas vdekjes.

Hendeku ekzistues, në civilizimin tonë perëndimor, në mes fushës politike dhe fetare, nuk gjendet assesi në një përmasë të tillë në Islam”.⁶⁵

Edvin Carvelery

Ka diplomuar në Universitetin Briston në SHBA. Ka shkruar disa libra për Islamin, mes tjerash, ai thotë:

“Shumë njerëz, nën ndikimin e trashëgimisë së tyre kulturore, gjendjes shoqërore dhe formimit të tyre arsimor, bëjnë ndarjen e fesë nga shteti. Protestantët perëndimorë, këtë çështje e konsiderojnë të padiskutueshme. Mirëpo, në realitet, kjo ndarje ndërmjet fesë dhe shtetit, është gjë e re për Kristianizmin dhe është shpikur nga shkolla të pakta. Islami, ose ndonjë fe tjetër botërore, nuk e ka njohur ndonjëherë këtë ndarje.

Le të sjellim, si shembull të një studimi të drejtë, artikullin që ka shkruar prof. Arthur Jefery, në revistën ‘Bota islame’, në janar të vitit 1940, ku flet për njërën nga përkthimet e Kur’anit në gjuhën angleze. Ai ka pranuar, në mënyrë të qartë, vlerat e shkëlqyeshme shpirtërore të fesë, së cilës ai nuk i përkiste”.⁶⁶

⁶⁵ Ibid, f. 220-221.

⁶⁶ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 216.

L. Lavta

“Islami e pranon njeriun ashtu siç është dhe përpiqet t’i drejtojë sjelljet e tij, pa pretendime që ta bëjë të mbina-tyrshëm”.⁶⁷

⁶⁷ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit. f. 42.

Prof. Bernard Luis

“Feja islame, ia doli aty ku Krishterizmi dështoi. Ajo arriti të predikojë besimin e thellë të shoqëruar me tolerancë fetare, e cila shprehet ndaj pjesëtarëve të religjioneve të tjera si edhe ndaj heretikëve dhe mosbesimtarëve. Ekzistimi i një numri të madh shkollash ideore, në rrafshin e shpjegimit dhe aplikimit të Sheriatit është argument tjetër i tolerancës dhe justifikimit logjik islam. Feja islame, për nga prizmi shoqëror, ka qenë gjithmonë demokratike ose, thënë më mirë, më e drejtë...”

Edhe përkundër tendencave të disa shteteve islame që të formojnë klasë aristokrate, ideja për barazinë, në asnjë periudhë kohore, nuk është çrrënjësuar nga shoqëria islame. Botëkuptimi islam e favorizon dominimin e ligjit dhe domosdoshmërinë e nënshtrimit të udhëheqësit (sundimtarit) ndaj ligjit.

Vendosmëria dhe forca e shkencëtarëve në periudhën osmane, ka bërë që të respektohet ky parim islam⁶⁸.

George Marcy

Orientalist francez, ka shkruar shumë studime për të drejtën islame dhe gjuhën arabe:

“Haxhxi, i cili është obligim për çdo musliman që mund ta marrë atë rrugë një herë në jetë, nuk është më me pak rëndësi, sa edhe këmbimi i mallrave dhe lidhja e pjesëve më të largëta të botës islame. Namazi është adhurim dhe nënshtrim i njeriut ndaj Krijuesit, pesë herë në ditë, i cili e zbaton atë në kohë të caktuar, pasi të jetë pastruar, duke u drejtuar kah Mekka, në drejtim Qabes. Besimtari, duke falur namazin, bën lëvizjet e sexhdes dhe të rukusë, që janë të përcak-

⁶⁸ Dr. Jusuf el Kardavi, op. cit., f. 50.

tuara saktësisht. Namazi bashkërisht është i pëlqyeshëm, por ai mund të falet edhe vetëm në çdo vend, me kusht që të bëhet larg çdo papastërtie, dhe në tokë të pastër. Namazi i përbashkët falet në xhami. Xhamia, në esencë, është shtëpia e namazit dhe është projektuar në atë mënyrë që të jetë e denjë për adhurim. Në namaz, njerëzit qëndrojnë njëri përkrah tjetrit, duke formuar kështu një front të gjerë, të radhitur rresht pas rreshti, të cilët i udhëheq imami i drejtuar me fytyrë kah Kibla. Edhe xhemati bën të njëjtat lëvizje, ashtu sikurse imami, duke u lutur si lutet ai, të drejtuar kah Qabja, qendra e Islamit dhe shtëpia (e parë) e Zotit në Tokë.

Islami është monoteizëm absolut, s'ka Zot tjetër përveç Allahut. Mësimet e Pejgamberit, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], janë shfaqur si sfidë e fortë kundër zotave të rrejtshëm: idhujve të cilët i madhëronin arabët, idhujtarisë greke, romake dhe trinitetit, të cilit i besojnë të krishterët. All-llahu nuk ka shok, Ai s'ka lindur dhe s'është i lindur, asgjë s'mund të krahasohet me Të. Përderisa, Kur'ani në mënyrë të përmbledhur e ka ndaluar adhurimin e idhujve, hadithet janë zgjeruar në këtë drejtim, dhe ky ndalim u ruajt fuqishëm dhe nuk u sfidua edhe gjatë zbukurimit të faltoreve dhe vendeve ku adhurohet. Kjo ka ndikuar në zhvillimin e artit islam në tërësi. Islami ka ndikuar në jetën e përditshme, madje edhe atëherë kur arti është përdorur për çështje shekulare. Në vendet islame, arti mbeti art islam".⁶⁹

J. K. Birge

Profesor në Universitetin e Ledenit. I ka kushtuar kujdes të veçantë misticizmit në Islam, dhe ka shkruar shumë studime për Xhelaludin Rumiun dhe të tjerë. Ai thotë:

⁶⁹ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 242.

“S’ka nevojë që të zgjerohemi aq shumë, për të theksuar specifikat e Islamit dhe ndryshimin e madh në mes Islamit dhe Hinduizmit. Sistemi i fraksioneve, që gjendet në Hinduizëm, s’ka kurrfarë gjurme në Islam. Kjo është fe tolerante, i cila fuqinë e vet e ka nxjerrë nga masat e gjera dhe dashuria e tyre ndaj Islamit. Islami ia doli ta bëjë vendin e vet në zemrat e njerëzve, ithtarët e tij krenohen gjithnjë me të, në të nuk ka kler, i cili e mbikëqyr jetën fetare. Divergjenca e mendimtarëve rreth një çështje, konsiderohet mëshirë e Zotit. Ky qëndrim i dijetarëve muslimanë tërheq vëmendjen tonë në të ekzistuarit e mirëkuptimit, tolerancës dhe argumenton domosdoshmërinë e kompaktësisë në mes muslimanëve, duke hedhur poshtë mundësinë e klerit, i cili do t’ua impononte njerëzve mendimin e vet.

Ndikimi i haxhxit, i cili është i obligueshëm për çdo musliman, që mund ta marrë këtë rrugë, një herë në jetë dhe ndikimi i gjuhës arabe në përpjekjet e tyre për bashkimin dhe unifikimin e metodave të arsimit në gjithë botën islame, ka bërë që ideja e mendimit unik të jetë e gjallë, madje të zë vendin e parë, edhe pas shpartallimit të Hilafetit në principata të ndryshme”.⁷⁰

Annemarie Schimmel

Studiuese e njohur gjermane, thotë:

“Islami është shembull tipik i interpretimeve të gabuara. Pikërisht, ashtu sikurse artistët e shekullit të XIX-të, që dëshironin të jepnin fotografinë e muslimanëve (muhamedanë nuk është term korrekt) si luftëtarë mizorë me shpatë në dorë, apo në skenat e nxehta të haremeve, ashtu edhe sot, fjala islam në mënyrë frekuentuese nxit pamjen e dijetarëve mizorë. Fotografitë dhe idetë e këtij lloji janë bazuar mbi

⁷⁰ Ibid, f. 159.

interpretime të gabueshme, të cilat mund të korrighohen nga ata, që kanë studiuar kulturën islame, apo kanë jetuar në mesin e muslimanëve. Islami, si i ardhur pas Krishterizmit, nga të krishterët mesjetarë është shikuar si herezi...

Shtimi befasues i bashkësisë muslimane arriti suksese të shumta duke u shkaktuar frikë perëndimorëve, nga superioriteti politik dhe ushtarak i muslimanëve. Në vitin 711, muslimanët në Perëndim kaluan Ngushticën e Gjibraltarit, duke i vënë themelet kulturës grandioze "maure" të Andaluzisë (Spanjës)... Njëkohësisht Spanja u bë stacion relejik ndërmjet Evropës dhe botës islame, e shprehjet e shumta shkencore, medicinale, astronomike dhe kulturore, sot dëshmojnë për ndikimin sofistik të kulturës muslimane andaluziane ku të krishterët, çifutët dhe muslimanët jetonin njëri pranë tjetrit, në harmoni dhe kuptim të ndërsjellë, dije e cila asnjëherë më nuk është parë... Por, është tragjike, tendenca që Islami bashkëkohor të identifikohet me terrorizmin apo fundamentalizmin (term i cili është marrë prej historisë amerikane të religjionit), edhe pse deri në një masë është e kuptueshme, meqenëse bëhet fjalë për ato manifestime të fesë që janë të huaja për të kuptuarit tonë fetar, i cili gjithmonë tërheq vëmendjen më të lartë, ngaqë grupet e moderuara, asnjëherë nuk kanë profile të larta. A e identifikojmë Krishterizmin me terrorizmin, kur dëgjojmë për sulme në qytete të ndryshme të Evropës? Ngandonjëherë, më duket se frika nga turqit, të cilët në dy raste patën arritur deri në Vjenë (1529 dhe 1683), edhe më tej jeton nën sipërfaqe, në Evropën Qendrore, duke formësuar shikimet e shumë njerëzve në fenë e turqve, arabëve, persianëve dhe muslimanëve të botës indo-indoneziane. Madje, edhe njerëzit e arsimuar dinë shumë pak për literaturën dhe artin islam, e rrallëherë flasin se Alhambra në Granadë dhe Taxh Mahalli në Indi, janë vepra të arkitekturës islame. E sa njerëz e dinë

se Islami flet me respekt të madh për Jezusin (Isain [alejhis-selam]) dhe nënën e tij të virgjër? Jezusi konsiderohet si i Dërguari, që i ka paraprirë Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe si njeri që publikisht ka predikuar dashuri dhe asketizëm, se ai nuk është kryqëzuar, por se është ngritur në qiell”.⁷¹

“Lexuesi do ta gjejë Islamin, të cilin shumë perëndimorë e shohin si të vjetruar, i prezentuar (autorja e ka fjalën për librin “Islami si alternativë”, të dr. Murad Hofmann) si fe përplot jetë, produktivitet dhe jetesë dinjitoze. Në fund, nuk duhet të harrojmë thënien e Goethes, prej Divanit Lindje-Perëndim, vepër që dëshmon sharmin e thellë të tij në botën shpirtërore të Islamit:

‘Nëse Islami është nënshtrim ndaj Vullnetit të Zotit, atëherë të gjithë jetojmë dhe vdesim në Islam’.⁷²

Dr. Hugo Marcus Ph. D.

Thotë: “Ndër të gjitha fetë, Islami qëndron më lart nga aspekti i arsytimit, sepse ai nuk kërkon gjëra, që nuk janë në përputhje me mendjen e shëndoshë të njeriut. Ai proklamonte se të gjitha mësimet e tij, vetvetiu ndjekin arsyen.

Në Islam, historia gjithkund zë vendin e dytë për të provuar të vërtetat e pavdekshme, dhe krejt në kundërshtim me fetë e tjera, ai shkon paralel me shkencën dhe intelektin. Prandaj Islami u jep fare pak rëndësi dogmave, kurse studiuesve të tij, u lë të lirë fushën e lirisë mendore. Kundërshtimi i rreptë

⁷¹ Dr. Murad Hofmann, *Islami si alternativë*, Shkup, 1421/2000, shih parathënien e shkruar nga Annemarie Schimmel, f. 5-12.

⁷² Dr. Murad Hofmann, op. cit., f. 12.

ndërmjet besimit dhe diturisë, që e ndan jetën shpirtërore të Evropës, në Islam nuk ekziston”.⁷³

Arthur Leonard

“Islami, në realitet realizoi një detyrë të madhe. La gjurmë të pashlyera në faqet e historisë, që mund të vlerësohen plotësisht vetëm gradualisht me zhvillimin e botës”.⁷⁴

Hilary Rodham Clinton

Bashkëshortja e ish-presidentit Bill Clinton, ka thënë:
“Islami është religjioni me përhapje më të shpejtë në Amerikë”.⁷⁵

Geraldine Baum

Shkrimtare religjioni në *Newsday*, shkruan:
“Islami është religjioni që më së shpejti përhapet në vendin tonë (Amerikë)”.⁷⁶

Ari L. Golman

“Islami është religjioni me përhapje më të shpejtë në Shtetet e Bashkuara”.⁷⁷

⁷³ *Islami dhe filozofia islame*, Rinia Islame, Shkodër, nr. 12, janar, 1998-Ramazan 1418, f. 4.

⁷⁴ Mevdudi, *Të kuptuarit e drejt të Islamit*, Shkup, 1999/1420, f. 54.

⁷⁵ *Udhërrëfyes i shkurtër i Islamit*, Prishtinë, 2000/1421, f. 48.

⁷⁶ Ibid, f. 48.

⁷⁷ Ibid, f. 48.

Usa Today

The Population Reference Bureau:

“Muslimanët janë grupi me përhapje më të shpejtë”.⁷⁸

D. Grenless

“Vë në dukje veçmas tolerancën e madhe të Islamit, i cili thekson se të gjitha fetë kanë lindur me shpalljet e njëpasnjëshme nga Një Zot, me parime të njëjta, në pajtim me hapësirën dhe kohën ekzistuese...”⁷⁹

⁷⁸ Ibid, f. 48.

⁷⁹ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 41-42.

Dikastri

“Për shkak të ngritjes së dinjitetit njerëzor, Islami arriti të bëjë për vete një shumicë të madhe njerëzish. Ky dinjitet njerëzor u lartësua nëpërmjet të përmendurit të Zotit, pesë herë në ditë dhe me ndalimin e gjërave (të dëmshme) që njeriu i dëshiron për vete. Ndër faktorët kryesorë, që mundësuan përhapjen e fesë islame, është shpjegimi i saj në mënyrë të qartë, të drejtë dhe të hapur që i bëhet njerëzve. Kjo fe është e natyrshme dhe e zhveshur prej çdo misterit”.⁸⁰

⁸⁰ Ahmed Hamdi, op. cit., f. 247.

KAPITULLI II

PËR KUR'ANIN

Johan Wolfgang von Goethe (Gëte)

Për Kur'anin thotë:

“Qoftë e lavdëruar nata e bekuar, në të cilën, Pejgamberit të Zotit, iu shpall, nga lart, Kur'ani, me përsosurinë e tij”.⁸¹

“Sa herë që ne i drejtohem Kur'anit, në fillim nuk na tërheq, por ai gjithnjë bëhet edhe më shumë tërheqës, na mallëngjen dhe në fund na detyron ta nderojmë... Stili i tij, në pajtim me kontekstin dhe qëllimin e tij, është i rreptë, madhështor dhe i mrekullueshëm, gjithnjë i lartësuar. Kështu, ky libër, do të ushtrojë ndikim shumë të fuqishëm, gjatë kohës”.⁸²

“Kur'ani i tij duhet parë si Ligj Hyjnor dhe jo si ndonjë libër njerëzor, i bërë për edukim apo për argëtim”.⁸³

“Ndoshta, në asnjë gjuhë tjetër shpirti, fjala dhe shkrimi nuk mund të trupëzohen në mënyrë kaq origjinale”.⁸⁴

“Askush nuk duhet të habitet me efikasitetin e lartë të Librit. Për këtë, ai është cilësuar si jo i krijuar dhe i përjetshëm, (si fjalë) e Zotit nga ana e admiruesve të vërtetë të tij”.⁸⁵

⁸¹ Dr. Katarina Mommsen, *Qëndrimi i Gëtes ndaj Islamit*, Glasnik, Sarajevë, nr. 7-8, qershor-korrik, 1968, f. 324.

⁸² Pamfleti: *Ç'thonë të tjerët për Kur'anin*.

⁸³ West-Ostlichen Diwan, WA, I, 7, 32, shih: Shejh Abdulkadir Al Murabit, op. cit., f. 23.

⁸⁴ Gëte ndjeu një dëshirë të madhe për të mësuar arabishten. Ai kopjoi vetë tekste të shkurta lutjesh dhe shkroi këto fjalë. Letër për Schlosser-in, 23. 1. 1815, WA IV, 25, 165, ibid, f. 10.

⁸⁵ West-Ostlicher Divan (WA 17. 35/36), Shejh Abdulkadir Al Murabit, op. cit., f. 11.

“Kështu, pra, do të mbetet ky libër, përjetësisht, me efikasitetin më të lartë”.⁸⁶

“Nëse Kur’ani është nga përjetësia?

Për këtë unë nuk pyes!...

Që ai është Libri i librave

Të besoj është detyrë e muslimanit”.⁸⁷

“Shumë prej zonjave tona fetare kërkuar në bibliotekë përkthimin e Kur’anit”.⁸⁸

“Prandaj është e vërtetë ajo, që Zoti thotë në Kur’an: Nuk i kemi dërguar asnjë populli pejgamber, përveçse në gjuhën e tij”.⁸⁹

“Kur’ani thotë: Zoti i ka dërguar çdo populli nga një pejgamber në gjuhën e tij”.⁹⁰

A. S. Pushkin

Poeti i madh rus, ka shkruar ciklin poetik, me titull “Imitime të Kur’anit”. Në këtë cikël, poeti paraqet të gjitha virtytet e Islamit, të cilat edhe sajonnë mrekullinë e Kur’anit të shenjtë. Prej Kur’anit, zgjedh atë që është më e nevojshme, të vërtetën superiore, dashurinë ndaj Zotit dhe besimit islam. Shkrimtari i shquar rus F. Dostojevski, me rastin e zbulimit të monumentit të Pushkinit, më 1880, thotë: “Vallë a nuk ishte Pushkini musliman i vërtetë? A nuk ndjehet fryma e

⁸⁶ WA 17. 35/36, ibid, f. 11.

⁸⁷ WA 16, 203, ibid, f. 12.

⁸⁸ Në një letër që mban datën 17. 1. 1814 (WA IV 24, 110) drejtuar birit të tij, Gëte i shkruan këto fjalë, ibid, f.15.

⁸⁹ Gëte ndihej, veçanërisht, i impresionuar edhe nga fakti se All-llahu i flet njerëzimit nëpërmjet pejgamberëve. Ai, me këtë rast, i është referuar sures *Ibrahim*, ajeti 4, (Letër për A.O. Blumentahl, 28. 5. 1819, WA IV 31, 160), ibid, f. 17.

⁹⁰ Gëte e përsërit të njëjtin ajet, në një letër që i shkruan Carlyle, (WA IW 42, 270), ibid, f. 7.

Kur'anit, madhështia skofiare e besimit dhe fuqia e hatashme e tij?" Një numër i madh pushkinistësh, mendojnë se, ishte Kur'ani që pati ndikim të jashtëzakonshëm, në rilindjen religjioze të poetit. Në vitin 1824, në letrën që ia shkruan vëllait, ai thotë:

"Jam duke lexuar Kur'anin e madhërishëm".

Kurse, në vjershën e papërfunduar, të vitit 1825, ai shkruan: "Në shpellën e fshehtë, ditën e ndjekjes, duke lexuar Kur'anin e ëmbël".

Kur'ani e mahniti poetin, në rrafshin filozofik dhe atë etiko-moral. Nëntë vjershat e ciklit të përmendur, në të vërtetë, janë imitime të sureve, kaptinave kur'anore. Ja disa shembuj:

"Ai (All-llahu) është mëshirues;

Ai Muhammedit Kur'anin e ndritshëm ia zbuloi,

që të dalim edhe ne në dritë,

dhe të na bjerë mjegulla sysh".

Le t'i krahasojmë dy vargjet e para me këto ajete kur'anore:

"Elif, Lam, Ra. (ky është) Libër; Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t'i nxjerrësh njerëzit prej errësirave në dritë; (t'i nxjerrësh prej errësirës) në rrugë të Fuqplotit, të Falënderuarit". (Ibrahim: 1)

Dy vargjet e fundit shprehin metaforën e Kur'anit dhe janë përpunim i motivit nga surja *El-Maide*.

"All-llahu e vë me të (Kur'anin) në rrugë të drejtë atë, që ndjek kënaqësinë e Tij dhe, me ndihmën e Tij, i nxjerr ata prej errësirës në dritë dhe i udhëzon në rrugë të drejtë".

Imitimi i shtatë:

"Ngrehu, i frikësuar,

në shpellën tënde.

Llamba e shenjtë,

digjet deri në mëngjes".

Poeti është mbështetur te surja *El-Mudethir*, e cila, është ndër të parat sure, që i shpallet Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

*“Me lutje të përzemërta Profet,
largo mendimet e hidhura,
ëndrrat mashtruese”.*

Në këtë imitim, bëhet fjalë për raportin në mes Zotit dhe Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Ai këshillohet që të lutet. Ndërkaq imitimi:

*“Deri në mëngjes lutjet,
bëni pa përtesë,
Librin qiellor
Lexo deri në mëngjes”.*

Ky “imitim” është bazuar në suren *El-Mudethir*, ku Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i urdhërohet që të ngrihet natën për lutje dhe të lexojë Kur’anin e madhërisëm.⁹¹

Muhammed Marmadjuk Pitkal

U rrit në një familje fanatike të krishterë. Babai dhe gjyshi i tij ishin priftërinj. Fëmijërinë e kaloi në Xheblis Ford. E ëma e inkudroi në radhët misionare dhe e dërgoi në Palestinë, për të mësuar gjuhët orientale. Kjo ishte përvoja e tij e parë me botën muslimane. Për mësues të gjuhës arabe pati priftin Hanover. Udhëtoi në Palestinë, Liban dhe Siri. Gjatë qëndrimit në Siri i pëlqeu Islami. Mes viteve 1903 dhe 1921, shkroi nëntë tregime e novela me tematikë nga Lindja. Prestigjin letrar, e arriti veçanërisht me novelën “Gjuetari i lumtur”. Më 29 nëntor, deklaroi botërisht, pranimin e Islamit. Në shumë raste, polemizoi duke treguar se Islami është superior dhe më përparimtar karshi religjioneve të tjera. Kur e

⁹¹ Selim Sulejmani, Dituria Islame, Prishtinë, 1993, nr. 53. f. 14-15.

pranoi Islamin, ndryshoi emrin. Ai mori emrin Muhammed. Në vitin 1928, iu dha leja e veçantë e sundimtarit të Hajderabadit, për përkthimin e Kur'anit nga gjuha arabe në gjuhën angleze. Ishte ky kulmi i angazhimit të tij për Islamin dhe përkthimi i parë i bërë nga një musliman, që kishte anglishten gjuhë amtare.⁹²

Ai thotë: "Kur'ani është simfoni unike, tingujt e së cilës i kanë shtyrë njerëzit deri në derdhje lotësh dhe ekstazë".⁹³

Napoleon Bonaparti

Francezi Dinet, i cili e ka pranuar Islamin dhe është shquar në letërsi duke e lavdëruar dhe mbrojtur Islamin, transmeton nga Hristian Sharkild (Bonaparte et l'Islam) një letër të Napoleonit, më 28 gusht 179, në të cilën Bonaparti thotë: "Unë shpresoj se s'do të kalojë shumë kohë, kur të urtët e botës do të bashkohen dhe do t'i zgjidhin problemet e botës, sipas parimeve të Kur'anit. Vetëm ato janë të drejta dhe i garantojnë njerëzimit lumturinë".⁹⁴

Et Dinet

Ka mësuar në Francë, më pas ka punuar në Algjeri, si gjykatës. Më 1927, deklaroi pranimin e fesë islame. Ka shkruar disa libra, për Islamin, në gjuhën frënge. Ai ka thënë: "Kur'ani në fushën e gjuhës arabe ka bërë mrekulli, të cilën s'mund ta bëjnë as akademitë më të mëdha shkencore. Kështu, sikur sot të vijë ndonjë nga shokët e të Dërguarit të All-llahut, do ta kishte të lehtë të kuptohej me mesimdhënesit e gjuhës arabe. Madje, nuk do të gjente ndonjë vështirësi

⁹² Revista Nur, Beograd, gusht, 1993, f. 23-24.

⁹³ Ahmed Dedat, *Kur'ani mrekullia më e përsosur*, Prishtinë, 2001, f. 15.

⁹⁴ Preporod, Sarajevë, 1986, nr. 3. f. 3.

gjatë komunikimit, edhe me popujt që flasin gjuhën e dadit (arabe).

Politeistët, në brendinë e tyre, ndienin se ajo fjalë e çuditshme, e cila buronte nga thellësia e zemrës së inspiruar të Pejgamberit, gati sa nuk ua pushtonte atyre zemrat. Të gjithë, në të shumtën e rasteve, gati sa nuk i bindeshin fjalëve të ëmbla, të cilat i inspironte besimi qiellor. Ata nuk i pengonte nga Islami, veçse verbëria dhe makutëria ndaj kësaj bote...

"Mrekullitë e pejgamberëve, para Muhammedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], në realitet, ishin mrekulli shqisore (që shfaqeshin në një kohë të caktuar), prandaj shpejt i nënshtroheshin harresës. Ndërkaq, mrekullia e vargjeve kur'anore, mund të konsiderohet e përhershme, sepse ndikimi i tyre është i përhershëm dhe aktualiteti i tyre i vazhdueshëm. Besimtari e ka të lehtë që ta shohë atë në çdo vend e kohë, mjafton që vetëm ta lexojë librin e All-llahut. Në këtë, qëndron sekreti i përhapjes së pashembullt të Islamit. Sekretin e zgjerimit të shpejtë të Islamit, s'mund ta kuptojnë evropianët, sepse ata nuk e njohin Kur'anin, ose ata e njohin atë, por nëpërmjet përkthimeve, të cilat janë shumë pak realiste dhe të pasakta...

S'është e çuditshme të shohim këtë pejgamber, i cili i sfidon poetët, që e përgënjeshtrojnë, duke kërkuar prej tyre të sjellin dhjetë kaptina të ngjashme me kaptinat e Kur'anit. Ai ishte i bindur në paaftësinë e tyre, se do të mund ta bënin një gjë të tillë".⁹⁵

Dr. Murad Wilfried Hofman

Diplomat gjerman, ka shërbyer me punë diplomatike në Bernë, Paris, Vjenë, Algjer, Bon dhe Bruksel. Gjatë viteve

⁹⁵ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 63-64.

1983-1987, ishte drejtor i sektorit për informata në kuadër të Paktit NATO, në Bruksel. Qe ambasador i Gjermanisë në Rabat, Marok. Ky akademik evropian, si edhe shumë emra të tjerë me renome, më 1980 e pranoi Islamin për fe, Kur'anin e madhërishëm për fjalë të Zotit dhe Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] për Pejgamber të Zotit dhe vulë të të gjithë pejgamberëve.⁹⁶

“Si shpallje përfundimtare, Kur’ani, është themeli më i rëndësishëm, por jo edhe i vetëm i Islamit. Ky libër me 6.236 ajete dhe të ndara josistematikisht në 114 kapituj (sure), më shumë si prozë në vargje, përmban të gjitha shpalljet, të cilat Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i pranoi përfërsisht ndërmjet viteve 610 dhe 632, në formën e tyre komplete dhe origjinale. Për muslimanët, Kur’ani është Fjalë e Zotit, e cila nuk është krijuar, por është shpallur në një periudhë historike, në gjuhën arabe dhe është gjëja e vetme mbinatyrore e Islamit (dhe njëkohësisht, vërtetimi më i çuditshëm i pejgamberisë së Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]). Krahës kësaj, Kur’ani nuk është, siç është rasti me pjesën më të madhe të Dhiatës së Vjetër dhe të Re, i “inspiruar”, nuk është tregim i dorës së dytë, por është të folurit e Zotit në tërësi, si në vetën e parë njëjës apo shumës, ashtu edhe në vetën e tretë njëjës (ashtu që gjithmonë mbetemi të vetëdijshëm për problemin e të kuptuarit të Qenies së Tij)...

Jomuslimani mund ta hedhë përmbajtjen e Kur’anit, por nuk mund të injorojë magjepsjen, që del nga forca e gjuhës dhe fuqisë poetike të tekstit të tij, i cili mahniti edhe Johan Wolfgang von Goethen dhe Friedrich Ruckertin”.⁹⁷

⁹⁶ Dr. Murad Hofmann, *Islami si alternativë*, op. cit., f. 29. *Ditari i një muslimani gjerman*, Dituria Islame, Prishtinë, 1993, nr. 51. f. 31-32.

⁹⁷ Dr. Murad Hofmann, op. cit., f. 30.

Edward Gibon

Historian eminent, është shprehur si vijon:

“Në sy të Kur’anit, nuk ka ndonjë dallim, një mbret me fuqi të madhe, nga një i vobektë i mjerë. Mbi këto themele dhe në të tilla baza, është trupëzuar dhe kompozuar ligji themelor i Sheriatit, i cili nuk ka shembull në botë. Bazat e Islamit, kanë refuzuar doktrinën e trinitetit, inkarnimin e Zotit dhe inkarnimin (në tërësi). Këto besime e lidhje filozofike, tregojnë ekzistimin e Zotit të trefuqishëm dhe se Krishti është “bir” i Zotit. Mirëpo, këto pretendime, mund t’i ngopin, vetëm të krishterët fanatikë.

Ndërkaq, Kur’ani është i pastër nga pretendime e dyshime të tilla dhe është dokumenti më i shëndoshë i njësisë së Zotit. Një besnik i vërtetë, që mendon drejt, nuk hamendet aspak në të pranuarit e pikëpamjeve islame. Islami është fe që qëndron lart, për nga shkalla dhe niveli i zhvillimit mendor”.⁹⁸

“Në fenë e Muhammedit, nuk ka vend për t’u hamendur, kurse Kur’ani është dritë e dëshmisë për njëshmërinë e Zotit”.⁹⁹

Will Durant

Autor bashkëkohor amerikan. Libri i tij “Historia e civilizimit”, i shkruar në tridhjetë vëllime, konsiderohet si njëri ndër librat më të njohur, i cili flet mbi historinë e civilizimit njerëzor. Në vëllimin 13. f. 68, 69, ai shkruan:

“Kur’ani, qysh prej katërmëdhjetë shekujsh, vazhdon të mësohet përmendësh dhe të ruhet në mbamendjen e musli-

⁹⁸ Hajrullah Hoxha, op. cit., f. 112.

⁹⁹ Ahmed Dedat, op. cit. f. 31.

manëve, duke ua ndriçuar imagjinatën dhe duke fisnikëruar moralin e miliona e miliona njerëzve.

Kur'ani ka meritën më të madhe për ngritjen e nivelit kulturor dhe moral të muslimanëve dhe është libër, që tek ata ka konstituar rregullat bazë të sistemit shoqëror dhe të unitetit të bashkësisë njerëzore. Ai i nxit ata të pasojnë principe të shëndosha dhe ua pastron trurin nga një mori besëtytnish e iluzionesh, madje dhe nga dhuna dhe vrazhdësia. Ai avancoi pozitën e skllevërve, kurse në zemrën e të diskriminuarve, skaliti krenarinë dhe fisnikërinë. Te muslimanët ngriti ndjenjën e maturisë dhe të largimit nga pasionet, shembull ky, që s'mund të haset në asnjë vend të rruzullit të populluar nga raca e bardhë njerëzore.

Islami i mëson njerëzit të ballafaqohen me provokimet dhe sfidat e jetës, t'i durojnë ato me gjakftohtësi dhe pa iu kundërvënë fatkeqësive që sjell jeta. Parimisht, ai kërkon nga besimtarët zemërgjerësinë, e cila paraqet veçorinë më fascionuese të muslimanëve, që e mban mend ndonjëherë historia. Ai e ka definuar fenë dhe i ka caktuar në mënyrë precize kufijtë e saj, sa që asnjë i krishterë apo hebre, nuk do të gjejë në të argument, që do të mund ta pengonte për ta pranuar atë".¹⁰⁰

H. G. Wels

"Evropianët, që janë marrë me shqyrtimin e detajeve dhe hollësive të Kur'anit, janë fare të paktë. Ata, nga kjo mosnjohje, i përshkruajnë atij shumë të pavërteta e të paqena. Nxitja e muslimanëve në përpunimin e pasurive të nëntokës dhe metaleve, në zhvillimin e inxhinierisë, astronomisë, arkitekturës, arteve të bukura dhe filozofisë ishte rezultat i

¹⁰⁰ Dr. Jusuf el Kardavi, op. cit., f. 58. Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 64-65.

Kur'anit. Ai i bashkoi dhe bëri që ata të arrijnë suksese në fushën e dijes dhe shkencës".¹⁰¹

Prof. Sir Hamilton A. R. Gibb

Ka jetuar nga viti 1895 deri më 1967. Konsiderohet prijës i orientalistëve anglezë. Ka qenë profesor i gjuhës arabe, në Universitetin e Londrës, më 1930 dhe profesor në Universitetin e Oksfordit, që nga viti 1937. Më poshtë, po citojmë disa fjalë të tij:

"Mirëpo, mekasit kërkonin nga ai mrekulli. Me vendosmëri dhe vetëmohim, që lë mbresë të thellë, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] iu referua vetë Kur'anit, si verifikimin më të lartë të misionit të tij. Si edhe të gjithë arabët, edhe mekasit, ishin njohës të mirë të gjuhës dhe oratorisë. Pra, Kur'ani, sikur të ishte vepër e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], atëherë, edhe njerëzit e tjerë do të garonin me të.

Le të formojnë vetëm dhjetë vargje, që do të ishin të ngjashëm me vargjet e Kur'anit. Nëse nuk ia kanë dalë dhe as që do t'ia dalin, atëherë Kur'anin duhet ta pranojnë për mrekulli të jashtëzakonshme".¹⁰²

"Nëse dikush mendon se, insistimi i Kur'anit, për vepra të mira është i pamjaftueshëm, bindjen e tij të gabuar e flakim, me argument të pakontestueshëm, duke i sjellë definimin e plotë të mirësisë, në këtë ajet madhështor: *"Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t'i ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, Ditës së Gjykimit, engjëjve, librit, pejgamberëve*

¹⁰¹ H. Hoxha, op. cit., f. 114-115.

¹⁰² Seid Ramadan, *E drejta islame*, Gjilan 2000. f. 32. & T. Nelaj, *Të huajt, jomuslimanët, për Islamizmin, Kur'anin dhe Muhammedin a.s.* op. cit., nr. 3. f. 36.

dhe pasurinë që e do ua jep të afërmeve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirim të robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zekatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit". (El-Bekare: 177)

Mirësia, pra, është kurora e besimit të vërtetë. Në fund, kur besimtari kupton se All-llahu është dëshmitar i përhershëm, i përgjigjet me mendime dhe vepra.

Në realitet, Kur'anit s'mund të përkthehet në mënyrë fundamentale, sikurse është rasti i përkthimit të poezisë me stil të lartë. Nuk mund të shprehet përmbajtja e fshehtë e Kur'anit, nëpërmjet gjuhës së thjeshtë. Nuk mund të ilustrohen pamjet dhe shembujt e tij, sepse çdo lidhje, metaforë ose përsosuri gjuhësorë e Kur'anit, duhet të studiohet gjatë, që të arrijë kuptimi i plotë tek lexuesi. Kur'anit gjithashtu ka muzikalitetin, ëmbëlsinë dhe bukurinë e vet. Struktura e përsosur nuk mund të përcaktohet, por ai me ndikimin e tij magjepsës, i përgatit mendimet e personit, i cili e dëgjon Kur'anin që të pranojë mësimet e tij. Prandaj, s'ka dyshim se përkthimi, në një gjuhë tjetër, e deformon Kur'anin dhe e shndërron atë, sikurse shndërrohet ari në thëngjill".¹⁰³

Prof. Edward Montet

"Të gjithë ata që e kanë njohur Kur'anin, në origjinalin e tij në arabisht, e pranojnë bukurinë unike të këtij libri fetar. Madhështia e formës së tij (në gjuhën arabe) shquhet aq shumë, sa që asnjë përkthim në gjuhët evropiane, nuk do të na lejonte që të japim mendim të prerë rreth Kur'anit".¹⁰⁴

¹⁰³ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 79-80.

¹⁰⁴ T. Nelaj, *Edukata Islame*, op. cit., nr. 3. f. 38.

“Kur’ani e ndalon viktimizimin e njeriut, vrasjen e fëmijëve, alkoolin dhe bixhozin, që ishin mjaft të përhapura tek arabët. Rezultatet e këtyre reformave manifestohen në kulturën kolosale, e cila i siguron një status të bamiirësimit më të madh të njerëzimit në histori”.¹⁰⁵

Dr. Xhon Son

Ajo, që thotë ky orientalist është shprehje e mendimit të intelektualëve të Evropës:

“Në realitet, Kur’ani është një gjë më e lartë se vjersha, e megjithatë ai nuk është as histori, as si predikimet që i bëri Krishti në mal, por si një përmbledhje prej proze dhe poezie. Madje, ai nuk është as si predikimet e Budës, që janë metafizike, as si këshillat që i bëri Platoni për secilin, por është zëri i Pejgamberit. Është zë i tillë, që mund ta dëgjojë mbarë bota. Kumbimi dhe jehona e këtij zëri (kur’anor) tingëllon nëpër pallate, hapësira fushore, kodrina, male, qytete dhe shtete. Feja që kumtoi ky zë, së pari ka gjetur ata që e përhapnin, pastaj, është shfaqur si një fuqi e fortë për rregullim dhe përparime të reja, me dritën që takoi Greqinë me Azinë dhe që shpërndau errësirat, që e kishin mbuluar Evropën. Kjo ndodhi, pikërisht atëherë, kur Krishterizmi gjendej në periudhën më të errët”.¹⁰⁶

Emanuel De Esh

Dijetar çifut me famë, në artikullin e tij “Islami”, botuar në të përkohshmen angleze “Kuarteli revue”, për Kur’anin shkruan:

¹⁰⁵ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 122.

¹⁰⁶ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 82; H. Hoxha, op. cit., f. 114.

“Do të flasim për librin e shenjtë, që i shtyri arabët të push-tojnë qytete më të gjera se Perandoria e Lekës së Madh, e të bëjnë një mbretëri më të madhe se ajo e romakëve, në një kohë gjashtë herë më të shkurtër se ajo që iu desh atyre.

Kur’ani është libër, me të cilin muslimanët kanë hyrë në Evropë si sundimtarë dhe gjykues. Fenikasit, hynë në Evropë si tregtarë, çifutët si skllevër, duke kërkuar vendstrehim, ndërsa muslimanët hynë si urdhërues. Muslimanët, me ndihmën e Kur’anit, ia mbajtën Evropës ndezur pishtarin e diturisë. Si orientit (Lindjes) ashtu edhe oksidentit (Perëndim), ia mësuam filozofinë, astronominë, mjekësinë, poezinë dhe i dhanë shpirt trurit dhe diturisë së vdekur të grekëve. Kur bota ishte katandisur në errësirën e injorancës, këta njerëz, e përhapen dritën anembanë botës, duke vënë kështu themelet e diturive të reja”.¹⁰⁷

¹⁰⁷ H. Hoxha, op. cit., f. 115.

Manuel King

Në kishën Teuta V. Nard të Presbitarëvet, më 1915, në ligjëratën e tij, thotë:

“Libri qiellor i Islamit është Kur’ani. Ky libër është grumbullim i përgjithshëm i inspirimeve, që iu bënë Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në kohën e peygamberisë së tij. Kur’ani, përveç bazave të besimit musliman, përmbledh shumë thënie morale dhe rregulla për jetën e përditshme. Me barazinë mes njerëzve, muslimanët qëndrojnë lart në krahasim me jomuslimanët. Kjo fe, të gjithë njerëzit i konsideron të njëjtë. Morali i lartë islam, meriton çdo lëvdatë dhe admirim. Urdhrat e librit të Zotit, janë perlat e ndërtimit të godinës së moralit. Shumë herë, pretendohet se Kur’anin e ka sajuar Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], madje sipas kësaj pikëpamje, ai e ka shkruar duke marrë nga Inxhili dhe Tivrati. Por bindja ime është kryekëput në kundërshtim me këtë pretendim. Në qoftë se në botën e frymëzimit- ilhamit është ajo, së cilës i thonë “inspirim” dhe se inspirimi ka një trup, formësim të plotësuar, nuk ka dyshim se Kur’ani është një libër i zbritur. Të krishterët, thonë se, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], nuk është peygamber i vërtetë dhe se Kur’ani është vepër e tij. Po të kishte qenë real ky pretendim dhe të ishte e vërtetë ajo që thuhet, si është e mundshme që Muhammedi të fliste ajete të tilla, të cilat e kritikojnë edhe atë, dhe t’i linte ato të gjendeshin në veprën e tij”.¹⁰⁸

Dr. Moris

¹⁰⁸ Ibid, f. 111.

Orientalist i njohur, në gazetën “La Parole Française-Romaine”, duke iu përgjigjur kritikave të përkthyesit të Kur’anit, Salmen Ronahut, veç të tjerash, thotë:

“Kur’ani është më i bukuri i librave qiellorë, që i është dhuruar njeriut. Kur’ani përmban adhurim dhe falënderim për Krijuesin e tokës dhe të qiellit. Çdo fjalë e Kur’anit shpreh madhërim ndaj Atij, që ka krijuar çdo gjë. Përveç kësaj, ky libër është një enciklopedi e ndritshme e ligjeve fetare.

Bukuritë e Kur’anit që shndrisin, shtohen dhe shumëzohen çdo ditë, misteret që sa kalon koha, aq më tepër kuptohen dhe nuk kanë të mbaruar, bënë që këta muslimanë që janë mjeshtër në prozë dhe poezi, të jenë të detyruar të gjunjëzohen para stilit më të lartë e të pastër të tij. Muslimanët, Kur’anin, e gjejnë si një thesar të pashterur, që do të ekzistojë deri në Ditën e Ringjalljes dhe, me plotë të drejtë, krenohen me të. Brezi i ri i sotëm dhe të diplomuarit e shkollave bashkëkohore, nuk mund ta durojnë qëndrimin fyes ndaj Islamit dhe Kur’anit. Kur’ani, me dy cilësi, e ka fituar dhe e meriton respektin. E para, është se Kur’ani që kemi sot në dorë, është i njëjtë (identik) me Kur’anin që i është shpallur Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] Ndërkaq, para Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re qëndrojnë shumë dyshime. E dyta, është se muslimanët e gjetën Kur’anin si gurrën më të pastër, nga ku i formuluan dispozitat fetare dhe nëpërmjet tij, ata ruajtën gjuhën arabe”.¹⁰⁹

Near East

Që botohet në Londër, më 1992 shkruante këto fjalë:

¹⁰⁹ Ibid, f. 110.

“I çfarëdo forme që të jetë mendimi ynë për Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] jemi të detyruar të pranojmë se: Kur’ani, në pikëpamje të radhitjes dhe të zbritjes, është një vepër e mrekullueshme, e cila të habit. Gjuha e Kur’anit dhe mendimet e tij janë të ndryshme nga gjuha e mendimit tonë, por të mohosh vlerën e pakufishme të tij, madhështinë e lartësisë, dhe në shumë pikëpamje bukurinë e tij, duhet të jesh i pamend dhe i paarsyeshëm”.¹¹⁰

F. F. Arbuthnot

Në “The construction of the Bible and the Coran”, Londër 1888, f. 5, shkruan:

“Kur’ani, për nga aspekti letrar, konsiderohet kryevepër e gjuhës më të pastër arabe. Është vërtetuar se, në disa raste, gjuhëtarët i kanë formuluar rregullat e gjuhës për t’i përputhur dhe përshtatur me shprehjet dhe frazat e përdorura në Kur’an. Edhe përkundër përpjekjeve, që të shkruhet një vepër e ngjashme me të për nga elokuenca, nuk u arrit ndonjë sukses.

Kodifikimi i plotë i tekstit kur’anor është bërë brenda njëzet viteve, pas vdekjes së Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], më vitin 632, dhe ka mbetur pa asnjë ndryshim deri në ditët tona. Mjerisht, një gjë e tillë, nuk mund të thuhet për Dhiatën e Vjetër dhe Dhiatën e Re”.¹¹¹

Filip Hiti

Me origjinë libaneze, ka doktoruar në Universitetin Kolumbia. Ka ligjëruar në Universitetin amerikan në Bejrut dhe

¹¹⁰ Ibid, f. 112.

¹¹¹ T. Nelaj, op. cit., nr. 3. f. 34.

Pernston. Është zgjedhur anëtar i shumë shoqatave dhe akademive shkencore.

“Stili i Kur’anit ndryshon, ai është krejt ndryshe nga stilet e tjera. Madje, ai as që mund të krahasohet me ndonjë stil tjetër. Ai është i paimitueshëm, në esencë kjo është mrekullia e Kur’anit... Nga të gjitha mrekullitë, Kur’ani është mrekullia më e madhe.

Mrekullia e Kur’anit s’mund të mbetet pa lënë ndikim të qartë, në letërsinë arabe. Ndërkaq, nëse ne shikojmë kopjen e Tevratit ose Inxhilit, e cila na është përcjellë në kohën e mbretit Xhejms, do të shohim se ndikimi i tyre në gjuhën angleze ishte shumë i dobët, duke krahasuar këtë me ndikimin që ka bërë Kur’ani në gjuhën arabe. Kur’ani, është ai, i cili e ruajti dhe e mbrojti gjuhën arabe që të mos ndahej (zhdukej) në dialekte”.¹¹²

Johan William Draper

Në “A History of the Intellectual Development of Europa”, Londër 1875, f. 343-344, shkruan:

“Kur’ani përmban ligje të përsosura dhe moral të jashtëzakonshëm. Përmbajtja e tij është e tillë, sa që nuk mund të shfletojmë asnjë faqe të tij e të mos gjejmë parime, të cilave duhet t’u përmbahen, pa dallim, të gjithë njerëzit. Kjo përmbajtje ofron ligje, parime dhe rregulla gjithëpërfshirëse që i përgjigjen nevojave të njeriut, në çdo situatë jetësore”.¹¹³

Thomas Patrick Huges, në librin “Burimet e Kur’anit”, shkruan:

¹¹² Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 57.

¹¹³ T. Nelaj, op. cit., nr. 3. f. 35.

“Nuk kemi asnjë provë se Muhammedi pati mundësi t’i njihte shkrimet e shenjta (dhe t’i bënte plagjiat ato, duke shkruar Kur’anin, A.S.)... Duhet gjithashtu ta kemi parasysh se nuk kemi asnjë gjurmë për ekzistencën e teksteve arabisht të Dhiatës së Vjetër e të Re, para ardhjes së Muhammedit. Versioni më i hershëm arabisht i Dhiatës së Vjetër që kemi është ai i R. Sadiaas Gaon, viti 900 e.s., ndërsa versionin më i vjetër arabisht i Dhiatës së Re është ai i botuar nga Erfenivsi, më 1616”.¹¹⁴

Dr. Laura Vecia Vaglieri

Në “Apologie de l’islamisme” f. 57-59, thotë:

“Shikuar në tërësi, në Kur’an, gjejmë përmbledhjen e urtësisë dhe filozofisë, të cilat mund të pranohen prej njerëzve më inteligjentë, mendimtarëve më të mëdhenj dhe politikaneve më të mençur.

Një argument tjetër, për origjinën hyjnore të Kur’anit, është fakti se ai ka mbetur i pandryshuar, që nga shpallja e tij deri në ditët tona...

I lexuar dhe sërish i rilexuar në tërë botën islame, ky libër nuk sjell mërzë te besimtarët, përkundrazi, mund të thuhet se gjatë rileximit, dashuria ndaj tij shtohet dita-ditës. Ai kalit ndjenja të thella devotshmërie dhe respekti, te njerëzit që e lexojnë...

Nisur nga kjo, shkaqet e përhapjes së rrufeshme të Islamit, nuk duhen kërkuar në mjetet e dhunës dhe forcës dhe as te misionarët e neveritshëm, por në faktin se, ky libër u është prezentuar të mundurve nga ana e muslimanëve në mënyrë të lirë, duke u dhënë atyre mundësi që të mund të pranojnë ose ta refuzojnë, se vërtet është libër i Zotit”.¹¹⁵

¹¹⁴ Hamza Mustafa Njazi, *Burimet e Kur’anit*, Tiranë, 1993, f. 90.

¹¹⁵ T. Telaj, op. cit., nr. 3. f. 34.

“Në Kur’an hasim xhevahire, begati të madhe të diturisë që tejkalojnë dituritë e gjenive më brilant, filozofëve më të shquar dhe politikanëve më të fuqishëm. Si mundet ai libër të jetë prodhim i mendjes së një njeriu dhe për më tepër i një njeriu, jeta e të cilit ka kaluar në qarqe tregtare, jo gjithaq religjioze, njeriut larg nga shkolla dhe arsimi? Ai, vazhdimisht, ka insistuar se është njeri i zakonshëm, si të tjerët. Për shkak të kësaj, njeriu nuk do të ishte i aftë që, pa ndihmën e Lavdiplotit, të realizojë vepra mbinatyrore, ashtu sikurse është Kur’ani. Askush tjetër, pos Zotit të Gjithëpushtetshëm, dituria e të Cilit përfshin gjithçka që është në tokë dhe në qiell, nuk mund të jetë autor i Kur’anit”.¹¹⁶

James A. Michener

“Kur’ani, pa dyshim, është libri më i lexueshëm në botë. Është libri që mësohet më së shumti përmendësh dhe mund të jetë libri me ndikim më të madh, në jetën e përditshme të atyre që e besojnë.

Edhe pse nuk është voluminoz si Dhiata e Re, Kur’ani është i shkruar me një stil të përkryer, por nuk është as prozë as poezi e rëndomtë dhe ka muzikalitet fascinaues që dëgjuesit i shpie deri në ekstazë”.¹¹⁷

R. Bosworth Smith

Misionar i krishter, në veprën e vet “Muhammedi dhe Muhamedanizmi” është i detyruar të dëshmojë për Kur’anin:

“Libër, që është poezi, ligj, lutje dhe shkrim i shenjtë - të gjitha së bashku. Ai gëzon respekt të thellë, deri në ditën e

¹¹⁶ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 80.

¹¹⁷ T. Nelaj, op. cit., 3. f. 33.

sotme, nga një e gjashta e njerëzimit, si mrekulli e stilit të pastër, të urtësisë dhe saktësisë. Kjo është e vetmja mrekulli që e ka përhapur Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sellem]. Ai këtë e quajti mrekulli të amshueshme, dhe me të vërtetë është mrekulli”.¹¹⁸

Sir Thomas W. Arnold

Ka jetuar nga viti 1864, deri në vitin 1930, është një nga orientalistët më të mëdhenj anglezë, ka shkruar disa libra për Islamin, ka studiuar në Kembrixh.

“Ne gjejmë, madje, edhe nga të krishterët, si p.sh. Alvari spanjoll, i cili, edhe pse është i njohur për fanatizmin e tij kundër Islamit, pranon se Kur’ani ka stil elokuent dhe të bukur. Të krishterëve, nuk u mbetet tjetër, veçse ta lexojnë Kur’anin dhe të mrekullohen prej tij.”¹¹⁹

Arthur J. Arberry

Përkthyes i Kur’anit në gjuhën angleze, thotë:

“Sa herë që dëgjoj leximin e Kur’anit më duket sikur dëgjoj muzikë, melodia e së cilës përcillet me të rrahura të përherëshme të lodrave dhe kjo (më krijon emocione të fuqishme) sikur më pëlcet zemra ime”.¹²⁰

“Tanimë, është e pranishme përpjekja për të përmirësuar gjithnjë e më shumë veprimet e paraardhësve të mi dhe për të bërë diçka, që mund të pranohet si jehonë, sado e zbehtë. Në retorikën e mrekullueshme të Kur’anit në gjuhën arabe, jam përpjekur t’i studioj ritmet e ndryshme të ndërlikuara dhe madhështore, të cilat përveç porosisë së vet, përmbajnë

¹¹⁸ Ahmed Dedat, op. cit., f. 32.

¹¹⁹ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 50.

¹²⁰ Ahmed Dedat, op. cit., f. 15.

edhe kërkesën e pakontestueshme, që Kur'ani të radhitet në mesin e kryeveprave më të mëdha letrare të njerëzimit... Kjo veçori, mjaft karakteristike "ajo simfoni unike", siç e ka përshkruar besimin, në librin e tij të shenjtë M. M. Pitkal, "tingujt e së cilës, i kanë shtyrë njerëzit deri në derdhje lotësh dhe ekstazë" ka qenë gati totalisht e pranuar nga përkthyesit e mëparshëm. Prandaj, nuk është çudi, që ajo që është përkthyer, tingëllon në mënyrë anemike dhe të zbehtë, kundrejt madhështisë së origjinalit (në gjuhën arabe)".¹²¹

¹²¹ Pamfleti: *Ç'thonë të tjerët për Kur'anin*.

Dr. Maurice Bucaille (Moris Bukai)

Doktor dhe shkencëtar, anëtar i akademisë së shkencave të Francës, i cili para disa vitesh pranoi Islamin, në librin e tij “La Bible, Le Coran Et La Science” (*Bibla, Kur’ani dhe shkenca*), që bëri jehonë të madhe në qarqet shkencore, sidomos ato kishtare, thotë:

“Nëse një njeri është autor i Kur’anit, atëherë: Si ka mundur që në shekullin e VII-të të e.s. të shkruajë atë, që sot është vërtetuar se është në përputhje me njohuritë bashkëkohore shkencore? Nuk ka asnjë dyshim: teksti kur’anor, që e kemi sot, është vërtet i njëjti tekst sikurse ai, i kohës kur ai u shpall. Çfarë shpjegim njerëzor mund të jepet për këtë konstatim? Për mendimin tim, nuk ekziston kurrfarë shpjegimi, sepse nuk kam pse të besoj se, në kohën kur në Francë sundonte mbreti Dagobert, një banor i Gadishullit Arabik, në sajë të kulturës së vet shkencore, ka mundur të ishte para nesh me dhjetëra shekujsh...

Është e papranueshme hipoteza se Muhammedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] është autor i Kur’anit. Si ka mundur një njeri, të sjellë fakte të tilla, të cilat në atë kohë nuk ka mundur t’i elaborojë asnjë qenie njerëzore, dhe të bëhet, nga pikëpamja e vlerës letrare, autori i parë i letërsisë së përgjithshme arabe?”¹²²

Hartwig Hirschfeld

¹²² Dr. Maurice Bucaille, *Bibla, Kur’ani dhe shkenca*, Gjakovë, pa vit botimi, 139-144.

I cili njihet për sulmet e tij ndaj Islamit, në "New research into the Composition and Exege of the Quran", Londër, 1902, f. 9, thotë:

"Nuk duhet të çuditemi kur konstatojmë se Kur'ani ka qenë pikënisje e shumë shkencave. Çdo çështje në lidhje me qiellin, tokën, jetën e njeriut, tregtinë ose veprimtari të tjera, kanë qenë të shqyrtuara në Kur'an, gjë që nxitën krijimin e monografive të shumta, që jepnin shpjegime të librit të shenjtë.

Duhet t'i jemi mirënjohës Kur'anit, për ato shkoqitje të gjera, sepse prej tij, në mënyrë indirekte, rrjedh zhvillimi i shkëlqyer i gjithë lëmenjve shkencore në botën islame. Ndikimi i tij, nuk është kufizuar vetëm te dijetarët muslimanë, por njësor, ka nxitur edhe çifutët që t'i shqyrtojnë problemet metafizike dhe religjioze, sipas metodave arabe. Edhe skola-stika krishtere, ka qenë e pasuruar me teozofinë arabe.

Aktiviteti shpirtëror, që kishte filluar brenda trevës islame, nuk është kufizuar vetëm në dituritë teologjike. Njohja e veprave të filozofisë, matematikës, astronomisë dhe medicinës greke, mundësoi vazhdimin e këtyre studimeve. Në përshkrimet e shpalljes së tij, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka përsëritur ftesën që të tërhiqet vëmendja në lëvizjen e trupave qiellorë, si shembull i mrekullive të Zotit, që janë për t'i shërbyer njerëzve, e jo të bëhen objekt adhurimi.

Me sa sukses, popujt muslimanë të të gjitha racave, i kanë bërë studimet në fushën e astronomisë, këtë më së miri, e dëshmon fakti se ata me shekuj ishin bartësit kryesorë të shkencave astronomike. Madje edhe sot përdoren shumë emra arabë për yjet, si dhe emërime teknike arabe.

Gjithashtu, Kur'ani ka nxitur zhvillimin e shkencave medicinale dhe ka rekomanduar seditjen dhe studimin e natyrës, në tërësi¹²³.

¹²³ T. Nelaj, op. cit. nr. 3, f. 36-37; Ebul Hasen en Nedevi, op. cit., f. 82-3.

Paul Casanova

“Sa herë që kërkonin nga Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] të vërtetojë autenticitetin e misionit të tij me ndonjë mrekulli, ai theksonte Kur’anin dhe domethënien e tij të pakrahasueshme, si argument për burimin e tij hyjnor. Vërtet, madje edhe për ata, që nuk janë muslimanë, nuk ka asgjë më mahnitëse sa gjuha e Kur’anit, e cila me kumbimin dhe muzikalitetin e saj të pushton. Nëpërmjet dëgjimit të thjeshtë, është ngazëlluar dhe entuziazmuar ai popull, i dashuruar në oratori. Shumëllojshmëria e rrokjeve të përsosura dhe rima e shkëlqyer, patën rëndësi të veçantë në përfitimimin e armiqve më të tërbuar dhe skeptikëve më të flaktë”.¹²⁴

Dr. Jarton

Në librin “Si shkon bota”, shkruan:

“Qëllim i shenjtë më i madh i Kur’anit është thirrja që u bën të krishterëve, çifutëve dhe atyre që u luten idhujve, për të pranuar njësinë e Zotit. Kur’ani, që ka zbritur në gjuhën e kurejshitëve, i përmbledh dhe i përmban të gjitha virtytet e mira. Në metodën e rrëfimit, ai është tërheqës dhe ka një gjuhë të rrjedhshme. Kur Kur’ani flet për atributet hyjnore, arrin kulmin”.¹²⁵

Rev J. N. Rodwel

“Është e nevojshme të theksohet se Kur’ani meriton mirënjohjen më të thellë, për kuptimin e tij të natyrës hyjnore,

¹²⁴ T. Nelaj, op. cit., nr. 3. f. 35.

¹²⁵ H. Hoxha, op. cit., f. 111.

për nga aspekti i cilësisë së fuqisë, diturisë, njësisë dhe qartësisë së përgjithshme që e karakterizon atë. Predikimi i tij për besimin në një Zot, që është Krijuesi i tokës dhe i qiellit, është i thellë dhe i zjarhtë. Gjithashtu, Kur'ani përfshin edhe shumë parime morale dhe fisnike, urti të thellë dhe themele, mbi të cilat mund të ngrihen kombe dhe mbretëri ngadhënjimtare".¹²⁶

Rev. G. Margoliouth

I cili është i njohur për sulmet e tij ndaj Islamit, në hyrjen që i bëri biografisë së J. N. Rodwelit, thotë:

"Studiuesit janë unik në atë se, Kur'ani zë vend të dalluar në mesin e librave të mëdhenj të botës. Edhe pse është më i riu në mesin e librave qiellorë, që ndërtuan historinë, ai ua kaloi të gjithë atyre, me ndikimin e mrekullueshëm që ka bërë te masat e gjera.

Kur'ani formoi një etapë të re në mendimin njerëzor dhe forcoi bazat e një shkolle etike të dalluar".¹²⁷

Harry Gaylord Dorman

Në "Towards Understanding Islam", New York, 1948, f. 3, thotë:

"Kur'ani është shpallje e shkruar e Zotit, i është shpallur Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], nëpërmjet kryeengjellit Xhibril. Është i përkryer në çdo germë të tij. Ai është mrekulli e pashtershme, që dëshmon njëmendësinë e vet dhe (misionit) të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], peygamberit të Zotit. Nduarshmëria e mrekullisë së

¹²⁶ T. Nelaj, op. cit., nr. 3. f. 38.

¹²⁷ Ebul Hasen En Nedevi, op. cit., f. 82; Pamfleti: *Ç'thonë të tjerët për Kur'anin*.

Kur'anit, pjesërisht, gjendet në stilin e tij të përkryer dhe të mrekullueshëm, saqë as xhinnët, as njerëzit, nuk mund të formulojnë madje as një kaptinë të vetme, e cila do të krahasohej me kaptinën më të shkurtër të tij, dhe pjesërisht në tekstin e tij që përmban mësim, njohuri për të ardhmen dhe lajmërimi çuditërisht të sakta. Prandaj, nuk mund të merret me mend, që Muhammedi analfabet, ta ketë sajuar vetvetiu (nga mendja e tij)".¹²⁸

Sir William Muir

"Me siguri, në botë nuk ka asnjë libër, i cili ekziston dymbëdhjetë (tani katërbëdhjetë) shekuj me pastërti të tillë të tekstit".¹²⁹

Aleks Luvaron

Filozof i shquar francez, në një ligjëratë të tij thotë:

"Kur'ani, që i është inspiruar Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], për udhëzimin e drejtë të njerëzimit, është një vepër e shkëlqyer, e mbushur me dije e filozofi të lartë. Nuk ka dyshim se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është peygamber i vërtetë, i dërguar nga Zoti".

Ndërkaq, në librin e tij "Jeta e Muhammedit", thotë:

"Me të vërtetë, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk dinte të shkruante, as të lexonte, por, edhe përkundër kësaj, ai i la botës një elokuencë e rrallë, një përmbledhje normash morale, një libër të shenjtë... Nuk ka nga shpikjet e reja të shkencës, çështje të zgjidhura me anë të dijes e të diturisë, ose ndonjë prej problemeve që njerëzit mundohen

¹²⁸ T. Nelaj, op. cit., nr. 3, f. 36.

¹²⁹ Ulfe Azizus Samed, op. cit, f. 13.

për t'i zbërthyer, e të jenë në kundërshtim me parimet islame. Përkundër përpjekjeve (të kota), që bëjnë të krishterët për të afruar Krishterizmin me ligjin e natyrës, ndërmjet Kur'anit, urdhrave të tij, dhe ligjeve natyrore gjendet një harmoni e plotë".¹³⁰

Doktor Shmil

"Në Kur'an ka parime shoqërore dhe njerëzore, që mund të vihen në zbatim dhe të veprohet sipas tyre në çdo vend e kohë. Këto parime, kanë të bëjnë edhe me femrat, të cilat Kur'ani i ka urdhëruar që të qëndrojnë larg të keqes, ligësisë dhe asaj që e vë në dyshim dinjitetin e tyre. Ai ka lejuar poligaminë, por e ka ndaluar, atëherë, kur burri s'është në gjendje të jetë i drejtë me gratë...

Kur'ani i ka lënë të hapura portat për të punuar për dy botët, për përsosjen e shpirtit dhe të trupit, në të njëjtën kohë. Ndërkaq, fetë e tjera e kanë mbyllur këtë portë, duke i mësuar njerëzimit se ai s'ka vend në këtë botë kalimtare e të mjerueshme".¹³¹

Shahib Mustekim Bledar

Gazetar gjerman, ka shkruar një numër librash, në mes të tjerash edhe "Satanic voices ancient and Modern", ku u përgjigjet atyre që e mbështesin Selman Ruzhdiun, kinse, në emër të lirisë së fjalës.

"Kur'ani, ndryshe nga shkrimet e tjera të shenjta, ka stilin e tij të veçantë të gjuhës, thjeshtësinë, kuptimin e lehtë, i cili

¹³⁰ H. Hoxha, op. cit., f. 119-120.

¹³¹ Ahmed Hamdi, op. cit., f. 250.

kuptohet nga ata që duan të kuptojnë, qofshin intelektualë ose të rëndomtë.

Fjalët kur'anore përmbajnë alegori, mundësojnë lidhje të ngushtë dhe bartin në vete të vërtetën, e cila ka të bëjë me çdo sferë të jetës sonë.

Në fakt, gjuha e Kur'anit, jo vetëm që është ruajtur me origjinalitetin e saj, por është e gjallë ashtu sikurse ishte në kohën e shpalljes. Ajo i ofron lexuesit aq sa mund të kuptojë dhe i përgjigjet nevojave të tij, duke e udhëzuar në çdo vepër. Ky libër është relevatë dhe kushdo që e hap sinqerisht, për të zbuluar të vërtetën, e ka të vështirë të ndahet prej tij".¹³²

Profesor Arthur Elejson

Dekan i fakultetit elektronik në Universitetin e Londrës. Është marrë me psikologji, shumë vjet ka qenë drejtor i shoqatës për hulumtime shpirtërore dhe psikologjike, në Angli. Është interesuar për Budizmin, Hinduizmin etj., por kur e njohu Islamin, e përqafoi atë.

"Të gjitha të vërtetat shkencore që janë cekur në Kur'anin famëlartë qysh para 14 shekujsh e të cilat po i zbulon shkencë bashkëkohore, më kanë bindur se ato nuk janë rezultat i mendjes njerëzore, por dëshmi e peygamberisë së Muhamedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

Bota materialiste perëndimore ka rënë në krizë të thellë dhe e vetmja rrugëdalje e saj, sikurse edhe ka filluar ta kuptojë, është të kthyerit kah feja. Prandaj, kemi obligim të madh që botës, e cila ka humbur rrugën, t'ia ofrojmë të Vërtetën. Islami, i cili nuk injoron shpirtin (idenë) dhe as materien,

¹³² *Ishte shpata që përhapri fenë islame apo e vërteta e saj*, Drita Islame, viti i botimit V, Tiranë, qershor, 1996, nr. 11 (94), f. 4.

gjegjesisht nuk tregohet mospërfillës ndaj kësaj dhe asaj bote, dhe i cili nuk bie ndesh me shkencën dhe logjikën, por është sintezë e tërë këtyre, ofron zgjidhje të mrekullueshme për një jetë të lumtur për mbarë njerëzimin”.¹³³

¹³³ Takvimi, Prishtinë, 1987, f. 128-130.

Kith Mur

Profesor i anatomisë dhe embriologjisë në Universitetin e Torontos, në Kanada. Ka udhëhequr shumë shoqata ndërkombëtare të anatomisë dhe embriologjisë në Kanada dhe në Amerikë, shoqatën e dijetarëve të biologjisë... Është zgjedhur anëtar i Shoqatës mbretërore të mjekësisë në Kanada, anëtar në Shoqatën e anatomisë për Amerikën e Veriut dhe atë Latine. Ka shkruar një numër librash, tetë libra prej tyre konsiderohen manual për studentët e mjekësisë.

“Jam shumë i gëzuar, që marr pjesë në shpjegimin e vargjeve kur’anore dhe thënieve të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], të cilat flasin mbi krijimin e embrionit. Jam plotësisht i bindur, se këto fakte, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i kanë ardhur nga Zoti, të cilat shkencë i zbuloi kohëve të fundit dhe pas një pune shumë të lodhshme.

Ky është fakt bindës, për mua, se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është i dërguari i Zotit”.¹³⁴

Alfred Kroner

Një ndër dijetarët më të njohur të gjeologjisë në botë, thotë:

“Duke menduar më thellë rreth këtyre çështjeve dhe rreth asaj se, nga i mori Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ato njohuri, kur dihet se ai ishte beduin dhe analfabet, besoj se është e pamundur që vetë ai, të mund të sillte njohuri kaq të sakta mbi gjithësinë dhe krijimin e saj. Këto dijetarët i zbuluan vetëm para disa kohësh, me anën e mjeteve të përsosura bashkëkohore.

Një njeri, që nuk dinte gjë për fizikën nukleare, sipas mendimit tim është e pamundur që me mendjen e vet, para 1400

¹³⁴ Abdul Mexhid Ez-Zendani, *Mrekullitë shkencore të Kur’anit*, Prishtinë, 2002, f. 15.

vitesh të zbulonte se toka dhe qiejt ishin një tërësi, apo dhe shumë çështje të tjera...

Besoj se të gjitha çështjet që janë përmendur në Kur'an, që kanë të bëjnë me tokën dhe krijimin e saj, si dhe me shkencën në përgjithësi, janë të vërteta të padiskutueshme. Këto mund të vërtetohen shkencërisht, prandaj mund të themi se Kur'ani është libër që përmban të vërteta shkencore. Vërtetimi i shumë të vërtetave të paraqitura në Kur'an, në atë kohë, që i pamundur. Sot shkenca bashkëkohore është në gjendje të vërtetojë atë që e tha Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] para 1400 vitesh".

"Pra, Kur'ani patjetër duhet të jetë i shpallur nga lartë, nga Zoti".¹³⁵

Profesor Marshall Xhonson

Përgjegjës i Katedrës së anatomisë "Tomas Xheferson", në Filadelfia të SHBA-së:

"Sikur të imagjinoja se do të kisha jetuar në atë kohë, me këto dije që kam mësuar deri më sot, s'do t'i përshkruaja dot gjërat, ashtu sikurse ato janë përshkruar në Kur'an. Unë nuk shoh se ka ndonjë shkas apo fakt, i cili tregon se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] posedonte ndonjë mjet, i cili i mundësoi marrjen e këtyre njohurive nga ndonjë vend. Për këtë arsye nuk shoh asgjë, që e bën të pamundur të kuptuarit se kjo ishte frymëzim ose Shpallje Hyjnore, të cilën ia arriti ta transmetojë".

"Po! Kur'ani është Shpallje nga Zoti".¹³⁶

¹³⁵ Ibid, f. 36-38.

¹³⁶ Ibid, f. 47, 48.

Profesor Jushjudi Kozan

Drejtor i institutit astronomik, në Tokio:

“Jam shumë i impresionuar me zbulimin e së Vërtetës në Kur’anin famëlartë. Para nesh, astronomët u morën me studimin e pjesëve të kufizuara në qiell, kurse ne jemi përqendruar në të kuptuarit e këtyre pjesëve. Nëpërmjet teleskopit, ne mund t’i shohim të gjithë pjesët kryesore në qiell. Ndërkaq, me leximin e Kur’anit, gjejmë edhe përgjigjen e pyetjeve. Besoj se unë, mund ta gjej rrugën time të ardhshme, për studimin e universit.

Unë njoha një metodë të re në studimin e universit. Atë duhet ta vështrojmë në mënyrë të përgjithshme dhe jo pjesërisht. Unë do t’i përmbahem kësaj metode. Pasi lexova Kur’anin dhe u njoha me vargjet kur’anore, të cilat flasin mbi universin, zbulova metodën e të studiuarit tim.

Në seminarët e mia të ardhshme, do të kem një vështrim të gjithanshëm, gjë të cilën e fitova nga libri i All-llahut”.¹³⁷

Xhuli Samsun

Profesor i gjinekologjisë, në universitetin North Western, në Çikago, SHBA:

“Unë besoj se nuk ka kundërshtim mes njohurive shkencore dhe shpalljes islame. Islami i përkrah dhe i nxit metodat shkencore. Revelata kur’anore, e cila iu shpall Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] para (më shumë se) 1400 vitesh, aludon në të vërtetat shkencore... Kjo dëshmon se Kur’ani është fjalë e Zotit”.¹³⁸

¹³⁷ Ibid, f. 53, 54.

¹³⁸ Ibid, , f. 61.

Profesor Hej

Është ndër dijetarët më të njohur të Oqeanologjisë në Amerikë, ai shprehet:

“Jam shumë i impresionuar që gjenden të tilla dije në Kur’anin e madhërishëm. Është shumë interesante, që këto të vërteta shkencore gjenden në Kur’an dhe vazhdimisht po punohet në zbulimin e domethënies së vargjeve të tij...”

“Besoj se, vërtet, këto vargje janë prej Zotit”.¹³⁹

Profesor Parsan

Përgjegjës i anatomisë në Fakultetin e mjekësisë në Kanada. Në një prej Seminareve ndërkombëtare mbi “Fenomenin shkencor në Kur’an dhe Hadith”, thotë:

“Më është shpjeguar se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte njeri i zakonshëm dhe nuk dinte shkrim e lexim. Ai jetoi para më shumë se 1400 vitesh, ishte analfabet dhe dha sqarime dhe shpjegime të thella, që çuditërisht përputhen me shkencën.

Unë, personalisht, nuk mund të them se kjo u bë rastësisht. Ka shumë gjëra që janë përmendur saktësisht. Prandaj, sikurse doktor Kith Mur edhe unë s’e kam të vështirë që të pranoj, me logjikën time, se: Kur’ani është inspirim ose Shpallje Hyjnore, që i është dhënë Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], për sqarimin e çështjeve”.¹⁴⁰

Profesor Balmar

¹³⁹ Ibid, f.

¹⁴⁰ Ibid, f. 75.

Është njëri prej dijetarëve më të njohur të gjeologjisë, në SHBA. Ishte kryetar i Shoqatës, e cila organizoi kremtimin e 100 vjetorit të Shoqatës Gjeologjike Amerikane. Ai thotë:

“Unë nuk e di se në çfarë shkalle të kulturës ishin njerëzit, që jetonin në kohën e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], nuk e di as nivelin e tyre shkencor... Nëse gjendja ishte ashtu si edhe te popujt e tjerë, ku njohuritë ishin në një shkallë të ulët, s’ka dyshim se këto njohuri, të cilat ne i lexojmë sot, në Kur’anin famëlartë, janë dritë nga dija e All-llahut, të cilën All-llahu ia shpalli Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]”.

Ai, seminarin e tij, e përfundoi me këto fjalë:

“Jam marrë me studimin e historisë së hershme të Lindjes së Mesme dhe nuk kam hasur të dhëna të tilla. Përderisa, në atë kohë, s’kishte kësisoj të dhënash, ky fakt më forcon bindjen se All-llahu, nëpërmjet Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], dërgoi pak dije nga Dija e Vet, të cilën, kohët e fundit, po e zbulon shkenca moderne. Ne do të vazhdojmë të merremi me aspektin gjeologjik në Kur’anin e madhëri-shëm”.¹⁴¹

Profesor Sijavejd

Është njëri ndër dijetarët më të shquar të gjeologjisë dhe hidrologjisë në Japoni. Është ndër dijetarët më me zë në botë. Në fillim kishte shumë dyshime rreth religjioneve në përgjithësi. Por, pasi i ofrohen shumë vargje kur’anore dhe thënie të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], që janë të lidhura me gjeologjinë dhe hidrologjinë, ai u shpreh:

¹⁴¹ Ibid, f. 80, 81.

“Më duket shumë misterioze, shumë! Madje, gati e pamundshme (ajo që lexova në Kur’an)... Vërtet, Kur’ani meriton vëmendje dhe kujdes. Unë pajtohem me këtë”.¹⁴²

Profesor Armstrong

Njëri ndër dijetarët e njohur të astronomisë në SHBA, punon në agjencinë e fluturimeve kozmike “NASA”. Kur u pyet se çfarë mendon për të vërtetat astronomike, të përmendura në Kur’anin famëlartë, ai u përgjigj:

“Kjo pyetje është mjaft e vështirë. Rreth saj kam filluar të mendoj... Jam shumë i impresionuar, se si Kur’ani përputhet plotësisht me astronominë bashkëkohore, gjë që zgjon kureshtjen e dijetarëve. Vërtet është shumë interesante... Është e pamundur që ato (të dhëna shkencore në Kur’an) të jenë rezultat i të dhënave shkencore të asaj kohe”.¹⁴³

Derga Bursad Rav

Profesor i oqeanologjisë. Tani është profesor në Universitetin “Melik Abdul Aziz”, në Xhide të Arabisë Saudite. Kur pyetet për mrekullitë shkencore në Kur’an, thotë:

“Është vështirë të imagjinohet se këto njohuri kanë ekzistuar në atë kohë, para 14 shekujsh. Edhe pse disa gjëra përfshijnë mendime të përgjithshme, përshkrimi i disa detajeve në hollësi është gjë shumë e vështirë. Nga kjo kuptohet se kjo s’është dije njerëzore, sepse njeriu i zakonshëm s’ka mundësi t’i shpjegojë këto fenomene me kaq përpikëri. Kjo më shtyn të mendoj për një Fuqi Mbinatyrore e Mbinjerëzore

¹⁴² Ibid, , f. 84.

¹⁴³ Ibid, f. 93, 94.

dhe më bën të besoj se këto njohuri kanë ardhur nga një Burim Hyjnor”.¹⁴⁴

Profesor Shruvejder

Një ndër dijetarët e oqeanologjisë në Gjermaninë Perëndimore, gjatë një simpoziumi të organizuar nga Universiteti mbretëror Abdul Aziz, në Xhide të Arabisë Saudite, pas një ligjërata të mbajtur nga dr. Abdul Mexhid Ez-Zendani, mbi fenomenin oqeanologjik, mes zbulimeve shkencore dhe vargjeve kur'anore, veç të tjerash (prof. Shruvejder) tha: “Dijetarët mendojnë se përparimi i shkencës ka hedhur dyshim rreth doktrinave fetare. Prandaj feja duhet t'i nënshtrohet shkencës. Ne këtu kemi të bëjmë me një qëndrim krejt tjetër... E vërteta e Kur'anit po zbulohet sot nga dijetarët bashkëkohorë. Unë jam i bindur se është me rëndësi që ky simpozium (në Xhide të A. Saudite), këtë të vërtetë, t'ua transmetojë dijetarëve të të gjithë popujve. Jam i bindur se të gjithë, pas këtij simpoziumi, do të kthehemi duke menduar më shumë rreth lidhshmërisë që ekziston mes oqeanologjisë dhe Kur'anit”.¹⁴⁵

Garry Miller

Në fjalimin e tij, të titulluar “Kur'ani i mahnitshëm”, parashtron shumë aspekte të çuditshme të Kur'anit të shenjtë. Në vazhdim do t'i përmendim vetëm tre aspekte. Aspekti i parë, është lidhja e çuditshme ndërmjet fjalëve dhe numrave. Shembujt që përfshijnë fjalën “Kalu”, që do të thotë “ata thonë”, e cila përsëritet 332 herë në Kur'an dhe

¹⁴⁴ Ibid, f. 107.

¹⁴⁵ Ibid, f. 110.

urdhri “Kul”, që do të thotë “thuj”, përsëritet gjithashtu 332 herë.

Shprehja “7qiejt”, shfaqet 7 herë në Kur’an.

Një vit ka 12 muaj, fjala “sheher” që do të thotë “muaj”, shfaqet 12 herë në Kur’an.

Fjala “jevm”, që do të thotë “ditë”, shfaqet 365 herë në Kur’an.

Një aspekt tjetër, i diskutuar nga Miller, ka të bëjë me dallimin midis përdorimit dhe kuptimit të fjalëve. Në përdorimin e një fjale ndodhet kuptimi i cili mendohet dhe në përmendjen e një fjale është vetë fjala e cila mendohet. Të analizojmë pohimin e mëposhtëm.

“Rinia është përpara burrërisë, vetëm me përjashtim të radhitjes në fjalor”. Në qoftë se ndokush, nuk e ka parasysh këtë dallim, atëherë, ka shumë mundësi që ta gjejë veten në ngatërresë.

P.sh. Miller shkruan se, në qoftë se ndokush thotë: “Nuk ka ndonjë gabim në Bibël”, ju mund të thoni se ai ka gabuar, po t’i tregoni atij pohimin ku thuhet: “Davidi bëri një gabim” dhe të tregosh fjalën “gabim”. Po ky mund të ishte një mashtrim, sepse Bibla nuk thotë se “nuk ka gabim në të”.

Është e habitshme, se Kur’ani ka shmangur edhe gabime të tilla.

Në Kur’an thuhet: *“A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur’anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie”*. (En-Nisa: 82)

Fjala arabe, e cila është përkthyer si “kundërthënie” është “ihtilafen”. Tani, deri sa Kur’ani thotë se, sikur të ishte prej dikujt tjetër, do të kishte disa “ihtilafen-kundërthënie”, dikush do të thoshte: ja një “ihtilaf-en” tjetër, pra Kur’ani ka “shumë” ihtilafen dhe nuk është hyjnor. Por, është e habitshme se fjala “ihtilafen” shfaqet vetëm një herë në tërë

Kur'anin dhe kjo vetëm në vargun dhe kapitullin e përmendur më lartë suren *En-Nisa*, ajeti 82.

Ndërkaq, ky problem është shmangur në këtë varg kur'anor, u thuhet:

"Ky është libri që nuk ka dyshim në te (sepse është prej Allahut)..." (El-Bekare: 2)

Pra, siç shihet këtu është përdorur fjala dyshim- rejb, e jo fjala kundërthënie-ihtilafen.

Një veçori tjetër e çuditshme, e cituar nga G. Miller, është fakti se sa herë që Kur'ani thotë "kjo është e ngjashme me atë", do të gjejmë që gjithmonë dy sendet e krahasuara do të përputhen në numrin e përgjithshëm, që secila përmendet në Kur'an.

Bile, çfarë është më mahnitëse, rreshti i cili përmend ato së bashku është ai, në të cilin ata janë në mënyrë ekzakte të barabartë, në qoftë se do të numëronim nga kapitulli i parë i Kur'anit.

Shembujt që vijojnë do të na bëjnë më të kuptueshme këtë.

All-llahu i Madhërishtëm në Kur'an thotë:

"Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) tek All-llahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha: Bëhu! Ai u bë". (Ali Imran: 59)

Ademi [alejhis-selam] është përmendur 25 herë në Kur'an.

Isai [alejhis-selam] - Jezusi është përmendur 25 herë në Kur'an.

Në kapitullin 3, ajeti 59, Ademi [alejhis-selam] përmendet për herë të shtatë, nëse numërojmë nga kapitulli i parë, njësoj në të njëjtin rresht, Isai [alejhis-selam] - Jezusi, përmendet për herë të shtatë nëse numërojmë nga kapitulli i parë i Kur'anit.

Në kapitullin 7, ajeti 176, Kur'ani i krahason me qentë, njerëzit që ndjekin dëshirat e tyre të kota dhe i përgënjeshtrojnë "Shenjat e Zotit". Shembulli i përgënjeshtrojes është sikur

ai i qenit... *"Shembulli i atyre që i konsideruan të rreme argumentet Tona"*, ngjashmëria e tyre është me një qen...

Shprehja *"Shembulli i atyre që i konsideruan të rreme argumentet Tona"* (el-ledhine kedh-dhebu bi ajatina) shfaqet për herë të parë në kapitullin e lartpërmendur (El-A'raf: 176)

Ademi [alejhis-selam] përmendet në rreshtat që vijojnë :
2:31; 2:33; 2:34; 2:35; 2:37; 3:33; 3:59 (shtatë herë).

Isai a.s.- Jezusi përmendet në rreshtat që vijojnë:

2:87; 2:136; 2:253; 3:45; 3:52; 3:55; 3:59 (shtatë herë).

Shprehja *"Shembulli i atyre që i konsideruan të rreme argumentet Tona"*, shfaqet si më poshtë:

7:176 (hera e parë), 7:177; 21:77; 25:36; 62:5 (pesë herë) .

fjala " qen " shfaqet si më poshtë:

7:176 (hera e parë), 18:18; 18:22; 18: 22, 18: 22. (pesë herë)

Kur Kur'an thotë: *"Kjo është e pangjashme me atë"*, numri total midis të dyjave është gjithashtu i pangjashëm.

Në kapitullin 14, vargu 26, All-llahu në Kur'an thotë:

"Dhe shembulli i fjalës së keqe është si një pemë e keqe që është shkukur mbi tokë e që nuk ka të qëndruar". (Ibrahim: 26)

Në Kur'an përmendet edhe 11 herë "pema" me asociacion ligësie dhe 11 herë "fjala" me asociacion ligësie. Të dyja këto fjalë përmenden për të gjashtën herë, në këtë ajet kur'anor.

Nëse analizojmë shembullin e parë, do të vërejmë se, nga momenti që Isai [alejhis-selam], përmendet për herë të parë në suren *El-Bekare*, ajeti 87, Ademi [alejhis-selam] tashmë është përmendur 5 herë duke i mbetur vetëm 2 herë. Megjithatë, Kur'an e zvogëlon këtë mosbalancim dhe në momentin kur dy emrat përmenden në suren *Ali Imran*, ajeti 59, janë të barabartë.

Pa dyshim Kur'an ka sfiduar ata që vënë në dyshim burimin e tij hyjnor dhe që duan të bëjnë një libër të ngjashëm

me të. Duket qartë se është më e arsyeshme të besohet se Kur'ani është një libër hyjnor.

Pra, dikush vetëm mund të mos e pranojë Kur'anin, por nuk mund të japë prova se ai është fals".¹⁴⁶

Annemarie Schimmel

Autore e njohur gjermane:

"Në Spanjë u provua përkthimi i parë i Kur'anit... Gjithsesi, Kur'ani i shpallur ndërmjet viteve 610 dhe 632 në Mekke, e pastaj në Medine, përkthyesit i shkaktën probleme gati të pakapërcyeshme. Për muslimanët, kjo është fjalë e Zotit, e shpallur në gjuhën e qartë arabe, e përkthimi i tij mund të jetë sipërfaqësor, pasi që askush nuk mund ta përcjellë bukurinë e pashoqe të fjalës së Zotit, në gjuhë tjetër. Shumë finesa dhe tinguj, që përcjellin çdo fjalë në gjuhën arabe, e bëjnë shumë të vështirë çdo përkthim nga gjuha arabe. Asnjë përkthim, nuk mund të prodhojë kuptim aq të mirë, sikurse origjinali, e kjo vetvetiu sjell deri te vështirësitë e të kuptuarit...

Shumë lëmenj të shkencave, që janë formuar me studimin e Kur'anit, sikurse arti, kaligrafia dhe recitimi i përshtatur i Kur'anit, i zhvilluar në përpjekjen që Fjalës së Zotit t'i jepet forma më e madhe, pastaj veprat klasike në gjuhët e botës islame - qoftë në gjuhën arabe, perse, turke, urde apo çfarëdo gjuhe tjetër, me të cilën flasin muslimanët, vështirë se mund të kuptohen pa njohje të drejtpërdrejtë të fjalorit të Kur'anit.

Për muslimanët, Kur'ani është Fjalë e Zotit, 'Libër i pakrijuar'.¹⁴⁷

¹⁴⁶ Për hollësira dhe shembuj të tjerë, shih apo dëgjo bisedën e Garry Millerit: "Kur'ani i mahnitshëm", mbajtur në Dubai, në vitin 1983, sipas Hamza Mustafa Njazi, op. cit., f. 75-77.

John Naish

“Kur’ani, me origjinalitetin e tij në gjuhën arabe, ka bukuri magjepsë dhe pushtuese, të cilat i posedon vetëm ai. Fjalët e tij kumbuese, me stil konciz dhe të mrekullueshëm, të dhëna shpeshherë në vargje-poezi, kanë fuqi shprehëse dhe forcë shpërthyesë.

Kjo gjë është, gati, e pamundur të ruhet edhe në përkthim”.¹⁴⁸

Dr. Steingass

Autor i fjalorit anglisht-arabisht, botuar në Londër më 1884, thotë:

“Meritat e Kur’anit, si krijim letrar, nuk duhen matur sipas disa maksimave paragjyquese të shijes subjektive dhe estetikë, por sipas efekteve që ai ka shkaktuar në bashkëkohësit dhe bashkatdhetarët e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Nëse ai, me aq forcë dhe arsye, ka folur për zemrat e dëgjuesve të tij, për sa i përket bashkimit të elementeve, deri tash centrifugale dhe antagoniste, në një tërësi kompakte dhe të organizuar mirë, të frymëzuar me idetë më të larta se ato, që deri tash kanë udhëhequr botëkuptimin arab, atëherë elokuenca e tij ka qenë e përkryer. Ai krijoi një popull të civilizuar, larg fiseve të egra dhe i dha një petk të ri themeleve të vjetra të historisë”.¹⁴⁹

Sydney Fisher

¹⁴⁷ Dr. Murad Hofmann, op. cit., f. 7-12.

¹⁴⁸ T. Nelaj, op. cit., nr. 3, f. 38.

¹⁴⁹ Pamfleti: Ç’thonë të tjerët për Kur’anin.

Profesor i historisë në Universitetin Ohajo, SHBA.

“Vërtet Kur’ani është fjala e All-llahut, që e bën për vete zemrën e muslimanit. Bukuria e tij shtohet kur besimtari e lexon me zë, por ai nuk e kupton këtë bukuri, ashtu sikurse, nuk e kanë kuptuar as shokët e tij, të cilët e kanë lexuar atë para tij, por, megjithatë e kanë pranuar elokuencën e Kur’anit.

Duke pasur parasysh ndikimin e jashtëzakonshëm të tij, tek zemrat e kënduesve dhe dëgjuesve, besimtarët, elokuencën e tij, e vlerësojnë përmes të dëgjuarit të Kur’anit.

Vërtet, Kur’ani është Libër edukativ dhe i kulturës. Ai nuk përmban vetëm rregulla të trashëgimisë dhe dispozita, por ka edhe vlera morale, për çka i porosit besimtarët. Ato vlera (kur’anore) janë ndër më të bukurat dhe më të saktat në lëmin e moralit. Udhëzimi i librit shfaqet përmes ndalesave dhe urdhërësive të tij”.¹⁵⁰

Basheer A. Shad

Ka lindur në vitin 1928. Rrjedh nga një familje e krishterë indiane. I ati i tij ishte misionar i krishter. Në vitin 1948 i përfundoi studimet e tij dhe filloi të punojë si misionar në Lahore. Mirëpo, si shumë të tjerë, pas një kohe e humbi bindjen e tij plotësisht në Krishterizëm. Pas 20 vjet studimi dhe përpjekjeje, arrin të deklarojë pranimin e Islamit.

“Kur besova njësinë e Zotit, fillova të kërkoj fakte dhe argumente që provojnë se Kur’ani është Libër i All-llahut të Madhërishëm, se është Libri i fundit qiellor dhe përmbyllje e tyre. Falënderoj All-llahun, që më mundësoi ta zgjidhja këtë çështje. Kur’ani fisnik, është libri i vetëm që i pranon të gjithë librat e tjerë qiellorë. Ndërkaq, të gjitha fetë e tjera, e

¹⁵⁰ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 78.

refuzojnë njëra-tjetrën. Kjo, në të vërtetë, është një nga veçoritë dhe specifikat e Kur'anit fisnik, librit të fundit dhe vulës së librave qiellorë.

Kur'ani është Libri i vetëm qiellor, i cili mësohet përmendësh, nga mijëra njerëz të vendeve të ndryshme të botës. Kurse librat e tjerë të shenjtë ruhen vetëm përmes mënyrës së shkruar. Prandaj, nëse ndodh që të zhduken librat e shkruar, Kur'ani, megjithatë, vazhdon të jetë Libri i vetëm i Zotit (i ruajtur) në gjokse (të besimtarëve). Kështu, ai ka të drejtë të mburret se ka qëndruar i sigurt larg ndryshimeve, se nuk i është hequr e as nuk i është shtuar qoftë edhe një shkronjë e vetme, që nga koha kur i është shpallur të Dërguarit të Zotit. Në të s'ka kurrfarë kundërthënie apo gabimi, çfarëdo qoftë ai. Ndërkaq, librat e tjerë qiellorë, në kopjet e tyre të sotme, janë përplot me ndryshime dhe shtrembërime. Ky është një shkak shtesë, që ka bërë që unë ta pranoj Islamin".¹⁵¹

Luis Sedilot (1808- 1876)

Orientalist francez:

"Në Kuran nuk gjen ajet, që nuk inspiron dashuri të fortë ndaj All-llahut, që nuk stimulon fuqishëm në ndershmëri dhe që përmes rregullave të veçanta nuk bart norma, që kanë të bëjnë me sjellje morale, thirrje të fortë për këmbim të ndjenjave, që nuk nxit qëllim të mirë dhe falje, edhe ndaj atyre që fyejnë. Ajetet kur'anore, na bëjnë me dije se mëkati mund të bëhet edhe përmes të menduarit dhe të parit. Ato na nxisin në plotësimin e premtimit, madje edhe ndaj mos-besimtarëve... në të qenit modest, që të kërkojmë falje për njerëzit që bëjnë keq dhe jo t'i mallkojmë. Mjaftojnë këto

¹⁵¹ Ibid, f. 74.

fjalë gjithëpërmbledhëse, përplot urti dhe udhëzim, për të forcuar dëlirësinë e rregullave morale në Kur'anin fisnik... Ai ka përfshirë çdo gjë. Kur'ani ka shërbyer si shembull për metodat dhe rregullat e gjuhës arabe. Kjo imponoi zhvillimin e shkencave të gjuhës. Ajo që vlen të përmendet është fakti se, pavarësisht nga gjuhët e ndryshme, të cilat i flasin popujt muslimanë, që nga Azia deri në Indi dhe që nga Afrika deri në Sudan, Kur'ani është Libër që e kuptojnë të gjithë. Këta popuj, me veti të ndryshme, i lidh lidhja e gjuhës dhe e ndjenjave".¹⁵²

H. Serouya

Orientalist francez:

"Kur'ani është prej Zotit, ka stil të lartë dhe të përkryer. Me stilin e tij s'mund të krahasohet asnjë stil njerëzor. Njëkohësisht (ai është revolucion në fushën e besimit, nuk njeh as papatin, as ndonjë institucion klerikal ose priftëror). Islami asnjëherë nuk ka treguar ndonjë dozë frike, ose të jetë trembur nga parimi i të gjykuarit logjiko-filozofik.

Nëse e krahasojmë Islamin me Krishterizmin dhe Hebraizmin, do të gjejmë vija ndarëse, sidomos me Krishterizmin. Sistemi i krishterë dhe ai hebraik dallojnë nga ai islam. Në Islam, nuk ka zbrazëti në mes Krijuesit dhe njerëzve. Kjo zbrazëti, te hebrenjtë dhe të krishterët, është përplot ndërmjetësues, gjë që bie ndesh me Islamin.

Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] edhe pse ishte pejgamber dhe i dërguar i Zotit, nuk u shfaq duke mohuar misionin e Musait ose Isait. Gjithë përpjekjet e tij ishin që të largonte, prej Zotit, gjithë atë që ia kishin mveshur njerëzit më herët, si p.sh Trinitetin.

¹⁵² Ibid, f. 72.

Ai ka tërhequr vërejtjen se Isai [alejhis-selam] s'është tjetër, veçse i biri i Merjemes dhe jo biri i Zotit, se thënia se 'Zoti ka bir' është politeizëm (shirk) i rëndë, nga i cili mund të çahen qiejt, të copëtohet toka dhe të fluturojnë malet. Kurse Shpirti i shenjtë është një engjëll, Xhibrili, misioni i të cilit ishte që Isait dhe Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] t'ia sillte thirrjen e shenjtë. Maria (Merjemja) është një zonjë e ndershme, e jo nëna e Zotit".¹⁵³

Dr. A. N. Sousa

Inxhinier dhe studiues nga Iraku, me origjinë çifute. Nën ndikimin e Kur'anit, pranon fenë islame. Ka shkruar shumë studime, ka shkruar edhe kundër pretendimeve sioniste botërore nga aspekti historik.

"Afrimi im kah Islami filloi atëherë, kur fillova të lexoj Kur'anin e shenjtë për herë të parë... Isha i magjepsur nga një ngazëllim i fuqishëm, isha ndikuar nga leximi i ajeteve kur'anore. Shtrembërimi dhe devijimi që i është bërë librave të çifutëve (Dhiatës së Vjetër), është një gjë, për të cilën, pajtohen të gjithë dijetarët e kohës së sotme si rezultat i studimit dhe kërkimit të tyre. Në mënyrë shkencore, mund të vërtetohen thëniet që, nëpërmjet gjuhës së Pejgamberit fisnik arab, janë shpallur qysh para 14 shekujsh.

Ndërkaq, Kur'ani fisnik, të cilin muslimanët e kanë ruajtur me kujdes të madh dhe amanet të besueshëm, është libri i shenjtë unikal, për çka pajtohen të gjithë se, ai është ruajtur dhe ka qëndruar larg çdo lloj shtrembërimi dhe devijimi. Në fakt, argumentet historike janë të qarta dhe të prera dhe s'lënë vend për kurrfarë dyshimi se, Kur'ani ka mundur të ketë çfarëdo shtrembërimi ose devijimi. Fjala e All-llahut,

¹⁵³ Ibid, f. 73, 74.

me përsosmërinë e saj, ka ardhur përmes gjuhës së Pejgamberit të Tij, pa u ndryshuar qoftë edhe një shkronjë e vetme. All-llahu i Madhërishëm, mrekullinë e Kur'anit dhe analfabetizmin e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i ka bërë argument për vërtetësinë e peygamberisë së tij dhe vërtetësisë hyjnore të Kur'anit".¹⁵⁴

S. Salhab

Autor i krishter, nga Libani.

"Vërtet, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte analfabet dhe s'dinte shkrim e lexim... dhe ja ky njeri analfabet i dhuroi njerëzimit librin më të mrekullueshëm, të cilin ai e ëndërronte qysh prej kohësh. Ai është Kur'ani fisnik, libri, të cilin All-llahu i Madhërishëm ia zbriti Pejgamberit të Vet, udhëzim për njerëzit e devotshëm.

Islami s'ka nevojë për pendën tonë, sado që penda jonë të arrijë elokuencën dhe përshkrimin. Penda jonë ka nevojë për Islamin, për pasurinë e tij shpirtërore dhe morale që përmban ai, ka nevojë për Kur'anin e mrekullueshëm, nga i cili mund të mësojmë shumë.

Asnjë nga librat e mëparshëm, cilado qoftë vlera e tyre, nuk pati fatin që t'i kushtohet kujdes dhe vëmendje dhe t'i mundësohen metodat e ruajtjes nga humbja dhe shtrembërimi, sikurse ngjau me Kur'anin, i cili është ruajtur nga humbja dhe shtrembërimi. Kur'ani është mbrojtur nga ato shtrembërime, që u kanë ndodhur librave të mëparshëm. Kjo gjuhë, që deshi All-llahu (të jetë gjuhë e Kur'anit) është gjuhë e përkryer, kulmi i saj është Kur'ani, i cili është maja e majave, sepse ai është fjala e All-llahut".¹⁵⁵

¹⁵⁴ Ibid, f. 70-72.

¹⁵⁵ Ibid, f. 69, 70.

J. S. Restler

Studiues bashkëkohor, francez.

“Meqë bukuria e Kur’anit qëndron në stilin e tij të mrekullueshëm, ai ka zbritur për t’u lexuar ose për t’u kënduar me zë të lartë dhe asnjë përkthim s’mund ta shprehë dallimin preciz dhe përplot ndjeshmëri orientale. Duhet ta lexosh në gjuhën e tij (arabe), në të cilën është shkruar, që të arrish të ndiesh gjuhën e tij, fuqinë shprehëse dhe madhështinë e formës së tij. Muzikaliteti dhe rima e tij sajojnë ndikim magjik në shpirt, ku shndrisin mendimet me fuqinë e tyre dhe pamjet me shkëlqimin e vet. Askush, s’mund të mohojë se ritmi i tij mahnitës dhe spiritualiteti i tij i shkëlqyer, ndikojnë në ndijimin tonë, dhe në atë se Muhammedi [sallallahu alejhi ve sel-lem] është i frymëzuar nga madhëria dhe madhështia e All-llahut.

Kur’ani, ofron zgjidhje, për të gjitha çështjet dhe vendos lidhje, mes ligjit fetar dhe atij moral. Ai përpaket të sjellë rend dhe kompaktësi shoqërore, largim nga mjerimi, arroganca dhe besëtytnitë. Ai i ndihmon të dobët, porosit mirësi dhe urdhëron mëshirë. Në fushën e legjislacionit, janë vendosur rregulla, për çështjet më precize të jetës së përditshme, është caktuar kontrata, trashëgimia sa i përket familjes dhe sjellja e çdo individi në raport me fëmijët, skllëvërit, kafshët etj”.¹⁵⁶

George Sarton (1884-1956)

Ka lindur në Belgjikë. Ka doktoruar në shkencat natyrore dhe matematikore. Ka ligjëruar në Universitetin e Uashingtonit dhe të Harvardit. Ka qenë anëtar nderi i dhjetë akademive shkencore, në shumë universitete botërore.

¹⁵⁶ Ibid, f. 66, 67.

“Gjuha e Kur’anit, e cila është gjuha, që e ka zgjedhur Zoti i Madhërishëm dhe i Lartësuar për shpallje, është e plotë. Kur’ani kontribuoi në lartësimin e gjuhës arabe në shkallën më të lartë të mundshme, në të shprehurit e qëllimeve, dhe atë e bëri mjet për të shprehurit e kërkesave më të larta jetësore”.¹⁵⁷

Bozena - Gajane Stryzewska

Studiuese bashkëkohore polake.

“Kur’ani fisnik, edhe pse i është shpallur një njeriu analfabet arab, që u rrit në një shoqëri injorante, ka sjellë ligje, të cilat njeriu s’mund t’i mësojë veçse në universitetet më të zhvilluara... Në Kur’an, gjithashtu gjejmë të vërteta shkencore, të cilat bota ka filluar t’i njohë pas shumë shekujsh”.¹⁵⁸

G. Hanna

I krishterë nga Libani.

“Doemos, duhet të pranojmë, se Kur’ani krahas asaj se është libër i fesë dhe i legjislacionit, gjithashtu, është edhe libër i gjuhës së pastër arabe.

Gjuhës së Kur’anit i takon mirënjohja më e madhe në zhvillimin e gjuhës arabe. Gjuhëtarët, qofshin ata muslimanë ose të tjerë, gjatë sqarimit të fjalëve (ose në vendosjen e rregullave të gjuhës arabe) i janë drejtuar Kur’anit dhe atë e kanë pasur pikëmbështetje”.¹⁵⁹

Washington Irving

¹⁵⁷ Ibid, f. 67.

¹⁵⁸ Ibid, f. 68.

¹⁵⁹ Ibid, f. 58, 59.

Orientalist amerikan, i ka kushtuar vëmendje të madhe historisë së muslimanëve në Andaluzi, Spanjë. Ka shkruar veprën “Çlirimin e Granadës”, “Jeta e Muhammedit”. Ai thotë:

“Teurati, në një kohë, ishte udhërrëfyes i njeriut dhe bazë për sjelljen e tij. Kur u shfaq Mesihu [alejhis-selam], të krishterët i ndoqën mësimet e Ungjillit. Pastaj, Kur’ani zuri vendin e atyre të dyjave (Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re). Kur’ani është më universal dhe më analitik se dy librat e mëparshëm. Ai, gjithashtu, i ka korrigjuar modifikimet dhe ndryshimet që u janë bërë më herët, dy librave të mëparshëm (Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re). Kur’ani përfshin çdo gjë, përmbledh të gjitha ligjet, ai është vulë dhe kurorëzim i librave qiellorë. Kur’ani fton në mëshirë, dëlirësi dhe moral të lartë”.¹⁶⁰

Dr. R. L. Blachere

Ka lindur afër Parisit, ka mbaruar Fakultetin e gjuhës arabe, në vitin 1936 ka doktoruar. Ka qenë ligjërues në Universitetin e Sorbonës. Ka shkruar shumë për letërsinë arabe. Ka bërë edhe përkthimin e Kur’anit në gjuhën franceze.

“Mirënjohja, pas Zotit, i takon halifit Uthman b. Afvan [radijall-llahu anhu], i cili bëri që, para vitit 655, të evitohet rreziku i ndryshimit nga kopjet e Kur’anit.

Vetëm atij, muslimanët duhet t’i jenë mirënjohës për ruajtjen e tekstit (original) të librit të tyre të shpallur, për të gjitha gjeneratat e ardhshme.

Kur’ani, nuk është mrekulli vetëm me përmbajtjen dhe mësimet e tij, por, para së gjithash, ai është kryevepër e

¹⁶⁰ Ibid, f. 50.

mrekullueshme letrare, e cila i tejkalon të gjitha kryeveprat, që i ka pranuar dhe i ka lavdëruar njerëzimi.

Halifi i ardhshëm Umer b. Hattabi [radijall-llahu anhu], në fillim kundërshtar i ashpër i fesë së re, pas dëgjimit të një pjese nga Kur'ani, gdhiu si një nga përkrahësit më të flaktë të kësaj feje.

Pamundësia e të imituarit (të Kur'anit), është mrekulli, që vërteton thirrjen e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sellem], i cili gjatë të folurit të tij të përditshëm nuk arriti nivelin e përkryer të Kur'anit".¹⁶¹

M. Poizar

Mendimtar dhe jurist francez bashkëkohor, i ka kushtuar kujdes të madh çështjeve të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut, ka shkruar një numër të madh artikujsh rreth këtyre çështjeve.

"Gjatë definimit të tekstit të shenjtë në Islam, doemos duhet të përmendim dy gjëra:

1. Kur'ani është libër i shpallur e jo i krijuar; dhe
2. Kur'ani është fjalë e gjallë në zemrën e Ummetit. Ai është mes Zotit dhe njeriut dhe e bënë joserioze prezencën e çfarëdolloj institucioni klerikal.

Kur'ani nuk është kufizuar asnjëherë, vetëm, në përmirësimin e moralit të arabëve të kohës së injorancës. Përkundrazi, ai ka Sheriatin e tij të amshueshëm dhe të përkryer, i cili i përgjigjet të vërtetave njerëzore dhe kërkesave shoqërore të çdo kohe.

Parimet, që i ofron shpallja kur'anore, bëjnë të mundshme, pa dyshim, rregullimin e shoqërisë bashkëkohore".¹⁶²

¹⁶¹ Ibid, f. 52, 53.

¹⁶² Ibid, 53, 54.

R. Landau

Kritik artistik anglez. Ka ligjëruar në shumë universitete amerikane, nga viti 1952-1957. Profesor i studimeve islame, ka shkruar disa libra, që kanë të bëjnë me Islamin dhe muslimanët.

“Përkthimi i Kur’anit me një fuqi të tillë ritmike, kërkon, krahas njohurive gjuhësore dhe shkencore që duhet të posedojë përkthyesi, edhe përkujdesjen e tij në këtë detyrë shumë të vështirë.

Deri vonë, nuk kemi njohur ndonjë përkthim të mirë, që ka mundur të vjelë diçka nga fryma e shpalljes muhamedane. Në realitet, shumë përkthyes të mëparshëm, jo vetëm se nuk ia dolën, që të ruanin bukurinë origjinale, por ata ushqenin urrejtje të plotë ndaj Islamit, dhe atë, deri në atë masë sa që edhe përkthimi i tyre i shërbente këtij qëllimi.

Megjithatë, edhe përkthimi më i mirë i mundshëm në formë të shkruar, nuk mund ta ruajë ritmin e mrekullueshëm muzikal të sureve, ashtu sikurse e lexojnë muslimanët (në gjuhën arabe).

Perëndimori nuk mund të kuptojë asgjë nga bukuria dhe fuqia shprehëse e fjalëve të Kur’anit, nëse ai nuk dëgjon ndonjë pjesë të tij kur lexohet në origjinal (në gjuhën arabe).

Shkruesi i Shpalljes, Zejd b. Thabiti [radijall-llahu anhu], është ngarkuar me tubimin e ajeteve kur’anore në formë Libri. Ebu Bekri [radijall-llahu anhu], e ka mbikëqyrur këtë mision. Pas tij, me përpjekjet e Halifit Uthman b. Affvani [radijall-llahu anhu], Kur’ani mori formën e tij definitive legislative dhe ashtu na ka arritur i paprekur, duke mos iu ndryshuar qoftë edhe një shkronjë e vetme”.¹⁶³

¹⁶³ Ibid, f. 85, 86.

Kwelem

Mendimtar anglez, ka lindur më 1856, kurse më 1887, ka pranuar Islamin dhe ka marrë emrin Abdullah.

“Pavarësisht se Kur’ani është libër i shpallur, për nga aspekti shkencor, është libri më i përsosur në Lindje. Në mesin e shumë bukurive të Kur’anit, janë dy gjëra shumë të qarta:

1. Shenja e devotshmërisë dhe qetësisë, e cila haset vazhdimisht te muslimanët, kur flasin për Krijuesin dhe kur tregojnë për drejtësinë e Tij;
2. Kur’ani nuk përmban legjenda, kundrëthënie, dobësi dhe të meta, etj.

Ndërkaq, të krishterët janë në pozitë të palakmueshme me librin e quajtur Dhiata e Vjetër, sa i përket kësaj gjëje. Në Enciklopedinë e Përgjithshme (Popular), në një ekzemplar, shkruhet: Kur’ani ngërthen në vete elokuencën dhe stilin më të lartë të gjuhës arabe. Stili i tij i bukur dhe kompozimi i mrekullueshëm ka bërë që ai të jetë i paimitueshëm dhe i pashembullt. Dispozitat e tij logjike janë të pastra dhe të urta. Nëse njeriu mediton sa dhe si duhet, do të jetojë një jetë të qetë”.¹⁶⁴

Enciklopedia Britanike

Shkruan: “Kur’ani është Libri më i lexuar në sipërfaqen e Tokës”.¹⁶⁵

Lady E. Cobold

Anglez, ka pranuar Islamin.

¹⁶⁴ Ibid, f. 83, 84.

¹⁶⁵ Ebul Hasen En Nedevi, op. cit., shih fusnotën 141.

“Kam përmendur, gjithashtu, atë që është thënë në Kur’an, për krijimin e universit, se si All-llahu i Madhërishëm ka krijuar çdo gjë çift. Këtë gjë e dëshmon shkenca bashkëkohore, pas zbulimeve të gjata që kanë bërë shumë breza.

Ndikimi i Kur’anit, në gjithë këtë përparim, nuk mund të mohohet. Kur’ani është ai që i nxiti arabët të çlirojnë botën dhe të formojnë një perandori, që ia ka kaluar perandorisë së Lekës së Madh për nga begatia, fuqia, ndërtimi dhe civilizimi.

Fjala e Kur’anit dhe stili i tij i mrekullueshëm është një gjë, që realisht s’mund ta përshkruajë dhe ta përcaktojë pena. Përkthimi, pa dyshim, e privon Kur’anin nga bukuria, madhështia dhe muzikaliteti i fjalëve që posedon ai, gjë e cila s’mund të gjendet tek librat e tjerë”.¹⁶⁶

Cte Henry de Castries

Shkrimtar francez i kohës sonë, thotë:

“Njeriut i ndalet mendja para faktit, se si mundet që këto ajete (vargje kur’anore) të dalin prej një njeriu analfabet. Gjithë Lindja, e pranon se ato janë ajete të paarritshme për mendjen njerëzore. Mendja njerëzore s’mund të formulojë vargje të ngjashme me to, si në aspektin gjuhësor, ashtu edhe në atë përmbajtësor. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] Kur’anin e solli nga Zoti si argument për vërtetësinë e pejgamberisë së vet. Kur’ani, deri në ditët tona, vazhdimisht, ka mbetur fshehtësi, i cili qëndron mbi intelektin njerëzor”.¹⁶⁷

“Kur’ani, edhe sot e kësaj dite, vazhdon të jetë përplot margaritarë që vështirë zbulohen. Këta margaritarë të fshehtë,

¹⁶⁶ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 81, 82.

¹⁶⁷ Mahmud b. Sherif, *Muslimanët nga Perëndimi*, Takvimi, Sarajevë, 1976/1396, f. 66.

s'mund t'i ndiejë, veçse ai, që beson se Kur'ani është shpallur nga All-llahu i Madhërishëm. Ne shohim ngjashmëri, në mes Kur'anit dhe Teuratit, në disa çështje. Por, shkaku i kësaj ngjashmërie është i kuptueshëm, kur dihet se Kur'ani ka ardhur për të plotësuar Teuratin dhe se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], është vulë e lajmëtarëve dhe të dërguarve të Zotit".¹⁶⁸

¹⁶⁸ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 62.

Mardiel

Orientalist francez, të cilin qeveria franceze e ka autorizuar për përkthimin e disa sureve kur'anore, thotë:

“Stili i Kuranit është stil i Krijuesit të madhërishëm, sepse esenca nga ku rrjedh ky stil, s’mund të jetë veçse hyjnor. Është e vërtetë dhe reale se shumë autorë, të cilët në fillim hezitonin dhe dyshonin, u dorëzuan para ndikimit të forcës dhe mrekullisë së tij. Ndikimi i Kur’anit mbi miliona muslimanë, anekënd rruzullit, ishte deri në atë masë, sa që misionarët e huaj kanë pranuar në mënyrë konsensuale pamundësinë e vërtetimit të madje të një rasti të vetëm, të largimit të ndonjë muslimani nga feja e tij. Kjo, sepse ky stil kur’anor, me elokuencën e tij, në përshtatje të harmonizuar homogjene, ka pasur ndikim të thellë te secili dëgjues, që e kuptonte gjuhën arabe. Gjithashtu, ishte e kotë dhe pa fryt përpjekja, që njeriu të mundë ta përcjellë këtë rimë të shkëlqyer (gjatë përkthimit të tij), gjë që s’mund ta dëgjojë në asnjë gjuhë tjetër”.¹⁶⁹

¹⁶⁹ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 82.

KAPITULLI III

PËR MUHAMMEDIN [SAL-LALL-LLAHU
ALEJHI VE SEL-LEM]

Bernard Show

Në "The Genuine Islam, voll.1, nr. 81936", për Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thotë:

"Gjithnjë e kam çmuar lartë besimin e Muhammedit, thjesht për shkak të vitalitetit të tij të jashtëzakonshëm. Mendimi im është se, Islami është besimi i vetëm i aftë, që të drejtojë me sukses ndryshimet e shumta të jetës. Unë parashikoj që Evropa, më në fund, do të pranojë fenë islame. Teologët mesjetarë të krishterë nga padituria dhe animi fetar, besimin e Muhammedit, e kanë paraqitur në mënyrë krejtësisht negative dhe kanë konsideruar se Muhammedi ka ushqyer urrejtje ndaj Isait (Jezusit). Unë e kam studiuar jetën e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Ai, është njeri i mrekullueshëm, e sipas mendimit tim, ai është larg nga të qenët antikrisht.

Atë, duhet ta quajmë shpëtimtar të njerëzimit. Jam i bindur se, një njeri i ngjashëm me të, po të merrej me problemet e kohës moderne, do t'i kishte zgjidhur me sukses ato, duke i sjellë njerëzimit paqen dhe lumturinë e nevojshme. Kam parashikuar se besimi i Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] do të jetë i pranueshëm për Evropën e nesërme, ashtu siç ka filluar të bëhet i pranueshëm, për Evropën e sotme".¹⁷⁰

¹⁷⁰ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 81. Pamfleti: *Ç'thonë të tjerët për Islamin*.

Gëte

Thotë: “Njeri i shkëlqyer, dritë e Zotit, u përpoq që, atë dritë, ta përhapte në botë, por bota u ngrit kundër tij. Detyrohet të bëjë kompromis, derisa të vinte çasti që të ndikonte tek ata. Në histori, kërkova shembullin e një njeriu të shkëlqyer, e atë e gjeta te pejgamberi arab”.¹⁷¹

“Ai është pejgamber dhe jo poet.”..¹⁷²

“Mrekulli nuk mund të bëj, tha

pejgamber,

Mrekullia më e madhe është që unë jam”.¹⁷³

“Kreu i qenieve të krijuara / Muhammedi”.¹⁷⁴

“Jezusi ndjehej i pastër dhe qetësisht mendonte

(për) Një dhe të Vetmin Zot;

Kush atë vetë në Zot e shndërroi

Ka fyer vullnetin e tij të shenjtë.

Dhe kështu duhet e drejta të ndriçojë

Atë që edhe Muhammedi mori;

Vetëm me konceptin e (Zotit) Një

Ai gjithë botën ka mbizotëruar”.¹⁷⁵

“Dhe tash më vjen ti, me një shenjë

Varur, që mes të tjerash...

Më tepër e përçmoj.

¹⁷¹ *Mendimet e njerëzve eminentë botëror për Muhammedin a.s.* Dituria Islame, Prishtinë 1991, nr. 25, f. 24.

¹⁷² Divani, Wa I, 7, 32, shih: Shejh Abdulkadir Al Murabit, op. cit., f. 23.

¹⁷³ Gëte theksoi hedhjen poshtë të sfidës së mosbesimtarëve ndaj Muhammedit a.s., të cilët kërkonin që të bënte mrekullira, Paralipomena III, nga Divani, WA I, 41, 307, Shejh Abdulkadir Al Murabit, po aty, f.17.

¹⁷⁴ Kështu shkruan Gëte në një dorëshkrim të Paralipomena III, 31, më date 27. 01. 1816, WA I, 6, 482, ibid, f. 18.

¹⁷⁵ Gëte hedh poshtë pikëpamjen e krishterë rreth Jezusit dhe pohon njëshmërinë e All-llahut, në njëren nga poezitë e tij në West-Ostlicher Divan, ibid, f. 7.

Gjithë këtë çmenduri moderne
 Do të ma sjellësh në Schiras!
 U dashka që unë, në gjithë obsesionin e saj,
 Të këndoj për dy copa druri të kryqëzuara?"
 "Dashke të bësh për mua Zot
 atë figurë të mjerë në (atë copë) dru!"¹⁷⁶
 "E ashtuquajtura ruzare muhamedane, në të cilën emri i All-
 llahut lartësohet me nëntëdhjetenëntë cilësi, është një litani e
 tillë lëvdimi. Cilësi pohuese e mohuese, tregojnë të pakon-
 ceptueshmen Qenie (Wesen); lutësi mbetet i mrekulluar,
 nënshetrohet dhe qetësohet".¹⁷⁷

Lamartini

Njëri nga poetët më të mëdhenj të Francës, për madhështinë
 e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në "Historia
 de la Turquie", shkruan:

"Kurrë njeriu nuk i ka venë vetes, vullnetarisht apo detyri-
 misht, qëllim më të lartë... Të rrënohen besëtytnitë, që ishin
 vënë ndërmjet njeriut dhe Krijuesit... Që njeriu t'i kthehet
 Zotit dhe të përtërihet ideja e arsyeshme dhe e pakontes-
 tueshme mbi hyjninë, në kohën e kaosit, të materializmit
 dhe të vizioneve idhujtarë rreth Zotit, të cilat ekzistonin
 atëherë.

Kurrë njeriu nuk e ka pranuar, një detyrë aq të paarritshme,
 për aftësinë njerëzore, me mundësi aq të dobëta, sepse si në
 ide, ashtu edhe në zbatimin e atij plani të madh, nuk ka
 pasur kurrfarë përgatitje të veçantë dhe kurrfarë ndihme,
 përveç një grushti të thjeshtë njerëzish, që jetonin në skajet e
 shkretëtirës.

¹⁷⁶ Gëte ndien shumë përcëpim ndaj simbolit të kryqit, ibid, f. 8.

¹⁷⁷ Në kapitullin e "Divanit..."., për Rumiun, Gëte përshkruan të drejtuarit
 me lutje e lëvdime, ndaj All-llahut dhe bekimin për këtë, ibid, f. 9, 10.

Kurrë, njeriu nuk ka kryer një revolucion aq të madh dhe të vazhdueshëm në botë, pasi për më pak se dy shekuj pas shfaqjes së tij, Islami përmes bindjes dhe forcës, në emër të Zotit, ka dominuar përgjatë tërë Arabisë, Persisë, Horasanit, Transaksonisë, Indisë, Sirisë, Abisinisë, përgjatë të gjitha vendeve të njohura të Afrikës Veriore, ujdhesave në Mesdhe, Spanjë etj...”

“Nëse madhështia e qëllimit, thjeshtësia e mendimit dhe rezultatet e arritura, janë tri kritere të gjenialitetit njerëzor, kush mund të marrë guximin të krahasojë, cilindo njeri të madh, në historinë njerëzore, me Muhammedin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]?”

Njerëzit më të njohur kanë vendosur vetëm ushtri, ligj dhe shtet. Ata s`kanë formuar asgjë më tepër se potenciale materiale, të cilat shpesh u zhdukën para syve të tyre. Ky njeri, ka nisur jo vetëm armatat, legjislacionet, shtetet, dinastitë dhe popujt, por miliona njerëz, 1/3 e botës së banuar të asaj kohe, madje edhe më shumë, më tepër se kjo: ai ndryshoi altarët, zotat, fetë, idetë, besimet dhe shpirtrat. Në bazë të Kur'anit, me çdo shkronjë që bëhej ligj, ndërtoi nacionalizmin shpirtëror, që është i pranuar për njerëzit e çdo territori gjuhësor dhe racor. Ai na ka lënë, si karakteristikë të pashlyeshme të nacionalizmit musliman, urrejtjen kundrejt zotave të rrejshëm dhe synimin për një Zot të pamaterializuar. Kjo rezistencë e patriotizmit, kundër bastardimit të besimit në Zot, u ka dhënë fuqi ithtarëve të Muhammedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Marrja e një të tretës se botës, përmes fesë së tij, qe mrekulli nga ana e tij.

Ideja e unitetit të Zotit, që e proklamoi midis trillimeve për zotat e ndryshëm, ka qenë e tillë, që mundi të rrënojë të gjithë tempujt e lashtë të idhujve, duke frymëzuar me fenë e tij një të tretën e botës. Jetën, përsiatjet dhe guximin e tij, ia kushtoi luftës kundër besëtytnive. Guximi i tij në kundërsht-

timin e idhujtarisë, qëndrueshmëria gjatë qëndrimit 13 vjet në Mekke, pranimi i njerëzve të përbuzur publikisht dhe gati të shtypur nga ana e bashkëkohësve, predikimi i tij i pandërprerë, lufta kundër pabarazisë, besimi i patundur në sukses, durimi mbinjerëzor gjatë sprovave, modestia në fitore, ambiciet e tij, të cilat kanë qenë të orientuara drejt një ideje, lufta e pafund dhe e vazhdueshme, bisedat mistike me Zotin, vdekja dhe triumfi pas vdekjes, të gjitha këto dëshmojnë jo për mashtrim, shtirje dhe gënjeshtëri, por për vendosmërinë e tij të fortë, që të përtërihet feja.

Kjo fe, ka pasur dy parime themelore: Zoti është Një dhe Ai nuk është material. Parimi i parë, tregon se çfarë është Zoti, kurse i dyti, se çfarë s`mund të jetë Zoti.

Muhammedi që përmbysës i zotave të rremë me shpatë, vendosës i idesë me fjalë. Filozof, orator, mësues, ligjvënës, luftëtar që luftoi për idetë e tij, përtëritës i besimit racional dhe adhurimit pa fotografi, themelues i 20 perandorive tokësore dhe i një perandorie shpirtërore. Ky është Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Duke marrë parasysh të gjitha kriteret, me të cilat mund të matet madhështia njerëzore, me të drejtë pyesim: A ekziston njeri më i madh se ai?¹⁷⁸

Leon Nikolajeviq Tolstoi

Shkrimtar i madh rus, në traktatin "Pejgamberi urtiplotë Muhammed", veç të tjerash, thotë:

"Nuk ka dyshim, se pejgamberi Muhammed, është njëri ndër reformatorët më të mëdhenj të njerëzimit. Atij i takon lavdia më e madhe, që e udhëzoi njerëzimin në dritën e vërtetë, në drejtësi dhe paqe. Ai pengoi gjakderdhjen e të

¹⁷⁸ Ulfe Aziz-us- Samed, op. cit., f. 25-26.

pafajshmëve dhe hapi rrugën e përparimit dhe prosperitetit. Këtë vepër të madhe, nuk ka mundur ta bëjë askush tjetër, përveç atij njeriu, i cili është i denjë për çdo respekt, admirim dhe konsideratë. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është peygamber i fesë islame. Ka lindur në Mekke, 571 vjet pas Isait [alejhis-selam] (Jezusit). Në rini, ruajti bagëtitë. Që në fillim, qenia e tij qe dhënë pas meditimit për Krijuesin e Universit. Populli i tij qëndronte larg Zotit, duke iu lutur një numri të madh idhujsh, ata kishin shkuar deri aty, sa që i varrosnin të gjalla foshnjat femra. Muhammedi ngriti zërin kundër fesë së baballarëve dhe idhujtarisë së stërgjyshërve. Ai ftoi popullin e vet që të adhurojë vetëm All-llahun, Zotin Një dhe të Vetëm. Udhëzoi në fenë e Zotit, ku Atij nuk i përshkruhet Zot tjetër. All-llahu është i drejtë dhe i Mëshirshëm. Njeriu është përgjegjës për jetën e vet. Kush punon sipas ligjit të Zotit, jeton i lumtur në këtë botë dhe në botën tjetër, ndërsa kush i rebelohet Zotit, atë e për-cjellin probleme të rënda në të dy botët. Çdo gjë është kalimtare, vetëm All-llahu është i Përjetshëm, i Madh dhe Fisnik. Pa besimin tek All-llahu, pa vepruar sipas urdhrave të Tij dhe pa u larguar nga mëkatet që i ka ndaluar Ai, është e pamundur, që në këtë botë të kalohet jetë e mirëfilltë. All-llahu i Madhërishëm, ka urdhëruar, që njerëzit ta adhurojnë Atë dhe t'i binden të Dërguarit të Tij dhe ndërmjet tyre të zotërojnë dashuria.

Adhurimi ndaj All-llahut, manifestohet nëpërmjet namazit, kurse dashuria ndaj njëri-tjetrit, arrihet përmes shoqërimit reciprok, duke e ndihmuar njëri-tjetrin në të mirë dhe gjatë vështirësive. Të mposhturit e pasioneve të dobëta dhe shmangia nga pijet dehëse, janë kushte të detyruara për çdo besimtar musliman. Gjithashtu, lufta kundër skllavërimit ndaj botës materiale, të punuarit, të përpjekurit dhe të qenit i durueshëm në fatkeqësitë e jetës, janë prej kushteve të besi-

mit. All-llahu dhe i Dërguari i Tij duhet të jenë për muslimanët më të dashur se vetvetja, fëmijët dhe pasuria. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk ka thënë se ai është peygamber i vetëm, por ka besuar edhe në shpalljen peygamberike të Musait (Mojsiut) dhe Isait (Jezusit). Ai ka theksuar (ajetin kur'anor): *"Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota..."* (El-Bekare: 256)

Në fillim të peygamberisë, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i përballoi të gjitha sprovat dhe qe i durueshëm dhe këmbëngulës në përhapjen e Amanetit të dhënë".¹⁷⁹

Volteri

Mendimi i Volterit mbi Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], i cili më parë, në veprën poetike, shfaqet i mjegullt në paragjykimet e tij, më pas evoluon, në dy kapitlat e veprës së tij historike, në kaptinën e VI "Mbi arabët dhe Muhammedin" dhe kaptinën e VII "Mbi Kur'anin dhe ligjin musliman". Volteri, nga paragjykimet që kishte, evoluoi gradualisht mendimin e tij mbi Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

"Nipi i Abdul Mutalibit, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], i cili më vonë do t'ia ndërrojë pamjen pjesës më të bukur dhe më të madhe të botës, që në moshën 40 vjeçare, barti shpatën në luftë përgjatë kufirit sirian. Ishte i ditur dhe modest, poet, astronom, reformoi kalendarin e arabëve, qe ligjvënës dhe mjek. Në një periudhë prej tre shekujsh, gjenialiteti i popullit arab, të cilin e vuri në lëvizje Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] bëri përparim mahnitës. Gjithë këtë e bëri nga vetvetja. Sikur të mos ishte Charles

¹⁷⁹ Muharrem Omerdiq, *Tolstoi për Islamin dhe Muhammedin a.s.* op. cit., f. 7-9.

Martela, Franca do të bëhej krahinë muslimane. Sundimtari musliman, Harun Reshid, e rigjallëroi dijen, ndërkaq bashkëkohësi i tij, Karli i Madh, i mbyti, në mënyrë mizore, 4600 saksonë të robëruar, në bregun e lumit Aller. Qysh në shekullin e dytë sipas Hixhretit, arabët bëhen mësuesit e Evropës në dije dhe arte, kurse të krishterët mësonin në Perëndim, te muslimanët”.¹⁸⁰

Napoleon Bonaparti

Thotë: “Musai (Mojsiu), ia ka shpallur fenë e Zotit, popullit të vet, Isai (Jezusi) botës romake, kurse Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], tërë botës. Arabia ishte vend pagan. Gjashtë shekuj pas Isait, Muhammedi e njohu botën me besimin në Një Zot të Vetëm, që është Zoti i Ibrahimit, i Musait dhe i Isait.

Arianët dhe sektarët e tjerë, e çoroditën botën me diskutime mbi trinitetin: Atin, birin dhe shpirtin e shenjtë. Ndërkaq, Muhammedi, shpalli se Zoti është Një, kurse triniteti imponon idenë e idhujtarisë”.¹⁸¹

Princi Otto Von Bismark

¹⁸⁰ Volteri, në letrat, që ua dërgon miqve të tij, shprehet në mënyrën më të mirë dhe më të sinqertë. Që nga koha e shkrimit të tragjedisë së tij, për Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ai jo vetëm që justifikohet para miqve të ngushtë, por edhe përmirësohet dhe pranon se ka gabuar rëndë mbi të vërtetën historike ndaj Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], jo vetëm duke sajuar disa “fakte”, por edhe duke paraqitur, në mënyrë të rrejshme, karakterin e tij. Shih Enver bin Tahir, *Volterova (Voltaire) tragedija “Muhammed ili fanatizam” i neka njegova kasnija djela*, op. cit., f. 262-263.

¹⁸¹ *Veliki ljudi o Muhammedu a.s.*, Glasnik, nr. 1-2, janar-shkurt, Sarajevë, 1965, f. 19.

Politikan dhe burrështetas i madh, themeluesi i Gjermanisë, i cili njihet në popull si “Udhëheqësi i Hekurt”, thotë:

“Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është personalliteti i jashtëzakonshëm. Jo rastësisht, Zoti nuk nxori ndonjë tjetër në skenën e ngjarjeve botërore. Muhammed, më vjen keq që s’isha bashkëkohësi yt. Ky libër, mësues dhe përhapës i të cilit je ti, s’është libri yt. Ai është libër hyjnor. Të mohosh burimin e tij është aq qesharake, sa edhe të pretendosh pasaktësinë e shkencave ekzakte. Prandaj njerëzimi, vetëm një herë, ka parë një figurë të tillë unike, siç ishte ti dhe më s’do të ketë rastin të shohë (të ngjashëm).

Unë, me respektin më të madh, përulëm, para paraqitjes tënde të madhërishtë”.¹⁸²

Mahatma Gandhi

Në “Young India” të botuar në “The Light”, Lahore, 16 shtator, 1924, thotë:

“Kam dëshiruar të njoh sa më mirë jetën e njeriut, që sot, pa dyshim, ka ndikim të padiskutueshëm në miliona zemra njerëzore. Jam bindur, më shumë se asnjëherë më parë, se s’është shpata ajo që ia siguroi Islamit vendin në botë. Jo s’është shpata, por modestia e plotë, thjeshtësia e Pejgamberit, të qenit rigoroz ndaj obligimeve, respekti i tij i thellë ndaj prindërve dhe miqve, guximi dhe trimëria, besimi i tij i patundur te Zoti dhe bindja e paluhatshme në pejgamberinë e tij.

Pikërisht këto, dhe jo shpata, përvetësuan njerëzit dhe iu dhanë fuqi atyre që të kapërcenin çdo vështirësi. Kur përfundova së lexuari pjesën e dytë të biografisë së tij, më erdhi

¹⁸² Shih Rinia Islame, op. cit., nr. 10, f. 11.

keq që s'kisha të lexoja edhe më shumë për atë jetë të madhe".¹⁸³

J. Lal Nehro

Politikan nga India, ka qenë kryetar i Partisë Kongresiste të Indisë. Ka pasur vend me rëndësi në ministrinë e Indisë. Ka lindur më 1889 dhe është takuar edhe me Gandin.

"Mbase kanë përjetuar satisfaksion, ata perandorë dhe udhëheqës, nga ai njeri (Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]), i cili, përmes mesazheve, i ftonte ata që t'i binde-shin. Dërgimi i mesazheve, tregon bindjen e paluhatshme të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], në misionin dhe vetveten e tij. Me një bindje dhe besim të tillë, ai ia parapërgatit Ummetit shkaqet e fuqisë, madhërisë dhe mirësisë. I bëri ata, nga banorë të shkretëtirës, në prijës, të cilët e çliruan gjysmën e botës. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] vdiq pasi i bashkoi fiset arabe, të armiqësuar mes vete, duke i bërë ata një bashkësi unike dhe kompakte".¹⁸⁴

Thomas W. Arnold

Orientalist dhe historian i njohur anglez, në librin e tij mjaft të çmuar "Historia e përhapjes së Islamit", thotë:

"Është e vërtetë se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka qenë entuziast dhe ka poseduar dashuri dhe flakërim të zjarrtë fetar. Ai, këtë kualitet të shkëlqyeshëm, e ka përcjellë te shumë ithtarë të vet...

Nuk bën të hiqet nga mendja se haxhxi është lidhja e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] me Ibrahimin,

¹⁸³ L.S.B. *Jomuslimanët për Muhammedin a.s.*, op. cit., f. 106.

¹⁸⁴ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 140.

besimin e të cilit ky misionar e rimëkëmbi. Nuk ka mendjemprehtësi më gjeniale të ndonjë gjeniu fetar, që të ketë mundur të mendojë mjetin më të qëlluar për impresionimin e shpirtit të besimtarëve dhe t'i japë domethënie kaq të lartë jetesës dhe vëllazërisë së përbashkët, se sa lidhjet me anë të kësaj feje".¹⁸⁵

Edward Gibon

Historian gjenial, në veprën e njohur "Historia dhe rënia e Perandorisë Romake", veç të tjerash, shprehet kështu: "Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] kishte memorie të shkëlqyeshme, sjellje humane, gjykim të drejtë dhe qëndrim të vendosur. Ishte i guximshëm në ide dhe aksione. Shpallja e parë, të cilën e pranoi nga Zoti, la vulë të thellë tek ai deri në fund të jetës".¹⁸⁶

Simon Ocklay dhe Edvard Gibon

Në "Historia e Perandorisë Saraçene" Londër 1870, f. 54, shkruajnë:

"Admirimin tonë e meriton besimi i përhershëm i Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], si para ashtu edhe pas fitores. Deri më sot, pas gjithë atyre shekujve zhvillimi e përparimi, ideja mbi Zotin Një, nuk ka mundur të errësohet me kurrfarë idhujsh dhe as jeta e tij e virtytshme nuk është vënë në dyshim, e përmbajtja e asaj jete është: Besimi në Zot dhe sjellja etike.

Sa të padrejta janë vlerësimet e Perëndimit, ndaj Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], i cili vetë, në atë kohë,

¹⁸⁵ Thomas W. Arnold, *Historia e përhapjes së Islamit*, Prishtinë, 2004, f. 410-412.

¹⁸⁶ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 38.

në shkretëtirën e largët, insistonte në ato parime, duke përfshirë edhe objektivitetin dhe përpjekjen për dije”.¹⁸⁷

Ata gjithashtu thonë:

“Ne besojmë te Një Zot dhe Muhammedi, i Dërguari i Tij, është shfaqja e thjeshtë dhe e pandryshueshme e Islamit”.¹⁸⁸

John Davenport

Dijetar i madh, në veprën “Apologjia për Muhammedin dhe Kur’anin”, thotë:

“Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte dinjitoz me të mëdhenjtë, kurse modest me të vegjlit, duke shkaktuar mahnitjen e të dy palëve. Edhe pse i pashkolluar, ai ndikonte te njerëzit, sikurse mësuesi te fëmijët. Asnjëherë nuk dëshironte të ngrihej mbi të tjerët. Vazhdimisht e përsëriste barazinë në mes njerëzve si krijesa të All-llahut dhe e ndante kafshatën me ish-skllëvërit”.¹⁸⁹

Washington Irving

Në edicionin “Muhammedi dhe trashëgimtarët e tij”, për të Dërguarin e Zotit thekson:

“Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] zotëronte cilësitë më të larta intelektuale, kishte imagjinatë të gjallë dhe një kujtesë të jashtëzakonshme. Ai nuk bënte kurrë dallim ndërmjet njerëzve, prandaj edhe njerëzit e thjeshtë e donin pamasë. Në çastet e triumfit më të madh, pas ngadhënjimit të tij, ndaj armiqve, atë nuk e kaploi mendjemadhësia. Asnjëherë, nuk lejonte, që p.sh. gjatë hyrjes së tij në dhomë, t’i bëhej ndonjë respekt i veçantë. Njerëzit i vlerësonte dhe

¹⁸⁷ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 41.

¹⁸⁸ Pamfleti: *A e njihni këtë njeri?*

¹⁸⁹ Ibid, f. 37.

çmonte vetëm, sipas thellësisë së besimit, manifestimit të tij në praktikë dhe kryerjes së veprave të mira”.¹⁹⁰

“Edhe pse ishte serioz dhe dinjitoz, ai nganjëherë bënte shaka dhe ishte i qeshur dhe plot humor. Thuhet se ka pasur buzëqeshje që të magjepste. Fytyra e tij ishte pak më e kuqe, siç janë zakonisht fytyrat e arabëve të tjerë. Ndërkaq, në momentet kur ishte i entuziazmuar, fytyra e tij merrte një shkëlqim të çuditshëm, që nxënësit e tij e shpjegonin si shkëlqim të mbinatyrshëm të Pejgamberit të Zotit...

Ishte modest në mënyrën e jetesës, i matur në ngrënie dhe ithtar i rreptë i agjërimit”.¹⁹¹

Ndërkaq në veprën “Biografia e Muhammedit”, f. 72, ai shkruan:

“Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte vula e lajmëtarëve dhe më i madhi i të dërguarve, të cilët All-llahu i dërgoi që të ftonin njerëzimin që ta adhuronin vetëm Atë”.

“Sjelljet e Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], në Mekke, dëshmojnë se ai ishte lajmëtar, i dërguar, e jo udhëheqës fitimtar. Ai u tregua i mëshirshëm dhe tolerant ndaj bashkëqytetarëve, edhe pse tanimë posedonte fuqinë. Mirëpo, ai triumfin dhe fitoren e tij e kurorëzoi me mëshirë dhe falje”. (po aty, f. 233.)

“Pejgamberi, gjatë përhapjes së Islamit, pësoi shumë tortura dhe sakrifikoi shumë. Madje, shumë dyshuan në vërtetësinë e thirrjes së tij. Kaluan disa vjet, duke mos pasur sukses të madh”. (po aty, f. 95, 96.)

“Gjatë predikimit të Shpalljes, iu ekspozua nënçmimit, sulmeve dhe torturave, sa që u detyrua të braktisë vendlindjen dhe të mërgojë në një vend tjetër. Atje, braktisi kënaqësi-

¹⁹⁰ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 38.

¹⁹¹ L.S.B., *Jomuslimanët për Muhammedin a.s.*, op. cit., f. 107.

të e jetës dhe përpjekjen për t'u pasuruar, për hir të përhapjes së besimit". (po aty, f. 300.)

"Fitoret ushtarake, nuk nxitën mendjemadhësi dhe kryenëçësi te Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Ai luftoi për hir të Islamit, e jo për interes vetjak. Madje, edhe në kulmin e famës, Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ruajti thjeshtësinë dhe modestinë. Ai kishte për qëllim që të formonte një shtet madhështor, e ai ishte Shteti Islam. Qeverisi me drejtësi dhe asnjëherë nuk u mundua që sundimin ta bënte trashëgim për familjen e tij". (po aty, f. 302, 303.)¹⁹²

James A. Michener

Thotë: "Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] qe njeri i inspiruar, që shpalli Islamin. Lindi në vitin 570 të erës sonë, në një fis arab, që adhuronte idhujt. I lindur jetim, gjithnjë qe i ndjeshëm, sidomos ndaj të varfërve, të skamurve, të vejave, jetimëve, skllevërve dhe të përbuzurve...

Në moshën dyzetvjeçare, ai kishte siguruar një mënyrë të shkëlqyer jetese: grua të dashur, fëmijë të mirë dhe pasuri. Më pas, përmes një rrjedhojë ngjarjesh dramatike e tronditëse, përmes engjëllit Xhibril, ai filloi të pranojë shpalljen e fjalëve të Zotit... Propagandimi i Muhammedit shkaktoi hidhërimin e arabëve të pasur, të cilët adhuronin idhujt, prandaj ai, së bashku me ithtarët e vet, u dëbua nga vendlindja e tij, Mekka. Në Medine, ai u bë udhëheqësi i saj, madje edhe sipas pohimeve të armiqve të tij, ai, këtë qytet, e qeverisi me plotë urti. Para mbarimit të jetës, i ofrohet mundësia që të bëhet sundimtar, ose i shenjtë, por e refuzon edhe të parën edhe të dytën, duke insistuar në atë se, ai është vetëm

¹⁹² Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 95-96.

njeri i rëndomtë, detyra e të cilit është që t'ia komunikojë botës shpalljen e Zotit".¹⁹³

"Me vënien në jetë të Kur'anit, me personalitetin dhe shembullin e tij të jashtëzakonshëm, ai e ka revolucionarizuar Arabinë, e më pas tërë Lindjen, dhe duke shkatërruar idhujt e Qabes, ai vendosi besimin në Një Zot".¹⁹⁴

James H. Hart dhe James A. Michener

Thonë: "Në çdo gjë, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], qe thellësisht racional. Kur i vdiq i biri i i tij i dashur, Ibrahim, pasoi zënia e diellit dhe populli filloi të flasë, se me këtë, Zoti po shpreh pikëllim. Sapo e dëgjoi këtë, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], tha: *'Zënia e Diellit (dhe Hënës) është fenomen natyror. Ajo nuk ka të bëjë me lindjen ose vdekjen e ndonjë njeriu'*.

Kur ndërroi jetë Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], u tentua që ai të ngrihej në shkallën e hyjnive, por njeriu, që do të bëhej pasardhës i tij administrativ (Ebu Bekër es- Sidiku), e shmangi këtë tendencë, në njërin nga fjalimet më madhështore në historinë e religjionit, duke thënë:

"Nëse mes jush, ka nga ata që e adhurojnë Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], le ta dinë se ai ka vdekur. Ndërsa ata që e adhurojnë All-llahun, duhet ta dinë se Ai jeton gjithmonë (dhe nuk vdes kurrë)".¹⁹⁵

Michael H. Hart

¹⁹³ Pamfleti: *Ç'thonë të tjerët për Muhammedin a.s.*

¹⁹⁴ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 41.

¹⁹⁵ Pamfleti: *Ç'thonë të tjerët për Muhammedin a.s.*

Në "The 100: A Ranking of the Mos Influential Persons in Histori", New York, Hart Publishing Company, Inc. 1988, f. 33, thotë:

"Vënia e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në krye të listës së personaliteteve më me ndikim në botë, mbase mund t'i befasojë disa lexues, e të tjerët t'i bëjë të pyesin për një rangim të tillë, por ai ishte njeriu i vetëm në histori, i cili ishte bindshëm më i suksesshmi, si në aspektin fetar, ashtu edhe në atë profan".¹⁹⁶

Herakli Cezari

Perandor Bizantin, në vitin 628 gjatë kthimit nga beteja ku mundi persianët, shkoi në Jerusalem në shenjë mirënjohjeje. U gjend pikërisht aty kur mori letrën e Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Ai urdhëroi që dikush nga Arabia duhej t'i paraqitej para tij. Në atë kohë njëri ndër armiqtë e përbetuar të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], Ebu Sufjani ishte duke qëndruar në Gaza me mallrat e tij. I dërguari i Cezarit e solli atë prej Gazës. Cezari zotëronte një oborr të madh mbretëror. Ai kishte vënë një kurorë mbretërore dhe ishte ulur në fronin e tij. Ishte viti 6 hixhri, kur Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte në gjendje lufte me mekkasit. Perandori i thirri arabët. Pranë kishin një përkthyes. Herakliti pyet, se kush është më i afërt nga fisi njeriut që thotë se është i Dërguar i Zotit? Ebu Sufjani përgjigjet: 'Unë jam më i afërti'. Pas kësaj Herakliti thotë: 'Më sillni pranë atë dhe shokët e tij. Por shokët le t'i qëndrojnë pas'. Pastaj u kthye drejt përkthyesit dhe i tha: 'Thuaju këtyre: Unë do ta pyes këtë njeri për disa gjëra në lidhje me

¹⁹⁶ Ç'thonë të tjerët për Muhammedin a.s., Dituria Islame, Prishtinë, prill 1991, nr. 24, f. 16.

atë që pretendon se është i dërguar. Nëse ai gënjen, këta le të thonë: Po gënjen!” Ebu Sufjani një herë tjetër kishte thënë: ‘Betohem në Zotin se, po të mos isha frikësuar se do të më thoshin vendasit e mi se po gënjej, unë do të kisha gënjyer’. Dhe pas pyetjeve që bëri Perandori dhe përgjigjeve që i mori nga Ebu Sufjani, Herakliti i thotë përkthyesit:

“Thuaj atij (Ebu Sufjanit), e pyeta atë për fisin (e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]), më tha se ka një fis fisnik e të lartë. Nga fise të tilla dërgohen peygamberët. Pyeta se a ka mes jush dikush që më përpara fliste për gjëra të tilla. Më tha: Jo. Po të kishte qenë ndonjë para tij të thoshte gjëra të tilla, do të thosha se ka parë dhe mësuar nga ai. Pyeta se a ka në mes të anëtarëve të familjes së tij mbretër, më tha jo. Po të kishte nga gjyshërit e tij mbretër do të thosha se dëshiron për ta marrë atë fron përsëri. Pyeta se para se t’i thoshte këto, a e keni akuzuar atë ndonjëherë për gënjeshtëri. Më tha se jo. Unë e di se një njeri i cili nuk flet gënjeshtëri para njerëzve, nuk flet gënjeshtëri as para Zotit. Pyeta se ata që i përgjigjen ftesës së tij a janë të parët e fisit, apo të varfrit. Më tha se janë të varfrit. Është e vërtetë që të parët që i besojnë peygamberëve janë njerëzit e varfër. Pyeta se ata që i përgjigjen ftesës së tij a pakësohen apo shtohen. Më tha se shtohen. Është e vërtetë e një feje të vërtetë se pjesëtarët vazhdimisht rriten e nuk pakësohen. Pyeta se a ka prej atyre të cilët hynë në fenë e tij e më pas dalin prapë nga ajo. Më tha se jo. Kur në zemër futet besimi, atëherë ndodh kështu. Pyeta se a ka pasur raste kur nuk ka qëndruar në fjalë. Më tha se jo. Të tillë janë peygamberët. Asnjëherë nuk i mohojnë fjalët e premtimet. Pyeta se ç’ju urdhëron ai juve. Më thatë se ai urdhëron që: T’i luteni vetëm një Zoti dhe të mos i bëni shok atij; të largoheni nga idhujt të cilëve u janë lutur gjyshërit tuaj! Po ashtu ju urdhëron të falni namazin dhe t’i vizitoni të afërmit. Nëse janë të vërteta këto fjalë që më

thatë, atëherë edhe ky vend ku i kam këmbët së shpejti do të jetë nën sundimin e tij. Unë e dija se do të del ky pejgamber, por nuk kam menduar se do të jetë prej jush. Po të kisha ditur se do të takohesha me të, do ta kisha marrë parasysh çdo përpjekje për t'u takuar. Po të isha pranë tij, do të ia kisha larë këmbët".¹⁹⁷

Abdullah Ibn Selam

Njëri nga dijetarët e njohur hebre, porsa e takon dhe e sheh Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], e vëren një dritë që ia kaplonte fytyrën e tij të bukur, bëhet musliman. I magjepsur nga ajo dritë që ndriçonte fytyrën e bekuar të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], thotë:
"Ai që ka një fytyrë të tillë nuk mund të jetë gënjeshtar!"¹⁹⁸

Martin Lings

Në librin "Muhammedi: jeta e tij bazuar mbi burimet më të hershme", Londër, G. Allen Unwin Ltd. 1983, f. 276, thotë:
"Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe familja e tij jetonin në një jetë plotë kursime. Aisheja tregon se përpara marrjes së Hajberit, ajo nuk kishte ngrënë kurrë hurma aq sa të ngopej. E tillë ishte varfëria e këtyre njerëzve, sa që gratë e

¹⁹⁷ Dialogu i Cezarit me Ebu Sufjanin i zemëroi tepër oborrtarët. Prandaj Cezari i largoi arabët prej oborrit mbretëror. Sidoqoftë, dashuria për kurorën dhe fronin mbretëror, si dhe kundërshtimi i oborrtarëve nuk e lejuan Cezarin të pranonte Islamin. Shih: Sulltan Ahmed Kureshi, *Letrat e Muhammedit a.s.*, Prishtinë, 2004, f. 109-111; Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 36-40.

¹⁹⁸ Osman Nuro Topbash, *Fllade Mëshironjëse nga Pejgamberi Mëshirues*, Stamboll, 1999, f. 46.

Pejgamberit atij kurrë nuk i kërkuan ndonjë gjë, përveç atyre gjërave më të nevojshme për jetën”.¹⁹⁹

Disa pyetje që i bënë idhujtarët Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] kishin të bënin me ndodhi të padëgjua në Hixhaz, dhe u zgjodhën për të parë dhe për të provuar, nëse pejgamberi i Zotit zotëronte ndonjë burim diturie, mbi gjërat e fshehta e të papara. Të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] iu desh të pres një kohë të gjatë, derisa i erdhi lajmi nga Zoti, ndërsa idhujtarët nisën të tallen dhe fjalët e tyre e mërzitën dhe e trishtuan shumë, pasi ndihma nuk erdhi ashtu si ai priste. Në lidhje me këtë, në veprën e përmendur, f. 77, thotë:

“Vonesa e Përgjigjes Hyjnore, ndonëse e dhimbshme për të Dërguarin e Zotit dhe pasuesit e tij, ishte me të vërtetë një forcë e madhe për të. Armiqtë e tij e mohuan domethënien e kësaj vonese, por për ata kurejshë që ishin akoma të pavendosur, ky fakt ishte një pohim i qartë i asaj se, Fjala e Shenjtë i vinte Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nga Qielli dhe se ai nuk kishte gisht, e as nuk mund ta kontrollonte atë. Është e kuptueshme se po të ishte se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], do t’i kishte trilluar të gjitha ato çfarë kishte thënë më parë, nuk do të ishte vonuar kaq gjatë për këtë trillim të ri, veçanërisht në një çast të tillë kur rreziku qe mjaft i madh”.²⁰⁰

Stanley Lane Pole

Historian i njohur, në veprën “Fjalimi dhe kuvendimi i Muhammedit”, shkruan:

¹⁹⁹ Hamza Mustafa Njazi, op. cit., f. 16.

²⁰⁰ Ibid, f. 37.

“Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte entuziast, në kuptimin më fisnik. Tregohej aq i lumtur dhe i kënaqur, sa që ai disponim përcillej edhe te të tjerët. Rolin e tij si Pejgamber i Zotit, e ka kryer në mënyrë dinjitoze, me urtësi dhe me tolerancë të madhe”.²⁰¹

“Dita e triumfit më të madh të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ndaj armiqve të vet, ishte, në të njëjtën kohë, edhe dita e fitores më të madhe të tij ndaj vetvetes. Ai, me zemërgjerësi, ia fali kurejshitëve vitet e urrejtjes dhe mërive dhe shpalli amnisti për të gjithë banorët e Mekkes. Ushtria e zbatoi urdhrin, dhe hyri në Mekke, në mënyrë paqësore. Nuk u plaçkit asnjë shtëpi dhe nuk u shqetësua asnjë njeri. Vetëm një gjë, iu nënshtrua zhdukjes. Duke hyrë në Qabe, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] qëndroi para 360 idhujve dhe duke treguar, me shkopin e vet, tha (ajetin kur'anor) :

“... Erdhi e vërteta e u zhduk e kota...” (El-Isra: 81) Me këto fjalë, shokët e tij i përmbysën idhujt dhe shkatërruan njëherë e përgjithmonë zotat e Mekkes dhe të rrethinës së saj. Kështu, u kthye Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në vendlindjen e tij.

Në të gjitha analet botërore, nuk ekziston ndonjë hyrje triumfale, që mund të krahasohet me këtë”.²⁰²

“Ai ka qëndruar guximshëm, edhe pse me vite, ishte i vetmuar dhe i urrejtur nga bashkëvendësit e tij idhujtarë. Ai, asnjëherë, nuk e ka tërhequr i pari dorën gjatë përqaimit. Ishte i dashur me fëmijët dhe kurrë nuk kalonte, madje, as pranë grupit më të vogël pa buzëqeshjen e syve të tij të mrekullueshme dhe pa fjalët e dashura për ta... Ka qenë nga ata pak njerëz fatlumë, për të cilët, kënaqësia më e madhe

²⁰¹ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 37.

²⁰² L.S.B , op. cit., f. 107.

ishte që njerëzit t'i bashkohen të Vërtetës së Madhe. Ai ka qenë Pejgamber i Zotit dhe kurrë që nga fillimi e deri në fund të jetës së tij, nuk ka harruar se kush ishte dhe as porosinë, e cila ishte thelbi i misionit të tij. Ai porosinë, ia përcolli njerëzve me dinjitet të lartë, gjë që rezultonte nga vetëdija mbi misionin e tij të madh".²⁰³

Majori A. G. Leonard

Në "Islam, Her moral and spiritual value", f. 20, 21, shkruan:

"Lexuesi duhet ta kuptojë menjëherë, se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk ka pasur një frymëzim shpirtëror të zakonshëm, nuk ishte një prijës i thjeshtë, apo për më tepër një endacak, por ai ka qenë një nga mendimtarët më të mëdhenj të të gjitha kohërave dhe epokave. Ishte njeri me qëllime të singerta dhe serioze, ishte jo vetëm i madh, por më i madhi ndër më të mëdhenjtë. Ishte njeri që njerëzimi nuk e kishte njohur kurrë më parë. Që madhështor, jo vetëm si pejgamber, por edhe si trim dhe burrshtetas. Që frymëzuesi shpirtëror, që krijoi popullin më të madh, shtetin më të madh dhe për më tepër edhe fenë më të madhe. Ai ishte modest me njerëzit dhe tepër i përlur e i përkushtuar ndaj Zotit. Lexuesi duhet ta kuptojë se Islami ka domethënie të thellë dhe synon t'i nxjerrë, ithtarët e vet, nga terri i errësirës njerëzore, drejt sferave më të larta të Dritës të së Vërtetës".²⁰⁴

G. W. Leitner

²⁰³ Ulfe Aziz-us-Samed, op. cit., f. 24.

²⁰⁴ Ibid, f. 24.

Në "Mohamedanism", Lahore, 1893, f. 4. thotë:

"Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] kurrë s'ka deklaruar për veten, se është i pagabueshëm. Në një çast, gjatë zbritjes së Shpalljes, ai u qortua rreptësisht, sepse në kohën kur ishte duke folur me disa njerëz nga paria e Mekkes, ia ktheu shpinën dhe nuk iu përgjigj një të verbëri. Megjithatë, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e komunikoi këtë shpallje, gjë që me siguri s'do ta bënte, sikur të ishte mashtrues, ashtu sikurse e konsiderojnë disa të paditur, në mesin e të krishterëve".²⁰⁵

Edward Montet

Profesor i Universitetit të Gjenevës, shpreh mahnitjen e tij ndaj Islamit, shpjegon dispozitat e tij, lavdëron Kur'anin dhe thotë se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], me reformat e tij, i ka bërë shërbim të pakufishëm njerëzimit, prandaj, meriton të numërohet, ndër mirëbërësit dhe reformatoret më të mëdhenj të njerëzimit. Në veprën e tij "Muhammedi dhe Kur'an", për Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], veç të tjerash, thotë:

"Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] kishte karakter fisnik, sjellje të jashtëzakonshme, fjalë bindëse, të drejta dhe tërheqëse".²⁰⁶

Rene Crouset, në veprën e tij "Civilizimi i Orientit", shkruan:

"Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] kur filloi të komunikojë Islamin, ishte i ri dhe fisnik, i mbushur me fuqi për gjykim të drejtë. Ai qëndroi lart mjedisit, në të cilin jetoj.

²⁰⁵ L.S.B., op. cit., f. 104.

²⁰⁶ Preporodi, Sarajevë, 1982, f. 6.

Në kohën kur i ftoi arabët, që të besojnë Një Zot, ata ishin zhytur në idhujtari. Ai kishte vendosur që, njerëzit t'i largonte nga idhujtaria, drejt monoteizmit të pastër".²⁰⁷

John Austin

Në "Muhammed the Prophet of Allah", në T.P. and Classels Wekly të 24 Shtatorit 1927, thotë:

"Për më pak se një vit, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], u bë udhëheqës i vërtetë shpirtëror, prijës dhe sundimtar i Medines. Pa përdorur aspak forcën, ia arriti shumë shpejt të tronditë mbarë botën".²⁰⁸

E. Laris

Historian i njohur francez, thotë:

"Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] qysh nga fëmijëria është dalluar për singëritet, sa që është quajtur: i drejti, i besueshmi".²⁰⁹

Huston Smith

Në "The Religions of Man", Mentor Books, f. 203, thotë:

"Ishte i singërtë dhe i dashur për njerëzit e vet, njeri bujar dhe i dhembshur. Gjithnjë ka ndier dhembje ndaj vuajtjeve njerëzore dhe tregohej i gatshëm t'u ndihmonte të tjerëve, e sidomos të varfërve dhe të paaftëve. Për shkak të ndjenjës së tij të ndershmërisë, obligimit dhe të besimit, fitoi tituj të lartë si 'i drejti' dhe 'i besueshmi.'"

²⁰⁷ Ibid, f. 6.

²⁰⁸ L.S.B., op, cit., 105.

²⁰⁹ Muhammedi a.s. në dritën e kritikës evropiane, Dituria Islame, Prishtinë, 1997 op. cit. f. 27.

Idhujtarët, të etur vazhdimisht për çudira, kanë kërkuar prej tij shenja dhe dëshmi nëpërmjet çudive, si dëshmi të pejgamberisë së tij. Ai këtë e ka refuzuar. Ai vazhdimisht deklaronte: Zoti nuk më dërgoi të bëj çudira, por t'i mësoj të tjerët. I lartësuar qoftë Krijuesi im. Unë nuk jam, asgjë më tepër, veçse njeri i dërguar si pejgamber.

Prej fillimit, deri në fund, ai refuzoi çdo përpjekje të glorifikimit të personalitetit të tij, duke thënë (fjalët kur'anore): *"Thuaj: Unë nuk u them juve se i kam në kompetencë depot e All-llahut (e t'ju sjell mrekulli), as nuk pretendoj se i di fshehtësitë (e t'ju tregoj se kur do t'ju vijë dënimi), as nuk u them se unë jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet mua"*. (El-En'am: 50) Këto s'janë fjalët e Muhammedit, por fjalët e bartësit të porosisë së All-llahut, drejtuar njerëzve.

Mjafton vetëm të vëzhgosh me vëmendje trupat qiellorë, të cilët lëvizin pandërprerë nëpër gjithësi, rendin e përkryer të universit, shiun që bie për ta gjallëruar tokën, palmat që janë përkulur nga frytet e tyre, anijet që lundrojnë nëpër dete, duke u shërbyer njerëzve, - të gjitha këto, janë mrekulli për ata që i vështrojnë. A mundet që këto, të jenë krijuar nga një zot prej guri? Sa i pakuptimtë është kërkimi i shenjave, kur tërë bota është shenjë. Në kohën e besëtytnisë, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], propagandoi studimin e përsosmërisë së universit, gjë që e ngriti diturinë islame kundrejt diturisë së krishterë".²¹⁰

Jules Meserman

Në fragmentin "Ku janë prijësit", botuar në revistën Time, më 15 Korrik, 1974. thotë:

²¹⁰ Ulfe Aziz-us-Samed, op. cit., f. 23-24.

“Mbase, prijësi më i madh i të gjithë kohëve është Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]”.

Edhe pse hebre, Jules Mesermen, profetin e vet, Moisiun (Musain [alejhis-selam]) e radhit pas Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], kurse Jezusin (Isain [alejhis-selam]) dhe Budën i vendos shumë më pas.²¹¹

²¹¹ Ahmed Dedat, op. cit., f. 32.

Lafajet

Filozof dhe njëri prej atyre që e patën përgatitur bazën ideore të revolucionit të madh francez të vitit 1789, ka shqyrtuar të gjitha sistemet juridike para se të botohet 'Deklarata e të Drejtave të Njeriut' dhe duke parë epërsinë e të drejtës islame, ka thënë kështu:

"O Muhammed! Atë që ti ke sjellë dhe aplikuar në botë, nuk e ka bërë askush. Ti e ke sjellë drejtësinë në një vend të paarritshëm!.." ²¹²

Dr. Laura Veccia Vaglieri

Orientaliste e njohur italiane, shkruan:

"Pejgamberi arab, i frymëzuar dhe i lidhur fortë me Krijuesin e vet, u ka predikuar monoteizmin me të pastër adhuruesve të fetishizmit, ithtarëve të Krishterizmit dhe Judaizmit të degjeneruar. Ai doli në konflikt të hapur me tendencat e atëhershme të prapambetura të njerëzve, që shpinin në politeizëm. Në predikimet e tij, për t'i bindur njerëzit me besimin në Një Zot të vetëm, ai nuk shfrytëzoi fenomene të ndryshme natyrore, për të mashtruar njerëzit, duke i quajtur ato si mrekulli të tij. Ai nuk i detyroi kurrë njerëzit që të pranojnë verbërisht thirrjen e tij, duke i frikësuar ata me kërcënime qiellore, gjë që do të rrezikonte mjaft aftësinë e tyre për të menduar e gjykuar objektivisht.

Ai i ka ftuar njerëzit me dashamirësi, jo që të braktisin bindjet e tyre, por të meditojnë mbi universin dhe ligjet e tij. Bindja e tij, e palëkundur, në Një Zot, në Një të Vetëm dhe të

²¹² Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 28.

Domosdoshëm, bënte që ai, vazhdimisht, t'u ofronte njerëzve të lexonin librin e jetës".²¹³

R. Dozy

Orientalist i famshëm, në "Essai sur l'histoire de l'islamisme", 1879, f. 31, thotë:

"Mashtguesi nuk është në gjendje të formojë një religjion, të cilin e kanë pranuar miliona njerëz dhe i cili është shndërruar në fe universale. Pa bindje të fortë dhe të thellë, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], kurrë, s'do t'ia dilte t'i bënte ballë tmerreve dhe rreziqeve për më shumë se dhjetë vjet".²¹⁴

R. Bosworth Smith

Në librin e tij "Jeta e Muhammedit", thotë:

"Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ishte, në të njëjtën kohë, udhëheqës fetar dhe profan... por pa pretendime për të sunduar, pa pallate, pa ushtri, pa gardë personale dhe pa të ardhura të caktuara. Nëse mund të thuhet për dikë, se ka sunduar në sajë të besueshmërisë dhe fesë, ky do të ishte Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Ai posedonte autoritetin më të lartë, duke mos shfrytëzuar për këtë qëllim mjetet e dhunshme, duke qëndruar jashtë etike-timeve dhe ceremonive oborrtare, në sajë të personalitetit të tij të shkëlqyer".²¹⁵

²¹³ Ulfe Aziz-us-Samed, op. cit., f. 52.

²¹⁴ Enver bin Tahir, op. cit., f. 170.

²¹⁵ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 38-39.

“Ai ishte njeri i pashkolluar, mezi dinte të lexonte dhe të shkruante, por ka shkruar Librin, që është poezi, ligj, lutje dhe shkrim i shenjtë, të gjitha së bashku”.²¹⁶

²¹⁶ Ahmed Dedat, op. cit., f. 31.

Henri De Kastro

“Është vërtetuar se, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], nuk ka lexuar ndonjë libër të shenjtë dhe nuk i është referuar ndonjë doktrine fetare, para tij. E dimë se, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ka ndier lodhje të shumta dhe ka përjetuar mundime të mëdha shpirtërore, para se të njoftonte për pranimin e shpalljes. All-llahu e krijoi me natyrë të tillë, i cili iu përkushtua plotësisht fesë. Atij iu desh të veçohet nga njerëzit, duke iu shmangur adhurimit të idhujve dhe besimit në shumë zota, të cilin e kishin shpikur të krishterët. Urrejtja ndaj këtyre të dyjave, i ishte ngulitur thellë në zemër. Këto dy doktrina, ishin sikurse gjilpëra në trupin e tij.

Ky njeri, i cili kishte arritur të dyzetat, kulmin e mençurisë, kërkonte nga lindorët, që karakterizoheshin për arsye të mprehtë dhe imagjinatë të gjallë, dhe me fuqi të lartë të të kuptuarit, që të përsërisnin, pa ndërprerë, fjalët: “All-llahu është Një”, “All-llahu është Një”. Këto fjalë, i përsërisnin të gjithë muslimanët pas tij. Ndërkaq, ne të krishterëve na mundon përmbajtja e tyre, për shkak të largimit tonë, nga ideja e monoteizmit...

Në periudhën e parë (në Mekke), nuk mund t’ia mohojmë, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], bindjen e plotë dhe singëritetin e besimit. Nuk i ishte luhatur besimi në zemër, madje as për një grimcë, edhe gjatë periudhës së dytë (në Medine).

Nuk qe i dhënë pas stolive të kësaj bote dhe nuk ishte koprrac. Ishte i përmbajtur dhe derisa u largua nga kjo botë, asnjëherë nuk u ngop me bukë elbi. Iu shmang ambicieve të kota, megjithatë arriti dhe ia doli të zërë vendin më të lartë,

në vendet arabe. Por, ai nuk u dha pas totalitarizmit. Nuk pati fron, ministri dhe as gardë”.²¹⁷

Anie Besant

Në “The Life and Teaching of Muhammed, Madras”, 1932, thotë:

“Çdo njeri, që e studion jetën, karakterin, nivelin e të mësuarit dhe mënyrën e jetesës së përditshme të peygamberit arab, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është e pamundur të ndiejë diçka tjetër, përveç admirimit të jashtëzakonshëm ndaj tij, si njëri nga peygamberët më të mëdhenj të njerëzimit”.²¹⁸

“Edhe pse me këto, që ju parashtroj, do të përmend shumë gjëra, të cilat, për shumë njerëz, janë më se të njohura, prapëseprapë, sa herë që i rilexoj ato, më kaplon një ndjenjë e re admirimi dhe respekti, ndaj mësuesit më të madh arab”.²¹⁹

M. Watt

“Karakterit i Peygamberit dhe qëndrimet e tij njerëzore, madje edhe ndaj armikut, shprehin synimin e lartë të Shpalljes, me qëllim që t’i integronte njerëzit në idetë e reja. Pakkush, nga njerëzit e mëdhenj të historisë, është vlerësuar aq gabimisht, në Perëndim, sikurse Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Jemi të obliguar t’i përmirësojmë këto shtrembërime, duke iu referuar karakterit virtuoze dhe të lartë të jetës së Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], dhe këmbëngulësisë në thirrjen, të cilën Zoti ia besoi atij”.²²⁰

²¹⁷ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 108-109.

²¹⁸ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 40.

²¹⁹ Pamfleti Ç’thonë të tjerët për Muhammedin a.s.

²²⁰ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 40.

D. G. Hogart

Në "Historia e Arabisë", veç të tjerash thotë:

"Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është i vetmi, ndër njerëzit më të shquar të njerëzimit, jeta e përditshme e të cilit është studiuar, është çmuar dhe është marrë si shembull, duke u zbatuar në jetë edhe sot nga miliona njerëz. Kjo gjë, nuk mund të thuhet për ithtarët e feve të tjera, të cilët, në jetën e tyre të përditshme, nuk praktikojnë mënyrën e jetesës së themeluesit të fesë së tyre".²²¹

E. Demerngem

Orientalist francez, është njëri nga orientalistët më objektivë, që ka shkruar për Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Ka shkruar veprën "Biografia e Muhammedit", "Muhammedi dhe Sunneti", ka botuar një numër studimesh në disa revista të njohura. Ai thotë:

"Mesihu [alejhis-selam], në Kur'an, ka vend të ngritur. Lindja e tij nuk ishte e zakonshme, si e njerëzve të tjerë. Ai ishte i dërguari i All-llahut, të cilit Zoti i foli me zë... Kur'ani e ka për qëllim Krishterimin e vërtetë kur thotë: Isa [alejhis-selam], është rezultat i fjalës, që Zoti ia përcolli Merjemes dhe ai është njeri. Kur'ani e lufton doktrinën e atyre që besojnë Isain (Jezusin) për Zot... Ai nuk e lufton Krishterimin e vërtetë. Prandaj, i krishteri, duhet të jetë i kënaqur me sulmin, që Kur'ani i bën Trinitetit, i cili përbëhet nga Hyji, Jezusi dhe Maria.

Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] veten e konsideronte si instrument për komunikimin e Shpalljes. Përpjekja e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] konsiston-

²²¹ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 40-41.

te në atë që të jetë i besueshëm, dëgjues dhe regjistruar besnik dhe thënës i pagabueshëm, i asaj që dëgjonte nga fuqia ndriçuese dhe zëri i heshtur i fjalës së amshuar në formë të kësaj bote, i fjalës së All-llahut, e cila është ajka e Librit. Fjala, të cilën e ruajnë engjëjt fisnikë, në qiellin e shtatë. Çdo pejgamber, duhet të ketë argument për mesazhin e tij. Secili, duhet të ketë mrekulli, me të cilën sfidon të tjerët... Dhe Kur'ani është mrekullia e vetme e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Stili i tij, është i mrekullueshëm, fuqia e tij mahnitëse vazhdon edhe në ditët tona. Ai e ngacmon lexuesin edhe nëse ai nuk është prej adhuruesve të devotshëm.

Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], e sfidoi njerëzimin dhe xhinnët, nëpërmjet Kur'anit, duke kërkuar prej tyre që të sjellin një të ngjashëm me të. Kjo sfidë, është dëshmia më bindëse, për besueshmërinë e mesazhit të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]

S'ka dyshim, se çdo ajet kur'anor edhe nëse flet për ndonjë ngjarje të caktuar të jetës, gjë të cilën e bënë me saktësi të plotë, në vete, përmban nga mrekullia mendore atë, me çka e trazon shpirtin. S'ka dyshim, se në ato ajete ka diçka ku duhet kërkuar fshehtësia e ndikimit dhe madhështia e suksesit.

Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], i cili është larg të qenit përpilues dhe sajues i Kur'anit, nganjëherë, më kot, e priste zbritjen e Shpalljes dhe mallëngjehej për të, pasi dëshironte që Engjëlli t'i vinte në mënyrë të pandërprerë".²²²

Andrin Serve

Orientalist francez, shprehet:

²²² Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 60-61.

“Ky peygamber, flet për femrën me respekt dhe konsideratë. Gjithnjë, bëri përpjekje për përmirësimin e pozitës dhe personalitetit të saj, në shoqëri. Para ardhjes së tij, gruaja nuk gëzonte të drejtën e trashëgimisë, ajo ishte objekt që trashëgohej nga të afërmit, sikur të ishte skllave. Ndërkaq, Peygamberi me ardhjen e tij, e ndërroi këtë bindje, e emancipoi femrën dhe i dha të drejtën e trashëgimisë. Vërtet, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] bëri emancipimin e femrës dhe ai që dëshiron të thellohet në këtë fushë, le të lexojë fjalimin e tij lamtumirës, në Mekke, ku porositi që të tregojmë mirëkuptim dhe konsideratë ndaj femrës. Këtë, mund ta lexojmë edhe në thëniet, hadithet e tij”.²²³

Eduard Perroy

Studiues bashkëkohor francez, profesor në Universitetin e Sorbonës, thotë:

“Erdhi Muhammedi, i biri i Abdullahut, peygamberi arab dhe vula e peygamberëve, i cili u solli sihariq, arabëve dhe mbarë njerëzimit, një fe të re. I ftoi ata, që të besonin se, All-llahu është Një dhe i Vetëm. Sheriati (ligji islam), nuk ndryshon nga besimi. Ligji islam, gëzon pushtet hyjnor të obligueshëm dhe rregullon jo vetëm çështjet fetare, por edhe ato shekullare. Ai ua obligoi besimtarëve zekatin, xhihadin kundër politeistëve... Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] përhap fenë e pastër... Kur ndërroi jetë, në vitin 632 të erës sonë, ai e kishte përmbushur thirrjen e tij dhe kishte vendosur sistemin shoqëror, i cili qëndronte shumë lart karshi sistemeve fisnore, në të cilat jetonin arabët, para Islamit. Ai i miqësoi ata dhe arriti një unitet të fortë mes

²²³ Mendimet e njerëzve eminentë botërorë për Muhammedin a.s., Dituria Islame, Prishtinë, 1991, nr. 25, f. 24.

tyre. Gadishulli Arabik, arriti një njësim të fuqishëm fetar, që nuk e kishte njohur asnjëherë më parë”.²²⁴

John India

“Modestia e Pejgamberit, dashuria ndaj së vërtetës, devotshmëria e shokëve të tij, guximi, besimi i paluhatshëm në Një Zot, të Vetëm, misioni që i ishte ngarkuar, ishin të gjitha këto virtyte dhe merita, dhe jo shpata, që bënë të mundur që feja dhe qytetërimi të ecnin përpara, duke mposhtur, çdo pengesë të kundërshtarëve të së Vërtetës”.²²⁵

Prof. Bevan

“Ajo që është shkruar, për Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe Islamin, në Evropë, në të shumtën e rasteve, duhet të merret si kuriozitet letrar.

Të flasësh për Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], si mashtrues dhe përdorues të forcës, më shumë shkakton probleme, se sa i zgjidh ato. Në Perëndim, asnjë figurë e madhe, gjatë gjithë historisë, nuk është vlerësuar me aq tendenca dashakeqe, sikurse është vepruar me Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]”.²²⁶

W. Montgomery

Në veprën "Mohammed at Mecca", Oxford, 1953, f. 52, thotë:

²²⁴ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 97.

²²⁵ *Ishte shpata që përhap i fenë islame apo e vërteta e saj*, Drita Islame, Tiranë, 1996, nr. 11 (94), f. 4.

²²⁶ Ibid, f. 4.

“Gatishmëria e tij për të përjetuar persekutime për shkak të besimit, karakteri i lartë, morali i njerëzve që i besonin dhe që e konsideronin udhëheqës, si dhe madhështia e të arriturave të përnjëhershme, dëshmojnë për personalitetin e tij të jashtëzakonshëm. Të konsideruarit e Muhammedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], si mashtrues, më shumë hap probleme, se sa i mbyll ato. Për më tepër, që në Perëndim, asnjë personalitet i madh historik, nuk është ndriçuar më zbehtë, se sa Muhammedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]”.²²⁷

Henri Servy

“Muhammedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], nuk mbolli, në shpirtrat e arabëve, vetëm parimin e Njesisë (monoteizmit), por solli edhe civilizimin dhe edukatën. Muhammedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] është personalitet historik i vërtetë. Sikur të mos ishte i tillë, as që do të përhapej Islami. Ai nuk pushoi së përsërituri, se është njeri sikurse të tjerët, të cilin e pret vdekja. Kërkonte mëshirë dhe falje nga All-llahu i Madhërishëm. Para vdekjes, deshi ta pastrojë ndërgjegjen, nga çdo njollë e mundshme, prandaj qëndroi në minber dhe iu drejtua masës me këto fjalë: ‘Muslimanë, nëse e kam qëlluar dikë, ja ku është shpina ime. Nëse dikujt i kam ndonjë borxh, pasuria ime është e tij’. U ngrit një njeri, duke thënë se, Pejgamberi i kishte borxh atij tre dirhemë. Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i përgjigjet, duke thënë: ‘Më mirë, njeriu të ndiejë turp, në këtë botë, se në botën e ardhme’. Menjëherë, ia pagoi borxhin. Civilizimi i vërtetë mendor dhe intelektual, nuk u shfaq dhe nuk u paraqit tek arabët, veçse me ardhjen e Muhammedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]”.²²⁸

²²⁷ Pamfleti: *Ç’thonë të tjerët për Muhammedin a.s.*

²²⁸ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 118-119.

Pater Hijacint

Prift i njohur, thotë: “Unë jam prift i krishterë dhe nxënës besnik i Jezusit, por konsideroj, se nuk e përul Jezusin (Isain [alejhis-selam]) kur them se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], është i Dërguar i Zotit.

Vetëm nëpërmjet inspirimit nga Zoti, ai mundi të themelojë një religjion të madh- Islamin, të cilit, sot, i besojnë miliona e miliona njerëz edhe pas njëmijë (e më shumë) vjetësh, që nga shpallja e tij”.²²⁹

Dr. Steingass

Autor i fjalorit anglisht-arabisht, thotë:

“Drejtësia e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], veprimet dhe vendosmëria e tij për të gjetur të vërtetën, këmbëngulja e vazhdueshme për t’i komunikuar urdhrat hyjnorë, besimi i tij i paluhatshtëm në çdo situatë, aftësia për t’i bërë që të dëgjojnë të vërtetën e amshueshme edhe ata që nuk donin ta dëgjonin, - të gjitha këto janë argumente bindëse dhe të pamohueshme, se ky peygamber, sipas mendimit tim, është vula e peygamberëve”.²³⁰

D. V. Bodly

Gjeneral amerikan, thotë:

“Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e studioi botën dhe problemet e saj. Në parimet e fesë, nuk la pas dore aspektin e kësaj bote. Bëri kompromis, në mes të kërkesave të njerëzve në këtë botë dhe nevojave të fesë së tyre.

²²⁹ Osman Nuri Haxhiq, *Muhammed a.s. i Kur'an, osvrt na historiju islamske kulture*, Zagreb, 1986, f. 111.

²³⁰ H. Hoxha, op. cit., f. 109.

Ai nuk ra në gabimet e atyre, të cilët u përpoqën t'i shpëtojnë njerëzit në mënyrë joadekuate. Ai e përshkoi jetën me një karvan udhëtarësh, i cili është nën mbikëqyrjen e Allahut, qëllimi final i të cilit është Xhenneti".²³¹

Selwyn Gurney

Sipas M. D. dhe Doroty "Short readings from World religions", Londër 1951, thotë:

"Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka shpallur fenë, të cilën e pasojnë miliona njerëz. Që nga fillimi, ndikimi i kësaj feje, vazhdimisht, është gjithnjë në rritje. Tiranët, që i besojnë vetëm forcës dhe mbështeten vetëm tek ajo, s'janë në gjendje të ndikojnë në gjeneratat e mëvonshme, ndikimi i tyre, ndihet vetëm gjatë jetës së tyre. Ne, ndërkaq, pas vdekjes së Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], shohim shembujt më të ndritshëm të fitoreve, që bota s'i ka parë kurrë më parë".²³²

Enciklopedia Angleze

Volumi 12, shkruan: "... Një shumë detajesh, nga burime të hershme, tregojnë se ai ishte njeri i drejtë dhe i ndershëm, i cili pati fituar respektin dhe besnikërinë e të tjerëve, që ishin njerëz të ndershëm dhe të drejtë".²³³

Diven Çand Sharma

Në "The Prophets of the East, Calcuta", 1935, f. 122, thotë:

²³¹ Mendimet e njerëzve eminentë botërorë për Muhammedin a.s., op. cit., f. 24.

²³² L.S.B., op. cit., f. 103.

²³³ Pamfleti: A e njihni këtë njeri?

“Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] qe shpirt i dashamirësisë. Ndikimi i tij, vazhdimisht, është ndier dhe kurrë nuk u harrua nga ata që e ndjenë afër”.²³⁴

A. C. Bouquet

Në veprën “Fetë komparative”, thotë:

“Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ndonëse jetonte jashtëzakonisht thjesht, nuk ishte asket. Nuk turpërohej të punonte çfarëdo pune, puritan në esencë, refuzonte të barte ose të dëfrehej me ar dhe argjend”.²³⁵

²³⁴ Imam Vehbi Ismaili, Michigan, 1987, op cit., f. 48.

²³⁵ Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 38.

Robert L. Gulick

“Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], në të vërtetë, është një edukator, një pemë udhëzimi për drejtimin e njerëzimit, drejt një lirie dhe lumturie më të madhe”.²³⁶

Dr. M. H. Duran

Nën ndikimin e një shkolle misionare bëhet i krishterë. Kalon një kohë në kishën angleze. Nga viti 1939, deri më 1963 punon si prift. Në vitin 1963, ashtu sikurse vjen prandaj, atij i erdhi e Vërteta, Islami, dhe u bë musliman.

“Mund të them, me gjithë forcë, se s’ka asnjë musliman të ri, i cili nuk ndien mirënjohje ndaj Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], për dashurinë, ndihmën, frymëzimin dhe udhëzimin që na ka dhuruar. Kjo, është një fuqi e mirë, që na ka dërguar All-llahu i Gjithëfuqishëm, si shenjë dashurie dhe mëshire ndaj nesh, në mënyrë që ne të ndjekim rrugën e Tij.

Në fund fillova të studioj biografinë e Pejgamberit, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], dhe u binda se një prej mëkateve më të mëdha, është të tregohesh mospërfillës ndaj atij njeriu, të inspiruar nga Zoti, i cili, e ngriti pushtetin e Zotit në mes një populli, i cili më parë kishte qenë në luftë mes vete. Ai popull, nuk udhëhiqej nga ndonjë ligj, adhuronte idhujt, bënte vepra të rënda. Ndërkaq, Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ia ndryshoi të menduarit, jo vetëm kaq, madje ia ndërroi traditat dhe moralin. Ai i mbledhi ata rreth një flamuri, një ligji, feje, kulture, civilizimi dhe një qeverie. Ky popull, i cili nuk kishte nxjerrë, gjatë historisë, asnjë njeri të madh, meritoi të përmendet që prej

²³⁶ Robert L. Gulick, op. cit., f. 103.

shekujsh. Nën ndikimin dhe udhëzimin e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ai popull, nxori me mijëra e mijëra njerëz fisnikë, të cilët shkuan, deri në skajet më të larta të botës, për t'i ftuar njerëzit në parimet dhe moralin islam. I ftuan ata, që të pranojnë sistemin islam të jetës. Njerëzit pranuan dhe mësuan çështjet e fesë së re.

Pejgamberi, u bëri ballë torturave të vazhdueshme, gjatë 13 vjetëve, në Mekke dhe 8 vjetëve, në Medine. Ai, të gjitha këto, i duroi dhe nuk u hamend nga qëndrimi i tij, as për një fije floku. Ishte i vendosur dhe këmbëngulës, i pathyeshëm, në qëndrimet dhe qëllimet e tij. Populli i tij, i ofroi sundimin dhe gjithë pasuritë e vendit, që të jenë nën këmbët e tij, vetëm e vetëm që të tërhiqej nga thirrja e fesë së re dhe përhapjes së misionit të vet. Por, ai i refuzoi gjithë këto oferta dhe në vend të tyre zgjodhi më të vështirën, për hir të misionit të besuar. Pse veproji kështu? Pse nuk pranoi kurrsesi pasurinë, famën, pushtetin, madhështinë, rehatinë, komoditetin dhe mirëqenien?

Njeriu, duhet të mendojë, doemos, përse Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] veproji ashtu, nëse dëshiron të marrë përgjigjen e duhur, për këtë çështje.

A mundet njeriu të përfytyrojë një shembull të sakrificës së jetës, dashurisë dhe mirësisë ndaj të tjerëve, më të lartë se ky shembull?! Ne shohim këtu, një njeri, i cili flizon lumturinë e tij personale, për të mirën e të tjerëve. Ndërkaq, populli, për përmirësimin e gjendjes së të cilit, ai bën përpjekje maksimale, ngrihet dhe e gjuan me gurë, sillet keq me të, e izolon dhe nuk i jep mundësinë për të kaluar një jetë të qetë, madje, as në izolim. Përkundër gjithë kësaj, ky njeri, refuzon që të pushojë së punuari për të mirën e tyre. A mundet që një mashtrues, njeri i pasinqertë, të tregojë një këmbëngulje dhe vendosmëri të tillë, ndaj parimeve dhe besnikëri ndaj tyre, deri në momentin e fundit, pa kurrfarë frike? Ai u nuk u

tregua i dobët, përballë rreziqeve dhe persekutimeve të ndryshme, të cilat s'mund të imagjinohen. I gjithë vendi, u ngrit kundër tij dhe kapi shpatën, për ta luftuar atë.

Vërtet, ky besim dhe kjo përpjekje e vazhdueshme, këmbëngulësia dhe vendosmëria me të cilën e udhëhoqi Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], luftën e tij deri në fitoren përfundimtare, është argument i qartë i bindjes së tij të plotë në thirrjen e tij. Sikur, të kishte në vete, madje, vetëm një fije dyshimi ose të hamendej, kurrë s'do të arrinte të qëndronte përpara stuhisë, e cila vazhdoi për njëzet (e tre) vjet. Pas kësaj, a duhet të kërkojmë ndonjë argument tjetër, i cili do të dëshmonte për vërtetësinë dhe sinqeritetin e plotë të qëllimit, moralit të drejtë dhe lartësisë shpirtërore. Gjithë këta faktorë, pa dyshim, çojnë në një përfundim, nga i cili s'mund të shmangemi: Ai njeri, vërtet, është i Dërguari i All-llahut. Ai, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është i dërguari i ynë. Ai qe personalitet, me cilësitë të rralla, shëmbëlltyrë e përkryer për virtytin dhe mirësinë, argument i besueshmërisë dhe sinqeritetit...

Pa dyshim, jeta e tij, të menduarit, sinqeriteti, udhëzimi, devotshmëria, bujaria, besimi dhe arritjet e tij, të gjitha këto, janë dëshmi unike për vërtetësinë e pejgamberisë së tij. Çdo njeri, që studion pa paragjykim, jetën dhe misionin e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], do të dëshmojë se ai, vërtet, është i dërguar nga Zoti dhe se Kur'ani, i cili ka ardhur (udhëzim) për njerëzimin, është libër i Zotit. Çdo mendimtar objektiv dhe serioz, që kërkon të Vërtetën, rrjedhimisht, do të përfundojë në këtë gjykim të vyer".²³⁷

H. Masse

²³⁷ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 105-106.

Ka ligjëruar në Universitetin e Algjerisë, është anëtar i shoqatës së shkrimtarëve dhe poetëve arabë, me seli në Damask. Ka shkruar një libër me titull “Islami” dhe ka botuar shumë studime, në fushën e orientalistikës.

“Me ndihmën e reformave fetare dhe politike, që bëri Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], e që ishin reforma fundamentale dhe unike, arabët u bënë të vetëdijshëm dhe dolën nga errësira e injorancës dhe anarkisë, duke realizuar hyrjen përfundimtare në historinë e civilizimit.

Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte ligdhënës i frymëzuar dhe gjeneratori i parë, në unifikim fetar në mes të gjithë popujve. Ai ishte modest dhe i vendosur”.²³⁸

George Sarton

“Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] u paraqit me thirrjen e tij, në vitin 610, kur ishte në moshën 40 vjeçare, sikurse edhe vëllezërit e tjerë të mëparshëm pejgamberë. Ai ishte më i mirë se ata në mënyrë joproporcionale, ishte asket, fakih, ligjvënës dhe njeri praktik.

Asnjë pejgamberi, para tij, nuk iu mundësua që të korrë fitore të plotë, si fitorja e tij. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], nuk qe vetëm Pejgamber i Islamit, por edhe i gjuhës dhe civilizimit arab, me gjithë të qenit heterogjen, të atyre që e flisnin gjuhën arabe dhe që ishin të shpërndarë në popuj dhe fe të ndryshme”.²³⁹

R. V. C. Bodley

Në “The Messenger”, Londër, 1946, f. 338, thotë:

²³⁸ Ibid, f. 138-139.

²³⁹ Ibid, f. 113-114.

“Veçantia e paraqitjes së Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], në historinë e religjioneve, qëndron në atë se, ai që i frymëzuar për çdo gjë dhe nuk ishte (emëroi veten) as i shenjtë dhe as engjëll. Ai kishte cilësi, që ishin krejtësisht njerëzore. Përveç personalitetit të tij të madh njerëzor, ai s’kishte asgjë, që e veçonte atë nga muslimanët e tjerë”.²⁴⁰

N. Schmidt

Në “Enciklopedia e Re Ndërkombëtare”, duke theksuar se e mahniti sinqeriteti i Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], veç të tjerash, thotë:

“Sado që, tani, e vlerësojmë në mënyrë kritike historinë e asaj periudhe, duke kërkuar të vërtetën e plotë, në kohë dhe hapësirë të largët për ne, është e pamundur që të mos mahnitemi me qëndrimet e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], mënyrën e jetesës, qëllimet dhe parimet, për të cilat ka luftuar pa kurrfarë frike, i nxitur nga fuqia e brendshme e misionit të tij hyjnor.”²⁴¹

H. George Wells

Shkrimtar dhe poet i njohur anglez, thotë:

“A ke dëgjuar se një njeri, pa cilësi të mira të mund të merret për shok? Ata, që e njohën më së miri Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishin po ata, që e besuan më së tepërmi. I besoi Hadixhja [radijall-llahu anha], e cila, tërë jetën, që bashkëshorte e dashur. Ebu Bekri [radijall-llahu anhu] dëshmoi për këtë. Ai, asnjëherë, nuk u hamend në besnikërinë e tij ndaj Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-

²⁴⁰ L.S.B., op. cit., f. 106.

²⁴¹ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 40.

lem] dhe e besoi atë. Është e vështirë, për çdo njeri, që të lexojë për ato ditë, e të mos e besojë Ebu Bekrin [radijall-llahu anhu] dhe Aliun [radijall-llahu anhu], i cili në ditët më të vështira, rrezikoi jetën për hir të Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], e bëri haxh-xhin e lamtumirës, një vit para vdekjes. Me atë rast, mbajti para popullit fjalimin madhështor. Gjëja e parë, të cilën e shpalli të pavlefshme ishte vjedhja dhe plaçkitja, si dhe hakmarrja dhe gjakderdhja. Në pjesën e fundit të fjalimit, solli parimin e barazisë së plotë, në mes një muslimani të zi dhe halifit. Kjo, më vonë, ndikoi imitime të madhërishme për veprimtari të drejtë dhe fisnike dhe kaliti te njerëzit frymën e fisnikërisë dhe tolerancës. Ishte ky, një realizëm shumë i lartë, që arriti të sendërtohet në jetë. Kështu, u themelua një shoqëri, me më pak totalitarizëm dhe me më pak padrejtësi shoqërore, se cilado shoqëri tjetër e mëhershme.

Arabët i ofruan botës një kulturë të re, një fe, e cila edhe sot e kësaj dite, vazhdon të jetë, një nga fetë më të fuqishme dhe më e madhërishme në botë. Njeriu, i cili e ndezi këtë flakadan, ishte Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]”.²⁴²

Le Comte De Boulainvilliers

Në “La Vie de Mohammed, Amsterdam”, thotë:

“Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], sistemin e tij religjioz e vendosi, jo vetëm në pajtim me ndjenjat e popullit të vet dhe konceptit dominues të vendit të tij, por më tepër se kaq, në një drejtpeshim të pranueshëm me konceptin e përgjithshëm të gjinisë njerëzore. Kështu, ai arriti që, mendi-

²⁴² Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 144.

mit të tij, t'ia bashkojë gjysmën e njerëzimit, dhe këtë e bëri, për më pak se dyzet vjet.

Na duket se, do të ishte e mjaftueshme vetëm të mundësohej dëgjimi i asaj doktrine dhe ajo, menjëherë, do të pushtonte shpirtin e njerëzimit".²⁴³

Po në të njëjtën vepër, ai gjithashtu thotë:

"Nëse e shqyrtojmë jetën e udhëheqësit të madh, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ose shokëve të tij, që ishin të jashtëzakonshëm, sjelljet e tyre, gjatë marrjes së vendeve të ndryshme, virtytet, guximin dhe ndershmërinë e tyre, atëherë, duhet të theksojmë: Ngjarjet, që i hasim në jetën e muslimanëve të parë, nuk mund t'i gjejmë as në ngjarjet, me të cilat krenohet historia botërore".²⁴⁴

Sir William Mur

Në "The Life of Mohamed introduction", f. 18, thotë:

"Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dallohet për fjalë përmbledhëse dhe për shpalljen e një feje të lehtë (të kuptueshme). Jeta dhe vepra e tij, janë shembull që admirohen nga të gjithë. Nuk përmendet, në histori, ndonjë reformator, që të ketë tronditur shpirtrat, të ketë gjallëruar moralin dhe të ketë lartësuar virtytin, sikurse veproji Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], Pejgamberi i Islamit".²⁴⁵

Prof. Montet

²⁴³ T. Nelaj, *Për Muhammedin a.s.*, Edukata Islame, Prishtinë, 1972, nr. 4. f. 25..0

²⁴⁴ L.S.B., op. cit., f. 106, 107.

²⁴⁵ H. Hoxha, op. cit., f. 108.

Profesor i gjuhëve lindore në Universitetin e Gjenevës, ka shkruar librin: "Muhammedi dhe Kur'ani", dhe ka bërë një përkthim të mirë të Kur'anit.

"Religjioziteti i Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], e fascinon çdo studiues objektiv, që ka qëllim të pastër dhe që reflekton sinqeritet të fuqishëm. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ishte reformator me besim të fortë. Pas një meditimi të thellë, kur ai arriti moshën e pjekurisë së plotë, filloi me këtë thirrje të madhërishe, e cila e bëri një nga fanarët më ndriçues të njerëzimit, në fushën e religionit. Në luftën e tij, kundër idhujtarëve dhe veseve të këqija, të cilat qenë përhapur në mesin e njerëzve, ai që i ngjashëm me pejgamberët e Beni Israilëve, të cilët ishin të mëdhenj, në historinë e popullit të tyre. Shumë njerëz, e injoruan Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe i anatemuan meritat e tij, edhe pse ai, është një prej reformatorëve të paktë, jeta e të cilit është e njohur në detaje. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte i pajisur me moral të lartë, sjellje fisnike, të folur të ëmbël, gjykim të drejtë, elokuencë të qartë. Cilësi dominuese, tek ai, ishin rezonimi i drejtë, shprehja e qartë dhe bindja e plotë, në atë që e bënte dhe e thoshte. Janë të rrallë, ata reformatorë, jeta e të cilëve është e njohur në detaje, sikurse jeta e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Me ndikimin e tij, në përkryerjen e moralit, lartësimin dhe fisnikërimin e shoqërisë, konsiderohet njëri prej mirëbërësve më të mëdhenj të njerëzimit.

S'ka dyshim në sinqeritetin e Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe frymëzimin e tij fetar, me të cilin është frymëzuar qenia dhe mendimi i tij".²⁴⁶

²⁴⁶ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 139-140.

David de Santilana

Ka lindur në Tunizi dhe ka studiuar në Romë. Ka doktoruar në fushën e jurisprudencës.

“Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], nga një shoqëri arabe, e cila ishte e rrënuar nga themeli, ngriti një shoqëri të re. Kjo punë e shkëlqyeshme, nuk i ka shpëtuar syrit të mprehtë të Ibn Haldunit. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e çrrënjosi kultin e fisit dhe familjes së asaj kohe dhe e zhdukuri kultin e individit.

Kush e përqafon fenë islame, duhet të ruajë lidhjet familjare dhe fafaisnore me ata, që e pranojnë fenë islame (ata konsiderohen vëllezër prej feje), ndërkaq ata që vazhdojnë në besimin e tyre të vjetër, atyre u thotë ashtu, sikurse i ka thënë Ibrahim i [alejhis-selam] familjes së vet: “(Përkujto, o i dërguar) Kur Ibrahim i babait të vet dhe popullit të tij i tha: **Unë jam i larguar prej asaj që adhuron i ju, përveç Atij që më krijoi, dhe që Ai do të më drejtojë!**” (Ez-Zuhruf: 26)

Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], është i dërguari i Zotit për të gjithë popujt, ashtu sikurse është i dërguari i Zotit edhe për të gjithë arabët”.²⁴⁷

Rainer Maria Rilke

“Kurrë s’ka lexuar, kurse tani-shiko! Një fjalë e tillë, edhe për dijetarin, është e paarritshme”.²⁴⁸

Luis Sudju

²⁴⁷ Ibid, f. 107.

²⁴⁸ Islamska Misao, v. IV, nr. 48, dhjetor, Sarajevë, 1982, f. 6.

“Erdhi koha dhe të gjitha vështirimet u drejtuan kah ai popull, i cili, ndonëse, në një kënd të Azisë, ishte i panjohur më parë, arriti të ngrihet në stadin më të lartë. Emri i tyre pushtoi horizontet e botës, plotë shtatë shekuj. Burim i kësaj mrekullie, ishte vetëm një njeri - Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk e konsideronte veten gjë tjetër, veçse vulë të peygamberëve të Zotit. Ai ka proklamuar se Isait, birit të Merjemes, i ishte dhuruar dhuntia për të bërë mrekulli, ndërsa, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], nuk i qe dhuruar një mrekulli e tillë. Ai ka vërtetuar amshueshmërinë e shpirtit. Ky është një nga parimet më të fuqishme të moralit dhe mburrjes së Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Ai, këtë e bëri më fuqishëm, se cilido ligjvënës tjetër”.²⁴⁹

Nasri Selheb

“Në Mekke... pa dritën një fëmijë. Në çastin e lindjes së tij, nuk i shkoi ndërmend askujt, se ai do të bëhet njeriu më i madh në botë, madje në histori, dhe mbase njeriu më i madhërisëm, në mënyrë absolute.

Madhështia e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], arriti që gjatë asaj periudhe të shkurtër, të formojë një legjislacion moral, shpirtëror dhe shoqëror. Askush në histori, nuk ia ka arritur të bëjë një gjë të tillë, me një shpejtësi të tillë marramendëse.

Ky njeri, i cili nuk diti për qetësi, rehati dhe stabilitet, arriti, që mes një mase të tillë njerëzish, të vejë rregulla për shtet, të vendos ligjin dhe të ngrejë sisteme.

²⁴⁹ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 116-117.

Thesari yt, o bir i Allahut, duhet të gjallërohet, jo vetëm në shpirt dhe zemër, por edhe në realitetin e jetës, për shkak të krizave, që po përjeton njerëzimi dhe vështirësive, me të cilat po përballet. Thesari yt është shkollë, nga minberët (e xhamive) çdo ditë jepen këshilla dhe mësim. Çdo pyetje, ka përgjigjen e saj dhe çdo problem, zgjidhjen e vet. Çdo problem, sado i vështirë dhe i komplikuar të jetë, në traditën tënde gjen zgjidhje.

Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk ishte vetëm i dërguar, i cili i udhëzonte njerëzit në besim, por ishte lider dhe udhëheqës i popullit. Ai kishte vendosur, që atë popull, ta shndërronte në Bashkësinë (Ummetin) më të mirë, për mbarë njerëzimin, dhe vërtet arriti atë që deshi”.²⁵⁰

²⁵⁰ Ibid, f. 115.

Ahmed Suse

Thotë: "Cili synim është më fisnik dhe më i afërt për njerëzimin, se sa feja e Zotit dhe synimi i Pejgamberit, për njësimin e zemrave dhe triumfin e së Vërtetës? Le të parafytyrojmë Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] duke u diktuar ithtarëve të Librit, shpalljen e All-llahut: *"Thuaju (o i dërguar): O ithtarë të librit (Teurat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos All-llahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos All-llahut! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)!"* (Ali Imran: 64)

Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte shembull për jetën njerëzore, me jetën e tij, të besuarit e sinqertë, të thellë, dhe të fuqishëm. Ai është shembull i përkryer për ruajtjen e amanetit dhe udhëzimit. Sakrifikat, për përhapjen e misionit të tij hyjnor, janë argumenti më i fuqishëm, që dëshmojnë mbi përsosmërinë e qenies, qëllimin fisnik, madhështinë e personalitetit dhe shenjtërinë e pejgamberisë së tij.

Historia, na tregon se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka sakrifikuar çdo gjë, për hir të misionit të vet. Disa herë, atij, i është ofruar rasti për të zgjedhur në mes dy mundësive: jetës së qetë, komode dhe të pasur, me kusht që të braktiste thirrjen e tij, - dhe jetës së vështirë dhe përndjekjes, nëse vazhdon misionin e vet. Ai preferoi të dytën, sepse besimi i tij, në misionin e besuar, ishte i paluhatshëm. Atij, i ishte shpallur se All-llahu e kishte obliguar që t'ia

përhapë misionin pejgamberik mbarë njerëzimit. Prandaj, ai preferoi atë që kishte zgjedhur All-llahu për të”.²⁵¹

Lightner

Studiues anglez, ka doktoruar në legjislaturë, filozofi dhe teologji.

“Nga ajo që di për dy fetë, për Krishterizmin dhe Hebraizmin, them se ajo, që ka predikuar Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk është plagjiat, por relevantë, që i është shpallur atij. Për këtë, nuk duhet të dyshohet, përderisa besojmë se, edhe më parë, ka ardhur Shpallja nga i Gjithëfuqishmi dhe i Gjithëdituri All-llah.

Unë, me respekt të plotë dhe me përulje, them se vetitë sikurse janë: ‘sakrifikimi personal, besueshmëria e qëllimit, besimi i fortë dhe i paluhatshëm, vështirimi i saktë dhe i thellë në hollësitë dhe fshehtësitë e të gabuarit’ - të gjitha këto, janë prej argumenteve të qarta, që dëshmojnë për pejgamberinë e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe për atë, se atij i është shpallur Kur’ani.

Në moshën njëzetepesëvjeçare, ai u martua me një femër dyzetvjeçare... Ajo, ishte e para, e cila besoi misionin e tij të shenjtë. I Dërguari, së bashku me të (Hadixhen), qëndroi njëzet vjet dhe nuk u martua me ndonjë tjetër, derisa ajo vdiq. S’është e drejtë dhe e vërtetë, që t’i përshkruajmë diçka, e cila nuk i ka hije njeriut të madhërishtëm, i cili gjithë jetën e kaloi me modesti dhe në mënyrë të ndershme. S’ka dyshim, se të martuarit e tij në një moshë kaq të thellë, ka qenë për shkaqe të tjera, jo për atë çfarë shkruajnë të krishterët.

²⁵¹ Ibid, f. 115-116.

Shtrohet pyetja se, cilat ishin shkaqet e vërteta të martesës, në një moshë kaq të thellë?

S'ka dyshim, se një gjë të tillë, e bëri për shkak të dhembshurisë, që kishte ndaj grave të shokëve të vrarë.

Një herë, Zoti e qortoi në mënyrë të rreptë, përmes Shpalljes që ia zbriti, sepse ai e largoi fytyrën e tij nga një njeri i verbër varfanjak, në kohën kur ishte duke biseduar me parinë e pasur. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] këtë gjë, ia komunikoi njerëzve. Sikur të ishte mashtrues, ashtu siç pretendojnë të krishterët, ai në të vërtetë, nuk do ta komunikonte një gjë të tillë.

Unë them, me zërin tim të lartë, dhe shpresoj se do të vijë dita, kur të krishterët, do të shprehin, në mënyrë të madhërishtme respektin e tyre, ndaj Isait [alejhis-selam] duke nderuar Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

S'ka dyshim, se çdo i krishterë, i cili e pranon misionin e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe beson atë që solli ai, do të jetë i krishterë i vërtetë".²⁵²

Dr. Nadhmi Luka

I krishterë nga Egjipti, thotë:

"Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] me virtytet dhe cilësitë e tij, nuk ishte sikurse edhe të tjerët. Tek ai, qenë tubuar të gjitha shenjat e peygamberëve dhe guximi i guximtarëve, prandaj, është detyrë, për çdo studiues objektiv, që të shprehë respekt ndaj një shëmbëlltyrë të tillë dhe të tregojë konsideratë ndaj tij.

Ai, ishte njeriu i vetëm, i cili qe gjuha e qiellit, sipër tij qëndronte vetëm Zoti dhe askush tjetër, nën të ishin besimtarët, adhuruesit e Zotit...

²⁵² Ibid, f. 133-135.

Edhe përkundër kësaj, ai asnjëherë nuk tregoi mendjemadhësi...

Këtij Pejgamberi, të cilit i ishte dhuruar udhëzimi i njerëzve, i cili ka arritur madhështinë, lartësimin dhe pushtetin, - edhe sikur të mburrej me gjithë ato, nuk do t'i merrej për të madhe. Ndërkaq, edhe përkundër kësaj, ai thotë: *'Mos më madhëroni mua, ashtu sikurse e madhërojnë të krishterët, të birin e Merjemes. Me të vërtetë, unë jam rob i All-llahut. Prandaj, thoni (për mua) robi i All-llahut dhe i Dërguari i Tij'*. Një herë, kur doli para një grupi besimtarësh, ata u ngritën në këmbë, duke e madhëruar atë, por ai e ndaloi një gjë të tillë, duke thënë: *'Mos u ngritni në këmbë, sikurse ngrihen të huajt, duke e madhëruar njëri-tjetrin'*.

Cili njeri, meriton që biografia e tij, të jetë larg çdo paragjykimi, ashtu siç meriton ky pejgamber, i cili miliona njerëz i shndërroi, nga adhurimi shkatërrues ndaj idhujve, në adhurues të Zotit, Krijuesit të gjithësisë, i cili i largoi nga humbja dhe devijimi dhe i shpuri në lartësinë e besimit. Nga lufta që bëri, nuk përfitoi asgjë, as ai dhe as familja e tij, prej atyre gjërave, për të cilat luftojnë përfituesit e kësaj bote".²⁵³

Gustav Lebon

"Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i bashkoi arabët para vdekjes, formoi një bashkësi (Ummet) të bashkuar, që përqafoi një fe dhe u udhëhoq nga një udhëheqës. Kjo është shenjë e madhe. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e arriti atë sukses, të cilin nuk e arriti asnjë nga fetë e mëparshme, të cilat u shfaqën para tij, në tokat arabe, as Hebraizmi dhe as Krishterizmi. Prandaj, kontributi i tij qe madhështor. Nëse madhështia e njerëzve matet me madhë-

²⁵³ Ibid, f. 136-137.

shtinë e veprave të tyre, atëherë Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është nga më të madhërishmit që ka njohur historia. Tanimë, dijetarët perëndimorë kanë filluar të tregohen objektivë, edhe përkundër asaj, se fanatizmi fetar, historianëve ua ka verbuar mjaft shumë sytë dhe të pranojnë superioritetin e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] kundruall të tjerëve”.²⁵⁴

²⁵⁴ Ibid, f. 135-136.

Lord Hidhu

Thotë: “Pejgamberi arab, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ka pasur një personalitet të jashtëzakonshëm, një karakter të fortë dhe një burrëri të tillë, që u pasqyrua në çdo hap të jetës së tij, duke bërë të qartë se, në botë, nuk ka si ai. Nëse do të ndienim nevojën për të pasur një shembull, që do ta udhëhiqte jetën tonë, atëherë, unë me bindje do të shprehesh: Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e lartëson jetën e njerëzve, pasi jeta e tij, është si një pasqyrë që reflekton në mendjehollësinë, bujarinë, burrërinë, guxim, durimin, krenarinë, faljen e gabimeve, modestinë dhe të gjitha sjelljet e shkëlqyeshme, që e pajisin njeriun me virtytet më të larta e më të shkëlqyera. Nuk do të lë pa përmendur se, Pejgamberi ka qenë plotësisht i bindur ndaj së Vërtetës, lutej më tepër se të tjerët, falej natën, derisa i ënjteshin këmbët dhe agjëronte aq shumë sa që shokët e tij thoshin: ky agjëron vazhdimisht! Kurse, nganjëherë, nuk agjëronte sa që ata thoshin: ky nuk agjëron kurrë (veç Ramazanit)! Prandaj, te Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] shohim një jetë plotë drita, që mund të ndriçojë jetën njerëzore”.²⁵⁵

R. Landau

Kritik anglez: “Në asnjë ditë prej ditëve të jetës së tij, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk i përshkroi vetes cilësi hyjnore, ose fuqi çudibërëse. Përkundrazi ai ishte i kujdesshëm për faktin se ishte vetëm i dërguar, të cilin Zoti e kishte krijuar për t’ia komunikuar shpalljen njerëzimit”.²⁵⁶

²⁵⁵ Dr. Muhammed A. Jemani, *Edukoni fëmijët tuaj me dashuri për Profetin Muhammed a.s.* Shkodër, 1996. f. 94-95.

²⁵⁶ Dr.Imadudin Halil, op.cit., f.136,137.

KAPITULLI IV

CIVILIZIMI ISLAM

Will Durant

Në bisedën e tij, mbi rezultatet e luftërave të kryqëzatave, thotë:

“Civilizimi islam, vërtetoi faktin se është më i ngritur se civilizimi evropian, në butësinë e tij, të mësuarit e tij, si dhe mënyrat e tij luftarake... Sa i përket letërsisë, shkencave dhe filozofisë arabe, Evropa u ndikua prej tyre nëpërmjet Spanjës (Andaluzisë) dhe Sicilisë”.²⁵⁷

“Sikur të mos ishte Ibn Hejthemi (që është themeluesi i shkencës bashkëkohore të optikës në kuptimin e plotë të fjalës), njerëzit asnjëherë nuk do të dëgjonin për Roxher Bekonin”. (Roxher Bekon, gati sa nuk bën asnjë hap, në studimet optike, pa sinjalizuar për Ibn Hejthemin, apo pa mos transmetuar prej tij.)²⁵⁸

Kurse, për qytetërimin islam në Spanjë, në “Kisatul Hadare”, vëllimi 13, thotë:

“Administrata arabe (në Spanjë) ka qenë fat dhe lumturi, për një kohë relativisht të shkurtër, për bujqit e këtij vendi, meqë pushtuesit nuk ngelën në pronat që ishin jashtëzakonisht të mëdha, e që i posedonin Gotët e Perëndimit. Gjithashtu, edhe bujkrobërit i liroi nga zgjedha feudale.

Islami, përplot pesë shekuj (së paku), gjegjësisht nga viti 700 e deri në vitin 1200 të erës sonë, i priu mbarë botës me fuqi,

²⁵⁷ Prof. Hani El Mubarek dhe dr. Shukri Ebu Halil, *Roli i civilizimit arabo-islam në renesansën evropiane*, Shkup, 1420/1999, f. 38-39.

²⁵⁸ Prof. Hani El Mubarek dhe dr. Shukri Ebu Halil, op. cit., f. 100.

qëndrueshmëri, organizim të mirëfilltë, zemërgjerësi qeveritare, moral dhe karakter, begatim dhe ngritje të standardit jetësor, legjislacion human e të mëshirshëm, tolerancë fetare, letërsi, kërkime shkencore, mjekësi, filozofi etj”.²⁵⁹

Në librin e tij “Historia e civilizimit”, II, f. 47, thotë:

“Në vitin dyqind e pesëmbëdhjetë sipas hixhretit, Halifi abasit Memun, kishte themeluar ‘Shtëpinë e Urtësisë’ (*Bejtul hikmeh*), në Bagdad dhe e kishte pajisur me observator astronomik dhe bibliotekë publike, për çka kishte ndarë dyqind mijë dinarë. Kishte tubuar një numër të madh njerëzish të ditur, të cilët njihnin gjuhët e huaja dhe disiplina të ndryshme shkencore, siç ishte Honain, Bakhteesho, Ibn Tarik, Ibn Mukaffa, Haxhaxh b. Matari, Sirgis, Ra’asi e të tjerë, duke ndarë mjete të mëdha materiale për punën e tyre, duke dërguar shumë prej tyre në vende të ndryshme të botës për të mbledhur libra për mjekësi, filozofi, matematikë, letërsinë e bukur dhe të shkencave të tjera, si në gjuhën hindu, pahlevi, shaldean, gjuhën e vjetër siriane, greke, latine, dhe gjuhën e vjetër persiane”.²⁶⁰

Roxher Bekon

(E zotëronte mirë arabishten, ka vepra të shumta, njihet si filozof dhe agjikator për përvetësimin e shkencave të muslimanëve dhe përhapjes së tyre në Evropë. Ai nuk qe i dyshimtë në pohimin se filozofia është me origjinë arabe.) Ishte penguar me urdhër të mbretit Eduardit I, të vazhdojë hulumtimet eksperimentale në fushën e kimisë, si dhe punën e profesorit në Universitetin e Oksfordit. Më pas, ishte transferuar me dhunë në Paris, për të qenë nën kon-

²⁵⁹ Jusuf Kardavi, op. cit., f. 58.

²⁶⁰ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 99.

troll të drejtpërdrejtë të Kishës. Ishte akuzuar se merrej me alkiminë satanike dhe ishte kërkuar t'i pritej dora këtij magjistari, si dhe të dëbohej ky "musliman" nga vendi.²⁶¹ Në vitin 1292, shkruan:

"Pjesa më e madhe e filozofisë së Aristotelit, meqë dorë-shkrimet ishin fshehur dhe ishin të rralla, ngase kishin subjekt shumë të vështirë, dhe për shkak të luftërave në lindje, nuk arriti të ushtrojë ndonjë ndikim në Perëndim, veçse pasi Ibn Sina (Avicena), Ibn Ruzhdi dhe të tjerë, në dritë të një shtjellimi të kuptueshëm, e risollën Aristotelin dhe filozofinë e tij".²⁶²

Thomas W. Arnold

"Gjatë shumë shekujve muslimanët lanë faqet më të ndritshme në historinë e Mesjetës. Ja ky ndikim i muslimanëve spanjollë, ka kaluar nëpërmjet Provancës, edhe në viset e tjera të Evropës, duke zgjuar ndjenja të reja dhe duke krijuar shkencën e re. Shkenca dhe filozofia, e cila dijetarëve evropianë ua ka freskuar veprimtarinë shkencore deri te Renesanca, gjenezën e ka në Spanjë...

Kur të krahasohet shkenca dhe letërsia e muslimanëve, me shkencën dhe letërsinë e të krishterëve, kjo e dyta duket mjaft e varfër. Islami në fushën e shkencës dhe letërsisë, si shtytës dhe faktor entuziazmes, ka kryer shërbim special për ithtarët e vet".²⁶³

Derberin

²⁶¹ Ibid, f. 98.

²⁶² Robert L. Gulick, Jr. op. cit., f. 73.

²⁶³ Thomas W. Arnold, op. cit., f. 127-135.

Profesor i Universitetit të Nju Jorkut, në librin e tij “Konflikti ndërmjet shkencës dhe fesë”, botimi i dhjetë francez, viti 1900, thotë:

“Pas vdekjes së Pejgamberit Muhammed [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], në gjuhën arabe janë përkthyer veprat më të rëndësishme greke. Mirëpo, periudha e artë e kulturës dhe shkencës në Azi, ka ndodhur në kohën e halifit Memun (813-832), i cili Bagdadin ë bëri kryeqendër grandioze të diturisë. Ai kishte themeluar një bibliotekë të madhe, kishte afruar shumë dijetarë dhe u kishte dhënë respekt të madh. Librat siguroheshin rregullisht, ndërsa shënimet historike përmendin një përmbledhje librash të sjella në Bagdad, prej më se 100 barra devesh”.²⁶⁴

J. Lal Nehru

Në librin e tij “Pasqyra e historisë botërore, f. 413”, shkruan: “Kordoba ka qenë qytet i madh me 1 milion banorë. I ngjasonte një parku madhështor, me gjatësi prej 20 kilometrash. Paralagjet shtriheshin në hapësirë deri në 40 kilometra. Thuhet se ka pasur 60.000 pallate me godina të mëdha banimi, 200.000 shtëpi të bukura më të vogla, 80.000 punëtori dhe dyqane të vogla, 3800 xhami, 700 hamame (banjo publike). Mund të ndodhë që këto numra të jenë zmadhuar, por ato, megjithatë, na ofrojnë një tablo të përafërt të këtij qyteti madhështor. Kishte shumë biblioteka, prej të cilave më e madhja dhe më e rëndësishmja, ishte Biblioteka mbretërore me rreth 400.000 tituj. Universiteti i Kordobës ishte i dalluar anekënd Evropës, madje edhe në Azinë Perëndimore. Ekzistonin edhe shkolla, në të cilat ishin siguruar arsimimi pa pagesë për të varfrit. Një historian deklaroi se çdo banor

²⁶⁴ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 100.

i Spanjës në këtë kohë dinte shkrim- lexim, ndërkohë që në pjesën tjetër të Evropës së krishterë, pos priftërinjve dhe klerit, duke përfshirë këtu edhe anëtarët e fisnikërisë më të lartë, nuk konsideronin se ia vlen madje edhe të provojnë të mësojnë shkrim-leximin”.²⁶⁵

Henry Pirene

Në “Mohammad and Charlemagne, f. 147-152”, thotë:

“Përhapja e Islamit, qe diçka e pa parë dhe, shpejtësia e rrufeshme e fitores, mund të krahasohet vetëm me atë, që shënoi fillimin e perandorisë së Atilës, Xhingis Kanit dhe Timer Lengut... Por, këto perandori u zhdukën si shkuma e sapunit, ndërsa Islami qëndroi... Përhapja e tij si rrufe qe një mrekulli e vërtetë, krahasuar me përparimin e ngadalshëm të Krishterizmit... Gjermanët nuk kishin asgjë, me anë të së cilës do t’i bënë ballë Krishterimit dhe Perandorisë. Ndërkaq, arabët qenë ngritur lart, nëpërmjet besimit të ri. Prandaj, ata nuk u asimiluan nga të tjerët... Arabët i përvehtësuan, qytetërimet e të pushtuarve, me një shpejtësi të çuditshme. Mësuan shkencën nga grekët, kurse artin prej tyre dhe prej persianëve.

Gjermanët, nuk ushtruan asnjë ndikim në qytetërimin romak, përkundrazi ata u influencuan dhe u romanizuan sapo hynë në tokën romake.

Ndërkaq, romakët u ndikuan nga arabët, sapo hynë nën pushtetin e Islamit. Në Spanjën e shekullit IX, të krishterët nuk dinin gjuhën latine dhe tekstet e këshillave i kishin përkthyer në gjuhën arabe. Arabët nxiteshin nga flaka e një zjarri të një thellësie, që ishte i panjohur për botën dhe popujt paganë”.²⁶⁶

²⁶⁵ Ibid, f. 102.

²⁶⁶ Robert L. Gulick, Jr. op. cit., f. 6.

Ser Eduard

Në veprën e tij “Nga historia e kimisë”, shkruan:
“Kimia ka përparuar dukshëm në kohën e halifëve abasidë. Muslimanët, që atëherë, e kanë njohur mjeshtërinë e distilimit, avullimit dhe sintezës. Për herë të parë, ata e kanë përdorur natriumin, karbonin, karbonat-natriumin, aluminin, kaliumin, amonium-kloridin, etj.”.²⁶⁷

Baroni Carra de Vaux

Autor i kaptinës “Astronomia dhe matematika”, në veprën “Trashëgimia islame” (OUP, 1931, f. 376-398), shkruan:
“Muslimanët kanë qenë tejet përparimtarë në shumë fushat e shkencës. Ata ia kanë mësuar njerëzimit përdorimin e numrave, ndërsa algjebrën e kanë vënë në themele shkencore, siç ia kanë vënë themelet edhe gjeometrisë analitike. Dihet mirëfilli që ata e kanë zbuluar trigonometrinë sferike, e cila nuk ka qenë fare e njohur te grekët e vjetër. Kur bota perëndimore krishtere zhvillonte luftëra barbare, muslimanët arabë merreshin me shkencë dhe i ruanin me kujdes vlerat e tyre fetare dhe morale”.²⁶⁸

“Në kohën e Renesancës, shpirti i njeriut, u mbush përsëri me zellin dhe zjarrin e dijes, u nxit nga shkëndija e gjenialitetit, u vendos në krye të punës, pasi arabët i kishin ruajtur dhe përsosur fushat e ndryshme të shkencës. Ata e mbajtën, shpirtin e gjurmimit, të gjallë, të freskët dhe të gatshëm për zbulime të reja”.²⁶⁹

²⁶⁷ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 109.

²⁶⁸ Ibid, f. 111.

²⁶⁹ Robert L. Gulick, Jr. op. cit., f. 84.

Zhan Bertrand

Profesor në Universitetin Kembrixh, në librin “Trashëgimia islame”, f. 152, shkruan:

“Kur Evropa po mbytej në pikëllim, mjerim, varfëri materiale dhe shpirtërore, muslimanët e Spanjës ndërtojnë një civilizim të madh, me një sistem të jashtëzakonshëm ekonomik. Spanja muslimane ka luajtur rol të rëndësishëm në shfaqjen dhe zhvillimin e industrisë, shkencës, filozofisë dhe poezisë. Në shekullin e XIII-të Islami kishte bërë ndikim te mendimtarët më të shquar të Evropës, siç janë: Dante dhe Toma Akuini. Prandaj, Spanjën duhet ta emërojmë si fanar të civilizimit evropian”.²⁷⁰

Xhember

Historian anglez në veprën “Futuhatul Arab ve kunuzul Adab”, f. 26, shkruan:

“Vërtet, lapsi nuk është në gjendje të përshkruaj tërë kontributin musliman për kulturën, civilizimin dhe lumturinë e jetës së njerëzve.

Ata ishin që kultivuan evropianët dhe promovuan progresin e tyre. Sikur muslimanët, nën udhëheqjen e Tarik b. Zijad, të mos kishin zbarkuar në vitin 711, në kodrën Xhebel Tarik dhe sikur prej andej të mos ishin nisur më tej kah Evropa, vetëm atëherë popujt evropianë do të ishin të vetëdijshëm për humbjen e tyre, dhe sa shumë do të kishin ngelur prapa progresit të sotëm”.²⁷¹

²⁷⁰ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 114.

²⁷¹ Ibid, f. 114, 115.

Bugoldi

Dijetar anglez, shkruan:

“Universitetet islame, posaçërisht në Bagdad dhe Spanjë, me dëshirë i kanë pranuar studentët e krishterë dhe hebrenj, ndërsa shkollimi i tyre ka qenë i mbuluar nga arka shtetërore. Muslimanët i nderonin, prandaj qindra të rinj evropianë e kanë shfrytëzuar këtë ndihmë dhe liri, duke u arsimuar në qendrat e mëdha shkollore islame”.²⁷²

Brouls

Në librin e tij “Krijimi i njerëzimit”, shkruan:

“Nuk ka dyshim se bazat e të gjitha shkencave dhe arteve mund t’i kërkojmë në themelet e kulturës islame. Shkencat e lashta kanë qenë dhuratë, të cilën muslimanët ia kanë ofruar shkencës moderne. Dëshmitë e kulturës islame bëhen evidente kur i shikojmë gjurmët e saj në këtë energji kolosale, e cila njerëzimit i ka dhuruar atë fuqi të pakufishme, atë energji të shpirtit për krijimtari shkencore dhe shkencat e natyrës. Atë çka shkenca moderne ua ka borxh muslimanëve, nuk janë vetëm zbulimet befasuese, porse është diçka shumë më e madhe, seç mund ta marrim me mend. Për ekzistimin e vet, shkenca moderne i është borxh muslimanëve. Ne e dimë shumë mirë me çfarë lidhje janë të lidhura shkencat tona moderne me shkencën e lashtë. Shkencat moderne kanë qenë pa rrënjë. Ajo, që ne sot në Evropë e studiojmë dhe e quajmë shkencë është rezultat i metodave bashkëkohore që janë paraqitur në domenin e vërtetimit eksperimental dhe vlerësimeve precize. Shkencat matematike kanë përparuar, posaçërisht në Greqi. Mirëpo, frymën

²⁷² Ibid, f. 115.

ambicioze dhe metodat shkencore i kanë shprehur muslimanët, të cilat ia kanë dhuruar Evropës”.²⁷³

Zhane Hersh

“Vepra e Aristotelit, pasi thuajse ishte zhdukur nga Evropa, ku nuk njihej më veçse fizika (teoria e natyrës), u soll nga doktorët arabë, pasi kishte shkuar në Afrikën e Veriut dhe në Spanjë. Kështu, ajo ushtroi një ndikim të madh”.²⁷⁴

E. Rosenthal

Në “Traces of Arabic Influence in Spain”, Islamic Culture, 11: 336, Korrik, 1937”, thotë:

“Në kohën (e Spanjës) muslimane, Kordoba ishte qendra e qytetërimit evropian dhe një nga qendrat më të mëdha të kulturës botërore. Pasi arabët e braktisën Spanjën, Kordoba u shndërrua në një qytet krahinor. Megjithatë, xhamia e mrekullueshme e Kordobës, kryeqytetit të ish-perandorisë arabe në Spanjë, është një trashëgimi e pakrahasueshme”.²⁷⁵

Khuda Bakhsh

Shkruan: “Në shekullin e parë të Hixhretit, gjejmë njerëz të mësuar që kishin ngatërresa me gratë e tyre, për shkak të numrit të madh të librave, dhe një nga këta, u vra nga një numër librash që i ranë mbi kokë, ndërsa ishte duke lexuar në dyshemenë e dhomës. Ishte për mburrje të kishe një shumicë librash të çmuara, dhe jo vetëm dijetarët, por edhe shtetarët mburreshin me koleksionet e tyre. Një njeri, i

²⁷³ Ibid, f. 115, 116.

²⁷⁴ Zhane Hersh, *Habia Filozofike*, Tiranë, pa vit botimi f. 99.

²⁷⁵ Robert L. Gulick, Jr. op. cit., f. 54.

quajtur Veziri Buvejhid, kurrë nuk merrte ndonjë udhëtim, pa pasur me vete 30 deve të ngarkuara me libra”.²⁷⁶

Anatole France

Në “La vie en Fleur, cituar ne Islamic Review”, 22:146, Maj 1934, thotë:

“Ngjarja më tragjike e historisë është lufta e Poitiers, kur shkenca, arti dhe qytetërimi arab, ranë në duart e frankëve”.²⁷⁷

C. H. Haskin, në “Studies in the History of Mediaeval Science”, f. 3-5, duke përmendur Renanin dhe duke shtuar komentet e tij, rezymon:

“Rifitimi i shkencës së lashtë dhe filozofisë në shekujt XII dhe XIII, shënon një epokë në historinë e dijes evropiane.

Studimi i teksteve arabe, nga studiuesit perëndimorë, sipas Renanit përcaktoi ndarjen e historisë së shkencës dhe filozofisë, gjatë Mesjetës, në dy periudha plotësisht të ndara:

Në periudhën e parë, mendja njerëzore u mjaftua duke kënaqur kureshtjen e saj, me pjesë të pamjaftueshme të shkollës romake, sikurse ishin tekstet e Martianus Capella, Bade etj.

Në periudhën e dytë, shkenca e lashtë erdhi sërish në Perëndim. Por, kësaj radhe ajo erdhi më e plotë, nëpërmjet matematikës dhe astronomisë arabe dhe shpjegimeve që i bënë ata veprave origjinale të shkencave greke, si të Hipokratit, Galenit, shkrimeve të Aristotelit, etj. Ndërkaq, romakët kishin nxjerrë përmbledhje të shkurtër prej tyre.

²⁷⁶ Ibid, f. 54.

²⁷⁷ Ibid, f. 43.

Rifitimi i tërë kësaj dije të lashtë, e cila qe plotësuar me studimet dhe sugjerimet që kishin bërë studiuesit arabë, shkaktoi rilindjen e shkencës në Mesjetë”.²⁷⁸

“Është fakt i ditur se, arabët e Spanjës, ishin burimi kryesor i diturisë evropiane”.²⁷⁹

Stanwood Cobb

Themelues i Shoqatës të Edukimit Përparimtar, në “Islam’s contribution to the World Culture, World Order, 6: 202, 9/40”, thotë:

“Kontaktimi i kulturës islame me vendet evropiane shkaktoi Renesansën në Evropë”.²⁸⁰

Robert L. Gulick, Jr.

“Studimi i parë, në mënyrë sistematike dhe kritike, i Dhiatës së Vjetër dhe të Re, në Evropë, u krye nga një musliman, Ibn Hazmi nga Kordoba. Shën Toma u ndikua në mënyrë të fortë nga Gazaliu dhe Ibn Ruzhdi.

Shkolla muslimane, për teologjinë dhe ligjin, ndikoi dhe solli në jetë shkollën teologjike kristiane, që u formua disa shekuj me vonë”.²⁸¹

“Ua kemi për borxh muslimanëve mirënjohjen tonë që ruajtën, përkthyen dhe ia dorëzuan Evropës veprat e filozofëve grekë. Sikurse e kemi thënë më parë, akuza se muslimanët shkatërruan librarinë e Aleksandrisë, është një shpifje qesharake”.²⁸²

²⁷⁸ Ibid, f. 41-42.

²⁷⁹ Ibid, f. 55.

²⁸⁰ Ibid, f. 5.

²⁸¹ Ibid, f. 76

²⁸² Ibid, f. 72

“Veprat e Gazaliut mbi logjikën, shkencat fizike dhe metafizikën, iu bënë të njohura evropianëve, nëpërmjet përkthimit në latinisht, që u botuan në shekullin XII në Toledo.

Parashtesat e Gazaliut, për vendin që zë arsyeja në teorinë teologjike dhe Relevatën, duhet të kenë frymëzuar disa nga arsyetimet e veprës *Summa Contra Gentiles*, të Shën Tomës”.²⁸³

“Besimi i zakonshëm se, murgët e krishterë të Mesjetës, ishin ata që e ruajtën dhe na përcollën kulturën helene, se vetëm manastiret e mbajtën të ndezur dritën e kulturës, është një besim i bazuar në prova jo të sakta dhe të pavërtetuar. Që në fillim, duhet të kemi parasysh faktin se, shoqëria kristiane e asaj kohe, ishte inferiore ndaj shkencës dhe qëndronte më poshtë se bota muslimane në rrafshin e dijes”.²⁸⁴

“Janë të paktë, ata studiues që do të mohonin faktin se ndikimi arab, në rilindjen evropiane, ka pasur rëndësi të veçantë. U desh të bëhen shumë përkthime, gjatë viteve, që pedagogët e Perëndimit të binden dhe t’i njohin, revolucionit islamik, një vend nderi në librat e historisë, ashtu sikurse ia njohin revolucionit frëng. Në ndriçim të faktit, shumë kërkime duhet të bëhen me qëllim që të nxjerrin në dritë thesaret intelektuale, që na kanë lënë muslimanët. Është dinjitoze për dijetarët tanë, që të heqin dorë nga përfundimet negative, rreth kontributit të civilizimit islam, në qytetërimin e sotëm”.²⁸⁵

²⁸³ Ibid, f. 75.

²⁸⁴ Ibid, f. 41

²⁸⁵ Ibid, f. 50

Rozhe Garodi

Intelektual i madh francez, pranoi Islamin, ai thotë:

“Islami ka nxitur frymën shkencore nga më të mrekullueshmet, çfarë s’ka parë bota ndonjëherë, që nga matematika e deri te mjekësia, nga astronomia e deri te fizika. Kultura islame, ka shndritur me shkëlqimin e saj, shekuj me radhë. Universiteti islam, në Kordobë (Spanjë), në shekullin X-të, ishte shëmbëlltysë, shpirti i së cilës duhet rigjallëruar që sërish të zhvillohet shkenca, por kjo, të bëhet jo me qëllim të shkatërrimit të njerëzimit, por që t’i shërbejë njeriut në rilindjen e tij shpirtërore drejt Zotit.

Nga Universiteti i Kordobës, nga shekulli X deri në shekullin XII ka shndritur kultura në të tri kontinentet, me formën e vet me të plotë”.²⁸⁶

John Davenport

Dijetar i shquar, cituar nga A. Karin në “Islam’s Contribution to Science and Civilization”, thotë:

“Duhet të pranojmë se e tërë dija në fushën e fizikës, astronomisë, filozofisë, matematikës që u përhap në Evropë, duke filluar nga shekulli X-të, buron nga shkollat arabe. Madje, saracenët (muslimanët) e Spanjës, mund të konsiderohen si etër të filozofisë evropiane”.²⁸⁷

Bertrand Rasel

Filozof i famshëm anglez, në veprën “Historia e civilizimit evropian”, veç të tjerash, thotë:

²⁸⁶ Rozhe Garodi, Gjallërimi Islamik, op. cit., f. 13.

²⁸⁷ Mevdudi, op. cit., f. 51.

“Fraza ‘shekujt e errët të Mesjetës’, ndërmjet shekujve VII-X, ka të bëjë vetëm me Evropën. Në atë kohë, prej Indisë deri në Spanjë, shkëlqente qytetërimi islam. Prandaj, është pasaktësi të flitet vetëm mbi qytetërimin e Evropës”.²⁸⁸

“Superioriteti i Orientit nuk ishte vetëm në fushën luftarake. Shkenca, filozofia, poezia dhe arti, lulëzonte në botën muslimane, në kohën kur Evropa vuante nga barbarizmi. Evropianët, me zemërngushtësi të pafalur, këtë epokë e quajnë ‘epoka e errësirës’, por vetëm Evropa ishte në errësirë. Vetëm Evropa e krishterë, sepse Spanja, e cila ishte muslimane, kishte kulturë brilante”.²⁸⁹

John Viliam Draper

Dijetari i madh anglez, në veprën, “Historia e zhvillimit intelektual të Evropës”, thotë:

“Si është e mundshme që, një astronom i ndërgjegjshëm, të mos ndiejë respekt të thellë ndaj arabëve, kur vëren tablotë astronomike të Tusit, të cilat i hartoi pas studimeve shumëvjeçare të qiellit, nëpërmjet observatorit astronomik në Meragi, në Persi.

Arabët, kanë lënë ndikim të pashlyeshëm në intelektin evropian dhe krishterizmi, së shpejti, do të jetë i detyruar që ta shprehë këtë.

Ky ndikim është skalitur fuqishëm në kupën e qiellit, gjë të cilin mund ta provojë çdonjëri që dëshiron të njihet, qoftë edhe sipërfaqësisht, me termat dhe emërimet e trupave qiellorë.

Në astronomi, ata, të parët, e ndanë globin tokësor në meridianë. Ata përcaktuan gjatësinë e një grade. Llogaritën

²⁸⁸ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 43.

²⁸⁹ Mevdudi, op. cit., f. 51.

sipërfaqen e Tokës dhe zbuluan se sa kilometra kubik ka globi tokësor. Duke vëzhguar lëvizjet e yjeve, llogaritën të parët se kur do të ndodhë eklipsi i Diellit dhe Hënës. Duke studiuar atmosferën, e cila mbështjell globin tokësor, e matën dhe zbuluan se lartësia e dritës është 100 kilometra, kurse jashtë kësaj lartësie, hapësira është e zbrazët, me çka pajtohen, me pak përjashtime edhe fizikanët e sotëm. Ata të parët, e ndanë ditën dhe natën në 24 orë dhe e zbuluan orën, si njësi matëse për kohën. Të parët, i studiuan trupat qiello-rë... dhe u dhanë emra të veçantë, të cilët përdorën edhe sot në gjuhët evropiane dhe shërbejnë si gjurmë të pashlyeshme të kulturës së lavdishme arabe. Ibn Ruzhdi, i njohur në përfundim me emrin Averros, nga Kordoba, është i pari që ka zbuluar njollat e diellit. Arabët në Spanjë kishin globin tokësor, në kohën kur në Kostandinopojë dhe Romë, mësohej se Toka është e rrafshët. Një prift katolik, pas mbarimit të studimeve në universitetin islam, tek arabët në Spanjë, sollti një glob tokësor në shkollën e tij në Romë, ku ka ligjëruar gjeografinë dhe astronominë. Ky prift, me vonë, bëhet Papa Silvester II²⁹⁰.

Në të njëjtën vepër, në "History of the Intellectual Development of Europe", f. 386, gjithashtu, thotë:

"Islami, gjatë gjithë kohës, pasoi shkencën fizike. Ndërkaq, krishterizmi pagan, jo vetëm që e hodhi poshtë këtë shkencë, por shprehu përbuzje të thellë dhe urrejtje ndaj saj. Mjekët shiheshin, nga Kisha, me sy jo të mirë dhe njerëzit i konsideronin të pafë.

Besonin me ngulm mësimet e dhëna, të cilat i mësonin se mund të shëroheshin nëpërmjet gjërave të shenjta të martirëve dhe kockave të shenjtoreve, përmes lutjeve dhe ndër-

²⁹⁰ Kur'ani dhe Zbulimet Bashkëkohore, Glasnik, Sarajevë, nëntor-dhjetor, 1966, nr. 11-12, f. 503.

mjetësimit, ku besohej se çdo pjesë është nën ndikimin shpirtëror. P.sh. besohej se, pjesa e parë e gishtit të madh të dorës së djathtë, ishte nën kujdesin e Zotit At, e dyta nën kujdesin e Virgjëreshës së Bekuar, e kështu me radhë. Besonin se për çdo sëmundje është një shenjtor”.²⁹¹

Georgi Zejdon (Xhorxh Zejdan)

Në librin “Madhështia e Spanjës Muslimane”, f. 183, shkruan:

“Farmaceutikët bashkëkohorë evropianë, që kanë studiuar historinë e profesionit të tyre, kanë zbuluar se ekspertët muslimanë kanë themeluar, në principe shkencore, farmakologjinë si shkencë. Ata kanë shpikur metodën e sajimit të ilaçeve dhe kanë sajuar ilaçe krejtësisht të reja. Ata, për herë të parë, kanë hapur dyqane të specializuara për përpunimin dhe shitjen e ilaçeve, siç janë sot barnatoret. Mek Kap ka shënuar se, vetëm në Bagdad, ishin rreth 60 barnatore të cilat kanë dhënë rregullisht recetat që janë paguar nga arka e shtetit (bejtul-mal), sipas urdhrit të halifit”.²⁹²

“Që në fund të shekullit të dytë hixhri, Mekka, Medina dhe qytete të tjera të mëdha muslimane kanë pasur spitale, ndërsa guvernatorët dhe ministrat e tyre garonin mes tyre, që regjionet e tyre të kenë institucionin më të mirë për shërimin e të sëmurëve. Vetëm Bagdadi kishte katër spitale të mëdha. Në vitin treqindëgjashtëdhjetë e tetë, guvernatori Dejlemi Izadu-devlet, kishte themeluar spitalin Abdudi, me 24 specialistë, secili ekspert për lëmin e tij. Ky spital, shumë shpejt, arriti një reputacion sa i tejkaloi të gjitha spitalet në botën islame, ndonëse me kohë, edhe ai u tejkalua”.²⁹³

²⁹¹ Robert L. Gulick, Jr. op. cit., f. 95.

²⁹² Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 105.

²⁹³ Ibid, f. 106.

Kurse, në librin "Historia e civilizimit arabo-islam", III, f. 282, shkruan:

"Rendi dhe rregullimi i spitaleve islame ishte i tillë, që mundësonte trajtim të drejtë për të gjithë pacientët, pa marrë parasysh përkatësinë e medh'hebit apo profesionit, ndërsa shërimi ofrohej me respekt të duhur ndaj secilit pacient. Ekzistonin sektorë të posaçëm për pacientë me sëmundje specifike. Në afërsi të spitaleve studiohej mjekësia dhe hulumtoheshin ilaçet. Këto ishin vende ku studentët mësonin teorinë, ndërsa në spitale e kryenin praktikën. Më tej, ekzistonin spitale lëvizëse (siç ekzistojnë edhe sot) me mjekë dhe pajisje të bartura me deve ose mushka në çdo vis. Sulltan Mahmud Selxhuku kishte udhëtuar me spitalin, për të cilin i janë dashur rreth 40 deve për transport".²⁹⁴

Dozy

Orientalist i madh, në librin e tij "Historia e muslimanëve të Spanjës", thotë:

"Pushtimi arab ishte i mirëseardhur për Spanjën, ai nxiti revolucionin e gjithmbarshëm social, flaku tutje pjesën më të madhe të së keqes, nën të cilën Spanja lëngonte në shekuj. Taksat, që vendosën arabët (ndaj popullsisë vendase) ishin thuajse krejtësisht të papërfillshme, në krahasim me taksat që u imponoheshin nga sunduesit e mëparshëm. Arabët, tokat e shumta që kishin feudalët, ua shpërndanin në mënyrë të barabartë atyre që i punonin: fshatarëve, çifçive, skllevërve, etj. Pronarëve të rinj, u interesonte t'i punonin ato sa më mirë që ishte e mundur. Të korrrat ishin të jashtëzakonshme. Tregtia u lirua prej kufizimeve dhe taksave të rënda, që më parë u shtrëngonin fytin... Kur'ani u mundë-

²⁹⁴ Ibid, f. 106.

soi sklevërve çlirimin e tyre kundrejt një pagese. Kjo, bëri që të vihet në lëvizje një energji e re. Të gjitha këto masa, sollën një mirëqenie të përgjithshme, e cila bëri që domini arab, të jetë i dëshiruar dhe i mirëpritur”.²⁹⁵

V. Robinson

Në veprën “Historia e mjekësisë”, thotë:

“Evropa ishte në errësirë, në kohën që Kordoba kishte bërë ndriçimin publik. Në Evropë, mungonin banjot, ndërkaq, Kordoba kishte me mijëra. Rugët e qyteteve evropiane, ishin zhytur në baltë, ndërkohë, që rrugët e Kordobës ishin të shtruara me pllaka.

Fëmijët e Kordobës studionin në shkollë, dhe mësuesit e tyre kishin formuar një bibliotekë të krahasueshme me dimensionet e bibliotekës së famshme të Aleksandrisë”.²⁹⁶

Robert Brifault

Historian i njohur, në librin e tij “The Making of Humanity”, thekson:

“Është mjaft e qartë se civilizimi evropian, pa arabët, nuk do të arrinte deri aty, sa të kapërcente fazat e para të zhvillimit. Edhe pse s’ka asnjë aspekt të zhvillimit njerëzor, në të cilin të mos jetë i dukshëm ndikimi i kulturës islame, ajo askund s’është më e qartë se sa në fuqinë nxitëse, ndikimin në kërkimin shkencor dhe kontributin në shkencat natyrore.

Ajo që konsiderohej shkencë, në Evropë do të karakterizohet me një shpirt të ri hulumtimi, metodë të re shqyrtimi, eksperimentim dhe vëzhgim. Matematika u zhvillua në një formë të re, e cila ishte thuajse e panjohur për grekët. Kjo

²⁹⁵ Rozhe Garodi, op. cit., f. 7-8.

²⁹⁶ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 42-43.

frymë dhe kjo metodë, u soll në Evropë nëpërmjet arabëve”.²⁹⁷

“Roxher Bekoni ka studiuar gjuhën arabe, arabistikën dhe shkencat arabe në Universitetin e Oksfordit, nga trashëgimtarët e profesorëve arabë, nga Andaluzia (Spanja).

Roxher Bekonit dhe emnakut të tij, i cili do të paraqitet më vonë, me të drejtë, nuk duhet t’i jepet merita për shpikjen e metodës eksperimentale, për arsye se Roxher Bekoni, është vetëm emisar i metodës dhe shkencës islame në Evropën e krishterë. Ai ka qenë luftëtar i zjarrtë për njohjen e gjuhës arabe dhe shkencave të saj, nga të gjithë bashkëkohësit e tij, duke e konsideruar atë rrugë për njohjen e vërtetë dhe të drejtë.

Polemikat e zhvilluara, rreth asaj se kush është themelues dhe shpikës i metodës eksperimentale, paraqesin rastin e një falsifikimi flagrant të origjinës së qytetërimit evropian. Metoda eksperimentale e arabëve ka qenë e përhapur në kohën e Bekonit, kurse njerëzit e trullit të Evropës me padurim dhe me një entuziazëm të pashembullt, i janë rrekur studimit dhe përvetësimit të saj”.²⁹⁸

Dr. Julije Shnajder

Astronom i madh gjerman, në librin e tij “Rregullimi i Gjithësisë”, duke folur për kontributin e popujve të ndryshëm në fushën e astronomisë, thotë :

“Romakët nuk e zgjeruan shumë shkencën e astronomisë. Qindra vjet, kjo fushë mbeti e paeksploruar, derisa në fund, këta përhapës të Islamit, i pushtuan qendrat kulturore përrëndimore. Ata u treguan punëtorë të vyeshtë në të gjitha

²⁹⁷ Mevdudi, op. cit., f. 51-52.

²⁹⁸ Dr. Jusuf El Kardavi, op. cit., f. 57.

shkencat, e veçanërisht në astronomi. Që nga ajo periudhë, rrjedhin shumë terma arab të yjeve”.²⁹⁹

Prof. Dalmas

Dekan i Fakultetit të Mjekësisë, në Universitetin e Montpeljes, thotë:

“Banorët e Montpeljes, qytet në jug të Francës, kur vendosën të themelojnë universitetin e tyre, në fillim të shekullit XII-të iu drejtuan për ndihmë universiteteve të tjera, sepse s’kishin profesorë dhe shkencëtarë me aftësi të duhura... Në fillim i drejtohen Parisit, por ai nuk ishte në gjendje më të mirë se ata. Pastaj, iu drejtuan Romës, por panë se vetë ata ishin në gjendje më të mirë se Roma. Kurse, Anglia dhe Gjermania, në atë kohë, ende nuk i kishin filluar hapat e tyre të parë shkencorë. Së fundi, vërejtën se i vetmi shtet, i cili mund t’u ofronte ndihmën e duhur me profesorë dhe shkencëtarë, ishte shteti musliman arab, në Andaluzi (Spanjë).

Ata kontaktuan dhe ia parashtruan të gjitha kërkesat, qeverisë muslimane, e cila ua përmbushi të gjitha ato, duke dërguar në Montpolje tre prej profesorëve më të njohur në mjekësi, në shkencat ekzakte dhe në filozofi. Ata iu përkushtuan me devotshmëri misionit të tyre, filluan me organizimin e universitetit dhe, në veçanti, organizimin e fakultetit të mjekësisë. Ata mbajtën ligjërata shkencore, gjatë një periudhe tre vjeçare. Pas kësaj periudhe, panë se profesorët francezë, ishin aftësuar në udhëheqjen dhe mbajtjen e ligjëratave, në mënyrë të pavarur, pa pasur nevojën e tyre. Prandaj, kërkuar leje nga organet franceze, që të kthehen në Spanjën arabe, në universitetet e tyre”.³⁰⁰

²⁹⁹ Kur’ani dhe zbulimet bashkëkohore, op. cit., f. 502-503.

³⁰⁰ Dr. Muhammed Abdullah Annan, *El Hamijado - gjuha e fshehtë e maurëve*, Dituria islame, Prishtinë, 1995, nr. 75, f. 35.

Arthur Leonard

“Islami, në realitet, plotësoi një detyrë të madhe. Ai la gjurmë të pashlyera, në analet e historisë njerëzore dhe ky kontribut mund të vlerësohet gradualisht, me zhvillimin e shoqërisë njerëzore”.³⁰¹

Guvernatori i Malkës

Në Spanjë, para simpoziumit të studimeve islame, në dhjetor të vitit 1966, në fjalën përshëndetëse, veç të tjerash thotë:

“Përshëndes studiuesit dhe shkencëtarët, që marrin pjesë në ciklin e pestë të studimeve andaluziane-islame, të cilat, kësaj radhe, po mbahen në qytetin Malka. Përshëndes punën tuaj madhore për ndriçimin e vlerave të civilizimit të Andaluzisë, thesarit të saj mendor dhe jetës së saj, nën hijen e Islamit, për tetë shekuj me radhë, gjatë të cilave ajo ishte qendër drite dhe vend i shkencës, artit, kulturës, nga ku shpërndahej në tërë Evropën.

Islami, i cili ishte feja e gjyshërve tanë, për një periudhë aq të gjatë kohe, ishte shkas i asaj renesance dhe frymëzues i orvatjeve dhe i punës së tyre të palodhshme në vendin tonë, i cili, para ardhjes së muslimanëve, ishte në një gjumë të thellë...

Unë, i nxitur nga dëshira ime për të zgjeruar horizontin e njohurive të mia, e studiova mirë Kur'anin, librin e shenjtë të muslimanëve. Po ashtu, kam lexuar për jetën dhe traditën e Pejgamberit Muhammed dhe pas gjithë kësaj mund të them: Islami, kjo fe madhështore, përmban në vete të gjitha

³⁰¹ Mevdudi, op cit., f. 54.

elementet, pa të cilat, një fe nuk mund të jetë e përkryer. Ai përmban besimin e qartë dhe të kuptueshëm për All-llahun e Madhërishëm, të përmbledhur në maksimën e njohur: 'Nuk ka Zot tjetër, përveç All-llahut dhe nuk ka ngadhënjyes tjetër, përveç All-llahut'. Kjo është baza e besimit islam. Pas kësaj, vjen urdhri për faljen e namazit, i cili, sipas Islamit, është lidhje shpirtërore ndërmjet njeriut dhe Krijuesit. Pas namazit, pason zekati, një pjesë e caktuar e pasurisë, që muslimani i pasur e ka për obligim t'ia japë vëllait të tij të varfër. Pas atyre të dyjave, vjen agjërimi, i cili ka për qëllim frenimin e epsheve dhe arritjen e dëlirësisë shpirtërore. Ndërsa, parimi i pestë i Islamit është haxhxi. Të gjitha fetë kanë vendet e tyre të shenjta, drejt të cilave besimtarët ia mësojnë për t'u pastruar nga veprat e këqija dhe mëkatet. Prandaj, së fundi mund të pyesim: A ka devocion më të lartë se ky, që bazohet në të gjitha këto parime?"³⁰²

Didie Zhylia

Profesor në filozofi dhe doktor i letrave, thotë:

"Filozofia e Ibn Ruzhdit (Averrosit) ushtroi një ndikim të madh, në gjithë Evropën dhe shënoi pikën kulmore të kulturës, në Mesjetë.

Mendimi dhe vepra prej dijetari e Ibn Sinas (Avicenës), luajtën një rol të madh në mendimin perëndimor mesjetar".³⁰³

Blasko Ibanez

Shkrimtar i njohur francez, në veprën e tij "Në hije të katedrales", kur flet për vendin e tij, thotë:

³⁰² Dr. Muhammed Abdullah Annan, op. cit., f. 34.

³⁰³ Didie Zhylia, *Fjalori i filozofisë*, Tiranë, 1994, f. 35-36.

“Në Spanjë, renesansa nuk erdhi nga Veriu, nga invadimet (dyndjet) barbare, por nga Jugu, me pushtuesit arabë... Ekspansioni i tyre ishte më shumë kulturor, se sa i natyrës ushtarake... Prej andej, na ka ardhur kjo kulturë e re, e fuqishme, e cila pati zhvillim të shpejtë në mënyrë fenomenale, kulturë, e cila, sapo u shfaq, ia kaloi të gjitha kulturave të tjera, kulturë, e cila, u formua përmes entuziazmit fetar të të Dërguarit të Zotit dhe e cila, në vete përmbante atë që është më e mira në shkencën çifute dhe bizantine. Jo vetëm kaq, ajo në vete përmbante edhe elemente të traditës indiane dhe persiane, dhe shumë të tjerë të përvetësuar nga Kina. Lindja, ishte ajo e cila, përnjëmend depërtoi në Evropë. Kjo nuk ngjau gjatë sundimit të Dariut dhe perandorëve të tjerë, që Lindja të depëronte përmes Greqisë.

Jo, kësaj radhe, çdo gjë ngjau nga ana tjetër, nga Spanja e civilizuar, e cila, më parë, kishte qenë nën prangat e pushtuesve kishtarë dhe klerit luftënxitës, nga vendi, i cili pushtuesit e rinj (arabët) i priti me dy duar. Nuk kaluan as dy vjet dhe ata vendosën pushtetin e tyre, dhe vetëm pas shtatë shekujsh arrihet largimi i tyre. Ajo nuk ishte luftë e imponuar me forcën e armës, por ishte fitore e shoqërisë së re, e cila dominonte kudo dhe e cila kishte rrënjët e forta. Parimi i lirisë së ndërgjegjes, i cili përbën gurin themeltar, mbi të cilin qëndron madhështia e vërtetë e çdo kombi, ishte shumë i vlerësuar, madje, gati i shenjtë. Në qytetet, ku sunduan, nuk i prekën kishat krishtere dhe as sinagogat çifute.

Nga shekulli tetë deri në shekullin pesëmbëdhjetë, lindi kultura më e bukur dhe më e begatë, që e ka parë ndonjëherë Evropa, në Mesjetë. Derisa, në veri popujt torturoheshin dhe zhdukeshin nga luftërat fetare dhe silleshin si fise të egra, populli i Spanjës, ndërkaq, kishte arritur në tridhjetë milionë. Në këtë masë të madhe njerëzish, ishin përzier të gjitha kombet dhe ideologjitë, me të gjitha ndryshimet dhe

specifikat e tyre. Ata përbënin një kompaktësi dhe tërësi. Rezultat i kësaj ishte fuqia e dukshme e shoqërisë islame dhe entuziazmi i saj shpirtëror e shkencor. Në këtë konglomerat (përzierje) frytdhënës të kombeve dhe kombësive, kanë bashkëjetuar paqësisht të gjitha ideologjitë dhe traditat. Rezultat i kësaj, ishin të gjitha zbulimet, të cilat deri atëherë u shfaqën në botë, të gjitha llojet e artit, shkencës, industrisë, rezultatet krijuese dhe sistemet e vjetra. Nga pikëtakimi i këtyre elementeve të ndryshme, lindën shumë zbulime të reja dhe forca të reja krijuese. Përmes tyre, nga Lindja, ka ardhur mëndafshi, pambuku, limoni, kafja, portokalli, shega, si dhe pëlhura, leshi, pudra e të ngjashme. Falë atyre, janë njohur numrat, algjebra, kimia, mjekësia, astronomia dhe poezia metrike. Filozofët grekë, pas një harrese të gjatë, i risollën përsëri, rimorën vendin e tyre, atëherë kur filluan t'i pasojnë arabët, gjatë pushtimeve të tyre. Qysh pas asaj kohe, Aristoteli ka triumfuar, në Universitetin e njohur të Kordobës..."³⁰⁴

H. E. Barnes

Në "A History of Historical Writing", f. 93, thotë:

"Në shumë aspekte, qytetërimi më i zhvilluar i kohës së mesme, s'ishte aspak ai i krishterë, por qytetërimi islam".³⁰⁵

Robin Kuk

Pasi thekson faktin "që rrënjët e kulturës perëndimore nuk janë vetëm me origjinë greke, apo romake, por gjithashtu edhe islame", ai vazhdon duke thënë:

³⁰⁴ Rozhe Garodi, *Kontributi i kulturës islame dhënë civilizimit njerëzor*, Takvimi, Sarajevë, 1975, f. 45-46.

³⁰⁵ Robert L. Gulick, op. cit., f. 41.

“Në zhvillimin e marrëdhënieve tona me botën islame, është mirë që Perëndimi të ketë parasysh borxhin që kultura jonë i ka Islamit, sepse jemi larguar shumë nga njëri-tjetri. Kemi lejuar që ndërmjet Islamit dhe Perëndimit të ngrihen barriera keqkuptimi dhe mosbesimi. Është e pavend që kjo klimë keqkuptimi të vazhdojë. Jo vetëm se është e mbrapshtë që dy kultura të shquara të gjykojnë kaq trishtueshëm njëra-tjetrën gabimisht, por edhe sepse në botën moderne na duhet të jetojmë dhe punojmë së bashku”.³⁰⁶

Princi Çarls

Duke folur rreth civilizimit islam, ku veçon çështjen e monoteizmit dhe tolerancës në Islam, thotë:

“Civilizimi perëndimor është dhënë së tepërmi pas fitimit dhe sundimit, gjë kjo e cila është në kundërshtim me përgjegjësitë tona ambientale. Ndjenja e monoteizmit, dhe ruajtja e aspektit të shenjtë shpirtëror të botës përreth nesh, janë çështje tepër me rëndësi, të cilat mund t’i mësojmë prej fillimit, nga Islami”.³⁰⁷

Renee Guineau (Gino) - (Abdul Vahid Jahja)

Është një personalitet historik i kohës së re, që është vlerësuar njësoj si nga Perëndimi ashtu edhe nga Lindja. Arabët e radhisin në mesin e atyre propaganduesve që, në fushën e besimit dhe ideve bashkëkohore islame, kanë dhënë një kontribut mjaft të madh. Ndërkaq, edhe perëndimorët, e

³⁰⁶ *Një dialog i ri me Islamin*, fjala e mbajtur nga ministri i jashtëm i Britanisë së Madhe, z. Robin Kuk në qendrën Ismailie të Londrës, më 9 shtator 1998, marrë nga Drita Islame, Tiranë, nëntor, 1998, nr. 21 (151), f. 1.

³⁰⁷ Prof. Hani El-Mubarek, Dr. Sheuki Ebu Halil, op. cit., f. 12.

radhisin në radhën e mendimtarëve dhe filozofëve-gjenialë botërorë. Ai thotë:

“Shumë perëndimorë nuk i dinë vlerat e shkencës dhe kulturës islame, të cilat, shekuj më parë, i morën nga arabët. Shpeshherë, ata nuk e kuptojnë këtë shkencë dhe kulturë, sepse faktet e vërteta rreth këtij realiteti, vazhdimisht i transmetojnë të përziera, me pak saktësi dhe me pak objektivitet.

Madje, edhe institutet e civilizuar, nuk e theksojnë këtë ndikim, por, faktet injorohen dhe mohohen qëllimisht. Ndërkaq, më i çuditshëm është fakti se evropianët e konsiderojnë vetveten përcjellës të drejtpërdrejtë dhe të pandërprerë të civilizimit të vjetër grek, edhe pse realiteti e përgënjeshtron këtë pohim të tyre, sepse shkenca dhe filozofia greke, gjë që është fakt i njohur historik, evropianëve u është përcjellë vetëm në sajë të muslimanëve. Trashëgimia mendore e grekëve, nuk arriti në Perëndim pa e njohur dhe pa e studiuar më parë Lindja (muslimane).

Po të mos ishin dijetarët dhe filozofët muslimanë, evropianët, për shumë kohë, s’do të kishin dijeni mbi ato njohuri. Evropianët fanatikë s’duan ta pranojnë këtë, dhe as superioritetin e lindorëve ndaj tyre, por koha është dëshmitari më i mirë. E vërteta, që ata duan ta mbulojnë, megjithatë do të triumfojë”.³⁰⁸

Gaillaume

“Kur, tërë lënda e pasur e librarive evropiane, të dalë në dritë, do të shohim se, ndikimi arab, në qytetërimin e Mesjetës, ka qenë shumë më i madh se sa është ditur deri më sot”.³⁰⁹

³⁰⁸ Mahmud b. Sherif, op. cit., f. 73-75.

³⁰⁹ Robert L. Gulick, Jr. op. cit., f. 77.

“Po t’ia japim atë që meriton ndikimi islam në fushat e ndryshme të kulturës në Mesjetë, historia e kulturës së Mesjetës, duhet të shkruhet sërish...”³¹⁰

“S’mund të vihet në dyshim, fakti se, evropianët u morën me studimin e Aristotelit dhe se zelli i tyre, për filozofinë, ishte nxitur nëpërmjet ndeshjes së tyre me mendimin arab. Sikur, mendimi arab të mos kishte paraprirë, në këtë drejtim, atëherë si mund të shpjegohet fakti se, gjatë gjeneratave, Aristoteli ishte përzier me mësimet e lëna nga Ibn Ruzhdi (Averrosi)”.³¹¹

“Përngjasimet, në mes të Ibn Ruzhdit (Averrosit) dhe Shën Tomës, janë dëshmi të shumta, dhe duhet të kuptohen si jo të rastësishme. Dëshira e njëjtë, tek ata, për të pajtuar filozofinë dhe teologjinë, nuk merr ndonjë kuptim të madh, por kur krahasimi bëhet paralel, natyrshëm arrihet në konkluzionin se, Ibn Ruzhdi u la trashëgim dijetarëve të krishterë, më shumë se një komentim të thjeshtë për Aristotelin”.³¹²

M. of Dufteria dhe Ave

Theksojnë: “Për daljen nga dekadencia mesjetare, duhet të falënderojmë dijen dhe artin islam”.³¹³

Durvi

Ish-ministër i arsimit në Francë, thotë:

“Kur tërë Evropa ishte zhytur në errësirën e padituriisë dhe kërkonte në vrimë të gjilpërës dritën e shkencës që të gjallë-

³¹⁰ Ibid, f. 77.

³¹¹ Ibid, f. 72.

³¹² Ibid, f. 76.

³¹³ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 42.

rohej, atje, në botën islame, shkëlqente një dritë e madhërshme.

Shkenca, etika dhe filozofia, atje, rrezatonin si dielli plotë rreze. Bagdadi, Basra, Samarkandi, Shami, Kirvani, Egjipti, Granada dhe Kordoba ishin qendra kulturore, prej nga iu shpërnda dija edhe popujve të tjerë. Popujt e Evropës, në kohën e Mesjetës, morën nga bota islame, shumë zbulime shkencore, zejet, artin dhe shkencën”.³¹⁴

Cidi

Anëtar i Akademisë Franceze, thotë:

“Duhet t’i jemi mirënjohës muslimanëve, që shpërndanë retë e errësirës që e mbulonin Evropën, ku invadimet barbare kishin prishur rendin dhe paqen. Muslimanët, jo vetëm që u përpoqën të përvetësojnë burimet e dijeve klasike, por edhe t’i zgjerojnë dhe t’i plotësojnë ato me zbulime të reja.

Zoti i krijoi popujt muslimanë, që të përhapnin qytetërimin prej brigjeve të Eufratit e deri në Vadi Kebir, të Spanjës. Këta popuj, nga Islami, morën shkencën dhe qytetërimin.

Muslimanët, me natyrën dhe sjelljet e tyre, lanë përshtypje të thellë në mbarë botën. Ata nuk ishin të izoluar, sikurse çifutët, por ishin në kontakt me popujt e tjerë. Kjo nuk ua ndërroi atyre natyrën fisnike që kishin. Gjermanët mundën të qytetëroheshin, pas kalimit të një kohe të gjatë, prej pushtimeve të bëra. Ndërkaq, muslimanët, aty ku shkuan sollën qytetërimin, përhapen fenë dhe shkencën. Në Evropën e krishterë, kur filloi të ndihej ndikimi i muslimanëve, në botën islame, ishin bërë shumë zbulime dhe ishin shkruar shumë vepra. Ky është fakt, se muslimanët ishin mësuesit tanë, gjë që s’duhet ta mohojmë”.³¹⁵

³¹⁴ Ahmed Hamdi, op. cit., f. 248, 249.

³¹⁵ Ahmed Hamdi, op. cit., f. 249, 250.

Gustav Le Bon

Historian i njohur francez, ka shkruar librin “Kultura arabe”, për kontributin e madh të muslimanëve ndaj Evropës, thotë:

“Observimet, eksperimentet dhe logjika induktive, të cilat formojnë bazat e diturive moderne, i atribuohen Roxher Bekonit, por, duhet pranuar se ky zbulim, në tërësi, ishte zbulim i dijetarëve arabë”.³¹⁶

Në librin e tij “Civilizimi islamo-arab”, v. III, f. 329, shkruan: “Në kohën kur librat dhe bibliotekat për evropianët nuk nënkuptonin asgjë, halifati islam dispononte shumë qendra dhe biblioteka madhështore. Për shembull, “Shtëpia e urtisë” e Bagdadit numëronte katër milionë ekzemplarë, biblioteka e sulltanit në Kajro një milion, biblioteka siriane ‘Tripoli’, tre milionë, ndërsa në Spanjë, nën pushtetin musliman, gjatë vitit publikoheshin 70 deri 80 mijë libra”.³¹⁷

Në librin e tij “Civilizimi islamo-arab”, f. 557 dhe 558, thotë: “Njeriu habitet jashtëzakonisht, prej zellit me të cilin arabët iu rrekën studimit. Nëse ekziston ndonjë popull, i cili është barazuar me arabët, duhet ta dish se nuk gjendet ndonjë popull, i cili ua tejkalon arabëve. Arabët, kur dominonin në një qytet, përkujdesjen e tyre e drejtonin në ndërtimin e xhamive dhe hapjen e shkollave, nëse qyteti ishte i madh, ata hapnin shumë shkolla. Benjamin Tudel, i cili vdiq në vitin 1173 të erës së re, tregon se në Aleksandri ka parë njëzet shkolla. Përveç shkollave fillore, qytetet e mëdha, sikurse ishin Bagdadi, Kajro, Toledoja, Kordoba etj., ishin përplot

³¹⁶ Ismail Muçaj, *Njerëzimi është debitor ndaj Profetit Muhammed*, Drita Islame, Tiranë, Gusht, 1997, nr. 14 (121), f. 4 & Ebul Hasen Ali En Nedevej, op. cit., f. 88.

³¹⁷ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 100.

universitete. Universitetet e tyre ishin të pajisura me laboratorë, observatoriume dhe biblioteka të pasura, dhe me çdo gjë që ndihmonte në studimin shkencor. Arabët, vetëm në Spanjë, kishin 70 biblioteka të përgjithshme. Në bibliotekën e halifit Hakemi II, në Kordobë, kishte 800.000 libra, siç transmetojnë historianët arabë. Thuhet se Karli (Charles) i Urtë, nuk arriti të tubojë, në bibliotekën mbretërore të Francës, pas 400 vjetësh, më tepër se 900 vëllime, gati një e treta e të cilave kishte të bënte me teologji”.³¹⁸

“Luftërat e kryqëzatave nuk qenë gjë tjetër përveçse konflikt i madh, mes disa popujve primitivë, të egër, barbarë dhe një civilizimi, i cili konsiderohet ndër civilizimet më të larta, të cilët i njohu historia”.³¹⁹

“Shkenca, të cilën e urrenin të tjerët, qe vlerësuar shumë lartë nga muslimanët. Ata duhen falënderuar për të vërtetën e thënë (hadith nga Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sellem]): *‘Të dobishëm janë ata njerëz, që mësojnë dhe i mësojnë të tjerët- kurse të tjerët (veç tyre) janë të dëmshëm, domethënë, prej tyre nuk ka dobi’.*”³²⁰

“Etja e muslimanëve për dije ishte në kulm. Ajo ishte prezente deri në atë masë, saqë halifët e Bagdadit përdornin të gjitha mjetet që të nxisnin dhe të sillnin në oborret e tyre shkencëtarë dhe artistë nga e gjithë bota. Njëri shkoi aq larg, saqë e konsideronte të nevojshme t’i shpallte luftë sundimtarit të Konstandinopojës, për ta detyruar që t’i lejonte një matematikani, që të vinte në Bagdad dhe të ligjëronte aty”.³²¹

³¹⁸ Ebul Hasen Ali En Nedevij, op. cit., f. 79-80.

³¹⁹ Prof. Hani El Mubarek dhe dr. Sheuki Ebu Halil, op. cit., f. 38.

³²⁰ *Dijalog islamskih i evropskih učenjaka*, Sarajevë, 1979, f. 81.

³²¹ Ibid, f. 81.

G. L'Estrange

Në librin "Trashëgimia islame", f. 230, shkruan:

"Universiteti 'Mustansarija' ishte godinë madhështore, e mrekullueshme në një lokacion të hapur afër Tigrit, ndërsa inventari i disejnit dhe kualitetit artistik, ishin çfarë nuk kishte në mbarë botën muslimane. Janë të njohur katër kolegjet e tyre juridikë, secili me nga 75 studentë dhe profesor, i cili nxënësit i mësonte gratis. Studentët kishin bursa të rregullta mujore në lartësi prej një floriri. Kuzhina e kolegjeve ka siguruar racione ditore. Ibn el Firati shënon se biblioteka përmbante libra të rrallë, me vlera të paçmueshme në shumë degë të shkencës, për nevoja të studentëve. Ishte e siguruar edhe letra dhe penda për çdonjërin, që dëshironte të shkruante ndonjë libër. Universiteti kishte hamame dhe ambulanca. Mjekët e tyre organizonin kontrollin ditor dhe përshkruanin receta për të gjithë që ishin të sëmurë. Ambulancat mund të jepnin edhe ilaçet e caktuar aty për aty. Të mos harrojmë se krejt kjo ishte në fillim të shekullin XIII-të".³²²

Dr. Maks Mejerhof

Në librin "Trashëgimia e Islamit", f. 132, shkruan:

"Mjekët muslimanë i përqeshnin sundimtarët evropianë, për shkak të ngathtësisë dhe paditurisë elementare. Evropianët nuk e dinin vlerën e librave të Ibn Sinës (Avicenes), Xhabirit (Jaber), Hassan b. Hajthemit, Raziut, porse kanë lejuar që këto libra të përkthehen në latinisht. Këto përkthime ekzistojnë edhe sot pa emrin e përkthyesve. Në shekullin e XVI-të librat e Ibn Rushdit (Averoes) dhe Ibn Sinës, në Itali, janë

³²² Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 100.

përkthyer në gjuhën latine dhe janë shfrytëzuar si bazë për arsimim në universitetet italiane dhe franceze”.³²³

“Xhamitë në Stamboll, posedojnë më se 80 biblioteka me mbi dhjetëra mijëra libra dhe dorëshkrime të vjetra. Në Kajro, Damask, Bagdad, si dhe qytetet e Iranit e Indisë ekzistojnë biblioteka të tjera, që kanë në gjirin e tyre pasuri të madhe. Katalogët e plotë të këtyre ngjarjeve ende nuk janë bërë, ndërsa fare pak nga kjo është publikuar. Madje, biblioteka eskiriale në Gadishullin Iberik të Spanjës, ka pasur një fond të jashtëzakonshëm të librave islame dhe dorëshkrimeve që i kanë shkruar dijetarët islamë, e të cilat gjithashtu presin kompletim dhe katalogizim”.³²⁴

Mek Kap

Në librin e tij “Shkëlqimi musliman në Spanjë”, f. 170, thotë: “Madje edhe klasat më të ulëta në shoqëri kanë qenë të etura për lexim, ndërsa punëtorët, me paga modeste, i kufizonin shpenzimet e tyre për ushqim dhe veshmbathje, për të shpenzuar paratë e fundit në blerjen e librave. Një punëtor kishte mbledhur një bibliotekë të tillë, kështu që njerëzit e shkencës tuboheshin rreth tij. Robërit e liruar dhe fëmijët e tyre bëheshin shkencëtarë të shquar të kohës së tyre - sikurse thuhet në veprën e Ibn Halikanit ‘Wafajat el Ajan’. Në mesin e personaliteteve të njohura ka pasur edhe femra”.³²⁵

Në librin “Madhështia e Spanjës Muslimane”, f. 183, shkruan:

“Kajro kishte spitale të mëdha me fontana, kopshte me lule dhe 40 oborre të gjerë. Çdo pacient i varfër trajtohej denjë-

³²³ Ibid, f. 103.

³²⁴ Ibid, f. 101.

³²⁵ Ibid, f. 102.

sisht dhe pas shërimit dërgohej në shtëpi me një monedhë ari”.³²⁶

Jolivet Castelot

Shkencëtar i madh frëng, në librin e tij “Laloi de l-histoire”, thotë:

“Përparimi i arabëve, pas vdekjes së Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ishte i madh. Ai ndodhi me shpejtësinë më të madhe të mundshme. Koha ishte e përgatitur për përhapjen e Islamit. Qytetërimi islam pati një ngritje të shkëlqyeshme, arriti sukses në çdo vend me mendjempërthësi të rrallë. Ndikimi i tij, u reflektua në arte dhe letërsi, poezi dhe shkencë. Brenda disa shekujsh, arabët e kapën me duart e tyre kandilin e dritës intelektuale, i përfaqësuan tërë njohuritë njerëzore, të cilat kishin të bëjnë me filozofinë, astronominë, kiminë, medicinën dhe shkencat psikologjike (shpirtërore). U bënë krijues të mendimit, zbulues dhe shpikës, jo në kuptimin e njohur, por me atë që arritën prej metodave shkencore, të cilat i përdorën me një aftësi shumë të shkëlqyeshme. Edhe pse qytetërimi arab qe jetëshkurtër, pati ndikim të madh. Neve s’na mbetet tjetër veçse të shprehim keqardhje për rënien e tij...

Evropa i ka borxh civilizimit arab për përparimin që arriti, prej shekullit X-të deri në shekullin e XIV-të. Prej Islamit, (Evropa) mori idenë filozofike shkencore, të cilën e pasoi me cungim në Mesjetë. Evropa do të na paraqitet neve e mjerë dhe injorante, para qytetërimit arab dhe para shkencës, artëve dhe letërsisë arabe. Evropa ia ka borxh ideve arabe, atmosferën e dobishme me të cilën u kënaq në ato shekuj. Kaluan katër shekuj dhe nuk pati ndonjë civilizim tjetër,

³²⁶ Ibid, f. 107.

përveç civilizimit arab, shkencëtarët e tij ishin bartës të atij flamuri valëvitës”.³²⁷

Dohrenxhi

“Pikëpamjet e Roxher Bekonit në shkencë, janë më autentike dhe më të qarta se pikëpamjet e emnakut të tij të zëshëm, Fransis Bekonit... Shtrohet pyetja se nga i nxori Roxher Bekon njohuritë e tij? Përgjigjja është: nga universitetet islame në Spanjë. Kapitulli i veçantë i librit të tij ‘Opus Majus’ që i kushtohet hulumtimeve optike, në realitet, nuk është gjë tjetër veçse kopje e veprës ‘El Menadhir’ të shkencëtarit Ibn Hejthem. Përndryshe, libri i Bekonit, në tërësi, është dëshmi e gjallë që flet për ndikimin e Ibn Hazmit në të”.³²⁸

Volfred Cantwel Smith

Në “Islam in Modern History”, New York, 1957, f. 36-37, thotë:

“Ngadhënjimi i muslimanëve, ishte ngadhënjim i brendshëm për fenë e tyre. Ata nuk arritën fitore vetëm në fushëbetejë, dhe jo vetëm që patën ndikim në sfera të ndryshme të jetës, por ata korrën fitore në orientimin e ri të jetës në përgjithësi dhe e natyralizuan atë me një natyrë të veçantë, e kjo është ajo që njihet me emrin civilizim. Në formimin e këtij civilizimi islam, kanë kontribuar faktorë të shumtë, si arabë, grekë, civilizimi semit i Lindjes së Mesme dhe iranian sasanid, si dhe elementet hinduse. Por, gjenialiteti i muslimanëve u demonstroi në koordinimin e këtyre faktorëve të

³²⁷ Ebul Hasen Ali En Nedevij, op. cit., f. 87-88.

³²⁸ Dr. Jusuf El Kardavi, op. cit., f. 56, 57.

shumtë, shkrirjes së tyre në një element të ri dhe nënshtrimit të tyre, një metode homogjene për jetën, duke mos i humbur këta faktorë veçoritë e tyre qenësorë, dhe ata u zhvilluan në mënyrë kontinuitive. Islami që ai, i cili i zhvilloi dhe i përsosi këta faktorë, u përgatiti atyre fuqi për ekzistencë. Ai i dha çdo sferë të jetës, natyrë islame të rëndësishme, ai që baza dhe elementi i saj përbërës, e përgatiti metodën islame për jetë, si unitet dhe fuqi. Ligji islam, pati rol qenësor në formimin e kësaj fuqie të përbashkët. Ai është, i cili i koordinoi tërë skajet e jetës, prej adhurimit e deri te pronësia dhe pushteti, me mënyrën e tij të veçantë të marrëdhënieve. Ligji islam ishte fuqi unike, e cila e lidhte shoqërinë islame prej Kordobës e deri në Meltan, ai është, i cili u përgatiti individëve të shoqërisë islame unitet, i bëri punët e tjera jetësore të lavdishme dhe të grumbulluara nga vetë natyra e tyre, me natyrën qiellore dhe i dha kohës unitet, që ta bëj shoqërinë të zhvilluar dhe jetëgjatë...”³²⁹

³²⁹ Ebul Hasen Ali En Nadevij, op. cit., f. 98-99.

Lalande

Astronom frëng, thotë:

“El Bettani është njëri nga njëzet astronomët e shquar, të cilët u shfaqën në tërë botën”.³³⁰

Sidjou

Mohon përdorimin e busullës, nga ana e kinezëve, duke thënë:

“Si mund të thuhet se kinezët e përdorën busullën, kur ata, deri në vitin 1850 besonin se, Poli Jugor i rruzullit tokësor, është ferr i zjarrtë... Disa autorë arabë, busullën e quajnë me emrin el hikk”.³³¹

“Rezultatet e begatshme të ideve arabe dhe zbulimet e tyre të shkëlqyeshme, dëshmojnë se ata janë mësuesit e Evropës, në të gjitha çështjet”.³³²

Arnold Twenbi

Në librin e tij “Studimi i historisë”, thotë:

“Ibn Halduni (filozof, historian, sociolog, studiues... vdiq në vitin 1406), është i rrallë në historinë e mendimit. Në atë shkallë, nuk ka arritur asnjë mendimtar, para tij, e as që ka ardhur ndonjë pas tij, në të gjitha kohërat”.³³³

Viliam Osler

³³⁰ Prof. Hani El Mubarek dhe dr. Sheuki Ebu Halil, op. cit., f. 55.

³³¹ Ibid, f. 43-44.

³³² Ibid, f. 101, shih fusnotën 91.

³³³ Ibid, f. 31-32.

“Arabët, fanarin e tyre, e ndezën nga kandilat e Greqisë, mirëpo, ata së shpejti u bënë fanar i shkëlqyer, me të cilin u ndriçua popullata e rruzullit tokësor”.³³⁴

“Libri ‘El Kanun’, i Ibn Sinait, ka jetuar më gjatë se çdo libër tjetër, si burim unikal në medicinë. Numri i botimeve të tij, në tridhjetë vitet e fundit të shekullit XV, ka arritur në njëzet botime, ndërsa edhe më tepër u shtua numri i botimeve të tij në shekullin XVII... Ibn Sina ua mundësoi shkencëtarëve perëndimorë të fillojnë me revolucionin shkencor, i cili praktikisht filloi në shekullin XIII, ndërsa epokën e tij themelore e arriti në shekullin XVII”.³³⁵

Beravin

Shkencëtar i shquar, në librin e tij “Medicina arabe”, thotë: “Mësimet medicinale të Ibn Sinasë i liruam studiuesit e tjerë nga kryerja e shumë gjurmimeve dhe hulumtimeve në të gjitha shkollat e shekujve të mesëm”.

Beravin përmend edhe porosinë e një mjeku të madh persian, i cili jetoi në gjysmën e shekullit XII, në të cilën thotë se: “Kush dëshiron që nga medicina të lexojë vetëm një libër, mund të ndalet te libri ‘el Kanun’ të Ibn Sinasë, ngase ky libër i ofron atë që kërkon”.³³⁶

Xhorxh Sarton

Në librin e tij “Historia e shkencës”, thotë:

“Me të vërtetë, pjesën më të madhe të detyrave të mendimit njerëzor, e morën muslimanët, kështu Farabiu është filozofi

³³⁴ Ibid, f. 21.

³³⁵ Ibid, f. 99.

³³⁶ Ibid, f. 97

më i madh, Mes'udiu është gjeografi më i madh, kurse
Taberiu është historiani më i madh".³³⁷

³³⁷ Ibid, f. 34, shih fusnota 10.

Princi Çarls

Trashëgimtar i fronit britanik, me rastin e vizitës së tij në Qendrën për Studime Islame në Oksford, me 27 tetor 1993, në ligjëratën e tij me titull: "Islami dhe Perëndimi", thotë:

"Që moti është pranuar fakti i rolit të Spanjës, në kohën kur ajo gjendej nën hijen e pushtetit islam, në ruajtjen e shken-cave dhe njohurive klasike, gjatë periudhës së errët, dhe në vënien e tullave të para të Renesansës Evropiane... Spanja, në periudhën e muslimanëve, nuk ka bërë përmbledhjen dhe të mësuarit përmendësh, të përmbajtjes mendore të civi-lizimit grek dhe romak, por ajo e ka komentuar këtë civili-zim dhe është zgjeruar në të, dhe ka dhënë kontribut të rëndësishëm, në shumë sfera të studimeve njerëzore, si në shkencë, në astronomi, në matematikë, në algjebër (vetë fjala është arabe), në jurisprudencë, në histori, në medicinë, far-maci, optikë, bujqësi, inxhinierinë e ndërtimtarisë, në fe, muzikë...

Civilizimi perëndimor është dhënë së tepërmi pas fitimit dhe sundimit, gjë kjo e cila është në kundërshtim me përgje-gjësitë tona ambientale. Ndjenja e monoteizmit dhe ruajtja e aspektit të shenjtë shpirtëror, të botës përreth nesh, janë çështje tepër me rëndësi, të cilat mund t'i mësojmë prej fillimit, nga Islami".³³⁸

Kaxhori

"Mendja habitet kur sheh atë, që kanë bërë arabët në algjebër".³³⁹

³³⁸ Ibid, f. 11-12.

³³⁹ Ibid, f. 73, shih fusnota 57.

Suter

Përmend në librin e tij: "Matematikanët dhe astronomët arabë dhe punët e tyre", mbi pesëqind astronomë dhe matematikanë arabë".³⁴⁰

J. W. Thompson

Në "The Introduction of Arabic Science into Lorraine in the Tenth Century" Isis 12: 19, maj 1929, thotë:

"Jam i bindur se shkollat e Lorraines, në shekullin 12-të, ishin vendi ku u mboll fara e parë, prej nga u përhap shkenca arabe në Evropë. Së këndejmi, dituria u përhap në vende të tjera të Gjermanisë, në Francë dhe, nëpërmjet kishtarëve të Lorraines, në Angli".³⁴¹

Ndërkaq, në "The Medieva, Library N.Y. Hafner Publishing Company", 1967, f. 263, ai shkruan:

"Lulëzimi i shkencës, në botën perëndimore, ka lindur për shkak të ndikimit të popujve të Evropës Perëndimore me njohuritë shkencore arabe dhe për shkak të përkthimit të shpejtë të veprave të muslimanëve, në sferën e shkencave dhe transferimit të tyre, prej gjuhës arabe në gjuhën latine, e cila në atë kohë ishte gjuhë e arsimit. Lindja e shkencës, në Perëndim, ndoshta ka qenë pjesa më madhështore dhe suksesi më kolosal, në historinë e bibliotekave islame".³⁴²

Osino Blathjos

Orientalist spanjoll.

³⁴⁰ Ibid, f. 73, shih fusnota 57.

³⁴¹ Robert L. Gulick, Jr. op. cit., f. 55.

³⁴² Prof. Hani El Mubarek, op. cit., f. 101 -102, shih fusnota 91.

Gjatë fjalimit të tij në Akademinë Mbretërore të Spanjës, në seancën e 26 janarit të vitit 1919, deklaroi se Danteja në “Komedia Hyjnore”, ka qenë i ndikuar prej Islamit, ndikim ky që vërehet edhe në përshkrimin e hollësishëm të ferrit dhe parajsës. Ai hetoi shumë ngjashmëri mes veprës së lartpërmendur dhe asaj që gjendet në disa libra islame, që flasin mbi Miraxhin e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] veçmas librit ‘Risaletul Gufran’ të Ebu Ala el Mearrit dhe të librave të Muhjidin bin Arabiut. Ndonëse, një numër i madh studiuesish italianë, të befasuar nga kjo, e pritën me një sulm të rëndë, megjithatë ai i demantoi të gjitha kritikët e tyre, në një libër që e botoi në Madrid, me titull ‘Botërat islame të pasvdekjes në Komedinë Hyjnore’. Në vitin 1949, Enriko Eçoroli, studiues italian, botoi përkthimin latin dhe frëng të një libri arab mbi Miraxhin, i cili ishte përkthyer nga gjuha arabe në fillim të shekullit XIII, libër, prej të cilit aktualisht ekzistojnë dy kopje, njëra, në Bibliotekën Bodli në Oksford, ndërsa tjetra, në Bibliotekën Popullore në Paris. Studimet vazhduan dhe kështu, më në fund, u vërtetua fakti, se ky përkthim ekzistonte, që para lindjes së Dantes, i cili lindi në vitin 1265, kurse vdiq në vitin 1321.³⁴³

Zigrid Honke

Orientaliste e njohur gjermane, e mahnitur nga civilizimi Islam, filloi të studiojë disa aspekte të tij. Mbrojti disertacionin e saj, në Universitetin e Berlinit, me titull: “Ndikimi i letërsisë arabe në letërsinë evropiane”. Ndërsa në librin e saj të njohur “Dielli arab shndrit mbi Perëndimin”, thekson rolin dhe rëndësinë e civilizimit islam, ndaj civilizimit

³⁴³ Ibid, f. 30, 31.

evropian në përgjithësi. Në këtë libër, veç të tjerash, ajo shkruan:

“Njerëzit, te ne (në Gjermani), dinë shumë pak rreth mundit tuaj të përjetshëm civilizues dhe rolin e tij në ngritjen e civilizimit perëndimor...

Ka ardhur koha, të flitet për një popull tejet të madh, në rrjedhën e ngjarjeve botërore, popull të cilit, Evropa i ka borxh, në veçanti, dhe tërë njerëzimi, në përgjithësi.

Edhe përkundër kësaj (rëndësisë dhe rolit të muslimanëve), kush lexon njëqind libra historikë, nuk gjen emër të atij populli (musliman) në nëntëdhjetë e tetë prej tyre”.³⁴⁴

“Pika e shikimit të shekujve të Mesjetës ende nuk ka vdekur, me ç’rast, edhe sot e kësaj dite, ekziston një grup njerëzish, me horizonte të kufizuara, larg nga toleranca fetare, i cili ndërton penda dhe pengesa përballë dritës...”³⁴⁵

“Malet Brans, nuk penguan lidhjet dhe përmes tyre, civilizimi arabo-andaluzian gjeti rrugën e tij, për në Perëndim...

Dritën e civilizimit arab, përmes Andaluzisë, e bartën mijëra robër evropianë, të cilët u kthyen nga Kordoba, Saragoza dhe qendrat e tjera kulturore të Andaluzisë. Ndërkaq, tregtarët e Lionit, Gjenovës, Venecias dhe Nyrnbergut, luajtën rolin e ndërmjetësuesit, mes qyteteve evropiane dhe atyre andaluziane, madje miliona hanxhinjë të krishterë evropianë, në rrugën e tyre për në Santiago, kontaktuan me tregtarë arabë dhe me pelegrinë të krishterë, të cilët vinin nga pjesa veriore e Andaluzisë...”³⁴⁶

“Turistët, vizitorët, pelegrinët, tregtarët dhe nxënësit, nga vendet e tyre në Evropë, niseshin për në Barcelonë dhe Valenci, ku prodhohej letra e butë (sikurse përmend el

³⁴⁴ Ibid, f. 23-24.

³⁴⁵ Ibid, f. 26.

³⁴⁶ Ibid, f. 36.

Idrisi), e më pas, ktheheshin të ngarkuar me sasi të mëdha të kësaj letre, e cila nuk kishte shembull në botë...

Ndërtimi i mullinjve ishte specializim arab, të cilin arabët e realizuan vetë, më pas ia mësuan Evropës të gjitha llojet e mullinjve të ujit dhe të erës".³⁴⁷

"Ky italian (Flavio Giou, për të cilin disa evropianë mendojnë se është zbulues i busullës) këtë mjet e njohu përmes arabëve, për të cilët, burimet vërtetojnë përdorimin e saj nga ana e tyre, para se atë ta njihte Evropa".³⁴⁸

"Arabët e Andaluzisë, në Spanjë, janë të parët, të cilët përdorën për qëllime ushtarake, gjuajtësit e zjarrit, në Evropë dhe me këtë ata u bënë mësuesit e evropianëve edhe në këtë fushë!"³⁴⁹

"Astronomia te grekët, ka qenë shkencë teorike (spekulative) racionale universale, larg metodës eksperimentale (empirike) në kuptimin e plotë të fjalës. Babilonasit ua tejkaluan atyre, me shquarjen e tyre praktike empirike. Në vitin 500 p.e.s., arritën në skicimin e kupës së dukshme të qiellit, në formë të rrumbullakët, në mes të së cilës, qëndron Toka. Pastaj, erdhi shkencëtari grek, Eristarion Samusi, në shekullin III p.e.s., dhe e vuri Diellin në vend të Tokës, në mes të hartës së universit..."³⁵⁰

"Arabët, maksimalisht, u interesuan për mjetet astronomike, kurse ajo që ata e trashëguan prej grekëve, ishte primitive dhe e pamjaftueshme që t'u ndihmonte atyre, në garë drejt famës, gjë të cilën ia vunë obligim vetes. Prandaj, ata i përsosën ato, duke u shtuar gjëra të shumta dhe ofruan zbulime,

³⁴⁷ Ibid, f. 41-42.

³⁴⁸ Ibid, f. 43.

³⁴⁹ Ibid, f. 44.

³⁵⁰ Ibid, f. 52.

të cilat u ngjajnë mrekullive... Ato, i mori Perëndimi prej tyre dhe i përdori një kohë të gjatë..."³⁵¹

Maurice Bucaille

Thotë: "Ndërmjet shekujve VIII dhe XII të erës së krishterë, është bërë një numër i madh hulumtimesh dhe zbulimesh në universitetet islamike, kurse në vendet tona të krishtera ka qenë imponuar kufizimi në zhvillimin shkencor. Në këtë epokë mu aty kanë ekzistuar mundësi të shkëlqyeshme për kulturë. Në Bibliotekën e halifit në Kordobë (të Spanjës), ka pasur 400.000 libra. Aty ka ligjëruar Averosi (Ibn Rushdi). Aty është transmetuar shkenca greke, indiane dhe persiane. Ja përse nga shumë vende të ndryshme të Evropës kanë shkuar të studiojnë në Kordobë, ashtu siç shkojnë sot për përkryerjen e disa studimeve në SHBA. Sa dorëshkrime të vjetra kanë arritur deri te ne me anë të shkencëtarëve arabë të cilët në vendet e pushtuara sillnin kulturën! Sa i kemi borxh kulturës arabe në matematikë (algjebra është arabe), në astronomi, fizikë (optikë), gjeologji, botanikë, mjekësi (Avicena-Ibn Sina) etj. Shkenca për herë të parë mori karakter ndërkombëtar në fakultetet islame të Mesjetës. Në këtë epokë njerëzit kanë qenë më të përshkruar me frymën fetare sesa janë sot, por kjo nuk i ka penguar që në mjedisin islam të jenë njëkohësisht besimtarë dhe shkencëtarë".³⁵²

Kaetani

Mendimtar evropian, thotë:

³⁵¹ Ibid, f. 59.

³⁵² Dr. Maurice Bucaille, op. cit., f. 134, 135.

“Shkollat e mjekësisë në Palermo, fillet e diturive të fizikës në universitetet e para italiane, vizioni i Dantes dhe teologjia e Thoma Akuinit, të gjitha ishin të frymëzuara dhe tjerë me dijen e vjetër dhe filozofinë të cilën e mblodhën dhe e përpunuan teologët arabë nga Bagdadi dhe Kordoba, mësuesit e dikurshëm të Evropës barbare”.³⁵³

Baron Kremer, shkruan:

“Krahas shkencave ekzakte me një kujdes shumë të madh mësoheshin dhe kultivoheshin edhe shkencat e politikës dhe drejtësisë, si dhe filozofiko-teologjike, i binin sistemet politike dhe teoritë për të drejtën të cilat për nga vlera e tyre i mbulonin të gjitha ato që kishin arritur popujt e tjerë të shekujve të mesëm. Mendimet e mëdha të cilat në Evropë hapen rrugë në shekullin XVIII-të, atje qenë proklamuar qysh para tetë shekujsh”.³⁵⁴

Vajll

Historian anglez, në librin e tij “Mealimu tarihi el Insanijje”, thotë:

“Evropa ia ka borxh Islamit, pjesën më të madhe të ligjeve të veta administrative dhe komerciale”.³⁵⁵

“Krejt çka kemi sot në fushën e matematikës rrjedh nga muslimanët”.³⁵⁶

Shedice

Historian francez, thotë:

³⁵³ Osman Nuri Haxhiq, op. cit., f. 28.

³⁵⁴ Ibid, 29.

³⁵⁵ Dr Jusuf El Kardavi, op. cit., f. 84.

³⁵⁶ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 111.

“Ligji i Napoleonit është huazuar nga vepra e Imam Malikut: Sherhu ed Derdir ala metni Halil”.³⁵⁷

Jacques Le Goff

Lindur në vitin 1924, konsiderohet sot si një ndër historianët e specialistët më të mirë të Mesjetës evropiane, temë, së cilës i ka kushtuar një numër mjaft të madh veprash.

“Ndërsa në Sicili, e sidomos në Spanjë, me gjithë konfliktet e armatosura, takimet dhe shkëmbimet mes muslimanëve dhe të krishterëve (edhe çifutëve) krijuan dukuri të rëndësishme akulturimi, në veçanti në fushën e artit e të shkencës arabe (mjekësi dhe astronomi). Shkenca arabe përhap, gjithashtu, traditat filozofike e shkencore të Greqisë së lashtë, të panjohura prej latinëve dhe që një prej nxitësve kryesorë në zhvillimin e dijes në krishterimin perëndimor, që lulëzoi gjatë shekullit XIII me skolastikën. Ka mundësi, që poezia arabe të ketë luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm në ngjizjen e poezisë oborrtare të krishterë, e në veçanti në poezinë e trubadurëve, në Evropën jugore, mes fundit të shekullit XI dhe gjysmës së shekullit XIII. Kordoba dhe Toledo (të rimarra prej krishterëve më 1085) qenë qendrat e mëdha të pikëpjekjes mes tre kulturave: arabe, hebraike e krishtere. Në shkencë, Palermo luajti një rol analog, edhe pse të një rëndësie më të vogël”.³⁵⁸

“Nëpërmjet Spanjës dhe Italisë Jugore, ndikimet greke dhe arabe takohen me krishterimin, duke e shndërruar Palerm - nën mbretërit normanë e më pas, në shekullin XIII, nën perandorin Federiko II - në një pikëpjekje të kulturës

³⁵⁷ Dr. Jusuf El Kardavi, op. cit., f. 84.

³⁵⁸ Jacques Le Goff, *Mesjeta në zanafillat e identitetit evropian*, Shtëpia e Librit & Komunikimit, Qendra ndërkombëtare e Kulturës, Tiranë, pa vit botimi, f. 19.

greke, arabe dhe latine. Së bashku, këto kultura nxisin të mësuarin e mjekësisë, në Salerno dhe në Montpelie, dhe pasurojnë doktrinën e Zherber d'Orilak, një njeri me shpirt enciklopedik që, do të bëhet Silvestri i II, papa i Vitit Njëmijë. Këto shkëmbime shkencore e intelektuale, i detyrohen shumë rolit të përkthyesve".³⁵⁹

Kenneth Clark

Jetoi nga viti 1903 deri në vitin 1983. Atij iu besua drejtimi i Galerisë Kombëtare të Londrës dhe konsiderohet një ndër historianët dhe studiuesit më të shquar të artit.

"Tatëpjeta e qytetërimit mund të ketë zgjatur shumë kohë*, por në mes të shekullit të shtatë u shfaq një force e re, që kishte besim, energji dhe vullnet për të ngadhënjyer si edhe një kulturë alternative - Islami. Fuqia e Islamit fshihej në thjeshtësinë e tij. Kisha e hershme e krishterë, e pat shkapërdërdhë fuqinë e vet në zënkat dhe grindjet teologjike, që vazhduan për tre shekuj me një duf dhe me sajesa të pabe-

³⁵⁹ Jacques Le Goff, op. cit., f. 85.

* Klark shpreh habinë e tij, duke thënë: njeriu, me të vërtetë, habitet kur mëson se gjatë gjithë kësaj kohe (për më shumë se pesëqind vjet), asnjë laik, duke filluar nga mbretërit dhe perandorët, nuk mund të shkruante dhe të lexonte. Karli i Madh mësoi të lexonte, por nuk arriti kurrë të shkruante. Pranë shtratit të vet, mbante tabela dylli, që të ushtrohej, por vetë thoshte që për këtë punë nuk i jepej. Alfredi i Madh, që ishte një njeri jashtëzakonisht i zgjuar, mësoi të shkruante, gati në moshën dyzetvjeçare dhe ishte autor i disa librave, por me sa duket ata ishin diktuar në ndonjë seminar. Njerëzit e mëdhenj, madje edhe klerikët, u diktonin sekretarëve të tyre... Edhe Shën Gregori, i cili në një gdhendje në fildish të shekullit të dhjetë të lë përshtypjen e një njeriu të përkushtuar tërësisht ndaj dijes, po ai Shën Gregor siç besohet, u vu flakën shumë vëllimeve të letërsisë klasike, madje bibliotekave të tëra, që të mos shtinin në ngasje, mendjet e njerëzve, që të linin studimin e shkrimeve të shenjta, shih: Kenneth Clark, Qytetërimi, Botoi Shtëpia e Librit, Tiranë, f. 36.

sueshme. Por, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] perjgamberi i Islamit, predikonte një doktrinë më të thjeshtë, e cila u pranua menjëherë dhe u dha pasuesve të saj atë ndjenjë solidariteti të pathyeshëm, që u pat prirë dikur legjioneve romake. Brenda një kohe çuditërisht të shkurtër - rreth pesëdhjetë vjet - bota klasike u nënshtrua".³⁶⁰

"Por, në përgjithësi, Bizanti ishte më i largët prej Perëndimit, sesa Islami, i cili, kishte krijuar një qendër të zhvillimit të jetës intelektuale, në Spanjën jugore".³⁶¹

³⁶⁰ Ibid, f. 29.

³⁶¹ Ibid, f. 40.

Murad Hofmann

“Spanja u bë stacion releik ndërmjet Evropës dhe botës islame, e shprehjet e shumta shkencore, medicinale, astronomike dhe kulturore, sot dëshmojnë për ndikimin sofistik të kulturës muslimane andaluziane ku të krishterët, çifutët dhe muslimanët jetonin njëri pranë tjetrit, në harmoni dhe kuptim të ndërsjellë, gjë e cila, asnjëherë, askund më nuk është parë”.³⁶²

Revista “Posta e UNESCO”, të cilën e boton UNESCO, në numrin e tetorit 1980, përmend se, libri “Kanun” i Ibn Sina-së, është mësuar në Universitetin e Brukselit, deri në vitin 1909.³⁶³

Në Universitetin e Pristonit në Uashington, është mbajtur kongresi mbi civilizimin arabo-islam, në vitin 1953, është konfirmuar se:

“Të gjitha faktet, vërtetojnë se shkenca perëndimore, i ka borxh me ekzistencën e vet civilizimit arabo-islam dhe se metodologjia shkencore bashkëkohore e ngritur mbi studim, vërtetim dhe empirizëm, të cilën e aprovuan shkencëtarët evropianë, ka qenë rezultat i lidhjes së shkencëtarëve evropianë me botën islame, e veçanërisht, përmes shtetit arabo-musliman, në Spanjë (Andaluzi)”.³⁶⁴

³⁶² Murad Hofmann, op. cit., f. 6

³⁶³ Prof. Hani el Mubarek, op. cit., f. 99.

³⁶⁴ Ibid, f. 101.

KAPITULLI V

TOLERANCA ISLAME

Thomas W. Arnold

Për tolerancën islame, thotë: “(Përhapjen e Islamit) nuk duhet ta kërkojmë as në ndërmarrjen luftarake, si e mendojnë këtë në imagjinatën e tyre: me shpatë me një, e me Kur’an në dorën tjetër, por kjo duhet kërkuar në aktivitetin modest të predikuesve dhe tregtarëve islamë, të cilët janë përpjekur që në të gjitha pjesët e tokës, ta përhapin fenë e tyre. Mënyra e këtillë paqedashëse e predikimit nuk është marrë vetëm për atë shkak kur këtë e ka kërkuar politika, as atëherë kur nuk ka qenë e mundur të përdoret fuqia, por për shkak se Kur’ani këtë mënyrë e preferon në shumë ajete: *“Në fe nuk ka dhunë...”* (El-Bekare: 256)³⁶⁵

“Një prej faktorëve që ka ndikuar në sukseset e muslimanëve është: në rend të parë vjen thjeshtësia e mësimit islam: ‘Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut, Muhammedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] është i Dërguar i Zotit’. Ky mësim i thjeshtë nuk kërkon përvojë të madhe fetare. Si parim, nuk paraqet vështirësi të veçanta intelektuale. E pa ngarkuar me ide teologjike, këtë mësim ka mundur ta shpjegojë cilido, madje edhe ai më pak i informuar me shprehjet teologjike”.³⁶⁶

H. A. R. Gibb

³⁶⁵ Thomas W. Arnold, op. cit., f. 22, 21.³⁶⁶ Prof. Hani El Mubarek, op. cit., f 410.

Autor i njohur, në librin e tij “Drejtimi islam”, thotë:
“Islami ka edhe një shërbim tjetër, ndaj kauzës së njerëzimit, gjë të cilën nuk e bëri Evropa. Ai zotëron një traditë madhështore për një mirëkuptim ndërmjet racave dhe një bashkëpunim të singertë. Islami ka aftësinë për të bërë pajtimin e elementeve të papajtueshëm të racës e traditës. Asnjë shoqëri tjetër, nuk e ka këtë aftësi, për të pasur sukses në barazimin e statusit të tyre. Për t’ia arritur kësaj, eliminimit të ndasive Lindje-Perëndim dhe krijimin e një bashkëpunimi në mes tyre, ndërmjetësimi i Islamit është i domosdoshëm. Nëse arrihet kjo, shpresa e një gjendje paqësore do të rritet pamasë. Ndërkaq, Evropa, nëse refuzon bashkëpunimin me Islamin, atëherë këtë iniciativë ia lëshon armëve, rivalëve të saj dhe për të dy palët fundi do të jetë fatal”.³⁶⁷

Will Durant

Është autor bashkëkohor amerikan. Libri i tij, prej 30 pjesësh “Civilizimi njerëzor”, konsiderohet ndër librat më të njohur në këtë fushë. Kur flet mbi skllëvërit, në historinë e kulturës islame, veç të tjerash, ai shkruan:

“Skllëvërve u lejohej martesë dhe arsimimi i fëmijëve të tyre, kur këta arrinin moshën e duhur të pjekurisë. Njeriu mahnitet kur vëren se një numër i konsiderueshëm i fëmijëve të skllëvërve, kanë ushtruar funksione me përgjegjësi të lartë politike dhe kulturore në botën islame. Ata janë bërë, madje, udhëheqës dhe emirë, siç ishte rasti me Muhammed El Gazneviun dhe me Memlukët në Egjipt”.³⁶⁸

³⁶⁷ Ebul Hasen En Nedevej, op. cit., f. 37-38.

³⁶⁸ Dr. Jusuf El Kardavi, op. cit., f. 50.

Xhon Devejnport

Në librin “Kërkim ndjese ndaj Muhammedit dhe Kur’anit”, f. 139, shkruan:

“Kur Salahudin Ejubi hyri në Kuds (Jerusalem), nuk është vrarë asnjë njeri. Ai tregoi mëshirë të madhe ndaj robërve të krishterë”.

“Egërsia, të cilën e kishin shfaqur krishterët në Spanjë, nuk ka qenë aspak më e vogël se ajo që e kishin treguar në Kuds. Pas gjithë asaj që muslimanët kishin lënë në Spanjë, krerët fetarë të ushtrisë së krishterë, me nxitjen e Filipit II, urdhëruan likuidimin e të gjithë muslimanëve, pleq e të rinj, gra e burra. Para se të arrinin të iknin, tri të katërtat e muslimanëve ishin vrarë, ndërsa ata që kishin shpëtuar nga kjo vdekje nuk arritën të shpëtonin nga dënimet me vdekje të inkuizicionit kishtar. Në këtë periudhë, janë vrarë 3 milionë muslimanë”.

Në veprën e njëjtë, në f. 133, shkruan:

“Si të mos mrekullohesh nga madhështia e sundimtarëve muslimanë në Spanjë, ose të mos çuditesh me përmendoret e civilizimit, trashëgiminë kulturore dhe arkitektonike që e kanë lënë pas? Dhe si të mos kujtojmë sjelljen e të krishterëve, fanatizmit të tyre, paditurisë dhe barbarizmit, të cilët janë përcjellë me mundime dhe shtypje?”³⁶⁹

Arnold J. Twenbi

Historian i njohur anglez, thotë:

“Zhdukja e vetëdijes racore të muslimanët, është një ndër arritjet e theksuara të Islamit, kurse në botën bashkëkohore,

³⁶⁹ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 144.

ekziston një nevojë e madhe për propagandimin e këtij virtyti islam".³⁷⁰

"Nuk është e vërtetë se muslimanët i detyronin njerëzit të zgjidhnin në mes Islamit ose shpatës. Njerëzit ishin të lirë të zgjidhnin Islamin ose dhënien e xhizjes".³⁷¹

"Eliminimi i dallimeve familjare dhe fanatizmave nacionale dhe të gjakut, është prej bamirësive dhe mburrjeve më madhështore të Islamit. Ndërkaq, në epokën aktuale, në të cilën jetojmë, kjo bamirësi, është prej sfidave më të mëdha të këtij shekulli. Nuk ka dyshim se popujt, të cilët flasin anglisht, kanë arritur një farë suksesi në lidhjen e popujve mes vete dhe i sollën botës njerëzore mirësi dhe mëshirë. Por, është fakt i pamohueshëm, i cili domosdo duhet të pranohet, se ata dështuan në eliminimin e animeve familjare dhe nacionaliste".³⁷²

Edward Gibbon

Autor i mirënjohur në gjithë botën, thotë:

"Një dogmë e dëmshme i është mveshur muslimanëve: detyra për t'i shfarosur me shpatë të gjitha fetë. Kjo akuzë, si rezultat injorance dhe fanatizmi, hidhet poshtë nga Kur'ani, historia e pushtimeve islame dhe nga toleranca e tyre publike..."³⁷³

³⁷⁰ Pamfleti: *Ç'thonë të tjerët për Islamizmin*.

³⁷¹ Mr. Qemajl Morina, *E vërteta dhe paragjykimet për Islamin në botë dhe ndër shqiptarët*, në: *Rreth përhapjes së Islamit ndër shqiptarët*, përmbledhje studimesh, përgatiti Muhidin Ahmeti, Shkodër, 1997, f. 120.

³⁷² Ebul Hasen Ali En Nadevij, op. cit., f. 38.

³⁷³ Drita Islame, Tiranë, qershor, 1996, nr. 11 (94), f. 4.

“Suksesi më i madh i jetës së Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], konsistoi në thjesht forcën morale të tij, pa goditur gjë me shpatë”.³⁷⁴

³⁷⁴ Ahmed Dedat, op. cit., f. 30.

Gustav Lebon

Historian dhe filozof francez, në librin e tij "Civilizimi arab", f. 605, rreth pushtimeve islame, thotë:

"Është i pamohueshëm fakti se komuniteti botëror nuk njih pushtues zemërgjerë, sikurse arabët (muslimanët) dhe as fe tolerante, sikurse feja e tyre".³⁷⁵

Në të njëjtin libër, f. 516", shkruan:

"Barazia te muslimanët ka arritur përsosmërinë, barazia e cila proklamohet me plotë gojë në Evropë, nuk ka kurrfarë efekti në realitet. Muslimanët, praktikisht, e kanë vënë në jetë parimin e barazisë. Në mesin e muslimanëve nuk ka dallime klasore, të cilat sot i vërejmë ndër trashëgimtarët e Revolucionit Francez. Islami i ka eliminuar të gjitha dallimet klasore, familjare dhe individuale, kurse të gjithë muslimanët janë vëllezër. Në botën arabe, një personalitet i madh ka bashkuar fise të ndryshme në gjirin e një fjale. Kjo fjalë i ka lidhur në një sistem ligjesh, sipas të cilit janë të barabartë të gjitha racat, në të gjitha kontinentet dhe ata nuk janë të huaj për njëri-tjetrin. Për shembull, muslimani kinez ka të drejta krejtësisht të njëjta në shtetin islam, siç i ka edhe arabi musliman, përkundër të gjitha dallimeve ekzistuese midis tyre".³⁷⁶

Kurse rreth muslimanëve në Spanjë, ai shkruan:

"Për disa shekuj, muslimanët e kanë ndryshuar tërësisht pamjen kulturore dhe ekonomike të Spanjës. Spanja ishte krenaria e Evropës. Ndryshimi ishte i dukshëm edhe në planin moral. Muslimanët kanë synuar të zhvillojnë te të krishterët një virtyt të madh civilizues, deri atëherë, për ta, fare të panjohur - jetën e përbashkët me ithtarët e besimeve

³⁷⁵ Dr. Jusuf El Kardavi, op. cit., f. 46, 47.

³⁷⁶ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 130.

të tjera. Qëndrimi i muslimanëve ndaj popujve të mundur ka qenë tejet tolerant: u është lejuar themelimi i kështillave kishtarë dhe shkencore në Sevilje dhe Kordobë, në vitin 852. Shumë kisha, të ndërtuara në kohën e pushtetit islam, tregojnë se muslimanët i kanë respektuar fetë e tjera. Shumë të krishterë e kanë pranuar Islamin, ndonëse për këtë nuk ka pasur ndonjë arsye të posaçme. Edhe hebrenjtë, edhe të krishterët, i kanë pasur të drejtat si muslimanët. Ata kanë mundur të kenë pozita të larta në pushtet”.³⁷⁷

Xhevahir Lal Nehru

Politikan, ish-kryeministër i Indisë, thotë:

“Depërtimi i luftëtarëve, të cilët erdhën nga Veriperëndimi i Indisë dhe depërtimi i Islamit, ka rëndësi të madhe në historinë e Indisë. Ai demaskoi ligësinë, e cila ishte përhapur në shoqërinë hinduse. Ai e tregoi ndarjen e klasave dhe verbësinë e braktisur, si dhe dëshirën e izolimit nga bota, në të cilën jetonte India. Teoria e vëllazërisë islame dhe barazisë, në të cilën besonin dhe jetonin muslimanët, pati ndikim të thellë në intelektin e hindusve. Këtij ndikimi, më së tepërmi iu nënshtruan njerëzit e thjeshtë, të cilët, shoqëria hinduse i privoi nga barazia dhe gëzimi i të drejtave njerëzore”.³⁷⁸
“Qytetërimi islam është nëna e qytetërimeve të reja”.³⁷⁹

Sarojini Naidu

Letrare dhe poete hinduse, e cila është quajtur “Bilbili i Indisë”, në librin e saj “Ligjërata dhe ese”, thotë:

³⁷⁷ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 143.

³⁷⁸ Ebul Hasen Ali En Nedevij, op. cit., f. 41.

³⁷⁹ Nexhat S. Ibrahim, *Paragjykimet ndaj Islamit gjatë shekujve*, Prizren, 2000, f. 67.

“Islami është feja e parë, që ftoi në demokraci dhe veprim, sipas parimeve të saj. Prandaj, posa dëgjohet ezani prej minares së një xhamie, menjëherë tubohen ata që dëshirojnë ta adhurojnë All-llahun. Ata tubohen në radhë, pesë herë në ditë dhe përulen përpara All-llahut me zërin e tekbirit. Me këtë, demonstrohet barazia islame në format e saj më fanastike. Unë, disa herë kam vërejtur se Islami, me fuqinë e unitetit praktik, i vë individët e ndryshëm të shoqërisë njerëzore në një linjë të vëllazërisë.

Nëse ti takon në Londër një egjiptian, algjerian, indian apo turk, nuk është me rëndësi, tek asnjëri prej tyre, nëse atdheu i tyre është Egjipti, ose India...”³⁸⁰

Lawrence E. Browne

“Megjithëse, asnjë këmbë ushtari, nuk ka shkelur Indonezinë, sot, ai është vendi më i madh musliman në botë. Kjo, përputhet me parimin e përmendur në Kuran: *“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota...”* (El-Bekare: 256)³⁸¹

Në librin e tij “Prospects of Islam”, Londër, 1949, f. 12, ai thotë:

“Vëllazërimi, të cilin e proklamoi Islami, ka qenë realitet dhe gjë jo e rëndomtë, të cilin nuk e kanë njohur popujt e Lindjes. Ne dyshojmë se të krishterët e Sirisë janë sjellë ndaj të krishterëve të Iranit, sikurse sillen vëllezërit në mes vete, njëjtë me atë sikurse sillen muslimanët e Shamit (Sirisë, Libanit etj.) ndaj vëllezërve të tyre iranianë prej një feje dhe të cilët i konsiderojnë anëtarë të një familje”.³⁸²

³⁸⁰ Ebul Hasen Ali En Nadevij, op. cit., f. 39.

³⁸¹ *Ishte shpata që përhap Islam në apo e vërteta e saj*, Drita Islame, Tiranë, qershor, 1996, nr. 11 (94), f. 4.

³⁸² Ebul Hasen Ali en Nadevij, op. cit., f. 38.

“Këto fakte të krijuara mirë, korrigjojnë idenë e përhapur, aq gjerësisht, në shkrimet kristiane se muslimanët, gjoja, kudo që shkuan, i detyruan njerëzit me majën e shpatës, që të pranonin Islamin”.³⁸³

Georgi Zejdon

Në veprën “Historia e civilizimit arabo-islam, 4/282”, shkruan:

“Pushtuesit e krishterë, në Spanjë, i kishin detyruar muslimanët dhe çifutët që të bartnin shenja identifikimi, që të njiheshin ngado që të lëviznin. Në fund, i vunë para zgjidhjes midis pranimi të krishterimit ose vdekjes”.

Në të njëjtin libër, 1/174, shkruan:

“Të krishterët i kishin shndërruar xhamitë muslimane në kisha, muslimanët i kishin privuar nga të gjitha liritë fetare, kishin rrënuar varrezat e tyre, u kishin ndaluar të gjitha domosdoshmëritë jetësore dhe kishin shkatërruar hamamet e tyre”.

“Sipas dëshmisë së vetë të krishterëve, në kohën e Henrikut IV, në Spanjë ishin mbytur nga dora e të krishterëve 400.000 banorë në qytetin Dilan”.³⁸⁴

A. S. Triton

Në librin “Islam”, Londër, 1951, f. 21, thotë:

“Figura e ushtarit musliman, në njërin dorë shpatën dhe në tjetrën Kur’anin, është plotësisht e rreme”.³⁸⁵

Diercks

³⁸³ Pamfleti: *Shpata e Islamit*.

³⁸⁴ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 145.

³⁸⁵ Pamfleti: *Shpata e Islamit*.

“Pretendimi se luftërat kundër jomuslimanëve ishin religjioze dhe për shkaqe fetare dhe se u ndërmorën nga ana e muslimanëve për shtypjen e feve të tjera, është përgjithësisht jashtë çdo diskutimi. Në raste të veçanta, do ta kemi shumë vështirë të mohojmë se arsyet materiale dhe politike nuk ishin motivimi i vërtetë i këtyre luftërave.

Dëshmia më e mirë vërteton se disa nga luftërat e mëvonshme ishin për shkaqe ekonomike dhe politike. Ndërkaq, luftërat e para, gjatë jetës së Pejgamberit, ishin përpjekje për të gëzuar të drejtën e jetës së lirë”.³⁸⁶

Sherbel

Profesor i madh, dekan i Fakultetit Juridik, pranë Universitetit të Vjenës, në konferencën mbi të drejtën, në vitin 1927, ka thënë:

“Vërtet, është nder për njerëzimin që një njeri si Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], i përket gjinisë njerëzore. Edhe përkundër të qenit të tij analfabet, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], ia doli që, qysh para më shumë se dhjetë shekujsh, të sjellë një ligj të tillë, kulminacionin e të cilit, ne evropianët, sikur ta arrinim edhe pas dy mijë vjetësh, do të duhej të ndiheshim më së të lumtur”.³⁸⁷

Dr. Isko Nasabato

“E drejta islame, në shumë studime të saj, ia kalon ligjeve evropiane. Ajo është një gurrë e tillë, që për nga cilësia dhe origjinaliteti i dhuroi botës ligjet më autentike”.³⁸⁸

³⁸⁶ Robert L. Gulick, Jr. op. cit., f. 47.

³⁸⁷ Dr. Jusuf El Kardavi, op. cit., f. 83, 84.

³⁸⁸ Ibid, f. 83.

E. Denison Ross

“Nuk duhet harruar se proklamimi i njësisë së Zotit, ishte pika qendrore e doktrinës që komunikoi Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Thjeshtësia e besimit islam, e jo shpata e komandantëve të tij ushtarakë, ishte, pa dyshim, faktori determinues dhe vendimtar në përhapjen e Islamit”.³⁸⁹

Dr. Hoking

Profesor i filozofisë në Universitetin e Harvardit, në veprën e tij “Ruhus sijasetil alemijeh”, thotë:

“Rruga e progresit të shteteve islame, nuk qëndron në përvetësimin e modaliteteve, që favorizojnë idenë se feja s’ka çfarë thotë për jetën e përditshme të individit, për ligjin ose sistemet politike. Është e domosdoshme, që njeriu të gjejë në fe burimin e progresit dhe të zhvillimit.

Nganjëherë, ndodh që të pyetet se deri në ç’masë sistemi islam është në gjendje të sjellë ide të reja dhe të ofrojë zgjidhje origjinale, që do t’u përgjigjeshin kërkesave të jetës bashkëkohore? Përgjigja, për pyetjen e parashtruar, është: ‘Sistemi islam posedon të gjitha predispozitat e nevojshme për progres. Ndërkaq, sa i përket prirjes së tij për evolucion, në këtë aspekt, Islami është gjithëpërfshirës dhe i mbizotëron të gjitha ligjet dhe sistemet. Prandaj, vështirësitë në ligjin islamik, nuk lindin si rezultat i mosekzistimit të mënyrës ose metodës për zhvillim të vrullshëm dhe përtëritjes, por për shkak të mungesës së entuziazmit dhe disponimit për t’i shfrytëzuar ato metoda.

³⁸⁹ T. Nelaj, *Edukata Islame*, Prishtinë, 1971, nr. 3. f. 33.

E ndiej se kam plotësisht të drejtë, kur pohoj se ligji islamik posedon tërësinë e duhur të parimeve, që janë të domosdoshme për transformim dhe zhvillim (të shoqërisë)".³⁹⁰

Dr. Çiro Truhalko

"Është mendim i gabuar të mendohet se Islami është përhapur me dhunë. Ekzistojnë argumente të shumta, të cilat hedhin poshtë këtë gjë. Unë do të përmend vetëm njërin: 'Sikur Islami të përhapej me dhunë shtetërore, atëherë shekulli XIX-të, nuk do të gjente asnjë të krishterë, apo manastir në Ballkan'".³⁹¹

V. V. Bartold

Në "Mussulman Culture", f. 17-22, thotë:

"Muslimanët, kurrë, nuk kanë ushtruar dhunë ndaj pjesëtarëve të feve të tjera, sikurse vepruan të krishterët në Spanjë. Në kohën e kryqëzatave, - nëse i besohet një historiani rus të Kishës, - priftëria dhe populli preferonin më shumë kthimin e sundimit të muslimanëve se sa vazhdimin e fuqisë së latinëve".³⁹²

Paul Findley

Anëtar i Kongresit Amerikan në shtetin e Iliniosit, post të cilin e mbajti për 22 vjet me radhë. Është i njohur për përpjekjet e tij për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut dhe për zhdukjen e diskriminimeve raciale apo fetare. Ka marrë shumë çmime për punën e tij të palodhshme kundër

³⁹⁰ Dr. Jusuf El Kardavi, op. cit., f. 84.

³⁹¹ Rreth përhapjes së Islamit ndër shqiptarët, op. cit., f. 121.

³⁹² Robert I. Gulick Jr. op. cit., f. 49.

diskriminimit. Është bartës i pesë titujve doktor nderi të dhëna nga Universitetet në SHBA dhe një nga Universiteti i San'as. Duke përmendur paragjykimet ndaj Islamit, për tolerancën islame shprehet:

“Në moshën gjashtëvjeçare, prezantimi im me Islamin pati një nisje të keqe... Për pjesën më të madhe të jetës sime, për muhamedanët ruaja në mendje imazhin e njerëzve të huaj, injorantë dhe kërcënues. Si shumë amerikan të sotëm, mësuësja ime përsëriste me pafajësi keqinformimin që kishte marrë nga njerëz të tjerë të painformuar. Ajo i recitoi klasës sonë atë që besonte se ishte e vërteta, përfshirë edhe emrin e gabuar ‘muhamedanë’. Nuk besoj se ajo donte të përhapte keqinformim apo të dëmtonte reputacionin e Islamit. Thjesht i mungonin faktet, ashtu si mësuesve të tjerë dhe pastorit, i cili udhëhiqte kongregacionin tonë.

Edhe një himn i preferuar, ‘Për kalorësit e ditëve të vjetra’, vazhdonte të ndikonte në ruajtjen e imazheve të rreme. Shtatëdhjetë vjet më vonë, mbaj mend faqen 219 të himneve, si notat ashtu edhe fjalët. Ushtrimet e hapura përmbanin gjithmonë këndimin në grup dhe ne lexonim plot entuziazëm himnin 219: ‘Për kalorësit e kohëve të vjetra/ që vështronin ndër malet e larta/ erdhi një vegim i sofrës së shenjtë/ dhe një zë përmes natës pritëse, duke thirrur/ ndiqni, ndiqni shkretimën/ flamujt e shpalosur në të gjithë botën/ ndiqni, ndiqni shkretimën e dorezës, e cila është sofrë’. Himni transmeton një pamje të shpërftytyruar të Islamit që ende pranohet gjerësisht si e pagabueshme nga shumë të krishterë e mbase nga shumica e tyre. Fjalët e tij nuk japin sqarime se kalorësit, të himnizuar si heronj, në fakt, masakruan mijëra muslimanë të pafajshëm dhe u ndjenë plot hare mes kësaj masakre. Ndërkohë që e quanin veten të krishterë, kryqtarët nuk e njihnin detyrimin e fesë së tyre

për tolerancë, mëshirë dhe drejtësi. Përkundrazi, ata vepruan plot egërsi si hakmarrës e gjakësor.

Unë do ta kisha humbur të gjithë interesin për himnin, nëse do ta kisha ditur se çfarë kishte shkruar një nga kryqtarët më 15 korrik të vitit 1099 mbi skenën gjakësore në Jerusalemin: 'Me shpatat zhveshur, njerëzit vepruan në qytet; nuk kursyen askënd, madje as përgjërimit për mëshirë. Kuajt ecnin mbi gjakun që u shkonte gjer në gjunjë, madje dhe më tepër, deri në frerë. Ishte një gjykim i drejtë dhe i mahnitshëm i Perëndisë.' Masakra nuk mbeti e kufizuar vetëm në Jerusalemin. Kryqtarët, duke ndjekur 'të paqytetëruarit dhe jobesimtarët', vranë muslimanë, hebrenj, madje dhe të krishterë në të gjithë Lindjen e Mesme, më së shumti në Antioki e Kostandinopojë. Ndërsa në të tre rastet e marrjes së Jerusalemit prej muslimanëve, as edhe një pikë gjaku s'është derdhur'.³⁹³

Robertson

Në librin e tij "Tarihu sharkijin", deklaroi:
"Vërtet, muslimanët dëshirën e zjarrtë dhe përkushtimin e tyre fetar, e kanë shoqëruar me shpirtgjerësi dhe tolerancë ndaj pjesëtarëve të feve tjera. Edhe përkundër përkushtimit të plotë dhe vendosmërisë në përhapjen e fesë, muslimanët, i lanë të lirë të gjithë ata që nuk pranonin Islamin, sepse ata, kështu, deshën të jenë konsekuent ndaj mësimëve të tyre fetare".³⁹⁴

Dr. Taraxhendi

³⁹³ Paul Frindley, op. cit., f. 20-21.

³⁹⁴ Dr. Jusuf El Kardavi, op. cit., f. 47.

“Në këtë periudhë, u zhvilluan shumë shkolla ideologjike, të cilat gjuhën popullore e shfrytëzuan, si mjet komunikimi dhe kuptimi në thirrje për ide revolucionare. Ata silleshin rreth klasave të ulëta, i përfaqësonin aspiratat e masave të privuar nga progresi dhe gëzimi i të drejtave të tyre të mohuara. Prijësit e tyre, ishin të përqendruar në prestigjin e njeriut dhe respektimin e anës njerëzore, sepse ata mendonin se çdo individ, me punën e tij individuale, mund të arrijë në gradën më të lartë të mundshme. E refuzonin klasën klerike dhe vizitën e tempujve idhujtarë, si dhe doket dhe traditat irracionale. Thirrja dhe pëshpëritja e tyre ishte se njeriu mund ta njohë dhe adhurojë Zotin në mënyrë direkte. Kjo lëvizje, filloi në shekullin e XV-të të erës sonë, por me kalimin e kohës ajo u shua. Prijësit e kësaj lëvizjeje, u takonin krahinave të ndryshme indiane, ndërkaq ndikimi i Islamit ishte i theksuar qartë në instruksionet dhe doktrinat e tyre”.³⁹⁵

Meredith Townsendi

Në “Mohammed”, f. 34, thotë:

“Skllavi, që përqaftonte Islamin, ishte i lirë, madje jo vetëm një njeri i lirë, por edhe një qytetar i lirë... Ai kishte të drejtë që, *de facto* dhe *de jure* të merrte çfarëdo posti në punët e shtetit.

Nëpërmjet Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], u arrit një formë demokracie *ex necessitate rei* (nga urgjenca, nevoja), më absolute, se kudo në botë. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte një edukator më thelbësor se sa

³⁹⁵ Ebul Hasen Ali En Nadevij, op. cit., f. 40-41.

reformuesit modernë, mësimet liberale të cilëve nuk ia dolën të ndalojnë luftën dhe tiraninë”.³⁹⁶

George Sale

Përkthyes i Kuranit të Shenjtë në gjuhën angleze, në vitin 1735, thotë:

“S’kam ndërmend t’i parashtoj shkaqet, të cilat bënë të mundur që feja islame të hasë në mirëkuptim të paparë në botë. Por, atyre që mendojnë se ajo është përhapur me shpatë, mund t’u them se ata mashtrojnë veten”.³⁹⁷

Mejshud

Në librin e tij “Tarihul Hurubis Salibije”, thotë:

“Kurani, i cili urdhëron xhihadin, është tejet tolerant ndaj ithtarëve të feve të tjera. Ai i liroi nga tatimi patriarkët, priftërinjtë dhe shërbëtorët e tyre. Ndërsa, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ndaloi vrasjen e priftërinjve, për shkak të përkushtimit të tyre dhe lojalitetit, që shprehin gjatë lutjeve.

Me rastin e çlirimit të Kudsit (Jerusalemit), udhëheqësi i muslimanëve Umer b. el Hattabi, nuk u bëri kurrfarë dëmi të krishterëve. Ndërkaq, kryqtarët i masakruan muslimanët dhe çifutët, dhe i dogjën ata, pamëshirshëm, në turrën e druve, duke e pushtuar Kudsën me zjarr dhe shpatë”.³⁹⁸

Adem Metz

³⁹⁶ Robert L. Gulick Jr. op. cit., f. 12.

³⁹⁷ Rreth përhapjes së Islamit ndër shqiptarët, op. cit., f. 120.

³⁹⁸ Dr. Jusuf El Kardavi, op. cit., f. 47.

Profesor i gjuhëve samite në Universitetin e Bazelit, në Zvicër. Ka shkruar disa vepra. Jetoj nga viti 1869 deri në vitin 1917.

“Konsiderohej devotshmëri dhe nder, që njeriu të mos godiste skllavin e tij. Transmetohet nga Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] të ketë thënë: *‘Njeriu më i keq është ai që ushqehet vetëm, që nuk sillet mirë dhe që e godet skllavin e tij’*.

Në shekullin e IV të hixhretit, disa e merrnin si pike referimi ajetin kur’anor, i cili thotë se: ‘muslimanët janë vëllezër’ dhe kritikonin ata që goditnin shkllevërit e tyre”.

“Në Islam, ka ekzistuar parimi, i cili ka favorizuar shkllevërit. Madje, çdonjëri prej tyre, mund të blinte lirinë me një shumë të hollash. Skllavi ose skllavja, gëzonte të drejtën që të punonte punën që dëshironte, në mënyrë të pavarur. Gjithashtu, prej mirësisë dhe traditës së lavdëruar, ishte që njeriu para vdekjes të linte porosi lirimin e disave nga shkllevërve që posedonte”.

“Muslimani mund të transferohej (lirshëm) brenda kufijve të shtetit musliman, me fenë e tij dhe nën flamurin e tij. Në të, gjente njerëzit që adhuronin Zotin, të Cilin e adhuronte edhe ai. Ata faleshin, ashtu siç falej edhe ai. Ligji, tradita dhe zakoni ishin të njëjtë. Në këtë shtet islam, mbisundonte ligji, i cili i siguronte të gjithë muslimanëve të drejtën e shtetësisë. Ai, ishte i sigurt dhe gëzonte lirinë personale, gjë të cilën s’kishte të drejtë t’ia kërcënonte askush. Asnjëri s’mund ta dëmtonte. Nasirudini ka shëtitur të gjitha vendet muslimane, në shekullin e pestë hixhri (XI-të), pa hasur në ndonjë vështirësi, me të cilat ballafaqohej gjermani duke u transferuar, madje, brenda vetë Gjermanisë, në shekullin e XVIII-të”.³⁹⁹

³⁹⁹ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 243-244.

“Vendet muslimane kanë dalluar nga Evropa e krishterë, për shkak të ekzistimit në to të të ashtuquajturave pakica fetare dhe etnike, që i kanë gëzuar të gjitha të drejtat dhe liritë. Një gjë të tillë, Evropa nuk e ka poseduar”.⁴⁰⁰

San Mak Brajd

Profesor i Universitetit të Dublinit, ish-ministër i punëve të jashtme të Irlandës, ish-sekretar gjeneral i Komisionit Ndërkombëtar të Drejtësisë, duke dëgjuar për esencën e së drejtës islame, shpreh admirimin e tij, duke thënë:

“Këtu, nga ky vend, duhet të proklamohen të drejtat e njeriut, e jo nga ndonjë vend të tjetër. Është detyrë e dijetarëve muslimanë që t’ia proklamojnë opinionit publik ndërkombëtar këto fakte të panjohura, mosnjohja e të cilave ishte shkak për shtrembërimin e prestigjit të Islamit, të muslimanëve dhe të qeverisë islame”.⁴⁰¹

⁴⁰⁰ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 143.

⁴⁰¹ Këto fjalë, Brajd, i cili udhëhiqte delegacionin evropian në Arabinë Saudite, i thotë pasi që dëgjon ekspozenë e bërë nga ana e delegacioni saudit, në pyetjet që kishte parashtruar delegacioni i tij, rreth të drejtave të njeriut në Islam, shih *Dijalog islamskih i evropskih učenjaka*, op. cit., f. 31.

Dr. Msje Lojl

Shkencëtar dhe njohës i mirë i çështjeve të Orientit, në librin “Civilizimi arabo-islam”, f. 515, shkruan:

“Muslimanët, vazhdimisht, deri më sot, e kanë ruajtur veten nga shembujt negativë të gabimeve të kobshme të Perëndimit, që kanë të bëjnë me jetën komode dhe të qetë të klasës punëtore. Ata, me fanatizëm, qëndrojnë në mbrojtje të sistemeve të mrekullueshme shtetërore, të cilat, parimisht, trajtojnë njësoj pasanikun dhe varfanjakun, punëdhënësin dhe punëtorin, prandaj nuk e teprojmë, nëse themi se populli musliman, të cilin evropianët dëshirojnë ta edukojnë është shembulli më i mirë, për këtë çështje esenciale.

Në Islam nuk ka klasa të privileguara, as pozita trashëguese. Themelet e sistemit politik në Islam janë të thjeshtë, ndërsa ata që jetojnë në këtë sistem, pa marrë parasysh pozitën, respektin, pasurinë dhe varfërinë e tyre ose ngjyrën e lëkurës, janë të barabartë”.⁴⁰²

Dr. Harold B. Smith

Profesor dhe zëvendëskryetar, në katedrën e feve, në Ohajo, të SHBA-së. Ka qenë kryetar i katedrës së filozofisë së moralit, në Universitetin Amerikan, në Kajro.

“Çdo njeri, me vullnet të lirë, është përgjegjës para Allahut për mendimet, sjelljet dhe veprat e tij...

All-llahu, nëpërmjet shpalljes, e udhëzon njeriun në parime të përgjithshme morale, të cilat burojnë nga vullneti i tij i amshueshëm. Njeriu, posedon një forcë të fuqishme, ai gëzon të drejtën të pranojë ose të refuzojë udhëzimin e All-

⁴⁰² Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 131. dr. Jusuf El Kardavi, op. cit., f. 50

llahut. Është një ajet i rëndësishëm: *“Ne ua ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë dhe u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete; dhe ai i bëri padrejt vetes, dhe ishte i padijshtëm”*. (El-Ahzab: 72)

Kuptimi i këtij ajeti vërtetohet, vetëm nëse pranohet liria e njeriut. All-llahu i ka ofruar amanetin gjithë krijesave, për ruajtjen e besimit dhe drejtimin e botës në emër të All-llahut. Njeriu pranoi të marrë këtë përgjegjësi, ndërsa krijesat e tjera refuzuan një gjë të tillë, për shkak të frikës dhe ngushëllimit! Pikërisht këtu qëndron sekreti i fshehtësisë së njeriut dhe gabueshmërisë së tij, edhe pse njeriu nuk është përkujdesur sa duhet për atë besim dhe nuk e ka drejtuar botën në mënyrë të vlefshme, duke marrë rrugën e padrejtësisë dhe injorancës.

Njeriu, sikur të mos ishte i lirë, nuk do të gabonte, dhe ai, sikur të mos ishte i lirë, nuk do ta pranonte amanetin”.⁴⁰³

Jobi

Shkruan: *“Vetëm Islami është i aftë të tubojë popuj të ndryshëm në një front edhe atë në bazë të barazisë. Komuniteti musliman në Kinë, Japoni, Indonezi, Indi, Afrikë, tregon se vetëm Islami mund të ndikojë tek popujt dhe racat e ndryshme. Nëse i vështrojmë më mirë dallimet ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit të sotëm, do të kuptojmë se shpëtimi nga këto dallime, qëndron vetëm në Islam”*.⁴⁰⁴

Lajuter

⁴⁰³ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 195-196.

⁴⁰⁴ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 131.

Filozof i shquar, thotë: “Nën ndikimin e sistemit islam të vlerave, lindorët janë tejet të kujdesshëm, bujarë dhe mikpritës ndaj të huajve. Kjo i dallon për nga nderi dhe sinqeriteti. Ndërsa, asgjë prej kësaj nuk mund të gjendet në mjedisin materialist perëndimor, midis prefikseve të vrazhdë dhe të pashpirt perëndimorë”.⁴⁰⁵

Edmund Burke

Politikan i shquar anglez.

“Ligji i Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], i cili vepron njësoj për të gjithë, prej kokës së kurorëzuar (mbretit), e deri te njeriu më i rëndomtë, është ligji i thurur dhe i përshkruar me principet më të urta, më shkencore dhe më civilizuese juridike, të cilat kanë ekzistuar ndonjëherë në botë”.⁴⁰⁶

Dr. Bernier

Mjek francez, thotë:

“Numri i fatkeqësive të ‘Sitas’ (sipas kësaj tradite vejusha, gjatë djegies së kufomës së burrit të saj, digjte vetveten) u zvogëlua relativisht, sepse muslimanët, të cilët qeverisnin në këto vende dhanë mund maksimal, që ta zhduknin këtë ves të egër edhe pse ata nuk kanë miratuar asnjë ligj për të ndaluar këtë fatkeqësi që të mos ndodhte, sepse ata, në qeverisjen e tyre, nuk synonin që të ndërhyjnë në çështjet fetare të hindusëve. Ata u lejonin atyre kryerjen e obligimeve dhe ritualeve të tyre fetare dhe u jepnin të gjitha liritë, por u munduan të ndalonin traditën ‘Sita’ në mënyrë

⁴⁰⁵ Ibid, f. 134.

⁴⁰⁶ Dr. Fadlurrahman Ensar, op. cit., f. 34-35.

indirekte. Prandaj, asnjë grua, nuk guxonte që t'i ekspozonte veten 'Sitas', veçse me lejen e sundimtarit të krahinës. Ndërkaq, sunduesi nuk ia lejonte asaj këtë gjë, veçse nëse vërtetohej se ajo në asnjë mënyrë nuk do të hiqte dorë nga qëllimi i saj. Gjithashtu, sunduesi i asaj krahine, mundohej që ta bindte gruan dhe ta nxiste atë që të hiqte dorë nga dëshira e saj, e frikësonte, i kërcënohej dhe po ashtu i premtonte të mira materiale. Kur të gjitha këto përpjekje dështonin dhe procesi i bindjes dhe kërcënimit nuk jepnin rezultate, atëherë e dërgonin atë te gratë, me qëllim që t'i bashkëngjitej grave të mençura, në mënyrë që, përmes bindjes së tyre, të hiqte dorë nga dëshira e saj. Mirëpo, edhe përkundër gjithë këtyre masave të ndërmarra, fatkeqësitë e 'Sitas' vazhdonin të ndodhnin shpesh, e veçanërisht në territoret e prijësve (raxhave) dhe vendeve, të cilat ishin nën sundimin e atyre, ku nuk sundonin muslimanët".⁴⁰⁷

Henri De Kastrie

"Kapitullimi i imponuar i të krishterëve nga ngadhënjyesit arabë, ishte gati gjithmonë i frymëzuar nga një frymë e madhe tolerance, e cila, atëbotë, ishte një ndjenjë shumë e rrallë në Evropë. Që të jemi më konsekuentë, duhet të theksojmë, se humaniteti i pushtuesve (në Evropë) konsiderohej dobësi..

Mund të thuhet se feja e re nuk është imponuar me predikim, e as me dhunë... Nëse, ndonjë i krishterë ka kaluar në fenë Islame, për ndonjë interes, të tjerët, në numrin më të madh, janë bërë muslimanë nga bindja e sinqertë dhe spontane. Ky kalim i tyre në fenë islame, përveç kësaj, ka qenë jashtëzakonisht i lehtë, për shkak të thjeshtësisë së vet

⁴⁰⁷ Ebul Hasen Ali En Nadevij, op. cit., f. 59, 60.

besimit islam. Pastaj, mjaftonte të shqiptohej formula e shkurtër e fesë, për t'u bërë musliman.

Veçanërisht, në Spanjë, manifestohej toleranca muslimane dhe kushtet që u imponoheshin të krishterëve ishin shumë më të buta, se ato që kishin nën sundimin e vizigotëve. Kjo fitore nuk shkaktoi asnjë mynxyrë. Ngadhënjimtarët (muslimanë), u linin të lirë spanjollëve religjionin e tyre, ligjin e tyre, gjyqet e tyre. Të krishterët ushtronin funksione publike dhe po ashtu, ishin nëpunës në oborret e halifëve, madje shumë prej tyre, si p.sh. Sidi, komandonte ushtritë muslimane. Kjo politikë tolerante e kishte bashkuar pjesën më të ndritur të popullatës së qyteteve. Shumë spanjollë, pa hequr dorë nga feja e tyre, e kishin përqafuar qytetërimin oriental, mësonin gjuhën e letërsinë arabe, e priftërinjtë e krishterë i qortonin që nuk merreshin më me himnin e kishës, por me poezitë profane të ngadhënjimarit. Atëherë, ishte aq e madhe liria e fesë në Spanjë, sa që çifutët, e përndjekur në Evropë, strehoheshin në masë, pranë halifëve, në Kordobë... Perandori Charl, duke hyrë si pushtues në Saragozë, urdhëroi ushtarët e vet t'i rrënojnë sinagogat dhe xhamitë. Avogdor Shekin thotë se, në shek. VIII, kishte aq shumë çifutë në Spanjë, sa e tërë tregtia e jashtme ishte në duart e tyre.

Në kohën e kryqëzatave, sa herë që ushtria e krishterë hynte fitimtare në ndonjë qytet Saracen (arab), bënte kërdi të madhe, ndër muslimanët dhe çifutët. Kështu, çifutët iknin nga shtetet e krishtera e strehoheshin në vendet muslimane, ku gjenin azil dhe mbrojtje. Kjo ishte tolerancë e madhe e Islamit dhe çifutët ishin mirënjohës në këtë situatë, dhe kjo nuk ishte sikurse pretendon Avidgor Sheikin, për shkak të

originës së komunitetit, ngjashmërisë së racës, gjuhës dhe religjionit të dy popujve”.⁴⁰⁸

Norman Benz

“Të krishterët ortodoksë, të Kostandinopojës, i urrenin shumë më tepër katolikët romanë, sesa ngadhënjimtarët muslimanë”.

Ata përsërisnin fjalët e peshkopit bizantin, duke thënë:

“Ne preferojmë më shumë të shohim në qytetin tonë turbanin turk, sesa kurorën papate”.⁴⁰⁹

Abe Misho

Në lidhje me udhëtimin e tij në Lindje, thotë:

“Është e trishtueshme për kombet e krishtera, që tolerancën fetare, e cila është një gjest i madh shpirtmirësie, i një populli kundruall një populli tjetër, e kanë mësuar nga muslimanët”.

Në historinë e tij për kryqëzatat, ai deklaron:

“Kur Umeri e mori Jerusalemin, nuk i bëri asnjë të keqe të krishterëve. Kur kryqtarët bëheshin të zotët e qytetit të shenjtë, i masakronin pa mëshirë muslimanët dhe i digjinin çifutët”.⁴¹⁰

Dr. Vaglieri

Shkruan: “Popujt e mundur i kanë pasur të gjitha të drejtat dhe sigurinë e plotë të pasurisë nga pushteti islam. I gëzonin thuajse të gjitha të drejtat si edhe muslimanët. Kur ara-

⁴⁰⁸ Dr Ahmed Muhamed El Hufi, *Toleranca islame*, Prishtinë, boton Shtëpia Botuese Dituria Islame, (pa vit botimi), f. 47-50.

⁴⁰⁹ Ibid, f. 50.

⁴¹⁰ Ibid, f. 46-47.

bët kanë qenë më të fuqishëm, gjithnjë i kanë ofruar armikut paqe, me kushte gjegjëse për kompensim material (xhizje) në këmbim për siguri dhe mbrojtje të plotë, krahas gëzimit të të gjitha të drejtave, që i gëzonin edhe muslimanët. Nëse i shikojmë pak me seriozisht fjalët dhe praktikën e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], si dhe ekspansionin e Islamit në periudhën e hershme të tij, do të kuptojmë se nuk ka bazë të duhur historike pohimi se 'Islami i është imponuar popujve të ndryshëm me dhunë'. Kur'ani thotë në mënyrë të qartë: "*Në fe nuk ka dhunë*".⁴¹¹

⁴¹¹ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 142.

Filip Hiti

Në librin e tij "Historia e arabëve", f. 638, shkruan:

"Kudo që ka shkelur këmba e ushtrisë muslimane, njerëzit e atyre viseve i kanë pranuar duarhapur dhe u kanë ofruar ujë dhe bukë, duke garuar në dalje nga istikamet e veta për t'iu bashkuar muslimanëve. Kjo mund të kuptohet lehtë nga ana e atyre, që e dinë se çfarë ishte tirania e vizigotëve".⁴¹²

Rozhe Garodi

"Të vetmet beteja të filluara, të cilat muslimanët në ekspansionin e vet i shpejtuan, kanë qenë luftërat kundër shtypësve feudalë, mbretërve despotë, e peshkopëve sektarë e inkuizitorë, e jo kundër popullit, që i kanë pritur si çlirimtarë të robërimit të tyre të mëparshëm. Kështu ka qenë, prej Gvadaletes në Spanjë, e deri te Kadisia në Persi. Në planin religjioz, arianët (pasardhësit e areinit) të Afrikës Veriore e të Spanjës vizigote, si dhe nastorianët nga Persia, domethënë, të gjithë ata, që Isain e kanë konsideruar për të Dërguar të madh të Zotit, por që kanë refuzuar ta bëjnë të barabartë me Zotin, kanë njohur mësimet e veta në fenë islame dhe me dëshirë kanë pranuar Lajmëtarin e fesë islame".⁴¹³

Dëshmia e konferencave ndërkombëtare

"Dëshmitë, për universalitetin dhe vlefshmërinë e Sheriatit (të drejtës islame), nuk dalin vetëm nga ekspertët objektivë të Perëndimit, por ato vijnë edhe nga një rreth më i gjerë dhe më gjithëpërfshirës, nga konferencat speciale ndërkombëtare të legjislacionit dhe të drejtës krahasuese. Në Hagë, në

⁴¹² Ibid, f. 141.

⁴¹³ Rozhe Garodi, *Gjallërim islamik*, op. cit., f. 8-9.

vitin 1937, është mbajtur Konferenca Ndërkombëtare, mbi të drejtën komparative, ku është ftuar edhe Universiteti El Ez'her, të cilin e përfaqësuan dy dijetarë të mëdhenj. Referatat e tyre i kushtohen dy temave:

1. 'Përgjegjësia civile dhe penale në të drejtën islame' dhe
2. 'Pavarësia e të drejtës islame dhe mohimi i çdo lidhshmërie mes Sheriatit dhe të drejtës romake'.

Në bazë të këtyre dy referateve, Konferenca solli rezolutën e saj 'historike' që i dedikohet juristëve dhe legjislatorëve përëndimorë, si vijon:

E drejta e Sheriatit, të çmohet si një nga burimet e të drejtës së përgjithshme.

E drejta e Sheriatit, është vitale dhe dinamike dhe si e tillë mbështet zhvillimin evolutiv.

Ajo është e drejtë e mëvetësishme dhe nuk është kopjim i ndonjë të drejte tjetër.

Po në Hagë, më 1948, është mbajtur konferenca ndërkombëtare e juristëve, ku kanë marrë pjesë 53 shtete dhe janë mbledhur një numër i madh profesorësh e juristësh brilant të vendeve të ndryshme.

Kjo konferencë, në bazë të propozimit të vet, për të drejtën komparative, solli rezolutën vijuese:

'Duke pasur parasysh fleksibilitetin e të drejtës Islame dhe rëndësinë e saj, Asociacioni Ndërkombëtar i Juristëve, obligohet të iniciojë studimin komparativ dedikuar të drejtës Islame dhe të punojë intensivisht në këtë drejtim.'

Ndërkaq, Seksioni për të drejtën orientale, pranë Akademisë Ndërkombëtare, ka organizuar simpoziumin, në Fakultetin Juridik, të Universitetit të Parisit, në vitin 1950, për studimin e të drejtës islame me titull: 'Java e së drejtës islame', ku u ftua një numër i madh profesorësh nga fakultetet juridike, nga vendet arabe dhe joarabe, profesor nga El Ez'heri, juristë arabë, francezë dhe orientalistë të tjerë.

Akademia Ndërkombëtare kishte dedikuar pesë tema nga fusha e të drejtës:

- Konsolidimi i pronës;
 - Shpronësimi për hir të interesit të përgjithshëm;
 - Përgjegjësia penale (e drejta ndëshkimore);
 - Ndikimi i ndërsjellë i medh'hebeve (shkollave juridike islame); dhe
 - Çështja e kamatës në fenë islame.
- Ligjëratat janë mbajtur në gjuhën frënge.⁴¹⁴

Ish-kryetari i shoqatës së juristëve, në Paris

Gjatë një diskutimi ka thënë: “Unë nuk di si të pajtoj, atë që është thënë mbi pamundësinë dhe paaftësinë e të drejtës islame, për të qenë bazë e një legjislacioni, që i përmbush kërkesat e shoqërisë progresive bashkëkohore, me këtë që po dëgjojmë sot, në ligjëratat dhe diskutimet, të cilat në mënyrë origjinale vërtetojnë plotësisht të kundërtën”.

Në fund, pjesëmarrësit e simpoziumit, hartuan njëzëri dokumentin, ku thuhet:

“Duke u bazuar në efektet e pakontestueshme, që u zhvilluan gjatë javës së jurisprudencës islame, konstatohet qartë: Parimet e të drejtës islame kanë vlerë të pa dyshimtë dhe të pakontestueshme juridiko-legjislative, dhe

Divergjencat e shkollave juridike islame (medh'hebeve), përfshijnë një pasuri të madhe konceptesh, njohurish e faktesh, të cilat janë mahnitëse dhe me ndihmën e tyre, e drejta islame, është në gjendje t'u përgjigjet kërkesave të jetës bashkëkohore dhe t'i plotësojë nevojat e saj”.

Pjesëmarrësit e simpoziumit shprehën dëshirën që 'Java e së drejtës islame' të vazhdojë për çdo vit dhe të formohet një

⁴¹⁴ Dr. Jusuf El Kardavi, op. cit., f. 87.

komision për hartimin e një leksikoni të së drejtës islame, që do të ndihmonte konsultimin e veprave të kësaj të drejte dhe do të shërbente si enciklopedi juridike, ku të dhënat e jurisprudencës islame, do të evidentoheshin në frymën e metodologjisë bashkëkohore”.⁴¹⁵

⁴¹⁵ Dr. Jusuf El Kardavi, op. cit., f. 85-86.

KAPITULLI VI

PËR ÇËSHTJEN E FEMRAVE

Volter

Për çështjen e femrës në Islam, thotë:

“Muhammedi ka sjellë ligje të mira, me të cilët ka dashur ta shpëtojë njerëzimin nga fatkeqësia, padituria dhe shfrenimi. Këto ligje e shikojnë bamirësinë dhe dobinë e të gjithë njerëzve mbi tokë: meshkujve dhe femrave, të rriturve dhe fëmijëve, të mençurve dhe të sëmurëve mentalisht, të bardhëve dhe të zinjve, të verdhëve dhe të kuqeve. Nuk është ai, që e ka aplikuar poligaminë (martesën me shumë gra). Përkundrazi, ai e ka kufizuar numrin e pakufishëm të grave, në vetëm katër gra. Ligji mbi martesën dhe shkurorëzimin, të cilin e ka proklamuar ai, është shumë më i mirë dhe më fisnik se ligjet e ngjashëm në krishterizëm. Ndërsa, sa i përket shkurorëzimeve, konkretisht, mendoj se nuk ekziston asnjë ligj më komplet dhe më gjithëpërfshirës se ligji kur'anor”.⁴¹⁶

Will Durant

“Nëse do të ishte e nevojshme të gjykohej, nga një këndvështrim tjetër, gruaja muslimane, krahasuar me disa gra në Evropë, ishte në gjendje më të mirë. Çdo mall ose para që fitonte, i përkiste asaj. As bashkëshorti nuk mund t'i merrte ato që fitonte. Në dhomat e veta, në siguri, endte, qëndiste, qepte, administronte shtëpinë dhe rriste fëmijët. Nga ana

⁴¹⁶ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 171.

tjetër, i mbetej kohë edhe për lojë e biseda, të shoqëruara me ngrënie ëmbëlsirash me shoqet e saj”.⁴¹⁷

Stanley Lane Pole

Thotë: “Ndryshimet e rëndësishme, që bëri Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në çështjet e gruas, asnjë ligjvënës i madh nuk i ka bërë. Vendimet, në lidhje me gratë, gjithsesi, janë dispozita të kodifikuara në Kur’an, deri në çështjet e imta. Ja, në këtë pikë, qëndron reforma më e rëndësishme e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Kjo reformë, sado e parëndësishme t’i duket një evropiani, kur krahasohet me sistemin ligjor të vjetër, lidhur me gruan, me të vërtetë është madhështore! Kufizimi i poligamisë, këshillimi i bashkëshortësisë me një grua, zëvendësimi i elementëve të bashkëshortësisë tradicionale arabe, që shkaktonin frikë për shkak të ortakërisë dhe përzierjes, me nivele të tjera ndalimi, kufizimi i ndarjeve, vendosja e rregullave shumë të forta për dhënien e kontributit, kujdesi dhe ushqimi për një kohë grave të ndara nga ana e burrave, së bashku me trajtimin e përpjesëtimit të ushqimit të fëmijëve, në raport të barabartë midis gruas e burrit, organizimi i risisë që garantonte zbatimin e statusit të tyre si trashëgimtarë ligjorë dhe heqja e zakonit dhe traditës që e pat lënë gruan e ve, në cilësinë e mallit të trashëgueshëm të burrit; të gjitha këto, formojnë një kuadër të madh ndryshimesh dhe reformash”.⁴¹⁸

Lois Lamya al Faruqi

⁴¹⁷ Topallogllu, op. cit., f. 30.

⁴¹⁸ Ibid, f. 29.

Luiz Lamya el Faruku, e mori titullin e saj të doktoraturës, për studimet islame, në Universitetin e Sirakuzës. Ajo ishte profesoreshë në Universitetin Batler, në Universitetin e Pensilvanisë, në Universitetin Uilianova dhe në Universitetin Tempël. Publikimet e saj përfshijnë: 'Islami dhe Arti', dhe 'Atlasi Kulturor i Islamit', në të cilat, ajo është bashkautore me burrin e saj, Isma'il Farukun. Ajo, u vra në shtëpinë e saj, së bashku me burrin e saj, më 30 maj, 1986. Ajo thotë:

Sipas Islamit gruaja është biologjikisht, pra edhe fizikisht dhe psikikisht më ndryshe nga burri. Gruaja dhe burri kanë pozitë të njëjtë, por detyra të ndryshme: ata kanë vlerë të njëjtë, por aftësi të ndryshme: të barabartë para Zotit, por kanë role të ndryshme në jetë.

Burrat dhe gratë duhet të jenë plotësues të njëri-tjetrit, në një organizim multi-funksional, më mirë se sa të konkurrojnë me njëri-tjetrin, në një shoqëri uni-funksionale.

Feminizmi, siç paraqitet në shoqërinë perëndimore, përgjithësisht ka mohuar çfarëdo diferencimi të tillë dhe ka kërkuar një lëvizje drejt një shoqërie uniseksuale, me qëllim që të arrihen të drejta të barabarta për gratë. Me "shoqëri uniseksuale", duam të themi një shoqëri, në të cilën parapëlqehet dhe respektohet një formë e vetme e roleve dhe e punëve, prej të dy gjinive dhe (ajo formë) synohet prej të gjithë anëtarëve të shoqërisë, pavarësisht prej dallimeve të moshës dhe të gjinisë.

Islami i ngriti gratë prej pozitës indiferente dhe përçmuese në atë të partnereve të barabartë në martesë me mashkullin. Prej një pozite të një mosqenieje ligjore, ajo u bë një personalitet ligjor në kuptimin e plotë të fjalës e aftë për të mbajtur pronën, me pasjen e së drejtës për të pasur pjesë të drejtë të pasurisë trashëguese të familjes dhe burrit të saj. Gruaja sipas Islamit mund të ketë një rol të barabartë me atë

të një burri, aq sa e lejojnë karakteristikat e saj të veçanta fizike.

Në fenë islame nuk ekziston koncepti i fajësisë së mëkatit fillestar mbi gratë. Larg prej idesë, se djalli e tundoi Evën, në rolin e saj si gruaja e parë, Kur'ani e vendos fajësinë për mosbindje në Parajsë si mbi Ademin ashtu edhe mbi gruan e tij. Ata të dy (Ademi dhe z. Hava) u penduan dhe kërkuan falje. Zoti i fali ata dy: (7:20-25; 20:121). Gjithashtu, gruaja është nëna e të gjithë burrave dhe roli i saj nuk përmban konotacione përbuzëse.⁴¹⁹

Gaudefroy-Demombynes

Përkrah opinionin se, nga pikëpamja e juridiksionit të gruas, e drejta islame qëndron më lart se ligjet e sotme evropiane.

“Dispozitat ligjore të Kur'anit, të cilat anojnë deri në fund nga ana e grave, edhe sikur të jenë vetëm sa për formë, Sheriati atyre u ka ofruar një status më të favorshëm, se ai që i ofrojnë ligjet e sotme të Evropës. Gruaja muslimane, sa i përket posedimit të pasurisë, gëzon të drejtën ligjore të pasurisë së veçantë. Me peshën që iu dha, ajo mund të zotërojë gjer në fund të jetës, mallra që do t'i kalojnë asaj si pajë, dhurata dhe trashëgim, si dhe të ardhurat e fituara prej punës së saj”.⁴²⁰

Anie Besant

“Islami është i pari që proklamoi lirinë (e femrës dhe skllëvërve), kurse Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] diti që me shembullin dhe zbatimin e Kur'anit, t'i vë ato në

⁴¹⁹ Lois Lamya al Faruqi, *Women Muslim Society and Islam*, Indianapolis, 1991, f. 25.

⁴²⁰ Ibid, f. 30.

jetë. Mes të tjerash, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sellem] është shprehur: *'Njeriu më i urryer është ai njeri, që e shet njeriun si skllav'.*"⁴²¹

"Për sa i përket çështjes së gruas, legjislatura islame është prej legjislatrave më të përparuara dhe më të drejta, të cilat kanë dalë në këtë botë. Legjislatura islame është shumë para legjislatrave perëndimore, sa i përket pasurisë së patundshme, të drejtave të trashëgimisë dhe ligjit të shkurorëzimit, ajo është mbrojtës i të drejtave të gruas. Frazat 'jetesa vetëm me një grua' dhe 'poligamia' i kanë tërbuar (mashtruar) njerëzit dhe i kanë kthyer kokat e tyre nga të menduarit rreth nënçmimit dhe mjerimit, në të cilin jetojnë zonjat perëndimore. Burrat e tyre të parë, të cilët ishin përgjegjës për mbrojtjen e tyre, i lanë rrugëve, pasi i kryen me ato nevojat e tyre, dhe u larguan nga ato për shkak mërzi dhe lodhjes, dhe për këtë pas kësaj nuk ndihmohen dhe as që mëshirohen"⁴²²

"Fati i femrës së tillë është i pakrahasueshëm me pozitën e femrës, e cila ka hyrë në martesë poligamiste të ligjshme dhe e cila, ndonëse e ndan burrin me një grua tjetër, e gëzon përkujdesjen e burrit, bëhet nënë në familje. Kur natën shoh mijëra e mijëra femra në rrugët tona, jam e bindur se Perëndimi duhet të mësojë nga Islami dhe duhet të ndërpresë të kritikojë Islamin në lidhje me poligaminë. Islami i mundëson gruas në martesën me shumë gra, të ketë burrë dhe fëmijë në prehër, në mënyrë legjitime dhe me të gjitha meritat. Kjo është shumë më e mirë, më e lumtur, më e respektuar dhe më dinjitoze për femrën sesa jeta e pasigurt dhe e rëndë në rrugë. Këto femra janë viktima të pasioneve të

⁴²¹ Dr. Fadlullah Ensar, op. cit., f. 42.

⁴²² Ebul Hasen Ali en Nadevij, op. cit., f. 32.

meshkujve. Ajo e bart fëmijën e vet jolegjitim, ndërsa ligji nuk e mbron aspak”.⁴²³

Profesor N. L. Coulsen

“Nuk ka dyshim se, normat ligjore kur’anore, që kanë të bëjnë me definimin e pozitës së gruas, e veçanërisht atyre të martuara, janë norma më të drejta dhe janë norma reale ligjore. Normat ligjore të kurorëzimit dhe shkurorëzimit, në masë të madhe, shikuar në përgjithësi, konsistojnë në përmirësimin e pozitës së grave në shoqëri dhe ngritjen e tyre. Ato bënë ndryshime revolucionare në zakonet arabe, të cilat dominonin para Islamit. Gruaja fitoi legjitimitet të pavarur, gjë që nuk e posedonte më parë. Ndërkaq, ndryshimin më të madh, të cilin e bëri Kur’ani, në parimet e shkurorëzimit, është vënia e ligjit të pritjes (iddetit) për të shkurorëzuarën”.⁴²⁴

Edward Montet

Profesor i gjuhëve orientale, në Universitetin e Gjenevës, në hyrjen e përkthimit të tij të Kur’anit, thotë:

“Reformat e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], arritën përparim të pamatshëm, prandaj e radhisin në mesin e mirëbërësve më të mëdhenj të njerëzimit. Një reformë e tij, e ajo është ndalesa e vrasjes së foshnjës femër të porsalindur, është e mjaftueshme që t’i sigurojë emër të paharrueshëm përgjithësisht, në histori”.⁴²⁵

⁴²³ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 180.

⁴²⁴ Ebul Hasen Ali En Nedevij, op. cit., f. 33.

⁴²⁵ *Dijalog islamskih i evropskih učenjaka*, op. cit., f. 120.

Doktori Gustav Le Bon

Shkruan: "Asgjë në Evropë nuk është kritikuar sikurse zakoni lindor i poligamisë. Evropa për asgjë tjetër nuk ka gabuar aq shumë, duke kritikuar institucionin e martesës me shumë gra. Është e sigurt, se martesa legale me shumë gra në Lindje, është më e ndershme nga prostitucioni i fshehtë apo publik i Perëndimit. Natyra e fshehur e marrëdhënieve ilegale i poshtëron të dy palët. Legalizimi i martesës me shumë gra, është më i mirë në çdo aspekt".⁴²⁶

Thomas W. Lippman

Gazetar çifut që ka punuar për tre vjet si shef i zyrës së gazetës "The Washington Post" në Kajro, në "Understatig Islam" New York, Mentor Books, 1990, për qëndrimin e Islamit ndaj gruas, shkruan:

"Në një shoqëri, në të cilën gruaja vlerësohej si pronë, që trajtohej si mall dhe që shpesh mbahej si e burgosur, Kur'ani vendosi rregulla dhe ndalesa që reduktuan keqtrajtimin e gruas, i dhanë asaj të drejtën e pronësisë dhe bënë që burrat t'i trajtojnë gratë me bujari dhe butësi... Rregullat e Kur'anit mbi statusin ligjor të gruas ishin të përparuara për kohën dhe ligji islam i jep gruas të drejta më çliruese se ato që gjenden në kodet hyjnore perëndimore... Kur'ani dhe Hadithi vendosin rregulla që i sigurojnë gruas respektin dhe dinjitetin që i ishte mohuar (para Islamit) dhe forcojnë qëndrueshmërinë e familjes".⁴²⁷

Paul Frindley

Për qëndrimin e Islamit ndaj femrës, thotë:

⁴²⁶ Topaloglu, op. cit., f. 42.

⁴²⁷ Paul Frindley, op. cit., f. 107-108.

"Islami përbën, mbase, ndikimin më çlirues për statusin e gruas në historinë e njerëzimit, duke lënë pas Krishterizmin dhe Judaizmin... Unë kur flas para një publiku të përgjithshëm, shpesh i filloj vërejtjet e mia duke bërë këtë pyetje: Në Islam, a trajtohen gratë si inferiore ndaj burrave? Gjithmonë marr një përgjigje pozitive ndaj kësaj pyetje. Në Amerikë, imazhi negativ i grave muslimane është rrënjësor thellë. Ky imazh është fryt i ndikimeve të ndryshme, si keqkuptimet, ndryshimet në rregulla që ekzistojnë mes vendeve muslimane, nganjëherë keqdashja, por, kryesisht padituria".⁴²⁸

⁴²⁸ Paul Frindley, op. cit., 107-108.

Ibrahim Huper

Drejtor i komunikimit në Këshillin për Marrëdhëniet Amerikano-Islame (CAIR) në Uashington, për propagandën antiislame, rreth qëndrimit të Islamit ndaj femrave, shkruan:

“Mbi 1400 vjet më parë, Islami zhduku diskriminimin e gruas, ndaloi praktikën paraislame të vrasjes së fëmijëve femra dhe u dha grave të drejtën e fitimit dhe pronës. Të drejta të tjera që i dha Islami gruas janë edhe e drejta e trashëgimisë, e drejta për të kërkuar divorcin dhe e drejta për të drejtuar një tregti”.⁴²⁹

Jules Le Boum

Shkruan: “Para Islamit arabët pinin shumë, luanin bixhoz dhe martoheshin me sa gra të donin dhe shkurorëzoheshin kur të donin. Gratë e veja kanë qenë pjesë e trashëgimisë së pasardhësve, të cilët kishin të drejtë të martoheshin me to, ose që t’i falnin ato. Këtë traditë Islami e ndaloi”.⁴³⁰

⁴²⁹ Paul Frindley. op. cit., f. 111.

⁴³⁰ Sejjid Muxhteba Musavi Llari, op. cit., f. 122.

KAPITULLI VII

PSE PRANOVA ISLAMIN

Muhammed Asad (Leopold Weis)

Ka lindur në vitin 1900 në Llavovë, e cila në atë kohë ishte pjesë e Austro-Hungarisë. Në moshën njëzet e dy vjeçare si korrespondent i gazetës "Frankfurter Zeitung" filloi udhëtimin e tij të gjatë nëpër vendet e ndryshme islame. Duke u njohur me parimet e Islamit dhe stilin e jetës në vendet muslimane, më 1926 ai e pranon Islamin. Tërë jetën ia kushtoi studimit të Islamit dhe merr pjesë në mënyrë aktive në shumë veprimtari. Pas themelimit të Pakistanit emërohet përfaqësues i saj në Kombet e Bashkuara. Më pas, tërhiqet nga kjo detyrë, në mënyrë që t'i shërbejë edhe më shumë Islamit dhe i përkushtohet veprimtarisë publicistike. Shkruan në gjuhën angleze, arabe dhe gjermane.

Ai thotë: "Islami më duket si vepër e përkryer arkitektonike. Të gjitha pjesët e tij janë të konceptuara harmonikisht, që ta plotësojnë dhe mbështesin njëra-tjetrën; asgjë s'është e tepërt dhe asgjë nuk mungon, që rezulton me baraspeshë dhe qetësi të përkryer. Mbase, pikërisht kjo ndjenjë, se çdo gjë në mësimet dhe postulatet e Islamit është në vendin e vet' më ka impresionuar tejet fuqishëm. Ka mundur krahas kësaj të ketë edhe mbresa të tjera që sot e kam vështirë t'i analizoj. Më në fund, kjo është çështje e dashurisë, kurse dashuria është më komplekse se shumë gjëra. Dëshirat dhe vetmia jonë, caqet tona të larta dhe mangësitë tona, fuqia jonë dhe dobësia jonë. Kështu ka qenë edhe me mua. Islami

ka hyrë tek unë heshtazi dhe fshehtazi, por përgjithmonë”.⁴³¹

Akademik prof. Italo Chuisi, (Muhammed Abdullah)

Është përkthyes i Kur'anit në gjuhën esperanto. Në këtë gjuhë ka shkruar veprën mbi Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe shumë studime mbi Islamin. Ka lindur më 13 maj 1919 në Trieste të Italisë. Në moshën njëzetvjeçare ka doktoruar shkencat matematikore. Ishte njohës i disa gjuhëve: gjermane, angleze, franceze, latine, spanjolle, esperanto dhe arabe. Brenda tetë muajsh, ka përkthyer Kur'anin në gjuhën esperanto. Evoluimin e tij fetar, dr. Chuisi e përshkruan si vijon:

“Para së gjithash, duhet të dini se në rini gjithnjë kam pasur ndjenja të thella fetare, por megjithatë, kurrë s’kam qenë i lumtur me mjedisin fetar. Veç të tjerash, edhe si matematikan, nuk mund të pranoja pa kritikë teorinë e Trinitetit, e cila paraqet mësimin bazë dhe dogmën e besimit kristian. Shpesh shtroja pyetjen, si është e mundshme që Zoti i Gjithëfuqishëm dhe Sovran është i detyruar që të jetë në Trinitet me origjinë të qartë njerëzore. Kurrë nuk i kam besuar dogmave progresive, të cilat mundohen që ta definojnë dhe përshkruajnë, rrjedhimisht me këtë edhe ta kufizojnë, madhësinë e Krijuesit. Këto janë karakteristika të qarta të fesë krishtere... Lexova disa libra dhe më pas fillova të lexoj Kur'anin. Në mënyrë që ta njihja sa më thellë bleva përkthimin e Kur'anit në gjuhën gjermane dhe italiane, por kjo nuk më kënaqi, prandaj me ndihmën e imamit (në një xhami në Frankfurt) fillova të mësoj gjuhën arabe. Në vitin 1966

⁴³¹ Muhammed Asad, *Rruga për në Mekë*, Shkup, 2003, f. 18. (Mendoj se është shumë me interes për lexuesin, që të lexohet ky libër i mrekullueshëm.)

vendosa të filloj përkthimin e Kur'anit. Atëherë pranimi i Islamit ishte bërë vetvetiu, sepse studimi i Kur'anit është i tillë, nga i cili nuk mund të tërhiqet askush, nëse e studion sinqerisht. Jam i sigurt se Kur'ani ka fuqinë për ta bindur çdo njeri, nëse Librit i afrohet pa paragjykime dhe në mënyrë dinjitoze. Qoftë i falënderuar pa masë All-llahu".

Në pyetjen e korrespondentit të gazetës "Heroldo de Esperanto", në gjuhën esperanto, thotë:

"Para së gjithash ju këshilloj që t'i ikni shprehjes "muhamedanët" kur mendoni të flisni për ithtarët e Islamit. Feja islame është rreptësisht dhe ekskluzivisht monoteiste, kurse Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është i pranuar si i Dërguar i Zotit, ai nuk është i shenjtë (mbinjerëzor) që duhet adhuruar. Muslimanët nuk parapëlqejnë shprehjen "muhamedanë", e cila është bërë shprehi në Perëndim, sepse sipas emërimit mund të mendohet se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] zë në Islam të njëjtin vend që zë Jezu Krishti në Krishterizëm. Mbi historinë e Kur'anit gjatë 1400 vjetëve do t'u sjell mendimin e orientalistëve, të cilët në këtë aspekt janë më autoritativë se unë si p.sh. Muir, i cili pa kurrfarë ngurrimi ka pohuar se Kur'ani i sotëm ka plotësisht tekstin e njëjtë, fjalitë e njëjta, si dhe fjalët dhe geramat identike, sikurse edhe para 1400 vjetëve. Nga ky këndvështrim, unë marrë guximin të theksoj se kemi të bëjmë me një fenomen unikal, sepse s'mund të përmend një libër tjetër, për të cilin do të mund të theksoja të njëjtin fenomen. Kur krahasohen botimet e ndryshme të të njëjtit libër, pas pak vjetësh ose dhjetë vjetësh, për shkak të përshkrimit, përkthimit dhe interpretimit, njëjtësia më nuk ekziston.

Besoj se pajtoheni që unë, në pyetjen tuaj se, a është Kur'ani vërtet shpallje e Zotit, apo diçka tjetër, të sjell mendimin e një personi tjetër. Bëhet fjalë për një mikun tim, prift katolik, jezuit me të cilin shkëmbejmë letra kohë pas kohe. Pak kohë

më parë i kam shkruar që të më njoftojë me qëndrimin e Kishës Katolike mbi të dërguarin Muhammed [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe a ekziston akoma mendimi sikurse në Mesjetë, se ai është i marrë, gënjeshtar ose diçka tjetër. Ai më është përgjigjur (citoj fjalë për fjalë letrën e tij): Është e mundshme, madje shumë e besueshme, që kontakti mes Zotit dhe Muhammedit të ketë qenë fakt i vërtetë”.⁴³²

Sir James Jeans

Shkencëtar i madh anglez.

Profesor Inajetullah, profesor i universitetit të Kembrixhit dhe njëri nga dijetarët më të mëdhenj të matematikës dhe fizikës në Indi, rrëfen: “Një ditë të diel, në vitin 1909, dola nga shtëpia për të kryer disa obligime familjare dhe papritmas takova astronomin e njohur Sir James, profesor në Kembrixh, duke shkuar në kishë. Ai mbante nën sqetull Biblën dhe ombrellën, edhe pse shiu binte rrëke. Iu ofrova dhe e përshëndeta. Ai nuk u përgjigj. E përshëndeta edhe një herë, atëherë më dëgjoi dhe më pyeti: Çfarë kërkon nga unë?

Dy gjëra zotëri - i thashë.

E para: Ombrellën e mban nën sqetull edhe pse bie shi. Ai buzëqeshi dhe e hapi menjëherë. E dyta, çka e shtynë një njeri me famë botërore si ju, të shkojë në kishë? U ndal një çast, e pastaj më tha, kërkoj nga ju që të më vizitoni në mbrëmje, gjatë kohës së çajit. Në mbrëmje, tamam në kohën e caktuar arrita në shtëpi të profesorit. Doli zonja James dhe më njoftoi se profesori më pret. Hyra brenda në dhomën e tij të punës. Para tij, ishte i vendosur çaji mbi një tavolinë të vogël, kurse ai ishte i thelluar në mendime.

⁴³² Kasim Haxhiq, *Akademik prof. Dr. Italo (Muhammed Abdullah) Chiussi*, Takvimi, Sarajevë, 1983. f. 249-257.

Kur e ndjeu praninë time, filloi të më ligjërojë rreth formimit të trupave qiellorë, funksionimit të tyre, largësisë, rrugës, rrotullimeve, gravitacionit, ndriçimit të tyre të ndryshëm. Mua më preku thellë fuqia e pakufishme e Zotit të madhërishtëm. Kurse, Sir Jamesit, i ishin ngritur flokët, lotët i pikonin dhe duart i dridheshin nga frika e Zotit. Papritmas, heshti një kohë, vazhdoi përsëri dhe më tha:

“O Inajetullah, kur i vështroj krijesat e madhërishtme të Zotit, trupi fillon të më dridhet nga madhështia e Zotit. Kur përulëm para Tij, i nënshtroar me të gjitha pjesët e trupit, them: Me të vërtetë, vetëm Ti je i Madhërishtëm. Atëherë ndiej qetësi dhe kënaqësi shpirtërore. Kjo është kënaqësia më e madhe që ndiej në jetë. Tash, a e ke të qartë, pse shkoj në kishë?

Zotëri, këto të vërteta shkencore më prekën mjaft, andaj më përkujtuan ajetin e Kur'anit Famëlartë, nëse dëshironi, mund t'ua lexoj. Ai luajti kokën në shenjë pohimi dhe më tha: Me gjithë kënaqësi. *“A nuk e sheh se All-llahu lëshon nga qielli ujë, e Ne nxjerrim me të fruta, ngjyra e të cilëve është e ndryshme, e edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza. Edhe nga njerëzit, nga gjallesat, nga kafshët po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Po All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët...”* (Fatir: 27-28)

Në atë çast Sir James, thërriti me zë: “Ç'the? All-llahut ia kanë frikën dijetarët? Mrekulli! Mrekulli! Një gjë të tillë e kam zbuluar gjatë studimit dhe hulumtimit pesëdhjetëvjeçar. Kush e ka njoftuar Muhammedin për këtë? A ekziston vërtetë ky ajet në Kur'an? Nëse është kështu, atëherë shkruaj se dëshmoj që Kur'ani është i shpallur nga Zoti.

Muhammedi ishte analfabet dhe ai vetë s'ka mundur ta zbulojë këtë. Zoti e ka njoftuar. Mrekulli! Mrekulli! Mrekulli!"⁴³³

Dr. Maurice Bucaille

Rreth pranimet të Islamit, thotë:

"Sikurse edhe francezët e tjerë, edhe unë Islamin e njihja si fe, të cilën e kishte themeluar Muhammedi gjenial. Pata fatin që si kirurg të takohem me pacientë muslimanë dhe të di më tepër për Islamin. Gradualisht, kur më janë cituar disa ajete nga Kur'ani fisnik, kam filluar të kuptoj se sa pak dija mbi Islamin, ndërkohë që një numër lajthitjesh vijnë edhe nga shtypi, televizioni, dhe rrugë të tjera të zakonshme. Kjo ishte rreth vitit 1926, kur dialogu i muslimanëve dhe i të krishterëve ishte akoma mundësi e largët.

E kuptova se më duhej t'i qasem studimit të Kur'anit drejt-përsëdrejti, kështu që dy vjet e studiova literaturën dhe gjuhën arabe, gjë që më lehtësoi leximin e origjinalit. Shpejt, pas kësaj, e kuptova se Kur'ani është libër i Zotit dhe se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është i Dërguari i Tij i fundit".⁴³⁴

Dr. Murad Hofmann

Ish-ambasador gjerman, në Marok, shkrimtar dhe doktor i shkencave juridike, nga Havardi. E pranoi Islamin më 25 shtator, të vitit 1980.

"Para fundit të jetës, i Dërguari i Islamit, u dërgoi mesazhe sunduesve fqinjë – Nexhashiut, në Abisini, Kajserit II (590-

⁴³³ *Pse e pranoi Islamin z. James Jeans*, Hëna e Re, Shkup, 15 korrik, 1993. f. 6.

⁴³⁴ Shkëlqimi Islam, Botim i Bashkimit të Rinisë Islamike Shqiptare, (Tiranë), v. V, nr. 1, pa vit botimi.

628), në Persi dhe perandorit lindor-romak, Heraklitit (610-641). Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i thirri me fjalë të thjeshta dhe të pa dyshimta që ta pranojnë Islamin, për të mirën e tyre personale dhe të mirën e popujve të tyre. Ky episod, në historinë diplomatike shënon fillimin e marrëdhënieve zyrtare, ndërmjet Islamit dhe Perëndimit, - raporte, të cilat, për 1400 vjet, asnjëherë nuk u ndërpre, e as që ndonjëherë përjetuan relaksim dhe krahas shumë kontakteve të frytshme ekonomike dhe intelektuale, gjithmonë kanë qenë të natyrës konfrontuese.

Zhvillimi historik, sidomos suksesi dhe të arriturat e ekspansionit të hershëm islam, sqaron shumë. Duke pasur parasysh këto suksese, është e kuptueshme se pse Perëndimi, edhe më tej përqendrohet në paraqitjen e Islamit si fe agresive, që duhet t'i falënderohet 'zjarrit dhe shpatës' për ekspansionin e vet. Është e saktë se, nga pikëpamja ushtarake, rajonet e krishtera dhe iraniane ishin të pafuqishme, që t'i kundërvihen guximit dhe vrullit fetar të muslimanëve të parë, por gjithashtu, është e saktë edhe ajo, se një numër i vogël i luftëtarëve muslimanë, nuk do të kishte mundësi, të merrnin rajone aq të mëdha, sikur populli i atyre vendeve, të mos u bashkëngjitej masovikisht dhe në numër më të madh.

Të krishterët heterodoksë në Magreb dhe Lindje, duke inkadruar edhe arianët dhe donatistët, pranuan mësimin islam, sepse ata nuk besonin, as në natyrën hyjnore të Jezusit (Isait [alejhis-selam]), e as në Trinitet. Në shekullin e njëmbëdhjetë, Islami u përhap deri në Senegal, Mali dhe Çad, pa zjarr e pa shpatë, e edhe sot e kësaj dite, qetë, përhapet përgjatë tërë Afrikës".⁴³⁵

⁴³⁵ Dr. Murad Hofmann, op. cit., f. 13-14.

Christian Hoffman

Jeton në Bon dhe punon si referent shtypi në CDU, në "Konrad Adenauer Haus" (Unioni Demokristian). Ai tregon:

"Jam lindur në Berlin, jam rritur në Hamburg dhe në Munih. Jam shkolluar në Londër dhe jetoj i lumtur, në një familje shumë të mirë, me xhaxha, dajë, teze, me shokë, me punë që më jep kënaqësi, me zgjedhjen e profesionit sipas dëshirës, me të ardhura të mira, jam njeri i kënaqur dhe i lumtur. Rreth kalimit të tij në Islam, ai thotë:

"Më goditi si vetëtimë prej qiellit! Asnjëherë nuk do ta harroj atë mesditë të ngrohtë janari të vitit 1988. Isha ulur në ballkonin e shtëpisë së familjes sime dhe shikoja gjelbërimin e parë pranveror, në kopsht. Lexoja një libër, për rikthimin e Iranit, në Islam...

Menjëherë dhe papritmas, m'u duk sikur dielli, në qiellin e kaltër të kristaltë, u shndërrua në rrufe, me një shkëlqim të pabesueshëm, dhe gjatë kësaj përpëlitje, syri njohu se: Ekziston vetëm një Zot, All-llahu, ndërsa Islami është religjioni i fundit i shpallur prej Tij! ...U mbusha me një ndjenjë të çuditshme, ndjenjë, të cilën më vonë e gjeta të shkruar në Kur'an: *"Atë që All-llahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) Islamin..."* (El-En'am: 125)

Isha aq i munduar, saqë nuk munda ta vazhdoj më leximin. Në vend të leximit, shkova në dhomën e ndejës, që në një fjalor të fjalëve të huaja, të kërkoj shprehjen, Islam. Lexova disa rreshta, por ato nuk më dhanë aq shumë njohuri, prandaj, ditën e nesërme, pas orarit të punës, shkova në librari dhe bleva librin tim të parë për Islamin...

Sa më shumë që njihja Islamin, aq më shumë paraqitej edhe një dëshirë më e madhe tek unë, që ta vazhdoj njohjen time të mjegulluar dhe të dëshmoj pranimin e Islamit dhe të bëhem musliman.

Ndërmarrja ime, që ta studioj Kur'anin, u tregua shumë e vështirë. Nëpërmjet një përkthimi shumë të dobët, siç e di sot, përveç kësaj edhe pa sqarime, - shumë gjëra, nga ai, më ngelën absolutisht të paqarta. Por, përsëri, më këmbëngulje, e lexova prej fillimit deri në suren e 112, sure, në të cilën e gjeta thënien, e cila për mua është porosia qendrore e Islamit. Për mua, kjo sure, është përshkrimi më i mirë dhe më burimor i monoteizmit, gjë, të cilën duke mos e ditur, në realitet, e kam kërkuar gjatë tërë jetës. Leximi i kësaj sureje, definitivisht, e ngriti perden mes meje dhe Islamit. Një ditë të nxehtë të muajit mars, shkova dhe para shumë dëshmitarëve, deklarova hyrjen time në Islam: Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër, përveç All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi, është rob dhe i Dërguari i Tij".⁴³⁶

Jacque Yves Cousteau (Zhak Kusto)

Ishte oficer i marinës franceze. Ka lindur më 1910, në Sant Andrea de Kuzbak. Nëpërmjet hulumtimeve të tij, të bëra me anijen 'Kalipso', u bë oqeanografi më i njohur i botës, për kohën tonë. Më parë ishte katolik, tani është musliman.

Një ditë, diku në thellësinë e oqeanit, Costeau ishte duke vëzhguar. Papritmas, konstatoi se, në ujin e kripur të detit, kishte disa burime uji të ëmbël (të pijshëm). Ajo që e mahniti atë më tepër ishte se uji i ëmbël i burimeve në det, nuk përzihej me ujin e kripur të detit. Për një kohë të gjatë, u përpoq të gjejë shkakun e natyrës së këtij fenomeni, por pa dobi. Një ditë, kur ia kujtoi atë mikut të tij, profesor Maurice Bucaille, i cili qysh më parë ishte bërë musliman, profesot

⁴³⁶ Christian H. Hoffman, *I shtrirë nga të gjitha anët, (një gjerman bëhet musliman)*, Tetovë, 2003. f. 17-18.

Bucaille, i tregoi se kjo dukuri s'është e re dhe se kjo gjë është shpjeguar në Kur'anin e Shenjtë, para katërmbëdhjetë shekujsh, në këto ajete:

"Ai la të lirë të bashkohen dy dete, ky (njëri) i pijshëm e i shijshëm, e ky (tjetri) i njelmët e i idhët, e mes tyre bëri si të jetë ndonjë pendë, pritë që të mos përzihen". (El-Furkan: 53), dhe:

"Ai i lejoi dy detet të puqen ndërmjet vete. Ndërmjet atyre të dyve është një pengues që ata të dy nuk e kapërcejnë". (Er-Rahman: 19-20)

Në fund të kërkimeve, Costeau pa se si masa ujore, ashtu edhe veçoritë, si të Detit të Bardhë, ashtu edhe të Oqeanit Atlantik ishin të ndryshme nga njëra tjetra. Sipas fakteve, përderisa, këto dy masa ujore, bashkohen në Ngushticën e Gjibraltarit, përqindja e kripës dhe dendësia e tyre duhej të ishin të barabarta. Por një gjë e tillë nuk ndodhte. Pra, ujërat nuk po përziheshin me njëri-tjetrin. Si përfundim i kërkimeve të bëra, doli në pah se, ekzistonte një pengesë e mahnitshme ujore, që pengonte përzierjen e ujërave njëri me tjetrin".⁴³⁷

Roy Earl Johnson

Tregon: "Jam me origjinë amerikane dhe fëmijërinë e kam kaluar në besimin kristian. Para se unë të pohoja rezultatin e kërkimeve dhe studimeve në shpirtin tim për Zotin (për Allahun), unë kisha përvetësuar shumë njohuri të rëndësishme. Pas shumë studimesh, leximesh, dhe rileximesh të shkrimeve, në librin 'Dialogu: Kristiani-dhe Muslimani' dhe krahasimit të tyre, në mes të 'Bibla e shenjtë, versioni i

⁴³⁷ Shih Zhak Kusto, Drita islame, Tiranë, janar, 1994, nr. 45, f.4; Ismail Muçaj, Madhështia e Kur'anit i bindi shkencëtarët anglezë, francezë e tajlandezë të përqafojnë Islamin, Drita Islame, Tiranë, Prill 1996, f. 1.

Mbretit Xhejms' dhe 'Kur'ani i Lavdishëm', përfundimisht deklarova Shehadetin në anglisht, pastaj në arabisht:

'Unë dëshmoj dhe vërtetoj, se nuk ka Zot tjetër, përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari dhe robi i Tij. Esh'hedu en la ilahe ilall-llah ve esh'hedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu'.

Përmes kësaj deklarate të thjeshtë dhe fundamentale islame, unë besoj se shumë njerëz do t'i nënshtrohen All-llahut, me besim të vërtetë, në shpirtrat e tyre. Unë shpresoj, gjithashtu, se ky libër modest (Dialogu: Kristiani dhe Muslimani), do të lexohet në mbarë botën dhe do të tërheqë vëmendjen e atyre, që kërkojnë besimin e vërtetë, besim, në të cilin shpirti i tyre do të gjejë prehje dhe kënaqësi".⁴³⁸

Malcom X

Është njëri nga liderët më të mëdhenj të zezakëve amerikanë, i cili pasi pranon Islamin punon me të madhe në përhapjen e Islamit në Amerikë. Duke parë numrin e madh të njerëzve që shkonin pas tij, dhe se me mijëra njerëz kishin filluar të pranojnë Islamin, si rezultat i ligjëratave të tij të mrekullueshme, ai vritet. Për përvojën e tij gjatë haxhxit, thotë:

"Atje, në Qabe, kishin ardhur qindra mijëra muslimanë, nga të gjitha anët e botës. Ata i përkisnin të gjitha racave dhe ngjyrave, duke filluar nga flokëverdhet me sy të kaltër, e deri tek afrikanët, me lëkurë të zezë. Por, që të gjithë, morën pjesë në të njëjtat dispozita, duke shprehur një frymë bashkimi, gjë që përvoja ime në Amerikë, më kishte bërë të besoj se një gjë e tillë, në mes të bardhëve e zezakëve, s'mund të ndodhte kurrë.

⁴³⁸ Hasan Baxhi, *Dialogu Kristiani dhe Muslimani*, Tiranë, 1993. f. 3.

Ndoshta, njerëzit do të çuditen nga këto fjalë. Por, atë që pashë dhe përjetova gjatë haxhxit, më bënë t'i ndryshoj mendimet e mia të mëparshme dhe të braktisja disa nga qëndrimet, në të cilat këmbëngulja në të kaluarën, gjë, e cila, s'qe shumë e vështirë për mua. Me gjithë bindjet e mia të paluhatshme, unë, gjithmonë, kam qenë i gatshëm të ballafaqohem me faktet dhe të pranoj të vërtetën e zbuluar përmes dijes dhe përvojave të reja...

Gjatë njëmbëdhjetë ditëve të fundit, që kalova në botën muslimane, i jam lutur të njëjtit Zot, kam ngrënë nga e njëjta pjatë, kam pirë ujë prej të njëjtës gotë dhe jam shtrirë në të njëjtin shtrat, apo qilim, me muslimanë me sy nga më të kaltër, me flokë ndër më të verdhat dhe me lëkurë ndër më të bardhat. Në fjalët, sjelljet dhe veprat e muslimanëve të bardhë, unë pashë e ndjeva të njëjtën përzemërsi, që e ndjeva në mes zezakëve afrikanë të Nigerisë, Sudanit, ose Ganës. Ne ishim, vërtet, të gjithë njësoj, vëllezër!"⁴³⁹

Margaret Marcus

Me prejardhje gjermano-hebraike. Pas një studimi të gjatë, ajo përqafoi Islamin, në Bruklin të Nju Jorkut dhe e ndërroi emrin në Merjem Xhemile. Ajo thotë:

"Rregullat dhe ligjet në Islam janë të natyrshme, ato burimin e tyre e kanë te Zoti. Kënaqësia dhe lumturia në Islam janë të natyrshme dhe rezultat i kënaqësisë emocionale të zbatimit të detyrave dhe obligimeve të kryera në mënyrë koshiente ndaj Zotit, me qëllim që të arrihet shpëtimi.

Vetëm, në Islam, arrita të gjej përgjigje të kënaqshme për vlerat absolute, që kisha kërkuar pareshtur.

⁴³⁹ Abdul Vehid Hamid, *Islamizmi rruga e natyrshme*, pa vit botimi, f. 170.

Vetëm, në Islam, arrita të gjej të Vërtetën, të mirën dhe të bukuren që e bëjnë jetën dhe vdekjen kuptimplote”.⁴⁴⁰

Sir Rowland George Alanson

Burrështeti anglez, gazetar dhe autor librash.

“Mundet, që disa nga shokët e mi të mendojnë se jam ndikuar nga muslimanët, për të pranuar Islamin! Por, nuk është ky shkaku, sepse bindjet e mia, tani, janë vetëm përfundim i shumë viteve mendimesh. Bisedat me muslimanët e shkolluar, rreth fesë, i kam filluar vetëm pak javë përpara. Duhet të them publikisht, se jam shumë i gëzuar dhe i kënaqur, që më në fund gjeta zgjidhjen e shumë pyetjeve, ku të gjitha teoritë e konkluzionet janë plotësisht në pajtim me Islamin.

Konvertimi në Islam, sipas Kur’anit, duhet të rezultojë si pasojë e vullnetit të përzgjedhjes së lirë të njeriut dhe assesi me detyrim, ose me forma indirekte mashtruese.

Kam njohur shumë protestantë të zellshëm, që i kanë vënë për detyrë vetes të vizitojnë vendet katolike, me qëllim që t’i konvertojnë ata në fenë protestante...

Më vjen shumë keq, kur mendoj se edhe misionarët kristianë, janë përpjekur dhe kanë përdorur gjithfarë metodash kundër muslimanëve... Kam marrë një letër nga disa persona, pasi kam pranuar Islamin, ata më thoshin se nëse nuk vazhdoj të besoj në hyjninë e Krishtit, unë nuk do të shpëtoj në jetën pas vdekjes. Por, po të kisha dyshim në misionin pejgamberik, që Zoti ia ka besuar Krishtit, do të më shqetësonte shumë... Falënderoj All-llahun, që nuk vuaj nga një e keqe e tillë...

⁴⁴⁰ Ishte shpata që e përhapri fenë islame apo e vërteta e saj, Drita Islame, Tiranë, qershor, 1996, nr 11 (94), 1. Më gjerësisht lexo librin: *Letërkëmbimi mes Merjem Xhemiles dhe el Mevdudit*, Shkup, 1992.

Ka mijëra burra e gra, që me shpirt e zemër janë muslimanë, por nga frika e komenteve të kundërta, me qëllim që të evitojnë çdo shqetësim nga opinioni publik, ata stepen dhe nuk marrin guximin të pranojnë faktet.

Unë e mora këtë hap, megjithëse e di që të afërmit e mi, tani e tutje do të më kundrojnë si njeri që e kam humbur shpirtin... E konsideroj veten, me qëndrimin që kam marrë, një kristian shumë më të mirë, se sa isha më parë. Mund të shpjegoj, se edhe të tjerë, do të ndjekin shembullin tim.

Besoj, ndershmërisht, se hapi im është i mirë dhe do t'i sjellë lumturi, çdo njeriu, i cili do ta respektojë atë, e që në të vërtetë, një hap i tillë, nuk është aspak armiqësor, ndaj Kristianizmit të vërtetë".⁴⁴¹

Ibrahim Halil Ahmed

Prift misionar, nga Aleksandria. Ka marrë shumë diploma nga Fakulteti Teologjik, në Egjipt dhe nga Universiteti Boston, në SHBA. Më 1954, ishte sekretar i delegacionit gjermano-zviceran. Misioni i tij ishte që t'i konvertonte muslimanët në të krishterë dhe të vepronte kundër Islamit. Por, studimi i thellë e shtyri që të pranojë Islamin, gjë të cilën e publikoi botërisht, në vitin 1959. Ka shkruar shumë libra, në mes të cilave edhe: "Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në Teurat dhe Ungjill", "Historia e Beni Israilëve", "Orientalistët dhe misionarët në botën arabe dhe islame", etj. Ai thotë:

"Ky Pejgamber është i lidhur me mrekullinë e përhershme, për çka ka paralajmëruar edhe Mesihu, Isai [alejhis-salam] në thënien e tij për të: 'dhe do t'iu njoftoj për gjërat e

⁴⁴¹ Haxhi Lord Headley El Faruk, Drita Islame, Tiranë, shkurt, 1995. nr. 63. f. 4.

ardhshme'. Ajo mrekulli është Kur'ani Famëlartë, mrekullia e amshueshme e Pejgamberit, për jetë të jetëve.

Kur'ani fisnik i ka paraprirë shkencave bashkëkohore, në të gjitha fushat si në: mjekësi, astronomi, gjeografi, gjeologji, legjislacion, psikologji, histori etj.

Në ditët tona, shkenca po arrin të zbulojë atë që ka përmendur Kur'ani fisnik, para më shumë se 14 shekujsh.

E them me bindje të plotë se sikur të isha një ekzistencialist... që nuk beson profetësinë qiellore dhe të vinte një grup njerëzish e të më flisnin për atë, me çka i ka paraprirë Kur'ani shkencave të ndryshme në të gjitha fushat, do të besoja Zotin e Madhërishëm dhe të Lartësuar, Krijuesin e qiejve dhe të Tokës, dhe Atij nuk do t'ia shoqëroja askënd.

Në këtë humbëtirë të tmerrshme, o i krishterë, Pejgamberit të All-llahut i zbriti Kur'ani i Shenjtë, që të të tregojë për All-llahun e Madhërishëm.

Muslimani duhet të krenohet me Kur'anin e tij fisnik, sepse ai është sikurse uji, që është jetë dhe që gjallëron secilin që dëshiron të largojë etjen përmes tij".⁴⁴²

⁴⁴² Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 49.

A. Ali David

Rrjedh prej një familje që besonte Brahmanizmin. Nëpërmjet misionarëve të krishterë, të cilët së bashku me kolonialistët kishin arritur në Indi, pranon Krishterizmin. Lexon shumë dhe kur i jepet rasti të lexojë Kur'anin e Shenjtë e kupton të vërtetën, braktis krishterizmin dhe pranon Islamin. Ai tregon:

“Mora një kopje nga përkthimi i Kur'anit në gjuhën angleze. Gjatë leximit mësova se Kur'ani është libër i shenjtë për muslimanët. Fillova të lexoj dhe të meditoj rreth kaptinave kur'anore. Ai e rrëmbeu gjithë vëmendjen time. U mrekullova kur, që në faqet e para të Kur'anit fisnik, gjeta përgjigje bindëse për pyetjen time rreth qëllimit të krijimit. Kjo pyetje më shqetësonte vazhdimisht. Kam lexuar ajetet 30- 39 nga kaptina e dytë, *El- Bekare*. Këto ajete, ia sqarojnë çdo studiuesi objektiv, qartë, të vërtetën.

Studimi i Kur'anit fisnik, më ka zgjidhur shumë dilema mendore dhe më ka sqaruar shumë kontradikta, që i kam hasur në librat e më hershëm qiellorë”.⁴⁴³

W. B. Beckard

Autor dhe shkrimtar anglez. Ka marrë pjesë në Luftën e Parë Botërore dhe është zënë skllav. Një kohë ka punuar në Ugandë. Më 1922 pranon Islamin. Ka shkruar librin “Aventurat e Kasimit”, “Bota e Re”, etj.

“Kam veçuar nga kopja e domethënies së Kur'anit të përkthyer nga Savary në gjuhën franceze, e cila është gjëja ime më e shtrenjtë që posedoj. Nga leximi i tij kam përjetuar kënaqësinë më të madhe dhe jam gëzuar shumë, sa që kur

⁴⁴³ Ibid, f. 59.

jam ngrysur, më është dukur, sikur rrezet e së Vërtetës së Amshueshme më kanë ndriçuar me dritën e saj të bekuar”.⁴⁴⁴

D. Potter

Ka lindur në Miçigan të Amerikës, ka mbaruar gazetarinë, në Universitetin e Miçiganit. Pasi bindet se s’ka fe tjetër, që i përgjigjet kërkesave të dy gjinive, mashkullit ose femrës, ajo pranon Islamin.

“Kur e përfundova Kur’anin fisnik më kaploi një ndjenjë, e cila më bëri të kuptoj se ai është i vetmi, i cili përmban përgjigjet e duhura rreth krijimit dhe çështjeve të tjera. Ai na paraqet ngjarjet në mënyrë logjike, ndërkaq ne ato i gjejmë të përshkruara në mënyrë kontradiktore te librat e tjerë fetarë.

Kur’ani na flet rreth ngjarjeve në mënyrë të mrekullueshme dhe me metoda rigoroze, dhe s’mund të kontestohet vërtetësia e tyre dhe të qenit e tij fjalë e Zotit.

Përmbajtja hyjnore e Kur’anit fisnik, është gjenerator i lartësimit dhe udhëzimit të njeriut, në njohjen e krijesave, njohje e cila është e përshtatshme për çdo kohë.

Si mundet që Muhammedi analfabet, i cili u rrit, madje në një mjedis injorant, të arrijë t’i njohë mrekullitë e Universit, që përshkruhen në Kur’anin fisnik. Këto mrekulli, shkenca bashkëkohore, po vazhdon t’i zbulojë edhe sot e kësaj dite. Prandaj, s’ka dyshim se, Kur’ani është fjalë e All-llahut të Madhërishëm”.⁴⁴⁵

⁴⁴⁴ Ibid, f. 57.

⁴⁴⁵ Ibid, f. 55.

Dr. Bogdan Kopanski (Ataullah Kopanski)

Fillimisht polak, tani amerikan. Doktor në histori dhe politikë. Dy herë është burgosur nga regjimi komunist polak. Në vitin 1974, pranoi Islamin.

“Kur isha 12 vjeç, nuk pranova besimin e paarsyeshëm dhe kontradiktor të kishës. Dy vjet më vonë, më 1962, u magjepsa nga lufta fitimtare e muslimanëve algjerianë muxhahidinë kundër kolonizimit francez. Kjo ishte ‘shigjeta’ e parë e Islamit... Në shkollë të lartë, në ditët e para të edukimit tim në universitet, isha shembull tipik i ‘brezit kryengritës’ të të Kuqve... Rruga ime, për tek e vërteta e Kur’anit, ishte e ngadalshme dhe e hapur. Në vitin 1974, vizitova Turqinë, ku shkrova disertacionin tim M. A. Për Sulltanin dhe Politikën e halifit Sulejman në drejtim të mbretërisë polake. Atje, u godita, nga zëri më i bukur i njerëzimit, nga ezani, thirrja për lutje. Flokët m’u ngritën përpjetë. Një forcë e plotfuqishme, e panjohur, më udhëhoqi për te Xhamia e Vjetër, në Stamboll. Atje, turqit e vjetër, me buzëqeshjen e tyre, më mësuën. Pranova me lot Shehadetin dhe fala namazin tim të parë. Flaka tutje doktrinat ideologjike. Për herë të parë në jetën time, mendja më ishte lehtësuar dhe në zemrën time, ndjeva kënaqësinë e dashurisë së All-llahut. Isha një musliman”.⁴⁴⁶

Viecheslav Kolosin

Kryeprift i ipeshkvisë Kaluga. Ai ka diplomuar në akademinë diplomatike të Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe mbrojti disertacionin e tij me temën: ‘Kisha Ortodokse Ruse dhe shteti në Bashkimin Sovjetik, 1971-91’. Ai është autor i

⁴⁴⁶ Pamfleti: *Shpata e Islamit*.

shumë punimeve shkencore nga lëmi i historisë, politikës, religjionit dhe filozofisë. Ai thotë:

“Vendosa ta sjell statusin tim social, në një vijë me bindjet e mia dhe të dëshmoj publikisht se e konsideroj veten pjesëtar të një tradite të madhe të besimit të vërtetë të pejgamberëve të monoteizmit, duke filluar me Ibrahimin [alejhis-selam]. Këtë e bëj duke mos e konsideruar veten si prift, apo si anëtar i ndonjë kishe ortodokse. Unë besoj se Kur’ani është shpallja e fundit në Tokë, i cili i është shpallur Pejgamberit Muhammed [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut dhe Muhammedi është i dërguari i Tij”.⁴⁴⁷

F. Montague

Studiues francez, ka shkruar me dhjetëra studime dhe libra për Islamin. Në verë të vitit 1977, shpall botërisht pranimin e fesë islame.

“Unë nuk dyshoj, për asnjë çast, në pejgamberinë e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Besoj se ai ishte vulë e lajmëtarëve dhe të dërguarve të All-llahut, që ishte dërguar për mbarë njerëzimin. Shpallja e tij, ka ardhur për të përmbyllur revelatat e mëparshme, Teuratin dhe Ungjillin.

Argumenti më i mirë për këtë, është Kur’ani mrekulli. Unë e refuzoj mendimin e Paskalit, urryes i Islamit dhe muslimanëve, përveç një mendimi të tij se: Kur’ani nuk është vepër e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ashtu sikurse edhe Ungjilli nuk është vepër e Mateut. Shembulli i mendimit arab dhe i muslimanëve është sikurse shembulli i atij njeriu, i cili mundohet të largohet nga gjaku i tij”.⁴⁴⁸

⁴⁴⁷ Kryeprihti Rus Viecheslav Kolosin, ka pranuar Islamin, *Vepër, Shkup*, nëntor, 2001, nr. 45, f. 25

⁴⁴⁸ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 88.

Hatem Hourì

Gazetar libanez, nga Bejruti, pronar i një agjencie lajmesh. “Arsyeja kryesore që më shtyri të pranoj fenë islame, janë vlerat e larta të Islamit, të cilat të udhëzojnë në rrugën e Zotit, në rrugën e përpjekjeve për liri dhe drejtësi. Kam qenë i krishterë, por kur kuptova se Krishterizmi shërben si mbulesë e kryqëzatave të reja, për kolonializimin dhe shfrytëzimin e popujve, sikurse është edhe qëllimi i sionistëve, deklarova me gojë dhe shkrim pranimin e fesë islame”. Në deklaratën, me shkrim, ai shkroi: “Jam besimtar i fesë islame dhe i Mesazhit të Pejgamberit, Muhammedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] vula e të gjithë pejgamberëve. Deklaroj se e pranoj Islamin. Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër, përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij dhe se feja e vërtetë, te Zoti, është feja islame”.⁴⁴⁹

R. Mary Howe

Gazetare angleze. U rrit në një familje fetare krishtere. Më vonë, humbi bindjen e saj fetare. Filloi të kërkoj një fe, e cila do t’i ofronte përgjigje të duhura. Në vitin 1977, deklaroi pranimin e Islamit dhe mori emrin Merjem. Tani punon në gazetën kuvajtiane, *Arab Times*, që botohet në gjuhën angleze. Ajo thotë: “Në Islam, kam gjetur përgjigjet e duhura, që kanë të bëjnë me shpirtin dhe trupin. Kam mësuar se ndaj trupit kemi obligime të njëjta, sikurse ndaj shpirtit. Nevojat trupore, sipas këndvështrimit islam, janë instinkte të natyrshme, të cilat meritojnë të plotësohen dhe ato nuk konsiderohen të

⁴⁴⁹ Mexhid Yveysi, *Mijëra francezë pranuan Islamin*, Dituria islame, Prishtinë, 1992. nr. 35. f. 32.

dëmshme dhe të neveritshme. Madje, është e domosdoshme që njeriu t'i plotësojë ato, në mënyrë që të jetë i fortë dhe produktiv. Mirëpo, Islami ka vendosur rregulla për plotësimin e këtyre instinkteve në baza të shëndosha, të cilat kënaqin nefsën e njeriut, duke iu përmbajtur urdhrave të Allahut. Për shembull, martesë në Islam është mënyra e vetme legjitime për plotësimin e instinkteve seksuale. Namazi, agjërimi dhe adhurimi janë mjete të tjera, për plotësimin dhe ushqimin e anës shpirtërore të njeriut. Kështu plotësohet ekuilibri, i cili është i domosdoshëm për një jetë të ndershme njerëzore. U bëra muslimane, pasi që u binda plotësisht për fenë islame. Dua të shtoj në këtë rast, se në zbatimin e mësimëve të fesë islame, njeriu zbulon natyrën e tij njerëzore dhe personalitetin e tij të vërtetë, pra ai arrin të njohë vetveten. Vërtet, feja islame është feja e vetme, e cila mi ofroi përgjigjet bindëse për pyetjet e mia që më ngacmonin vazhdimisht".⁴⁵⁰

Vengatachalam Adiyar (Abdullah Adijar)

Me shtetësi indiane, është shkrimtar i njohur tamil, njëkohësisht fitues i çmimit të lartë të vendit, në art.

"Në Islam gjeta përgjigje të përshtatshme, për të larguar dyshimet që lindnin në mendjen time, rreth pyetjeve që kanë të bëjnë me teorinë e krijimit, statusin e gruas, krijimin e universit, etj. Jeta dhe historia e Pejgamberit Muhammed [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] më impresionoi shumë dhe më lehtësoi punën, që të kuptoja ndryshimet, në mes Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe udhëheqësve të tjerë, dhe filozofive të tyre".⁴⁵¹

⁴⁵⁰ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 250.

⁴⁵¹ Pamfleti: *Shpata e Islamit*. Drita Islame, Tiranë, 1996. qershor, viti V. nr. 11 (94), f. 4..

Michel Jensen

Tregon: “Unë i kam rrënjët e thella, në Amerikë. Disa prej të parëve të babait tim, kanë emigruar në koloninë britanike, që në vitin 1609, ndërsa, disa prej të parëve të nënës sime, kanë luftuar krah për krah me George Washingtonin dhe Abraham Linkolnin. Një prej stërgjyshërve të mi, ka punuar si kalorës i postës së re ‘Pony expres’. Deri në moshën gjash-tëmbëdhjetë vjeçare, prindërit janë munduar të më japin edukatë, që përgjithësisht konsiderohet si tipike amerikane dhe protestante. Kam lindur dhe jam rritur në qytetin Bay City, të shtetit Miçigan. Kam qenë anëtar i famullisë së kishës episkopale. Çdo të diel, kam shkuar në shkollën fetare dhe kam marrë pjesë në korin e kishës.

Mirëpo, kur arrita në moshën 16 vjeçare, për herë të parë, më ra në dorë Kur’ani. Fjalët e thjeshta dhe plotësisht të qarta të kapitullit *El-Fatila*, të Kur’anit, më lanë përshtypje të thella, sa që fillova t’i mësoj përmendësh. Ato, më tërhoqën shumë dhe më shtynë, që të përqafojë fenë islame, gjë që vërteton thënien e Pejgamberit, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] se të gjithë njerëzit lindin muslimanë, por janë prindërit apo rrethi shoqëror, që më vonë, i tjetërsojnë ata, në çifutë ose në të krishterë, etj. Që nga ajo ditë, unë jam përpjekur të jetoj me mendje dhe zemër i drejtuar kah Mekka, drejt Qabes. Para se të shkoja në haxh, të gjitha dispozitat e haxhshit, ashtu si dhe disa dispozita dhe obligime të tjera më dukeshin të çuditshme. Por, kur e bëra vetë atë udhëtim të paharruar, kuptimi i dispozitave të haxhshit u bë i qartë, si dhe dituritë e mia, mbi atë se çdo të thotë të jesh musliman, u zgjeruan dhe u thelluan edhe më shumë. Prandaj, unë mendoj se kjo është arsyeja, pse All-llahu e urdhëroi Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-

lem] që t'u bëjë thirrje besimtarëve muslimanë, për ta përmbushur detyrën e shenjtë të haxhxit".⁴⁵²

Edison Mishel (Muhammed Abdusselam)

Prift në Haiti. Në vitin 1973, ai e pranoi Islamin. Më vonë, e kreu edhe obligimin e haxhxit. Ai zgjodhi misionin e thirrjes në fenë islame. Ndërsa deri dje, ua mësonte të tjerëve Krishterizmin, sot, ai u mëson Islamin. Ai ndërroi edhe emrin dhe tani quhet Muhammed Abdusselam. Kohët e fundit, duke dëgjuar ligjëratat e tij, pranuan Islamin mbi 150 banorë të Haitit".⁴⁵³

Joseph Amado (Ahmed Jusuf)

Prift katolik, ka shërbyer në Kishën 'The New Papal Church of Kenema', në Siera Leone. Së bashku, me dymbëdhjetë anëtarët e familjes së tij, e pranoi Islamin. Amado, para se të bëhej musliman, mori pjesë në një konferencë fetare për Misionarët e Kishës, në Frankfurt të Gjermanisë. Kishte caktuar që të ndërtonte një kishë të re, në Siera Leone, por dëshira dhe vullneti i All-llahut ishte që ai të bëhet musliman. Kështu, prifti Amado, morri emrin Ahmed Jusuf dhe kaloi në Islam. Ndërkaq, gjithë dokumentacionin zyrtar dhe konfidencial, ia dorëzoi Kishës përgjithmonë.

Ish-prifti katolik, deklaroi se do të punojë që, edhe të tjerët në Afrikë, të përqafojnë Islamin dhe uroi që All-llahu edhe

⁴⁵² Abdul Vahid Hamid, op. cit., f. 169-170.

⁴⁵³ *Njëqind e pesëdhjetë të Krishterë e pranojnë Islamin nga dora e (ish) priftit Edison Mishel*, Dituria Islame, Prishtinë, 1994. nr. 62, f 24.

ata t'i nxjerrë, nga errësirat e idhujtarisë, në dritën e Islamit".⁴⁵⁴

⁴⁵⁴ Mexhid Yvejsi, *Prifti katolik pranoi Islamizmin*, Dituria Islame, Prishtinë, 1991. nr. 26. f. 40.

Nil Armstrong

Astronaut amerikan, njeriu i parë që shkeli në Hënë, ka pranuar Islamin.

“Ishte duke ecur rrugës, me një grup miqsh, kur nga një Qendër Islame, aty afër, dëgjoi ezanin, që ftonte besimtarët për faljen e namazit. Armstrongu ndali hapat dhe pyeti njërin nga shoqëruesit e tij, nëse e dëgjoi edhe ai këtë. Miku iu përgjigj se edhe ai e dëgjoi dhe i shpjegoi Armstrongut se kjo është thirrje që u drejtohet të gjithë besimtarëve muslimanë për t’u falur, dhe quhet ‘Ezan’. Armstrongu mbeti shumë i çuditur, por edhe i kënaqur nga ajo që dëgjoi, dhe i pohoi mikut të tij se ishte hera e dytë, që ai e dëgjonte këtë zë. Herën e parë, kumbimin e tij, e kishte dëgjuar kur po hidhte hapat e parë në Hënë. Pas kësaj, Armstrongu, pranoi Islamin”⁴⁵⁵.

Jusuf Islam (Cat Stevens)

Këngëtar anglez i muzikës pop, me famë botërore. Në vitin 1973, pranoi Islamin.

“Në atë kohë, më është dukur sikur, në jetën time, kisha bërë çdo gjë, kisha arritur sukses, popullaritet, pasuri dhe femra... çdo gjë... mirëpo isha sikurse majmuni, i cili, kërcen prej një peme në pemën tjetër dhe nuk isha i bindur aspak. Ndërkaq, leximi i Kur’anit, ishte në cilësinë e vërtetimit të çdo gjëje. Në brendinë time, shihja të vërtetën dhe gjendja ime ishte sikur ballafaqohesha me personalitetin tim të vërtetë.

⁴⁵⁵ Salim Khan Burma, *Njeriu që shkeli i pari në Hënë, pranoi Islamin*, Drita Islame, Tiranë, 1994. nr. 47. f. 4.

Kur'ani fisnik pranon shumë gjëra për martesën, për lidhjet mes burrit dhe gruas dhe gati për të gjitha çështjet".⁴⁵⁶

"Do të ishte gabim, të gjykojmë Islamin nga këndvështrimi i sjelljes së disa muslimanëve të këqij, që janë treguar gjithnjë të dyshimtë. Është njëlloj, si ta gjykosh veturën si të keqe në qoftë se shoferi është i dehur dhe e përplas atë për muri. Islami udhëheq gjithë qeniet njerëzore, gjatë jetës së përditshme, nga aspekti shpirtëror, mendor dhe dimension i fizik. Ne duhet të gjykojmë, burimet e këtij udhëzimi në Kur'an dhe shembullin e Pejgamberit. Kështu ne mund të shohim idealin e Islamit".⁴⁵⁷

Muhammed Ali (Cassius Clay)

Mbreti dhe legjenda e ringut botëror, të boksit profesionalist. Ishte i krishterë. Në vitin 1965, pranoi Islamin.

"Kam pasur shumë çaste të këndshme në jetën time, por ato, që përjetova gjatë qëndrimit në kodrën e Arafatit (gjatë haxhshit), ishin çastet më të lumtura. U magjepsa nga atmosfera e papërshkrueshme, ku mbi një milion e gjysmë (tani disa milionë) haxhinj, i drejtonin lutjet e tyre All-llahut, që t'ua falte mëkatet dhe t'u dhuronte atyre mirësi. Ishte një eksperiencë e papërsëritshme, kur shikoje njerëz të racave, ngjyrave dhe popujve të ndryshëm, mbretër, kryetarë shtetesh, njerëz të zakonshëm nga vende të varfra, të gjithë të mbështjellë me dy çarçafë të thjeshtë të bardhë, duke iu lutur All-llahut, pa kurrfarë mburrjeje apo hipokrizie. Ishte një manifestim praktik i parimit të barazisë në Islam".⁴⁵⁸

⁴⁵⁶ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 68.

⁴⁵⁷ Drita Islame, viti V. Tiranë, qershor, 1996, nr. 11 (94), f. 4.

⁴⁵⁸ Ibid, f. 4. Pamfleti: *Shpata e Islamit*.

Antonio Inoki

Boksier profesionist japonez, i cili dominoi në arenën e ringut, gjatë viteve shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë. Ai tregon se rruga e tij drejt kërkimit të së Vërtetës dhe paqes e sollën në rrugën e fesë islame. Tani, ai është anëtar i Parlamentit Japonez.

Inoki ishte impresionuar nga Muhammed Aliu, me të cilin u ndesh në Tokio. Që të dy, ishin legjenda të vërteta, në stilet e tyre të ndryshme. Më 1976, Inoku pat ardhur në Pakistan, për t'u ndeshur me vëllain e vogël të Bolus, Akramin. Inoku ishte më i mirë se Akrami, por ai ishte impresionuar nga mikpritja e vëllezërve të Boluas. Inoku ishte shprehur se kontaktet që kishte së pari me mbretin e boksit, Muhammed Aliun dhe pastaj me anëtarët e klanit të Bolusë, e shtynë të mendojë lidhur me fenë islame dhe e nxitën të mbledhë të dhëna rreth Islamit.

Më pas Inoki përqafoi Islamin. Ai është zotuar se do të bëjë një jetë të pastër prej muslimani⁴⁵⁹.

Kris Jubank (Hamdan)

Kampion botëror në kategorinë e mesme. Në tetor të vitit 1996, në Dubai, kur fitoi ndeshjen ndaj kolumbianit Kamilo Elak, deklaroi botërisht përqaftimin e fesë islame dhe preferoi të ndryshojë emrin nga Kris, në Hamdan. Ai gëzon popullaritet të madh në Angli. Gazeta "The Times" e zgjodhi, në mesin e një mijë personaliteteve më të njohur, në historinë e sportit. Është quajtur "njeriu më tërheqës", pastaj "njeriu me trup më të bukur".

⁴⁵⁹ Inoki duke kërkuar të Vërtetën, Dituria Islame, Prishtinë, 1992. nr. 37. f. 28.

Më 9 shtator 1995, Jubank pësoi humbjen e dytë në ndeshjen me irlandezin Stiv Kolins. I pakënaqur, me mënyrën arbitrare, e braktis boksën. Pas një ndërprerje të përkohshme, i ftuar nga mbreti Husejn i Jordanisë dhe Nelson Mandela i Afrikës së Jugut, Jubank iu kthye ringut, për të marrë me vete kënaqësinë e brohoritjeve të spektatorëve të Dubait. Pas fitores me Kamilo Elakun, ai deklaroi botërisht, duke thënë: “Dëshmoj se s’ka Zot tjetër përveç All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është rob dhe i Dërguari i Tij”.⁴⁶⁰

Abdullah Colobong Mangaoang

Thotë: “Kam lindur në një rreth që i përket fesë së krishterë. Në rini, isha anëtar aktiv i Kishës së Bashkuar Metodiste. Ëndërroja që, një ditë, të bëhesha misionar dhe ta ktheja në Kristianizëm atë popull pagan, barbar dhe të egër, siç i konsideronim ne muslimanët. Madje, shqetësoja të afërmit e mi, që të më ndihmonin, të mësoja përmendësh citate nga Bibla. Por, besimi im i patundur, në kristianizëm në përgjithësi, e në veçanti në Kishën e Bashkuar Metodiste, filloi të luhatej, për shkak të kundërthënieve të shumta, dallimeve të mëdha, besimeve iracionale, blasfemive në Bibël dhe traditave pagane të dogmave të krishtera. Vura re se, gjatë viteve të shkuara, unë kisha qenë një vijues i verbër i besimit me dogma pagane, sikurse janë:

Krishti qan: “Krishti qan me zë të lartë, duke thënë: O Zoti im, O Zoti im, pse më harrove?” (Shën Marku: 15-34)

Ky citat tregon qartë se Krishti (Isai) nuk ishte Zot, por thjesht një pejgamber i Zotit, e asgjë më shumë. Ai iu drejtua

⁴⁶⁰ Boksieri Kris Jubank përqafton Islamin, Drita Islame, Tiranë, dhjetor, 1997. nr. 23. f. 4.

Zotit për ndihmë me një zë të mekur dhe në gjendje të dëshpëruar.

Krishti, bir i Zotit. Kjo dogmë bie ndesh me mësimet dhe thëniet e Isait [alejhis-selam] dhe është përdorur në kuptimin metaforik. Kjo shprehje, në kuptimin metaforik është përdorur edhe për shumë peygamberë të tjerë, në Bibël.

Shlyerja e mëkatit: "Baballarët nuk do të vdesin për fëmijët e tyre, as fëmijët e tyre nuk do të vdesin për baballarët e tyre, por çdonjëri do të vdesë për fajin e vet". (2 Kronikat 25-4)

"Ai që bën mëkate nuk do të vdesë: djali s'do të përgjigjet për fajet e t'et, as i ati s'do të përgjigjet për fajet e të birit. Të drejtit do t'i takojë drejtësia dhe të paudhit paudhësia". (Ezekiel, 18:20)

Citatet e përmendura tregojnë qartë, se dogma 'Shlyerja e mëkatit burimor' është e pabazë. Nëse vërtet Zoti e ka dërguar Isain [alejhis-selam], që me vdekjen e tij në kryq, t'ia falë mëkatet njerëzimit, siç thonë të krishterët, atëherë Zoti i të krishterëve, bie ndesh me fjalët e tij dhe Ai paraqitet si i pamëshirshëm dhe jo i drejtë. Ai u bën padrejtësi krijesave të tij duke lejuar, që njeriu i pafajshëm, të vuajë për njeriun e fajshëm.

Triniteti: "S'ka Zot përveç një Zoti". (1 Koritianët, 8: 6)

"Tashti, ndërmjetës nuk ka ku është vetëm një. E Hyji është një i vetëm". (Galatasve 3: 20). "Unë jam i dërguar vetëm te delet e humbura të shtëpisë së Izraelit". (Mateu 15: 24)

Vallë, këto citate dhe citate të tjera të Biblës, a nuk e përgënjeshetrojnë dogmën e "Trinitetit", duke vërtetuar njësinë e Zotit dhe peygamberinë e Isait [alejhis-selam] dhe se misioni i tij, nuk ishte universal.

"Mos t'ju shkojë ndërmend, se erdha për ta shlyer Ligjin ose Profetët! Jo, s'erdha të shlyej, por të përkryej. Me të vërtetë, po ju them: derisa të jetë qielli, asnjë germë dhe asnjë presje,

nuk do t'i hiqet Ligjit, por do të zbatohen të gjitha..."
(Mateu 5: 17, 18)

Këto citate, shprehin qartë, se Isai [alejhis-selam] s'ka sjellë religjion të ri, se Krishterizmi s'mund t'i atribuohet atij dhe se Krishterizmi s'ka themelues.

Madje, studiova Hinduizmin, Budizmin, Judaizmin etj., por ishte humbje kohe, sepse, këto fe, nuk të çojnë drejt shpëtim.

Mendja ime nuk gjente prehje e qetësi... Fatmirësisht, një mik më huazoi një libër, me titull "Feja islame - zgjedhja jonë ". Libri përmbante mbresat e personaliteteve eminente, që kishin pranuar fenë islame. Fillova të studioj librat e fesë islame. Feja islame është fe e përkryer monoteiste, e udhëzon njerëzimin drejt një jete të lumtur dhe i garanton kënaqësi, në këtë botë dhe në botën e amshueshme.

Më 1972, pranova Islamin. Falënderoj All-llahun që gjeta të Vërtetën".⁴⁶¹

Lord Hidhu

Është intelektual dhe shkrimtar anglez. Ka studiuar jetën e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Në fund pranoi Islamin. Veç të tjerash, ai thotë:

"Kam menduar e studiuar, gjatë 40 vjetëve, për të arritur tek e Vërteta. Duhet të pohoj se, vizita ime në disa vende islame, më ka mbushur zemrën me respekt ndaj fesë së natyrshme të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], e cila e obligon njeriun t'i drejtohet me lutje çdo ditë Zotit, gjatë gjithë jetës së tij dhe jo vetëm gjatë ditëve të diela. Unë e falënderoj shumë Zotin e Madhërishëm, që më udhëhoqi në

⁴⁶¹ *Pse e përqafova fenë islame*, Abdullah Colobong, Dituria Islame, Prishtinë, gusht, 1991. nr. 28. f. 30-32.

këtë fe, që është rrënjësuar thellë në zemrën time dhe që më mundëson të jetoj në një paqe dhe prehje të tillë shpirtërore, që nuk e kam jetuar kurrë më parë. Kam qenë i humbur në errësirë, ndërsa, feja islame, më nxori në dritë, ku çdo gjë ndrin nga dielli i së Vërtetës. Kështu fillova të ndiej të Vërtetën e pastër, siç ndihet ajri i pastër i detit”.⁴⁶²

Taxhata Taxhasun

Përgjegjës i anatomisë dhe embriologjisë, në Universitetin Cang Maj në Tajlandë dhe njëherësh edhe dekan i Fakultetit të Mjekësisë në këtë Universitet.

“Gjatë tre vjetëve të fundit, fillova të merrem me Kur’anin... Unë besoj vërtet se çdo gjë, që është përmendur në Kur’an, para më shumë se 1400 vjetëve, është e vërtetë e qëndrueshme, gjegjësisht, mund të shpjegohet përmes shkencës. Pejgamberi Muhammed [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk dinte të shkruante as të lexonte. Patjetër që ai është i Dërguar, i cili na solli këtë të vërtetë. Kjo e vërtetë, atij iu dha nëpërmjet Shpalljes, nga Krijuesi, Gjithënjohësi i çdo gjëje. Ky Krijues s’ka dyshim se është All-llahu.

Prandaj besoj se erdhi koha të deklaroj se: S’ka Zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij”.⁴⁶³

Dr. Garnijet

Mjek francez, thotë: “Përjetova një harmoni të brendshme shpirtërore, kur përqafova Islamin. Kam lexuar vargjet e Kur’anit që lidhen me shkencat natyrore, me shkencën e

⁴⁶² Dr. Muhammed A. Jemani, *Edukoni fëmijët tuaj me dashuri për profetin Muhammed a.s.* Shkodër, 1996. f. 100-101.

⁴⁶³ Abdul Mexhid Ez-Zendani, op. cit., f. 33.

mjekësisë dhe kam bërë studime përkatëse në ato fusha. Pastaj, krahasova vargjet e Kur'anit, me dijet e arritura në shkencat natyrore dhe në mjekësi, të cilat i kam studiuar në universitet dhe arrita në përfundimin se, vargjet e Kur'anit pajtohen plotësisht me këto dije.

E pranova Islamin, sepse u binda që Muhammedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], shumë shekuj para nesh, ka ardhur me të Vërtetën e qartë, shumë më parë se ne të arrinim në këtë stad zhvillimi. Shpreh bindjen e plotë se, çdo shkencëtar që krahason atë çfarë thuhet në Kur'an, me arritjet e sotme shkencore, ashtu sikurse veprova unë, pa dyshim do të pranojë Islamin, ashtu sikurse e pranova edhe unë. E në qoftë se, në zemrën e tij, sundojnë paragjykimet, ai, së pari, duhet të shërohet nga kjo, e pastaj të kërkoj bindshëm të vërtetën".⁴⁶⁴

Antonio (Salahudin) Cariovato

Ka specializuar në filozofi. Rrjedh prej një familje konservatore italiane. Ai thotë:

"Të gjithë anëtarët e familjes sime, shkonin rregullisht në kishë, iu bindeshin rregullave të fesë katolike dhe i zbatonin ato. Kështu veproja edhe unë, derisa kuptova se, në Krishterizëm ka shumë kundërthënie, falsifikime dhe kontradikta...

Në Islam, gjeta të vërtetën. Ndërkaq (në Krishterizëm), për Jezusin, ka mendime nga më të ndryshmet. Disa thonë se Jezusi (Isai, paqja e All-llahut qoftë mbi të) është bir i Zotit, të tjerë thonë se Jezusi është vetë Zoti, por me pamje njeriu! Logjika e shëndoshë i hedh poshtë këto pretendime. U përpoqa të mësoj se ç' thotë Kur'ani në lidhje me këtë çështje.

⁴⁶⁴ Dr. Muhammed A. Jemani, op. cit., f. 97-98.

Zbulova të Vërtetën e qëndrueshme. E falënderova Zotin. Ky ishte hapi im i parë drejt Islamit. Duke lexuar Kur'anin, gjeta vazhdimisht përgjigjen e atyre pyetjeve, që më trazonin shpirtin. Vendosa të bëhem musliman... Islami përmban një moral të shkëlqyer dhe përkrah fuqishëm marrëdhëniet familjare dhe shoqërore. Në Islam unë dhe bashkëshortja ime, gjetëm siguri e paqe. Jeta jonë filloi të marrë kuptimin e vërtetë, kuptim, i cili i mungon njeriut modern, në shoqërinë evropiane. Civilizimi materialist, po e bën njeriun të stresuar, të pasigurt, të shqetësuar e të humbur. Besimi, në All-llahun e Plotfuqishëm, mjafton që t'i ofroj njeriut paqe dhe siguri në këtë jetë. Kjo, vërtet, mund të realizohet vetëm në sajë të fesë islame. Prandaj, me pranimin e Islamit, mund të them se zbulova shumë mirësi dhe lumturi".⁴⁶⁵

Alfons Dadge

Artist e piktor francez, pasi studioi fenë islame, meditoi për parimet e saj të larta, vendosi të bëhet musliman dhe mori emrin Nedhir, që do të thotë qortues. U përpoq në përhapjen e fesë islame, në Francë dhe vende të tjera, duke hedhur poshtë gënjeshttrat e atyre, që shpifnin kundër Islamit. Shkroi një libër për jetën e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], të cilin ia dedikoi dëshmorëve të rënë në Luftën e Parë Botërore. Ai thotë:

"Feja islame nuk ndalon lirinë e të menduarit. Në fenë islame, Zoti i Madhërishëm nuk u ngjan njerëzve ose ndonjë krijese, sikurse shprehet dijetari çifut Balas (Bulus) për fenë katolike, ose siç thuhet për Jehovain, Zotin e çifutëve, të cilët

⁴⁶⁵ Filozofi italian pranoi Islamin, Dituria islame, Prishtinë, Janar, 1993. nr. 45. f. 31.

e përfytyrojnë Zotin e Madhërishëm në gjendje aspak të pranueshme. Sa e vështirë është të pranohet që Zoti e lë djalin e vet të vetëm, t'ia gozhdojnë armiqtë, derisa ai të vdesë!

Në Kur'an dhe në thëniet e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] Zoti i madhërishëm nuk përfytyrohet dhe nuk përshkruhet, mbasi, Atë, askush nuk e ka parë. Zoti nuk ka pamje, si krijesat. Nuk është i kufizuar. Zoti nuk i ngjan askujt dhe askush nuk i ngjan Atij. Ai i ka të gjitha virtytet e cilësitë të veçanta. Ai s'ka nevojë për asgjë, kurse çdo gjë ka nevojë për Të. Ai nuk ka lindur, prej kujt dhe askush nuk ka lindur, prej Tij. Ai nuk ka të barabartë".⁴⁶⁶

⁴⁶⁶ Dr. Muhammed A. Jemani, op cit., f. 100-101.

K. Lal Gaba

Politikan, autor dhe gazetar. Ka lindur në Lahore. Rrjedh prej një familje shumë të pasur, të ngritur dhe prestigjioze në mesin e hindusëve. Pasi pranon Islamin, transferohet në Bombei.

“Jam ndikuar në mënyrë të veçantë nga thjeshtësia e shoqërisë islame dhe ndjenja e tyre për respektimin e njeriut, dhe nga dashuria e ndërsjellë njerëzore ndërmjet individëve. Gjithashtu, më ka bërë për vete respekti dhe parimi i barazisë që zbatohet në ato shoqëri. Shkëndija e besimit të Islamit ka vazhduar të jetë e ndezur në vendimin tim të ngadalshëm dhe me hamendje. Në fund kjo shkëndijë më drejtoi drejt Islamit. Kështu që sot, me mirësinë e All-llahut, zemra dhe mendja ime, që të dyja janë të ndriçuara me të vërtetën e Islamit. Sa herë që kaloja pranë ndonjë xhamie të muslimanëve në Indi, zemra ime mbushej me ndjenjën e madhërisë dhe shenjtërisë së këtij vendi”.⁴⁶⁷

Najimu Ramoni

Është prej Gane. Prindërit e tij ishin anëtar të kishës. Mësoi në shkollë të bëhet misionar. Në moshën 20 vjeçare, filloi misionin e tij si misionar i zellshëm. Një ditë i bie në dorë një libër për Islamin, të cilin ia ofroi një prej miqve. Nën ndikimin e së vërtetës islame, qartësisë dhe saktësisë së mrekullueshme, filloi t’i luhatet bindja për Krishterizmin. Vazhdoi të kërkojë të vërtetën. Në vjeshtën e vitit 1963, shpall botërisht pranimin e fesë islame.

“Nuk kisha zgjedhje tjetër! Gjatë krahasimit, ndërmjet parimit të Njësisë (Teuhidit) sipas konceptit kur’anor dhe

⁴⁶⁷ Dr. Imadudin Halil, po aty, f. 167-168.

besimit tim në trinitet, kuptova se parimi i fundit qëndronte shumë poshtë, në krahasim me parimin e Njësisë në Islam. Fillova të luhatem në besueshmërinë time në fenë e krishterë, duke pasur parasysh se besimi në Zot, është parimi i parë dhe më i rëndësishëm në cilëndo fe. Nëse besimi im në Zot, është i gabuar sipas të kuptuarit të drejtë fetar, do të thotë se të gjitha aktivitetet e tjera janë të kota, s'kanë dobi dhe janë të pakuptimta".⁴⁶⁸

Volter Xhuli

Kirurg suedez, thotë: "Një ditë, dëgjova këndimin e Kur'anit. Ajo që dëgjova u ngulit thellë, shumë thellë në zemrën time. Më pas, vendosa të shkoj tek një miku im, që të mësoja gjuhën arabe dhe t'i kërkoja atij të më shpjegojë fjalët e bukura që kisha dëgjuar: *"Thuaj: Ai, All-llahu është Një! All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë"*. (El-Ihlas: 1-3)

Sa kuptim madhështor kanë këto fjalë! Para njohjes së Islamit, ndjehesha shumë i vetmuar. Jo vetëm unë, por në përgjithësi banorët e qytetit tim, e madje shumica e njerëzve në Evropë dhe Amerikë jetojnë të vetmuar e të izoluar nga të tjerët. Ata nuk shoqërohen dhe nuk kanë marrëdhënie, madje edhe me fqinjët më të afërt. Së shpejti, pritet që në Evropë, numri i qenve të barazohet me numrin e familjeve, pra të krijohet raporti 1:1. Evropiani vetëizolohet nga fqinjët e tij, duke kërkuar shoqërim me kafshë dhe duke shpërfillur lidhjet e tij me njerëzit e tjerë. Islami është fe e dashamirësisë, shoqërimit, e bamirësisë, fe e respektit ndaj prindërve, ndaj të afërmve, fqinjëve, etj.

⁴⁶⁸ Ibid, f. 181-182.

Prandaj unë pranova këtë Fe madhështore”.⁴⁶⁹

K. L. Gauba

Hindus i shkolluar, gjykatës i madh në gjykatën supreme. Nuk pranoi të vazhdojë fenë e tij, që kishte trashëguar nga babai dhe gjyshërit. Ai filloi të bëjë krahasimin mes feve, dhe kështu në fund pranoi Islamin.

“Gjëja e parë, që më ka tërhequr në këtë fe, është thjeshtësia dhe qartësia e saj e plotë. Cilësia e dytë, që më ka bërë për vete në Islamin e madhërishëm, është fryma origjinale demokratike, me të cilin ai veçohet. Barazia në Islam ndryshon nga barazia në bolshevizëm, që përpiqet t’i shkatërrojë të pasurit në dobi të të varfërve, ajo nuk është si barazia në Krishterizëm, ku goditet me kamxhik njeriu i zi, vetëm pse shikimi i tij bie mbi ndonjë grua të bardhë. Zezakët e adhurjnë Zotin e tyre veçmas nga kishat e të bardhëve. Ndërkaq, në Islam, të gjitha xhamitë i kanë dyert e hapura për çdo musliman, të pasur apo të varfër, të zi apo të bardhë, mbret apo skllav. Kjo veçori ngre kështjellën e fuqishme të bashkimit të vërtetë ndërmjet muslimanëve. Islami nuk organizon ceremoni të veçantë për ata që e pranojnë Islamin, sikurse bëjnë fetë e tjera. Për individin, mjafton që të thotë dy dëshmi (shهادتين), dhe të gdhijë anëtar i vëllazërisë më madhështore në botë, nën hijen e së cilës janë të barabartë të gjithë njerëzit. Nuk ka askund në botë, një vëllazërim më të singertë dhe më të gjithëpërfshirës se sa vëllazërimi islam. Shkaku, pse unë e zgjodha Islamin për fe timen, është përputhja dhe elasticiteti i Islamit për t’u pajtuar me kërkesat e jetës bashkëkohore. Nuk ka asnjë fe,

⁴⁶⁹ *Pse e zgjodha fenë islame*, Volter Xhuli, Dituria Islame, Prishtinë, 1995. nr. 73. f. 8.

përveç Islamit, e cila ka fuqi për t'i zgjidhur problemet bashkëkohore, me të cilat ballafaqohet njeriu sot".⁴⁷⁰

⁴⁷⁰ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 168-169.

Moris Bezhar

Ka lindur në vitin 1927, në Marsejë të Francës. Është vallëzues e koreograf, estetika dhe konceptonet e tij skenike, paraqesin një vizion krejtësisht të ri, me përmasa botërore. Ai ishte i besimit katolik, por u bë musliman. Ai thotë: "Isha në një shkretëtirë iraniane, në vitin 1973... Vetvetiu m'u zbulua e vërteta e fesë islame".⁴⁷¹

Ali Selman Banoist

Doktor i mjekësisë në Francë, thotë:

"As profesioni im, si doktor i mjekësisë, as familja ime katolike, nuk më përgatiten për rrugën time shpirtërore. Kjo ndodhi, jo pse nuk e besoja Zotin, por sepse mësimet krishtere, e në veçanti, ato katolike, nuk më lejuan të ndiej ekzistencën e Zotit. Ndjenjat e mia ndaj Zotit, më ndaluan të besoj parimet e Trinitetit (Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë). Si pasojë e kësaj refuzova të besoj në hyjnizimin e Krishtit. Në fillim, e përqafova Islamin për shkaqe metafizike dhe meditative. Mirëpo, ka edhe arsye të tjera që më shtynë ta pranoj Islamin, sikurse janë refuzimi i klerit, që pretendon se ka fuqi për të na falur mëkatet, në vend të Zotit (i lartësuar është All-llahu nga ajo që i përshkruajnë injorantët dhe mashtruesit). Refuzova kategorikisht ritet katolike, të cilat (janë të përziera me paganizëm dhe) kanë prejardhje prej popujve primitivë, që adhuronin idhujt.

Krishterizmi nuk rekomandon asgjë për pastrimin e trupit, para lutjes. Kjo, më duket fyerje ndaj Zotit, i Cili na ka dhuruar shpirtin dhe trupin dhe ne nuk kemi të drejtë të

⁴⁷¹ Drita Islame, Tiranë, janar 1994. nr. 45. f. 4. Thirrja Islame, viti I. Nr. 1. revistë fetare, boton Komuniteti Musliman Shqiptar në SHBA dhe Kanada.

tregohemi mospërfillës. Islami i përshtatet natyrës njerëzore. Arsyeja kryesore, që më bëri të besoj në fenë islame, është Kur'ani fisnik. Para se të bëhesha musliman, e studiova Kur'anin me shumë kujdes dhe këtë e bëra me shpirtin kritik prej një intelektual perëndimor. Janë disa ajete, në Kur'an, që kanë të bëjnë me shkencën dhe të cilat, shkencëtarët po i vërtetojnë shkencërisht. Jam shumë i lumtur me fenë e re, dhe edhe njëherë deklaroj: 'Dëshmoj se s'ka Zot tjetër përveç All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi është i Dërguari i Tij'." ⁴⁷²

Dr. Klod Milan

Mjek i njohur francez. Konsulent i sëmundjeve të kancerit dhe drejtor i repartit kimik, në spitalin Sant Luis, në Paris. Ai thotë:

"Më parë, nuk isha mbështetur në ndonjë fe. Isha dhënë pas shkencës dhe e konsideroja atë çdo gjë për mua, por megjithatë ndieja gjithnjë një lloj zbrazëtie. E pashë të domosdoshme, që krahas elementit shkencor, duhet të zhvilloja edhe një element të rëndësishëm jetik, anën shpirtërore. Gjatë punës sime me pacientë të sëmurë, kam vërejtur një dallim të madh ndërmjet fetarëve dhe afetarëve. Fetarët muslimanë, krejt ndryshe nga afetarët, i përballonin sëmundjet më lehtë. Kështu, që e pashë të domosdoshme që, krahas mjekësisë të ushtrij edhe ndjenjën e besimit të Zoti. Përfundimisht, u binda se shkenca, në të cilën mbështetemi ne mjekët, në shërimin e shumë sëmundjeve, kërkon besimin. Islami është ai, i cili mund të kryejë këtë funksion, sepse posedon anën shpirtërore, në mënyrë të tillë që e veçon nga çdo fe tjetër. Një shoku im musliman, pasi që kisha lexuar

⁴⁷² Përse e pranova Islamin, Dituria Islame, Prishtinë, 1992. nr. 37. f. 28.

literaturë të shumtë islame, më ftoi që të pranoj Islamin. Unë iu përgjigja thirrjes së tij. Për mua, filloi një jetë e re. Më vonë, shkova në haxh dhe umre. Haxhxi la gjurmë të thellë, në shpirtin tim”.⁴⁷³

Ahmed Holt

Kontraktues civil anglez. Udhëtoi shumë nëpër botë, duke kërkuar të Vërtetën Hyjnore. Harxhoi shumë kohë me punë kërkimore dhe studime krahasimi, në mes të Judaizmit, Krishterimit dhe Islamit. Në vitin 1975, pranoi Islamin. “Shpata e Islamit, nuk është shpatë prej çeliku. E di, këtë, nga eksperiencia, sepse shpata e Islamit goditi thellë brenda, në zemrën time. Ajo nuk solli vdekje, por një jetë të re, një vetëdijesim dhe një zgjim se kush jam unë, dhe për çfarë jam unë këtu”.⁴⁷⁴

Donald S. Rockwel (Rokvell)

Poet dhe kritik letrar. Ka lindur në SHBA, dhe ka studiuar në Universitetin Washington dhe Kolumbia. Ka marrë shumë shpërblime shkencore. Pasi nuk u bind në fenë e tij të krishterë, pranoi Islamin.

“Në Islam, më kanë tërhequr shumë faktorë, që s’mund t’i përmbledh të gjithë. Disa prej tyre janë të dukshëm, të qartë dhe të padiskutueshëm, ndërsa disa të tjerë janë të fshehtë, të brendshëm, që kanë të bëjnë me çështjen e shpirtit dhe qëndrojnë në brendi të ndërgjegjes.

⁴⁷³ *Islami po depërton në Evropë për shkak të vitalitetit të tij*, Dituria Islame, Prishtinë, 1996. nr. 84. f. 37.

⁴⁷⁴ *Drita Islame*, Tiranë, qershor, 1996, viti V nr. 11 (94), f. 4. Pamfleti: *Shpata e Islamit*.

Kam lexuar për Islamin, për Kur'anin dhe për biografinë e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], birit të Abdullahut dhe shumë gjëra kanë tërhequr vëmendjen time, sikurse janë: thjeshtësia, lehtësia e besimit islam, ku nuk ka gjëra sekrete dhe as dogma, rreth të cilave nuk mund të diskutohet. Përkundrazi, besimi mbështetet në logjikë, të vështuarit e krijesave të All-llahut, si edhe në rendin e përkryer të universit, i cili shpie pashmangshëm në pranimin e ekzistimit të një Zoti, të Cilit i përket krijimi dhe urdhri"⁴⁷⁵

Peggy Raderik

Ka lindur në Indi. Është edukuar në frymën fetare, përmes misionarëve të krishterë. Në moshën dyzet e ca vjeç, duke bërë krahasimin në mes të gjitha feve, pranon Islamin. "Besimi monoteist tek Zoti, që përbën fundamentin e Islamit, është më afër arsyes dhe mendjes, se sa që është, ta zëmë, besimi në Trinitet. Mendja ime, e ka pranuar dhe është pajtuar me besimin monoteist në All-llahun Një. Gjithashtu, më ka pëlqyer shumë qëndrimi i Islamit ndaj feve të tjera. Islami konsideron se të gjitha fetë e mëdha në botë, kanë burim qiellor, gjë që është një lloj njohje dhe respekti për fetë e tjera. Islami qëndron më afër logjikës dhe tolerancës, sesa Krishterizmi, i cili të gjitha fetë e tjera i përshkruan si fe politeiste. Jam i impresionuar pa masë nga parimi i vëllazërimit në Islam, i cili i përfshin të gjithë, pavarësisht nga ngjyra, raca dhe bindja. Islami është feja e vetme që arriti të realizojë këtë parim madhështor në praktikë. Të gjithë janë të barabartë, parimi i vëllazërimit, ka përparësi ndaj çdo parimi tjetër..."⁴⁷⁶

⁴⁷⁵ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 182-183.

⁴⁷⁶ Ibid, f. 183.

Bernard Lewis

Ka lindur në vitin 1916. Ka diplomuar në Universitetin e Londrës dhe Parisit. Ka punuar asistent i historisë islame, në Universitetin e Londrës. Ai, gjithashtu, ka punuar edhe në Ministrinë e Jashtme, në vitet 1941-45. Ka ligjëruar historinë e Lindjes së Afërt dhe të Mesme, në Universitetin e Londrës në vitin 1949 dhe të Kalifornisë, në vitet 1955-56. Është autor i një numri të madh librash. Ai thotë:

“Para Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe shokëve të tij, nuk ka dalë problemi i zgjedhjes ndërmjet Zotit dhe Cezarit. Në Islam nuk ka Cezar, por është All-llahu-Një, kurse Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte ai që predikonte dhe gjykonte në emër të Tij. Pushteti i tij buronte nga i njëjti Burim, i cili e ndihmonte Pejgamberin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në të dyja misionet (në misionin fetar dhe atë shtetëror). Vetë Shpallja i jepte përparësi misionit të parë dhe, njëkohësisht, ishte edhe bazë për misionin e dytë. Kur vdiq Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] misioni i tij shpirtëror dhe pejgambërik (përhapja e fesë së All-llahut) ishte plotësuar dhe kishte mbetur puna fetare dhe veprimi politik. Tregues i kësaj pune ishte përhapja e Sheriatit (Ligjit) të All-llahut në mesin e njerëzve, dhe kjo mund të bëhej nëpërmjet rrugës së zgjerimit të anëtarëve dhe pushtetit të bashkësisë, të cilët e pranonin këtë ligj dhe e përkrahnin atë. Prandaj, ishte i domosdoshëm një përgjegjës, apo një zëvendës për Pejgamberin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], për udhëheqjen e kësaj bashkësie. Fjala arabe ‘halif’ i përmban të dyja këto kuptime. Në kohën e halifëve të drejtë, qeverinë fetare e gjen si të vetmen qeveri. Në fillim të Islamit, nuk kemi ndarje ndërmjet sistemit qeverisës dhe sistemit fetar. Edhe përkundër zhdukjes

së hilafetit dhe ndarjes së botës islame në shumë njësi politike të pavarura dhe, shpeshherë, edhe në luftë të ndërsjellë ndërmjet tyre, ndjenja e identitetit dhe bindja se (muslimanët megjithatë janë një Ummet) ka mbetur e fortë dhe aktive”.⁴⁷⁷

⁴⁷⁷ Ibid, f. 238-239.

Profesor Harun Mustafa Lyon

Me origjinë angleze. Në vitin 1882 pranon Islamin. Ishte anëtar nderi i shumë shoqatave fetare, në Evropë dhe Amerikë. Profesor i respektuar, në shkencën e gjuhëve, dijetar me zë në gjeologjisë. Ka fituar shumë medalje nderi, njëra prej tyre është edhe ajo e dhënë nga Sulltani Abdul Hamidi i Dytë.

“Prej mrekullive të Kur’anit është se ai pajtohet me arsyen dhe nuk kërkon prej ithtarëve të vet, që ta neglizhojnë këtë dhunti të rëndësishme hyjnore, krejt ndryshe nga fetë e tjera, të cilat insistojnë nga ithtarët e tyre, që të pranojnë parime (dogma) të caktuara, pa menduar rreth tyre dhe pa shtruar pyetje në mënyrë të lirë, por duke i imponuar ato me pushtetin e Kishës. Ndërkaq, Islami preferon kërkimin dhe studimin dhe i fton ithtarët e tij që të analizojnë, të thellohen dhe të vështrojnë, para se të besojnë. Islami e përkrah urtinë e thënë ‘Argumento saktësinë e çdo gjëje, pastaj paso më të mirën’. Nuk duhet të çuditemi për këtë, sepse urtësia është gjëja e humbur e besimtarit. Kudo që e gjen ai, është e drejtë e tij, e më shumë se cilitdo tjetër, që ta marrë atë. Islami është fe e arsyes dhe e logjikës. Pikërisht për këtë, fjala e parë, që i është shpallur Pejgamberit, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është fjala ‘lexo’. Islami është feja e vërtetë. Arma e tij është dija, kurse armiku i tij i përbetuar është injoranca”.⁴⁷⁸

Dr. R. L. Mellema

⁴⁷⁸ Ibid, f. 240-241.

Antropolog, shkrimtar dhe dijetar holandez. Pas një kërkimi dhe meditimi të gjatë, gjatë vizitës në Pakistan, në vitin 1955, pranon Islamin. Është kryetar i Katedrës Islame, në Muzeumin e Amsterdemit. Ka shkruar një numër librash për Islamin në gjuhën holandeze, të cilat janë përkthyer edhe në gjuhë të tjera. Rreth asaj, se ku qëndron bukuria e Islamit dhe se çfarë e ka tërhequr te ky besim, ai thotë:

“Do të përgjigjem shkurt në disa pika:

Njohja e qartë e një Qenie të Mbinatyrshme, e cila kuptohet lehtë me logjikë nga çdo krijesë. All-llahu është Ai, tek i Cili të gjithë i mbajnë shpresat. Ai s’ka lindur, as s’është i lindur dhe askush s’është si Ai. Posedon urtësi të pakufishme, fuqi absolute dhe bukuri mahnitëse. Bamirësia dhe mëshira e Tij nuk njohin kufij.

Lidhja, ndërmjet Krijuesit të Universit dhe krijesave, është e drejtpërdrejtë. Islami nuk ka nevojë për meshtarët. Në Islam, marrëdhëniet me Zotin, varen nga vetë besimtari. Ai është përgjegjës për veprat e tij dhe s’mund të shfajësohet, me sakrifikimin e një njeriu të pafajshëm. Askush s’do të japë llogari për atë, që nuk e ka bërë.

Toleranca e Islamit shihet në këto fjalë: “Në fe nuk ka dhunë...” (El-Bekare: 256) Muslimanit i obligohet të kërkojë të vërtetën, kudo qoftë ajo. Vëllazërimi islam, përfshin të gjithë njerëzit, pa dallim ngjyre, race. Islami është e vetmja fe, që e ka realizuar në praktikë këtë. Muslimanët, kudo qofshin në botë, e konsiderojnë njëri-tjetrin vëllezër. Barazia islame për të gjithë njerëzit, para Zotit, shprehet qartë në haxhë. Islami e pranon ekzistencën e komponentit material dhe shpirtëror. Zhvillimi i shpirtit është i ndërlidhur me nevojat e trupit. Njeriu duhet të sillet në mënyrë të tillë, që shpirti të

ngadhënjejë ndaj anës trupore dhe që trupi të kontrollohet nga shpirti..."⁴⁷⁹

⁴⁷⁹ Dr. R. L. Mellema, *Ku qëndron bukuria e Islamit për mendimin tim*, Triumfi islam, Shkodër, Maj, 1994. nr. 16. f. 4; Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 246-247.

Fadlullah Wilmot

Nga Australia, rrëfen: “Jam rritur në atmosferë ateiste. Kur fillova të shkoj në Universitet, lexova disa libra shkencorë, njëri prej tyre ishte: ‘A është e mundshme që jeta të fillojë rastësisht’, nga autori francez La Come de Liet. Ky libër, bëri që unë të mendoj se, përveç krijesave, duhet të jetë një fuqi e madhërishme, Zoti. U bëra i krishterë dhe përpiqesha që të jem sa më i mirë. Fillova të shkoj në kishë dhe isha shumë aktiv në grupet e krishtera. Studiova Krishterizmin, lexova librin ‘Komentimet në Bibël’, i cili shpjegonte dhe analizonte çdo gjë në Bibël. Gjatë leximit, vura re kundërthëniet. Madje shumë të krishterë, që kanë shkruar rreth ungjijve, dyshojnë rreth komentimeve të tyre. Por, unë nuk i kush-tova rëndësi kësaj. Në Universitet studiova historinë. Fillova me studimin e Rilindjes Evropiane. Aty kuptova ndikimin e mendimit arabo-musliman në mendimin evropian. Fillova të studioj ndikimin e mendimit islam, në civilizimin evropian. Zbulova se muslimanët ishin ata, që e nxorën Spanjën nga errësira e Mesjetës. Po të mos ishin muslimanët në Spanjë, Evropa do të mbetej edhe më tej si në Mesjetë. Girardi, dijetar frëng, i cili studioi në Universitetin Islamik të Kordobës, në Spanjë, kur u kthye në Francë, u zgjodh asistent i Papës, në Kishën Katolike. Ai gjatë qëndrimit në Kordobë, studioi numrat arabë. Ishte mendja arabe, e cila e zbuloi zeron, që është bazë e matematikës. Girardi, asistent i Papës, që i pari që, në Evropë, vuri në zbatim zeron dhe numrat arabë, pa të cilët s’do të ishte e mundshme të zhvillohej matematika moderne.

Algjebra është një shkencë e pastër arabe, ashtu sikurse është edhe shkenca e llogaritjes, e shpikur nga muslimanët. Edhe mjekësia bazohej në veprat e Ibn Sinës dhe Raziut, të cilat studiohen edhe sot në Universitetin e Sorbonës. Roxher

Bekoni, i cili njihet si themelues i shkencës empirike, ka thënë: Nuk mund ta njihni shkencën, derisa nuk e mësoni gjuhën arabe. Roxher Bekoni, metodën empirike, e mësoi nga muslimanët. F. Magelani, i cili i pari provoi se Toka është e rrumbullakët, është bazuar në studimet islame, të botuara në Spanjë.

Madje, detari, i cili ishte kapiten i anijes së Magelanit, ishte musliman, nga brigjet e Afrikës. Nuk e teprojmë nëse themi se, dituria në të cilën bazohet shkenca moderne, kryesisht, është nga shkencëtarët muslimanë. Edhe marrëdhëniet shoqërore, bujaria, fisnikëria e respekti ndaj femrës në Evropë, erdhën nga muslimanët e regjionit ndërmjet Francës dhe Spanjës.

Koncepti i sigurimit për dëmshpërblimet, në Evropë, u bë i njohur nëpërmjet arabëve. Çeqet bankare, janë përdorur, së pari, nga muslimanët. Në astronomi, Ibn el Hejthemi, shpiku astrolobin. Këto, janë vetëm një pjesë e vogël, nga zbulimet e bëra. Fillova të pyes se, kush janë muslimanët? Nga Enciklopedia, mësova se muslimanët kanë një libër qiellor, Kur'anin.

Gjatë studimit konstatova: Në Kur'an nuk ka kundërthënie, sikurse te librat e tjerë fetarë dhe se ndërmjet përmbajtjes së Kur'anit dhe shkencës s' ka kundërthënie.

Kur'ani përfshin çdo aspekt të jetës. Fillova të studioj jetëshkrimin e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe studimet e mia zgjatën pesë vjet. Në fund, kuptova se, Islami është i thjeshtë dhe i kuptueshëm, prandaj e pranova. Falënderoj Zotin, që gjeta të vërtetën dhe jam i bindur plotësisht se, s'ka të vërtetë tjetër përveç fesë islame dhe nuk ka rrugë tjetër për shpëtimin e njerëzimit, përveç Islamit".⁴⁸⁰

⁴⁸⁰ *Pse e pranova Islamin*, Dituria Islame, Prishtinë, 1991. nr. 25. f. 30-31.

April Sushit

Amerikane e cila shërben vullnetare në Trupat e Paqes në Jordani, e pyetur nëse ndonjë ngjarje kishte qenë pikë kthese për të, ajo përgjigjet:

“Nuk ishte një ngjarje e vetme që më ndryshoi jetën. Në atë kohë isha 22 vjeç dhe isha në kërkim të diçkaje, por s’mund të them se ajo që kërkoja ishte feja...

Rreth dy vjet pas kolegjit, punova si shefe e financave për Tojotën. Gjatë asaj kohe u miqësova me një egjiptian, i cili ishte musliman. Në fillim, reagimet e mia ishin tipiket e femrave perëndimore të emancipuara dhe të shkolluara. E akuzoja Islamin për shtypje ndaj gruas dhe si të stërmбуshur me rregulla. Nuk e kuptoja që s’po kapja ‘pamjen e madhe’ që Zoti është më i madh se çdo vogëlsi tjetër.

Pas disa muajsh debatesh dhe leximi, perspektiva ime filloi të ndryshonte dhe vendosa të përqafoj Islamin. E vetmja gjë që më mbante larg kësaj ishte frika se mos hidhesha në ferr për mospranimin e Jezusit si bir të Zotit. Dua të them, isha deri diku, e sigurt në besimet e mia të reja, por, po nëse e kisha gabim? Besomëni kur ju them që jam lodhur në orë të tëra mendimi dhe meditimi e vetmuar. Them se ajo që më lehtësoi ishte njohuria që unë s’po hiqja dorë nga besimi im te Jezusi si i dërguar i Zotit. Islami e ngre atë në një pozitë të lartë”.⁴⁸¹

Alen Jou

Avokat amerikan, në “USA Today”, 1-18-2000 dhe 1-20-2000, rreth konvertimit të tij në Islam, thotë:

⁴⁸¹ Paul Frindley, op. cit., f. 46-47.

“Në rastin tim, përkushtimi ndaj Islamit ishte një vendim shumë personal dhe shpirtkërkues. E pranova Islamin si zgjedhje ndaj Krishterimit, i cili ishte besimi i prindërve të mi. Shumë njerëz nuk përballen me një zgjedhje të tillë. Të krishterë të shumtë, thjesht, ndjekin shtegun fetar të paraardhësve të tyre. Fatkeqësisht, shumë të krishterë janë të keqinformuar mbi Islamin dhe ky keqkuptim, më duket mua, shton jotolerancën. Është e lehtë të jesh jotolerant ndaj një feje, të cilën nuk e njeh”.⁴⁸²

Douglas Archer

Ka lindur në Xhamajkë dhe ka qenë protestant. Pasi, e pranon Islamin, jep dorëheqje nga detyra e tij, si profesor i psikologjisë në SHBA, ku kishte specializuar dhe kthehet në vendlindje, që të japë kontributin e tij, për të ftuar bashkëdhetarët e vet në Islam. Punon drejtor, në institutin edukativ, në Karibe.

“Studimi im i doktoraturës ishte në fushën e edukatës dhe të bashkësisë. Aty mësova se çfarë u nevojitet popujve për formimin e tyre në aspektin social, ekonomik, politik dhe atë shpirtëror. Gjatë studimit tim kam zbuluar se shtyllat kryesore të Islamit ofrojnë parime madhështore dhe bazë me vlerë, për riformimin e bashkësisë në aspektin social, ekonomik dhe shpirtëror. Prandaj, nëse më pyet se përse e kam pranuar Islamin, do të të thoja se Islami është feja e vetme, në të cilin shtyllat e tij kryesore ofrojnë bazë për qeverisje, të cilët përfshijnë ndërgjegjen dhe jetën e besimtarit në të njëjtën masë. Edhe pse fetë e tjera e predikojnë besimin në një Zot, ato adhurojnë dy apo tre zota. Kurse muslimanët adhurojnë një Zot të Vetëm dhe nuk i shoqërojnë asgjë gjatë

⁴⁸² Paul Frindley, op. cit., f. 92.

adhurimit. Nga kjo rezulton ndjenja e fortë e vëllazërisë islame në të gjithë botën islame, dhe veçanërisht ndërmjet atyre muslimanëve, që besojnë me besim të fortë dhe që e zbatojnë Islamin me sinqeritet”.⁴⁸³

Rozaroi Paskovini

Avokat nga Milano. Çonte një jetë të vështirë. Tani ka brak-tisur alkoolin dhe jeton si musliman. Është redaktor i gazetës islame “Mesazhi Islam”, e cila botohet në Itali në gjuhën italiane.

“Pas një kohe të gjatë shtegtimi, arrita ta gjej fenë islame, mësimet e së cilës na mësojnë se duhet t’i përulemi vetëm All-lahut. Unë këtë kërkoja dhe ja, e gjeta shpëtimin”.⁴⁸⁴

Shaheen Gulfaam

Nga Holanda, thotë: “Unë isha rritur dhe edukuar në një familje të krishterë dhe besoja Perëndinë me bindje të thellë. Por, në moshën 16 vjeçare, nuk mund ta besoja Jezusin për bir të Zotit... Kjo, madje, më shqetësonte aq shumë sa që mendoja se isha mosbesimtar. Fillova të studioj Hinduizmin, Budizmin, Sikizmin, etj. Mirëpo, gjithnjë, ndjeja se diçka është gabim. Por, kam ditur pak, për fenë islame... Në Universitet, zgjodha arabishten si lëndë dhe zura të lexoj për historinë, fenë dhe kulturën islame.

Kur fillon të merresh me fenë islame, ajo të fascionon dhe të bën për vete. Unë kuptova se mënyra se si unë besoja, për një kohë të gjatë, ishte në përputhje me mësimet e fesë islame... Krahastuar me Krishterizmin, Islami sjell ekuilibrin në jetën e njeriut. Nuk ka ndarje në mes shpirtërores dhe

⁴⁸³ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 150-151.

⁴⁸⁴ Kler Patrik, *Italianët pranojnë fenë islame*, Dituria islame, Prishtinë, 1993. nr. 46. f. 33.

shekullares... Çdo aktivitet jetësor, në Islam, konsiderohet adhurim. Sa bukur është kur të dyja (shekullarja dhe fetarja) shkrihen në një. Të marrim, për shembull, namazin. Kohë më parë, unë ushtroja Jogën dhe meditoja. Ndërkaq, në namaz, njeriu i bënë të dyja dhe, për më tepër, ai fiton një satisfaksion shpirtëror dhe prehje të muskujve të tendosur. Feja islame, më ka mësuar të gjej paqe, qetësi dhe prehje në vetvete”.⁴⁸⁵

R. Ingram

Sineast në Holivud. Ka lindur në Skoci, në fund të shekullit të kaluar dhe ka marrë pjesë në Luftën e Parë Botërore. Ka shkuar në shumë vende të Lindjes. Ka punuar sineast në Holivud. E pranon Islamin, pasi e gjeti të vërtetën. Ai thotë: “Unë jam i bindur se Islami është e vetmja fe, e cila sjell paqe dhe qetësi në brendinë e njeriut dhe i frymëzon atij prehje, rehati dhe kënaqësi në këtë jetë. Fryma e Islamit në brendinë time, është futur fshehurazi dhe kështu fillova të ndiej me mirësinë e besimit, përcaktimin hyjnor dhe të mos ndikohem në mënyrë të tepruar nga ndikimet materiale të kënaqësisë dhe dhimbjes. Për vite e kam studiuar Islamin. Dhe atë nuk e pranova si fe timen, përveçse pas një kërkimi të thellë të zemrës sime dhe një analizimi të gjatë. E ndërrova fenë time të mëparshme, që të gjeja qetësi, larg nga vorbullat e jetës së çmendur, që të shijoja rehatinë në hije të qetësisë dhe të meditimit, larg vështirësive, shqetësimeve dhe sprovave, që shkakton rendja pas fitimit dhe lufta për pasuri, i cili është bërë idhulli i njerëzimit dhe Zot i tyre.

⁴⁸⁵ Zofeen T. Ebrahim, *Pse u bëra muslimane*, Dituria Islame, Prishtinë, 1991, nr. 22-23. f. 35-36.

Unë jam bir i Islamit. Jam më i gëzuar se në cilëndo ditë tjetër të jetës sime. Në mesin e civilizimit tim perëndimor, me veshje perëndimore unë jam i kënaqur, që si musliman besoj Islamin e amshueshëm, i cili është feja qiellore më e përsosur dhe që All-llahu është i kënaqur që ajo të jetë fe e gjithë njerëzimit”.⁴⁸⁶

⁴⁸⁶ Dr. Imadudin Halil, op. cit., f. 155.

B. A. Pattel, (Beshir Ahmed Abdurrahman Pattel)

Ka lindur në Indi, në vitin 1929. Rrjedh nga një familje e vjetër hinduse. Feja e tij, nuk i ofroi bindjen e mjaftueshme, prandaj bëhet socialist-komunist. Edhe kjo, nuk ia plotëson kërkesat. Filloi të kërkojë mes feve, derisa, së fundi, gjeti qetësinë në Islam. Tani, është përgjegjës për katedrën e gjuhës angleze dhe historisë së saj, në një shkollë në Darusalam, në Tanzani.

“Jam bindur plotësisht se Islami është program, i cili realizon qëllimin (e ekzistencës së njeriut). Ai veçohet me thjeshtësi, prakticitet, superioritet, ndjeshmëri, dhe universalitet. Islami i respekton të gjitha fetë dhe flet denjësisht për të gjithë peygamberët. All-llahu i Madhërishëm ka thënë: *“Ju (besimtarë) thuani: Ne i besuam All-llahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre peygamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur”*. (El-Bekare: 136) A ka argument më të plotë se ky, mbi universalitetin e Islamit, të bindjes dhe të besimit islam në Zotin Një dhe të Vetëm?”⁴⁸⁷

Berisha Bankmart

Ka lindur në Tajlandë. Është rritur në një familje budiste, që besonte mësimet e Budës. Megjithatë, ai nuk ndiente qetësi. Pas studimeve edukativo-arsimore, vazhdoi të kërkojë një fe të re, e cila do të ishte fe universale për njerëzimin. Në vitin

⁴⁸⁷ Ibid, f. 157.

1971, pranoi Islamin dhe e ndërroi emrin në Uthman Abdullah.

“Islami është fe e paqes, barazisë, lirisë, vëllazërimit, respektit dhe fuqisë. Kjo shihet qartë nga dispozitat, parimet dhe veçoritë e tij. Agjërimi në Islam, nuk është sikurse agjërimi te fetë e tjera. Islami është fe e natyrshme. Agjërimi islam e kalit egon me durim dhe luftë kundër instinkteve të ndaluara, që të ruhet nga All-llahu në vetmi dhe publikisht. Nuk kam gjetur fe, e cila të ketë vendosur për zekatin, një legjislacion të plotë sikurse Islami. Në shoqërinë islame, e cila përkujdeset për dhënien e zekatit, s’ka të varfër, të braktisur dhe të lënë pas dore. Shoqëria islame, që u përmbahet dispozitave të Islamit dhe vlerave të tij, është shoqëri e pastër dhe e lumtur, në të cilën krimi, me të gjitha llojet e tij, nuk ekziston”.⁴⁸⁸

Mary Oliver

E krishtere, nuk u bind në besimin e saj. Filloi të studiojë Budizmin, Hinduizmin, por nuk gjeti atë që kërkonte. Pasi u bind se Islami është e vetmja fe që i përgjigjet kërkesave të njeriut, e pranoi atë.

“Vlera më madhe e Islamit është se ai i pushton zemrat e njerëzve në mënyrë të vetvetishme, prandaj dhe për këtë arsye gjejmë fascionim të çuditshëm dhe tërheqje madhështore të njerëzve me horizont të hapur në mesin e jomuslimanëve. Ajo që ka ndikuar më shumë tek unë, është thjeshtësia e mësimave islame dhe rruga e drejtë, të cilën ndjekin muslimanët, që i përmbahen mësimave të tij. Islami, ndryshe nga Hinduizmi dhe Krishterizmi, nuk i konsideron asnjë nga mësimet e tij privilegj për një shtresë të caktuar njerëzish.

⁴⁸⁸ Ibid, f. 160.

Kjo do të thotë se në Islam nuk ka papat, as kler fetar, si shtresë e veçuar që gëzon privilegje. Mësimet e Islamit janë për të gjithë njerëzit, ato janë të thjeshta dhe të lehta dhe çdo njeri, me shumë me lehtësi, mund t'i kuptojë ato".⁴⁸⁹

Muhammed Siddiq

Ka lindur në vitin 1944, në Berlin. Ka punuar sekretar, në një bankë, në vitin 1962, pranon Islamin.

"Vërtet, forma e namazit, është ajo që më ka bërë të mendoj për Islamin. Dëshiroja të dija, pse ata njerëz përulëshin gjatë namazit në atë formë. Kam ardhur në përfundim se, ajo është mënyra më e mirë, që e zgjedh njeriu për ta adhuruar Krijuesin e vet. Fillova ta fal namazin sipas mënyrës islame, edhe pse akoma isha protestant. Isha duke kërkuar të vërtetën dhe njohjen. Fillova t'i studioj fetë, në mënyrë të përgjithshme dhe Islamin, në mënyrë të veçantë. Gjatë studimeve të mia u binda se bota ime mendore dhe ndjenjat e mia, ishin më afër Islamit se Krishterizmit. Gradualisht, zbulova se Islami si program jete përputhet plotësisht, në të gjitha aspektet, me natyrën time njerëzore. Këtu mund t'u sjell shembuj teorikë dhe praktikë, p.sh. kur i studiova tekstet islame për Isain [alejhis-selam] kuptova se unë kurrë s'kisha besuar se Isai është bir i Zotit. Më vonë, gjithashtu, mësova nga një profesor protestant se një numër i madh i protestantëve, rreth 80 % e tyre, së paku në këtë aspekt, për nga besimi i tyre janë më afër Islamit se Krishterizmi. Nga aspekti praktik, deri para se ta pranoja Islamin, ikja nga alkooli, vallëzimi etj., gjëra të cilat kuptova më vonë, se ishin të ndaluara në Islam. Kështu pra, për mua, Islami që si një veprim i zbulimit të natyrshmërisë sime. *"Përqëndro vetve-*

⁴⁸⁹ Ibid, f. 155-156.

ten tënde singërisht në fenë, i larguar prej çdo të kote, (e ajo fë), feja e All-llahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga All-llahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë". (Er-Rrum: 30)⁴⁹⁰

F. Filweas

Admiral britanik, ka marrë pjesë në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore. Është rritur dhe edukuar në një familje me traditë krishtere. Pasi lexoi Kur'anin e Shenjtë dhe disa libra islame, në vitin 1924, publikoi pranimin e të Vërtetës dhe u bë musliman.

"Islami mundëson arritjen e harmonisë së plotë në jetën e kësaj bote. Ai është fe e lehtë, në të s'ka gjëra konfuze dhe as të paqarta. Ai nuk përmban supozime dhe hipoteza, të cilat nuk çojnë në besim. Format e adhurimit në Islam janë pasqyrim i çdo vërtetësie, singëriteti dhe besnikërie. Arritjet shkencore pajtohen plotësisht me parimet islame, sepse Islami është fe e dijes... Jam bërë musliman, sepse Islami është feja e vetme e vërtetë, si nga aspekti teorik, ashtu edhe në atë praktik. Mëdyshja dhe dyshimi kaluan shumë shpejt, kur zemrën time e mbërtheu dhe pushtoi ndjenja e fortë, se Islami është rruga e drejtë".⁴⁹¹

Q. Al Aine

Rrjedh nga një familje fetare krishtere. Ka lindur në Nju Jork. Ka mbaruar universitetin në Pensilvani. Ishte e pasionuar pas leximit dhe studimit, veçanërisht në fushën e feve

⁴⁹⁰ Ibid, f. 204-205.

⁴⁹¹ Ibid, f. 209.

komparative. Në Islam, gjeti përgjigjet e mjaftueshme për pyetjet e saj. Kështu ajo e pranoi Islamin.

“Interesohesha për studimin e feve. Në Islam gjeta tolerancë dhe arsyeshmëri. Pashë se interesimi im për Islamin e kishte kaluar thjesht fazën e shfletimit, leximit apo dëgjimit për të, duke arritur në fazën e lidhjes me këtë fe. E ndjeva veten të lumtur, sepse më në fund gjeta fenë, e cila më mundëson që të sillem ndaj vetes dhe Zotit tim, në bazë të parimeve të shëndosha që reflektohet në veprimet e mia të shëndosha dhe të moralshme ndaj anëtarëve të shoqërisë. Ndieja se ajo që lexoja më bindte logjikisht dhe plotësonte, gjithashtu, zbrazëtinë shpirtërore në zemrën time. Ndieja, se unë lexoja për një fe të re, e cila nuk ishte e re për shpirtin tim. Leximi i përgjigjeve logjike dhe gjeta përgjigje rreth pyetjeve të shumta, të cilat vërtiteshin më parë në brendinë time. Shkurt, në Islam, gjeta kënaqësinë, të cilën e kërkoja më parë dhe e falënderoj All-llahun për këtë”.⁴⁹²

Qamila Qarar

Ka lindur në Austri. Rrjedh nga një familje ateiste. U përpoq të bëhej e krishterë, por krishterizmi nuk e bindi atë. Lexon për Islamin dhe pasi bindet, në moshën njëzetvjeçare pranon Islamin.

“Jam ndikuar shumë nga fakti i barazisë në mes muslimanëve dhe më ka pëlqyer të qenit e Islamit fe universale, për mbarë njerëzimin. Në Islam kam gjetur një fe, e cila i unifikon të gjitha fetë dhe ngjyrat në hijen e një sistemi fetar unikal. Në Islam ka vëllazëri të vërtetë, të cilën nuk e ka njohur dhe nuk e njeh asesi shoqëria materialiste perëndimore. Gjithashtu, edhe parullat boshe socialiste s’mund të

⁴⁹² Ibid, f. 211.

ofrojnë kurrë një vëllazërim të tillë. Islami ka shkaktuar ndryshim në gjithë jetën time. Ai më ka liruar nga dëshpërimi, qortimi dhe dorëzimi dhe këto janë rezultat i këndvështrimit materialist, i cili dominon tek shumica e njerëzve në shoqëritë perëndimore”.⁴⁹³

Thomas M. Clayton

I krishterë amerikan, nuk gjen bindjen e duhur në Krishterizëm dhe e braktis atë. Një ditë prej ditësh, i bie në dorë Kur’ani, me përkthim në gjuhën angleze dhe i hapet rruga drejt së Vërtetës. Pas një studimi të literaturës islame, në vitin 1947, pranon Islamin.

“Pasi të kuptojmë esencën e Islamit, e kemi të lehtë të mësojmë arsyen, që e nxit njeriun t’i bashkohet flamurit islam. Çdo musliman e di se, Islam do të thotë bindje dhe nënshtrim i plotë ndaj vullnetit të All-llahut. Kur lindim, lindim muslimanë, por pastaj e lemë rrugën e All-llahut dhe pasojmë rrugët e shtrembëta. Islami është fe e natyrshme. Çdo foshnje lind me natyrshmëri të pastër (islame) dhe rritet kështu, derisa nuk i imponohet ndonjë besim tjetër, që bie ndesh me vullnetin e All-llahut. Mund të themi se edhe shkëmbinjtë dhe pemët janë muslimanë (të dorëzuar) sepse ata iu nënshtrohen ligjeve të All-llahut në krijim. Prandaj, nga kjo ne kuptojmë se nëse përpiqemi ta largojmë muslimanin nga bindja dhe nga feja e tij, në çfarëdo fe tjetër, kjo do të thotë se ne përpiqemi të ndërhyjmë dhe veprojmë kundër ligjeve të natyrshme të All-llahut, dhe domosdo natyrshmëria do të hakmerret (Er-Rrum: 30)”.⁴⁹⁴

⁴⁹³ Ibid, f. 210.

⁴⁹⁴ Ibid, f. 222.

Fatima Zuesken

Nga ish-Çekosllovakia, ka studiuar kaligrafinë. Ka lexuar shumë dhe ka kontaktuar me një numër gjermanësh që e kishin pranuar Islamin. Pasi bindet, në vitin 1963, pranon Islamin dhe nga Monika bëhet Fatime.

“Në fillim nuk kuptoja dallimin e madh, që është në mes mesimeve islame dhe traditave lindore. Këtë arrita ta kuptoj, kur hyra në botën shpirtërore islame, nëpërmjet Kur’anit dhe librave islame. Kështu, fillova të ndiej se, dalëngadalë, Islami po më tërhiqte. Mësimet e tij, i drejtoheshin mendjes dhe ndërgjegjes sime. Ajo që më ka tërhequr më së shumti është sistemi i përkryer shoqëror në Islam, barazia ndërmjet të gjithë njerëzve, toleranca e cila s’ka kufi, përpjekja për të kërkuar dijen, gjë që konsiderohet obligim për çdo musliman dhe muslimane dhe së fundi jam mrekulluar nga lidhja e drejtpërdrejtë midis robit dhe Zotit të tij. Duke lexuar librin e All-llahut, kam kuptuar se Islami është rruga e vetme, të cilën Zoti ia ka mësuar, që nga fillimi i krijimit, njerëzimit dhe se ai është i vërtetë”.⁴⁹⁵

Rabija Lemaie Evans

E lindur në Belgjikë, pasi që viziton Indinë bëhet muslimane. Ajo, veç të tjerash, thotë:

“Nuk e shoh të arsyeshme, pse të mos jem si perëndimorët e tjerë, por, në të njëjtën kohë, të jem edhe muslimane”.⁴⁹⁶

Mojra Ni’Kolmejn

⁴⁹⁵ Ibid, f. 165-166.

⁴⁹⁶ *Përse Mojra bëhet Bushra*, Dituria Islame, Prishtinë, 1994. nr. 62. f. 21.

Është edukuar në frymën irlandeze katolike. Pas kontakteve, që pati me muslimanët, në Spikers Korner, në Hajd Park në Londër, edhe pse gjithnjë kishte menduar, duke thënë se, jam katolike dhe do të vdes e tillë, në vitin 1992, kaloi në Islam dhe mori emrin Bushra.

Ajo thotë: “E dua sigurinë dhe vlerat morale islame. Në Islam, e di se ku e ke vendin dhe cilat janë të drejtat e tua. Për katolikët, paraqet shqetësim të madh, ndalesa e marrëdhënieve seksuale para martesës. Ndërkaq, në Islam kjo gjë është shumë e thjeshtë. Nuk mban kontakte me njerëzit jashtë martese. Nga mashkulli, kërkohet që të përkujdeset për gruan e vet, kurse unë parapëlqej faktin se, prona ime konsiderohet imja, kurse çdo gjë, që e ndaj me të tjerët, konsiderohet akt bamirësie. Kështu, Islami ka vendosur ekuilibër në mes dy gjinive”.⁴⁹⁷

Xhozefina

Murgeshë katolike, studionte teologjinë dhe banonte në konvikt të murgeshave në qytetin Modena, në jug të Italisë. Një ditë, ajo filloi të lexojë Kur'anin dhe ai u bë i pandashëm nga shpirti i saj. Dyshimi mbi fenë e saj dhe profesionin që ushtronte, zuri t'i vijë vërdallë në kokë. Shpesh, shkonte në Qendrën Islamike, në Milano. Në fund, pasi mendoi dhe meditoi gjatë, braktisi kallogjerizmin dhe fenë katolike, dhe pranoi fenë islame. Mori emrin Fatime.⁴⁹⁸

Dr. Hamid Marcus

⁴⁹⁷ Ibid, f. 21.

⁴⁹⁸ Kler Patrik, *Italianët pranojnë fenë islame*, Dituria Islame, Prishtinë, 1993. nr. 46. f. 33.

Shkencëtar, autor veprash e gazetar gjerman, botues i "Moslemische Revue" në Berlin, për arsytet e pranimit të Islamit, thotë:

"Që kur isha i ri, ndieja një shtytje nga brenda për të mësuar diçka për Islamin dhe studiova një përkthim të vjetër të Kur'anit të botuar që në vitin 1750. Ky ishte edicioni, prej të cilit edhe Gëte kishte marrë njohuri për këtë fe. Nga studimet që bëra, u preka thellësisht në shpirt për ndërtimin racional të Islamit, gjë që më tërhoqi shumë. U impresionova shumë nga revolucioni gjigand shpirtëror, që u bë në vendet islame të asaj kohe. Islami u shtoi shumë ide të mira koncepteve të dobishme të njerëzimit. Ai nuk merret me dogma, që bien ndesh me të dhënat shkencore moderne; besimi në Zot është i shenjtë dhe pajtohet me arsyen. Në Islam, nuk ka konflikt ndërmjet besimit, nga njëra anë, dhe shkencës, nga ana tjetër.

Feja islame predikon një sistem që ndikon në jetën e përditshme të njeriut.... Islami ndjek një rrugë të mesme ndërmjet individualizmit e socializmit logjik, krijon një hallkë ndërli-dhëse, ndërmjet asaj që urdhërohet dhe asaj që zbatohet nga liritë individuale".⁴⁹⁹

Fatime Kazue

Nga Japonia

"Isha fatlume që u njoha me një besimtar, i cili banonte përkohësisht në Tokio. Përgjigjet që mora ishin të sakta, të drejta, të kënaqshme dhe aq me vend, sa më sollën një qetësi e rehati në mendje e shpirt! Kurrë nuk kam menduar se, jeta ime do të ndryshojë dhe do të ndërrojë aq shpejt, ashtu

⁴⁹⁹ Dr. Hamid Markus, *Na cikli 'përse e përqafova Islamin'*, Drita Islame, Tiranë, nr. 11-12, korrik, 1999, f. 4.

sikurse ndodhi me mua, kur fillova të jetoj si besimtare muslimane. Nga miku im musliman, unë mësova shumë gjëra, që duhet t'i besoj çdo musliman i devotshëm.

Unë e dua shumë mënyrën e jetesës islame, jetesë e cila është e pastër, e thjeshtë dhe paqedashëse! Jam plotësisht e bindur se, vetëm Islami mund t'i sjellë paqe individit dhe shoqërisë. Vetëm feja islame mund t'i sjell botës paqen, për të cilën njerëzimi është aq shumë i nevojshëm”.⁵⁰⁰

Ms. Linda Lam, (Jasmina Lam)

Mësuese e gjuhës angleze, thotë: “Ndihesha e paafte, që përmes fesë sime t'u përgjigjesha pyetjeve që kishin të bënin me Krijuesin, njeriun, etj. E braktisa fenë time, për shkak të përgjigjeve, që më ofronte ajo rreth së vërtetave dhe fillova të kërkoj gjithandej, por u dëshpërova pa masë, sepse nuk po gjeja dot të Vërtetën, megjithëse një shkëndijë shprese vazhdonte të më mbante gjallë! Njoha Budizmin, Hinduizmin dhe filozofi të ndryshme... por nuk mora përgjigjen e duhur, rreth pyetjeve të mia dhe nuk gjeta qetësinë e duhur shpirtërore. Më në fund, takova një musliman, i cili më foli gjerësisht për shpalljen e Kur'anit.

Duke dëgjuar pjesë nga Kur'ani, zemra më ngazëlleu nga gëzimi dhe mallëngjimi. E gjeta menjëherë veten time... Më në fund, Zoti më mundësoi të njihja të Vërtetën.

Kalova javë e muaj, duke bërë pyetje rreth Kur'anit dhe thënieve të Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Për çdo pyetje, mora përgjigjen e duhur. Ndjeva kënaqësi dhe qetësi shpirtërore. Vetëm, nëpërmjet Islamit, kuptohet e Vërteta. Realiteti zëvendëson iluzionin, dëshpërimin e zë

⁵⁰⁰ Pse zonjusha japoneze e pranoi fenë ilame, Dituria Islame, Prishtinë, 1996. nr. 84. f. 38.

paqja. Feja islame ofron përgjigje për çdo pyetje, sepse është Fe e shpallur nga Zoti, Krijuesi i Gjithëdijshtëm”.⁵⁰¹

Dr. A. Keen

Filozof amerikan. Është marrë me gazetari, më pas ka shkruar artikuj, me përmbajtje shoqërore dhe filozofike. Në vitin 1961, deklaroi pranimin e Islamit, në Nju Jork.

“Isha tërhequr në vetvete dhe lexoja me zell dhe vëmendje, çdo gjë që më binte në duar, prej librave të feve të ndryshme. Kështu, vazhdova për 10 vjet. Në fund, arrita në një përfundim të rëndësishëm, gjeta të Vërtetën, të cilën e kërkoja prej kohe. Arrita konkluzionin jetik: do të pranoj Islamin dhe do të bëhem musliman. Kam kuptuar me bindje të plotë se feja islame është fe e arsyes dhe e logjikës, fe e jetës së kësaj dhe e asaj bote. Ajo gjithashtu është fe, e cila i përgjigjet jetës materiale dhe shpirtërore. Kam kërkuar shumë për sekretin e ekzistencës dhe jam thelluar në studimet e mia. Si studiues i filozofisë dhe sociologjisë, kam kuptuar se Islami është e vetmja fe qiellore, që është më afër qenies njerëzore. Bindja ime se Islami është fe fisnike është forcuar, dhe unë e pëlqeva atë dhe e përqafova”.⁵⁰²

Fatime Lamear

Është me origjinë gjermane. Nuk e bindi feja e saj e krishterë. Filloi të interesohet për Islamin, që nga viti 1951.

Më vonë bëhet muslimane. Ajo thotë:

“Islami më ka ardhur, ashtu siç vjen burimi i nxehtë në tokën e ftohtë, pas dimrit me acar. Ai, më ngrohu shpirtin

⁵⁰¹ Drita Islame, viti V, qershor, 1996. nr. 11 (94), f. 4.

⁵⁰² Ibid, f. 230.

dhe, me mësimet e tij të pastra, më përshkoi trupin. Ah, sa të qarta, të këndshme dhe sa logjike janë mësimet islame! Nuk mund të përshkruaj gëzimin, i cili më ka kapluar me pranimin e Islamit. Ndjeva se kjo ishte feja që e prisja. Deklarimi i pranimit të Islamit nga unë, ishte një përkthim i dukshëm i zërit të ndërgjegjes sime. Islami është feja më e vjetër dhe para të gjitha feve. Në kohën kur mësimet dhe parimet e feve të tjera kanë filluar të lëkunden përballë madhësisë së shkencës, dijetarët e botës në kohën tonë, kanë filluar t'i drejtohen Islamit, duke kërkuar kënaqësi, sepse mësimet e Islamit janë më afër shkencës, se çdo fe tjetër".⁵⁰³

Ayesha Bridget Honey

Është rritur në një familje angleze të krishterë. Ishte e pasionuar pas filozofisë. Gjatë studimeve, në Kanada, njihet me të vërtetën. Ajo tregon:

"Në fëmijëri unë studiova në një shkollë fetare dhe mësova lëndët që mësohen në shkollat e Kishës Angleze. Por, nuk isha e kënaqur me disa nga besimet bazë të Krishterimit. Veçanërisht, me trinitetin dhe besimin se, Zoti apo Jezusi, i ka liruar njerëzit me shpërblësë dhe, duke pranuar kryqëzimin, ka shlyer fajin e mëkateve të tyre. Unë dëgjoja shumë diskutime dhe argumentime rreth këtyre bindjeve, por, tërë atë që dëgjoja, më dukej vetëm një anë e realitetit, rreth të cilit unë doja të dija gjithçka. Shkolla ime ishte shkollë kristiane, por unë u largova prej saj si një jobesimtare.

Kur lexova librin e Tao The Ching, që është një përmbledhje e shkrimeve të hershme, rreth filozofisë kineze të Taos, u ndikova nga mendimi i tij. Pastaj, kur gjeta disa informacione, rreth Budizmit, vendosa të shkoj në thellësi të këtyre dy

⁵⁰³ Ibid, f. 231.

besimeve filozofike. Kur shkova në Kanada, u njoha me filozofinë Hindu dhe lexova librat e shenjtë Hindu. Tre besimet: Tao Czi, Budizmi dhe Hinduizmi, kishin bukuri, thellësi e ekzaltim. Por, asnjë prej tyre, s'mund të kënaqte mendjen time dhe ndjenjat e mia... këto fe, kanë dështuar totalisht, për të arritur ndonjë balancim. Ato neglizhonin disa nga aspektet e jetës së njeriut.

Çfarë duhet të besoj? Cili është qëllimi i jetës? A është jeta, thjesht një shans, një aksident, sikurse thonë disa njerëz?!

Në Universitet, pata fatin të njohesha me muslimanët. Deri atëherë s'kisha dëgjuar, as lexuar asgjë rreth Islamit. Si njerëzit e tjerë në Perëndim edhe unë ushqoja paragjykime e moskuptime për të. Më pas, fillova të lexoj rreth Islamit. Isha shumë e impresionuar nga logjika dhe argumentimi i muslimanëve, për Krijuesin e Universit. Kam pyetur veten shpesh, rreth arsyeve kryesore që më bënë mua të pranoj Islamin. Është e vështirë për mua të jap një përgjigje të kënaqshme për këtë, sepse shembulli i Islamit, sikurse e ka thënë një musliman evropian, është si një model gjeometrik perfekt e i kompletuar, ku çdo pjesë e tij, plotëson pjesët e tjera dhe bukuria e tij e vërtetë, ndodhet në harmoninë dhe koleksionin e këtyre pjesëve. Kjo është karakteristikë e Islamit, i cili ndikon thellësisht në qeniet njerëzore...

Bota perëndimore jeton në errësirë. S'ka, madje, asnjë dritë të vogël shprese, që ajo të marrë rrugën për lirim dhe shpirtit dhe qenies. Secili, që është në dijeni për gjendjen aktuale të shoqërive perëndimore, sheh lodhjen dhe shqetësimin, që fshihet pas shkëlqimit verbues fals dhe përparimit material. Tani, njerëzimi po kërkon rrugëdalje nga vështirësitë, por nuk po sheh rrugëzgjidhje. Kërkimi i tyre është pa fryt. Para tyre qëndron vetëm një zgjidhje, që ata të shkojnë edhe më tej përpara drejt territ! Ndërkaq, harmonia e bukur në mes kërkesave trupore dhe nevojave shpirtërore, që prezanton

Islami është tërheqëse e fortë për Perëndimin. Islami mund t'i tregojë, civilizimit modern, rrugën që çon në suksesin e vërtetë dhe në shpëtim. Ai, mund t'i ofroj njeriut perëndimor, kuptimin e qëllimit të vërtetë të jetës dhe ta shpie drejt kënaqësisë së All-llahut⁵⁰⁴.

Prifti Isak

Kryetar i Komitetit, për përhapjen e fesë së krishterë, në Afrikë dhe Azinë Perëndimore. Një ditë u ul në karrigen e pendimit, që të dëgjojë mëkatet e një gruaje të përdalë, e cila i kërkoi atij falje, meqë ishte prift. Mirëpo, në vend, që të ngrinte kryqin, në fytyrën e saj, sipas traditës së krishterë, sipas së cilës, prifti "ia fal" mëkatet një mëkatari, ai filloi të qajë para saj, duke thënë: "Unë fal mëkatet e tjerëve, e kush do të falë mëkatet e mia?".

Ai tregon: "Erdhi një grua, duke kafshuar gishtat nga pendimi dhe më thotë: unë bëra tre herë mëkat dhe jam para teje, duke e pohuar me gojën time. Të lutem zotëri, më fal mëkatet dhe ju premtoj që nuk do të përsëris më! Kur desha ta ngre kryqin, nuk ma bëri dora, goja mu paralizua, qava e thashë me vete: kjo ka ardhur tek unë, të kërkoj të falur për mëkatet e saj, po mua kush do të mi falë mëkatet? Në atë çast, para syve, m'u shfaq Kur'ani i Shenjtë dhe më pas e lexova, me zë, kaptinën *El-Ihlas*:

"Thuaj: Ai, All-llahu është Një! All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë".

Shkova menjëherë te peshkopi dhe i thashë: Unë fal mëkatet e të gjithë njerëzve! Po kush do t'i falë mëkatet e mia? Ai mu

⁵⁰⁴ Bisedë me Ayesha B. Honey, Triumfi Islam, Shkodër, 1994. nr. 15. f. 4.

përgjigj: Papa! Kush i falë mëkatet e Papës? Në atë moment, peshkopi u dridh dhe bërtiti si i xhindosur duke thënë: Papa nuk bën gabime, as mëkate! Si është e mundur ta bësh këtë pyetje?

Thashë: 'I falem All-llahut, vetëm ai nuk gabon'. Me urdhër të Papës, më burgosën. Pas tre ditësh, me sy të lidhur, më vendosën ndërmjet priftërinjve të tjerë, të cilët më godisnin me shkop, duke thënë: Ky është dënim për ata, që shesin fenë dhe kishën. U dhanë urdhër murgjve të vazhdojnë torturimin tim, me mënyra nga më të ndryshmet saqë ende më kanë ngelur shenja në trup. Më vonë, më vunë si bari derrash. Pas tre muajsh, më dërguan në një manastir, për edukim fetar. Kryemurgu më priti, me këto fjalë: 'O bir, Zoti shpërblet ata që rrojnë dhe kryejnë vepra të mira. Do të rrosh dhe ki shpresë tek All-llahu.' Thashë me veten time, këto fjalë, nuk janë nga Bibla, as nga fjalët e shenjtorëve të krishterë... dhe ja një ditë trokita në derën e tij dhe nuk mu përgjigj njeri. Hapa derën, hyra brenda dhe u befasova kur pashë që, Kryemurgu po falte namazin e sabahut. U gozhdova në vend, nga ato që pashë dhe mblodha veten menjëherë. Mbylla derën, që të mos më shihte njeri. Pas disa çastesh, më erdhi me sy të përbotur, duke thënë: 'Mos trego, o bir. Ajetet e Kur'anit, janë ushqim i shpirtit tim dhe shoku im në vetminë time, udhërrëfyes në rrugën e Zotit'.

Hasa në shumë vështirësi, për të shpallur Islamin tim, sepse isha prift me pozitë, kryetar për përhapjen e fesë së krishterë, në Afrikë. Pas shumë debatesh, më thanë: O pronat e tua, o fenë e re. Ua dhashë gjithë pasurinë, sepse, fenë islame, nuk e krahasoj me asgjë. Kur'ani është i përkryer".⁵⁰⁵

⁵⁰⁵ *Pendimi im filloi në karrigen e pendimit, Shkëlqimi Islam, viti II, Tiranë, 18 Janar, 1992, nr. 1, (3), f. 4.*

Muhamed Eman Hobahm

Ish-diplomat gjerman në shumë vende të botës, thotë:

“Përse ne, në Perëndim, e pranojmë Islamin? Arsytet janë të shumta. Arsyeja e parë: E Vërteta, përherë ka fuqinë e saj. Parimet kryesore të fesë islame janë aq racionale, aq të natyrshme dhe aq tërheqëse, sa që për një hulumtues të ndershëm të së vërtetës, është e pamundur të mos impresionohet prej tyre. Për shembull, besimi monoteist. Sa natyrshëm të tërheq feja islame në barazinë e njerëzimit, sepse të gjithë jemi nga i njëjti Zot dhe të gjithë jemi shërbëtorë të të njëjtit Zot... Ideja e jetës pas vdekjes, të transformon. Besimi në Ditën e Gjykimit e ndalon njeriun nga veprat e këqija dhe e nxit të bëjë vepra të mira, të cilat ia sigurojnë shpëtimin e përhershëm. Besimi se, askush s’mund t’u ikë pasojave të gjykimit nga Zoti, e bëjnë njeriun të mendojë mirë, para se të bëjë ndonjë gabim. Arsyeja tjetër, që të tërheq të pranosh Fenë Islame është toleranca. Namazi i përditshëm, e mëson njeriun me përpikërinë, agjërimi i muajit të Ramazanit, e ushtron njeriun në vetëkontroll...”

Unë kam jetuar në sisteme të ndryshme të jetës dhe kam pasur raste të studioj ideologji të ndryshme, por kam arritur në përfundimin se asnjëra nga ato, nuk është aq e përsosur sa Islami. Asnjë sistem, nuk ka një kod të plotë për ndërtimin e një jete kaq fisnike, përveç Islamit, i cili nuk është (vetëm) teorik, por (edhe) praktik e i zbatueshëm me sukses. Etimologjikisht, fjala islam do të thotë: ‘Nënshtrim i plotë ndaj vullnetit të Zotit’, ashtu siç është Islami në praktikë.

Vetëm feja islame, është e përsosur dhe kjo është arsyeja, që unë e pranova dhe që njerëzit e mirë, po e pranojnë atë”.⁵⁰⁶

⁵⁰⁶ Drita Islame, Tiranë, qershor, 1996. nr. 11 (94), f. 1.

Anatoll

Gjeneral rus, i cili pasi pranoi Islamin, hoqi kapelën e gjeneralit dhe u bë muezin në xhami. Ai mori emrin Ali. Rreth shtegtimit të tij drejt Islamit ai thotë:

“Unë jam rus i lindur në Baku - Azerbajxhan. Aty u rrita dhe i kreuva mësimet. Në mënyrë fanatike e urreja Islamin, sa që ndjeja urrejtje e neveri të pa masë ndaj nxënësve muslimanë. Rrjedh nga një familje krishtere, mirëpo nuk besoja në asnjërin fe dhe vazhdimisht tallesha me nxënësit të cilët përmendnin gjëra të padukshme fetare. Gjithnjë shtroja pyetjen, se si është e mundur që njeriu të shndërrohet në dhë e pastaj të kthehet përsëri në jetë dhe të japë llogari para Zotit, dhe kështu të hyjë në Xhennet apo Xhehennem. Nuk hulumtoja për të vërtetën nga se nuk dyshoja asnjëherë në vërtetësinë e mendimeve të mia, ndërsa kënaqesha duke i urrejtur dhe nënçmuar muslimanët. Pasi hyra në ushtri dhe meqë isha udhëheqës i forcave ruse në betejën e Kandaharit në Afganistan, kjo qe rruga ime nëpërmes të cilës më vonë do ta gjej të vërtetën. E ndjeja veten shumë të gëzuar sepse më ishte dhënë rasti që gjithë armiqësinë time ndaj Islamit dhe muslimanëve ta realizoj në praktikë. Krahës kësaj kisha urrejtje të madhe ndaj muxhahidëve për të cilët mendoja se janë të zhytur në injorancë, që refuzojnë civilizimin dhe duan jetën e shpellave e të maleve. Mirëpo, nuk është për t’u çuditur, sepse kjo ishte pasojë e njohurive dhe e propagandës së rrejshme që na ofronte muri i errësirës socialiste që na mbajti në burg më se shtatëdhjetë vjet të tëra. Nga ushtarët e mi kërkoja që të sillen sa më brutalisht me muslimanët, që të mbysin e vrasin sa më shumë muslimanë dhe të sillen sa më keq me robërit. I luftuam me armët më moderne që disponim, i bombardonim nga ajri me armët më shkatërruese. Ndërkaq, arma e tyre e vetme ishte xhihadi i çuditshëm dhe

pushka e cila nuk mund të kapte as gjahun më të thjeshtë. Duke qëndruar me oficerët tjerë u thosha atyre se muxhahidinët janë të marrë kur luftojnë e ballafaqohen me ushtrinë e shumtë e të armatosur deri në dhëmbë me armatimin më bashkëkohor, ndërkohë që ata ishin duar thatë. Mirëpo, kohë pas kohe, gjithnjë e më shumë befasohesha me njerëzit e tillë të cilët fare nuk i frikësoheshin vdekjes! Fillova të mendoj më shpesh për ata, të cilët ngadhënjenin edhe përkundër fuqisë dhe armatimit tonë superior. Me të vërtetë ata i mbronin një fuqi më e madhe, e padukshme dhe u ndihmonin një armë më e fuqishme. Së këndejmi u bëra skeptik dhe tek unë lindi dyshimi. Ky ishte fillimi i rrugës sime kah hulumtimi i të vërtetës... Dhe meqë, e gjeta të vërtetën në vete, fillova t'i ftoj në Islam, së pari familjen time – bashkëshorten e djemtë të cilët edhe e pranuan fenë e re e përparimtare - Islamin.

Një ditë në mëngjes u zgjova nga gjumi dhe erdhi e vërteta, erdhi ajo e vërtetë që më mungonte aq kohë të gjatë, e ajo ishte feja islame. I njoftova shokët e mi për këtë, mirëpo, ata më thanë që mos e bëja kurrsesi një gjë të tillë. Por, zemra ime tashmë ishte mbushur me iman, zëri i së vërtetës kishte depërtuar në të gjitha pjesët e trupit tim. Menjëherë iu drejtova imamet M. H. dhe kërkova nga ai që ta shpallë Islamin tim. Të gjithë u gjendëm të përbotur nga gëzimi i papërshtatshëm.⁵⁰⁷

⁵⁰⁷ Ish-gjenerali rus pranoi Islamin, hoqi kapelën e gjeneralit dhe u bë muezin në xhami, Takvimi, Prishtinë, 1993, f. 95-98.

T. H. Mc Barklie

Nga Irlanda, thotë: “Këto pak rreshta, janë një përpjekje modeste, nga ana ime për t’iu përgjigjur pyetjeve të shumta që më vijnë nga vende të ndryshme dhe kërkojnë shpjegime, se pse përqafova Islamin... Pranova këtë fe, sepse kjo fe është fe historike dhe mësuesi i saj është personalitet historik. Për fetë e tjera dhe mësimet e tyre, ne dimë shumë pak. Disa të dhëna, që përbëjnë parimet morale, na janë të njohura, por saktësia e tyre është pranuar në atë mënyrë, ku ka vend për hamendje. Jeta e të gjithë mësuesve të feve të tjera, është e errët, e shoqëruar me mite dhe mistere... Ndërkaq, me rastin e Islamit, asnjë njeri nuk dyshon në autenticitetin e shkrimit të tij të shenjtë. Libri i Islamit, Kur’ani i Shenjtë, është i njëjtë (identik) me atë, që ishte në ditët e Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Veprat dhe thëniet e tij, me të cilat ai i shtjellon parimet e ndryshme të Kur’anit, kanë arritur deri te ne me një pastërti origjinale. Unë gjeta në të ngushëllim, për çka isha lodhur kot së kërkuari gjatë! Kisha nevojë për një fe të thjeshtë e praktike, të zhveshur nga dogmat, doktrinat dhe mendimet, të cilat s’do të mund t’i pranoja pa vrarë arsye. Këtë, unë e gjeta në Islam”.⁵⁰⁸

Dr. Silvia Feuzi

Tregon: “Kam jetuar në Paris, kam studiuar inxhinierinë kimike, ku edhe kam magjistruar. Përgatitesha për disertacion dhe, edhe pse posedoja komoditet dhe post të lartë shkencor, gjithmonë isha e mërzitur dhe e shqetësuar. Njerëzit në Paris, kanë liri të plotë dhe jetë komode, por e di se ata nuk janë të lumtur, nuk ndiejnë qetësi. Studiojnë me

⁵⁰⁸ Pse e përqafova Islamin, Drita Islame, Tiranë, dhjetor, 1994. nr. 18. f. 2.

seriozitet Budizmin, Krishterizmin, Hebraizmin. Ndërkaq, kur është fjala për Islamin, e vërteta rreth tij shtrembërohet. Thuhet se Kur'anin e ka shkruar Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], se Islami është fe e luftës dhe shpatës, kurse gruaja muslimane është robëreshë e burrit, se nuk ka kurrfarë të drejte... Mjetet e informimit japin pamje jo të vërtetë për Islamin. Islamin e paraqesin si të tillë, që nuk meriton të mendohet rreth tij, madje shfrytëzojnë të gjitha metodat propaganduese dhe informative për këtë qëllim. Nëpërmjet një familje muslimane, fillova ta njoh Islamin, në mënyrë të drejtë, fillova të lexoj rreth Islamit dhe zemra ime filloi të gjejë qetësi. Fillova të kuptoj shkakun e shqetësimit dhe mërzisë sime, para Islamit. All-llahu më përgatiti për ta pranuar Islamin. Gjoksi im u zgjerua, shpëtova nga humbja. Për të gjitha pyetjet që i kisha në kokë, rreth jetës dhe vdekjes, gjeta përgjigje të plota në Islam. Deklarova dëshminë, shehadetin dhe e pranova Islamin... Isha në humbje dhe jetoja me njerëz të humbur! E falënderoj All-llahun që më udhëzoi në Islam".⁵⁰⁹

Franko Licizi

Artist që rrjedh nga një familje e Napolit. Si shumica e italianëve, është edukuar me parimet dhe mësimet e fesë katolike. Për disa vite, thotë ai, më janë shfaqur disa ndjenja të padefinuara dhe ndieja se më mungonte diçka. Pas një sërë vizitash, që ia bëri Xhamisë së Napolit, i shoqëruar nga një mik i tij italian, i cili qysh më parë e kishte pranuar Islamin, Licizi, bindet se feja islame do t'ia plotësonte atë prirje të padefinuar dhe atë boshllëk. Ai thotë:

⁵⁰⁹ Në *Islam gjeta përgjigjen e pyetjeve të mia*, Rinia Islame, Shkodër, dhjetor, 1998, f. 5.

“Gjithnjë orvatesha që t’i krijoja vetes shprehinë e vetëdisiplinës. Por kjo, nuk zgjati shumë. Ndërkaq, gjatë gjashtë vjetëve të shkuara, vura re një përmirësim të dukshëm. Duke kryer namazin, në kohën e vet, pesë herë në ditë, arrin ta thyesh monotoninë e punës së përditshme dhe të jepet mundësia që të mendosh për çështje të ndryshme. Kështu, njeriu arrin të mos shndërrohet në robot dhe të mos bëhet vegël mekanike. Ne që jetojmë në Perëndim, jemi si të kredhur në një gjumë të rëndë, dhe kemi humbur shumë nga dimensionet e jetës shpirtërore, duke kaluar një jetë të pakuptimtë dhe trishtuese”.⁵¹⁰

John Webster

Ka lindur në Londër dhe është rritur si i krishterë, me bindje protestante. Ai thotë:

“Si i ri, fillova të ballafaqohem me problemet e jetës dhe në këtë kohë nuk i vëreja mangësitë e Krishterizmit. Krishterizmi është një dualizëm, i cili e paraqet botën si të mëkatshme. Me entuziazmin rinor, më tepër emocional se sa i ditur, refuzova Kishën dhe Krishterizmin dhe u bëra komunist. Komunizmi, nuk më solli kënaqësinë e duhur dhe, për shkak të materializmit, e refuzova edhe këtë. Më vonë, fillova të studioj filozofinë dhe religjionin. Gjatë kohës sa jetova në Australi, u interesova të gjeja Kur’anin e Shenjtë, në librarinë publike të Sidnejit. Nuk mund të përshkruaj dhe as të shpreh, atë që ndjeva kur lexova suren *El-Fatiha*. Lexova edhe rreth jetës së Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sellem]. Me mëshirën e All-llahut, gjeta atë që kërkoja. U bëra musliman. Kur dola nga libraria, e ndjeva veten të lodhur nga tronditja intelektuale dhe emocionet që përjetova në

⁵¹⁰ *Kler Patrik*, Dituria Islame, Prishtinë 1993, n. 46, f. 34.

librari, gjatë leximit të Kur'anit dhe biografisë së Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Pyeta veten: Ishte e vërtetë ajo që lexova, apo isha në ëndërr, ç'është ajo që më transformoi menjëherë?! Duke ecur, rrugës sytë më shkuan në një ndërtesë ku shkruante 'Muslim Mosque' (Xhamia e muslimanëve). Aty për aty, i thashë vetes: e njohe të Vërtetën, tash pranoje!

La ilahe il-lall-llah Muhammedun resulull-llah! - dhe kështu, me mëshirën e All-llahut, u bëra musliman! Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër, përveç All-llahut, Muhammedi është i Dërguari i Tij".⁵¹¹

Robert Artur Viljemz (Abdurreshid Elensar)

Maestro i njohur anglez i baletit. Braktisi artin dhe skenën e baletit, edhe pse qëndronte në krye të baletit anglez. Harroi rolet e tij udhëheqëse në 'Ana Karenjina', 'Kali i çuditshëm', 'Rënia e idhullit' dhe shfaqje të tjera baleti. Harroi entuziazmin, që krijonte në sallë dhe duartrokitjet frenetike, duke interpretuar shumë vepra të Shekspir. Tani, punon profesor i edukatës fizike, në Kajro. Ai thotë:

"Që nga rinia e hershme, kam qenë i përkushtuar me mendime për Zotin. Mirëpo, jeta dinamike, jeta e natës dhe pijet, më kanë shkatërruar shëndetin. Shtrirja në shtrat, më mundësoi që të lexoj shumë libra fetarë. Meditimi mbi të Gjithëfuqishmin, më ktheu forcën shpirtërore. Dy vitet e qëndrimit në spital, më kthyen fuqinë fizike dhe më dhanë vendimin kategorik, që të vij tek e vërteta mbi Zotin. Lash Londrën dhe erdha në Lindje, në rajonin ku janë lajmëruar shpalljet hyjnore. Kam udhëtuar nëpër Indi dhe Pakistan.

⁵¹¹ John Webster, *Përse pranova Islamin*, Dituria Islame, Prishtinë, 1992. nr. 38. f. 22.

Hyra në një tempull budist. Mirëpo, aty nuk gjeta të vërtetën dhe u tërhoqa në vetmi, duke kërkuar nga Zoti të më tregojë udhën e drejtë. Një natë, shoh në ëndërr... Zgjohem, duke i përsëritur vazhdimisht fjalët: All-llah, Muhammed. Tashmë, e njihja mirë Islamin dhe mësimet e tij. Shkova te dijetari Ahmed Sherkavi, i dërguari i Universitetit të el Ez'herit në Indi dhe e pranova Islamin. Ishte kjo në Madras, në njërin nga qytetet e Indisë".⁵¹²

Umar Mita

Ekonomist nga Japonia.

"Gjatë tre vjetëve të fundit, me mëshirën e All-llahut, jam duke kaluar një jetë të lumtur muslimane...

Shumica e popullit tim, janë budistë, por ata janë budistë vetëm me emër. Ata nuk e zbatojnë Budizmin, e as që kanë njohuri fetare. Arsyeja kryesore, për këtë gjendje apatike, është fakti se Budizmi paraqet një filozofi të ndërlikuar dhe nuk ofron diçka praktike. Për njeriun e thjeshtë, i cili është i ngarkuar me problemet e jetës, budizmi është i paarritshëm, i pakuptueshëm dhe i pazbatueshëm. Kjo gjë, nuk ndodh me Islamin. Mësimet e fesë islame janë të thjeshta, përparimtare dhe shumë praktike. Ato na drejtojnë në të gjitha fushat e jetës, e formulojnë mendimin e njeriut, dhe kur të menduarit është i kthjellët, veprimet e pastra, ndiqen vetveti. Mësimet islame janë aq të thjeshta, të lehta dhe aq praktike, sa që çdo njeri mund t'i kuptojë e t'i zbatojë në jetë. Ato nuk janë monopol i priftërinjve, siç ndodh në religjionet e tjera. Feja islame, në Japoni, ka një ardhmëri që premt. Japonezët, po bëhen për ditë e më tepër materialistë dhe më

⁵¹² *Zašto je prešao na Islam*, Glasnik, Sarajevë, janar-shkurt, 1967. nr. 1-2, f. 85.

të dëshpëruar. Atyre duhet t'u tregohet se paqja e vërtetë është në fenë islame, e cila është një kod i përsosur për jetën dhe udhërrëfyes, në të gjitha fushat e jetës. Nëse Islami do të ketë sukses në Japoni, gjë për të cilën, unë jam fare i sigurt, se një ditë do të ketë, të gjithë ata që e duan fenë islame, duhet të mendojnë për këtë çështje dhe të përpiqen që të bashkëveprojnë për këtë qëllim.

Jeta praktike e muslimanëve, që janë besimtarë të vërtetë, mund të jetë shembull për të tjerët. Ata duhet ta vizitojnë Japoninë dhe ta mësojnë e udhëzojnë popullin, në fenë islame. Populli im është i etshëm për paqe, për të vërtetën, singëritetin dhe çdo të mirë në jetë. Andaj, unë kam besim e shpresë, se Islami mund ta shuajë etjen e pjesëtarëve të tij.

Islam, do të thotë paqe dhe s'ka popull në botë, që e dëshiron paqen më shumë se japonezët. Paqja e vërtetë mund të vendoset, vetëm duke e pranuar fenë e paqes (Islamin). Islami i ofron njeriut paqe me vetveten, paqe me njerëzit dhe paqe me Zotin. Vëllazërimi në fenë islame, është një parim i veçantë dhe në të, qëndron shpëtimi i njerëzimit. Me mëshirën e All-llahut dhe pastaj me ndihmën e misionarëve pakistanezë, e pranova fenë islame dhe në këto tre vjet, jam duke jetuar një jetë të lumtur muslimane".⁵¹³

Donald S. Rockwel

Poet dhe kritik letrar, amerikan. Ai thotë:

"Janë disa arsye, që më tërhoqën ta pranoj fenë islame, por më kryesorët janë: thjeshtësia, atmosfera e qetë që mbizotëron nëpër xhami, besnikëria e besimtarëve muslimanë, frymëzimi i tyre dhe besimi që ata kanë në All-llahun, të

⁵¹³ *Përse e pranua Fenë Islame*, përgatiti Mexhid Yvejsi (rrëfime të vërteta), grup autorësh, Prishtinë 2002. f. 7, 8.

Cilit i përgjigjen pesë herë në ditë, posa e dëgjojnë thirrjen (ezanin), për lutje në namaz. Kur vendosa të pranoj Islamin, zbulova arsye të thella, që vërtetojnë këto fenomene. Në mesin e tyre, ishte thjeshtësia e jetës së Pejgamberit Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], i cili këshillohej me bashkëpunëtorët e tij, i cili ndezi dashurinë e mirësisë ndër bashkëkohësit, i cili rregulloi të drejtat e grave, etj. Këto mësimet e porosi, si dhe shumë të tjera, më bindën ta pranoj fenë islame. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] erdhi me një fe, e cila është një sistem i përsosur për një jetë të natyrshme, e jo besim në mënyrë të verbër...

Toleranca e fesë islame ndaj besimeve të tjera, e bën për vete çdo kërkues e gjurmues të lirisë e të vërtetës. Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i urdhëronte besimtarët muslimanë, sikurse porositi edhe Kur'ani, që ndaj hebrenjve dhe të krishterëve (*ehli kitab*), posedues të librave hyjnorë, të tregonin respekt ndaj besimit të tyre. Kjo porosi dhe ky respekt, ndaj mësimet të Ibrahimit (Abrahamit), Musait (Mojsiut) dhe Isait (Krishtit), paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi ta, si të dërguar të Zotit, pa dyshim, është një cilësi superiore, në krahasim me religjionet e tjera.

Lirimi e pastrimi absolut nga idhujtaria, është një argument, i cili shpreh, fuqishëm, pastërtinë dhe madhështinë e fesë islame. Mësimet e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], nuk prihen nga flaka e fanatizmit, por nga drita e arsyes. Kur'ani, Libri i shenjtë, qëndron i pandryshuar, që nga koha kur iu zbulua Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], pa iu ndryshuar asnjë fjalë, shprehje dhe madje, as edhe një shkronjë e vetme! Kujdesi për shëndetin personal e shoqëror, si dhe pastërtia, ishin disa prej porosive kryesore të Pejgamberit të dashur.

Kur i vizitoja xhamitë në Stamboll, Damask, Jerusalem, Fes, Algjer dhe në qytete të tjera, të vendeve islame, më kaplonte

një ndjenjë e fuqishme për fenë islame, sepse thjeshtësia e tyre tregonte praninë hyjnore, më tepër se çdo rit, pikturë, skulpturë ose muzikë që kanë tempujt e tjerë.

Unë gjithmonë jam i fascionuar nga demokracia islame. I varfri dhe i pasuri, janë në një rrafsh në obligimet fetare, kur janë në namaz, para Zotit, kur i luten Atij, e adhurojnë dhe i nënshtrohen vullnetit të Tij me përvuajtje, etj. Muslimanët, nuk e pranojnë ndërmjetësinë, në mes Zotit dhe njeriut, dhe as të rrëfyerit (para priftit). Muslimanët, Zotin e konsiderojnë Krijues Fuqiplotë të Gjithësisë dhe Burim të Ekzistencës, ata nuk pranojnë ndërmjetës në mes tyre dhe Zotit, kurrfarë kleriku fetar. Vëllazërimi i besimtarëve, humaniteti, solidariteti pa dallim ngjyre, race ose gjinie, janë disa nga arsyet kryesore, që më inkurajuan të pranojë fenë islame”.⁵¹⁴

Suzane Hanef

Gazetare amerikane.

Ajo, pasi gjen qetësinë shpirtërore të cilën e kërkonte, dëshiron që edhe të tjerët, në Amerikë dhe kudo në botë, të kuptojnë dhe të pranojnë këtë fe të re dhe të përsosur. Si rezultat i kësaj dëshire të zjarrtë, ajo shkroi një libër për fenë islame në gjuhën angleze, e cila u botua në qytetin Lahore, të Pakistanit. Ajo pasi e falënderon All-llahun, në këtë libër, veç të tjerash thotë:

“Jetojmë në shekullin e ndërrimeve të mëdha e të shpejta, në një pasiguri të plotë. Njerëzit janë shumë të shqetësuar. Megjithëkëtë, ka njerëz, që përpiqen të gjejnë rrugëdalje dhe ta shpëtojnë njeriun, nga kjo gjendje në të cilin është katan-disur. Është e vërtetë se ne sot, po jetojmë në kohën kur përparimi dhe civilizimi materialist kanë arritur kulmin, por,

⁵¹⁴ Ibid, f. 19-20.

njëkohësisht, cilësia e jetës, morali njerëzor, kanë rënë aq poshtë, saqë shoqërisë njerëzore, po i kanoset shkatërrimi.

Feja islame ofron zgjidhje! Vetë fjala Islam do të thotë paqe, bindje. Kur besimtari jeton në paqe dhe i bindet vetëm Zotit Një dhe të Vërtetë, atëherë feja islame ndikon intensivisht në mendimet dhe veprimet e tij. Vetëm Zoti është Krijuesi dhe Sunduesi i Gjithësisë dhe njeriu i përgjigjet vetëm Atij.

Islami nuk është vetëm një sistem fetar, një ideologji, apo një religjion, sikurse jemi mësuar ta quajmë. Ai është tërësia e jetës së njeriut, është një sistem i gjithmbarshëm, gjithëpërfshirës, i cili udhëzon dhe drejton, individin, bashkësinë dhe shoqërinë, në çdo fushë të jetës. Përmes obligimeve fetare, që i ka caktuar Zoti, marrëdhëniet njerëzore kanë një optimizëm, një shpresë dhe përmes tyre, krijohet një identitet i veçantë në dobi të vetvetes, shoqërisë dhe natyrës. Feja islame, në Amerikë dhe Evropë, kuptohet gabimisht, sepse ajo prezantohet në mënyrë tendencioze! Shumë njerëz, në Amerikë, mendojnë se kjo fe është sekt, ose fe kulti! All-llahu për ta është një hyjni pagane, kurse për Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] mendojnë se është një person që adhurohet nga paganët e tejdetit, tej oqeanit! Pse ndodh kështu? Pa dyshim, e kaluara historike, ka lënë plot paragjykime, si pasojë e kryqëzatave shekullore, propagandës së vazhdueshme me qëllim tendencioz, hegjemonist e të tjera.

Mirëpo, e vërteta është se feja islame, e liron njeriun nga prangat e robërimit material, nga epshet e shfrenuara shtazarake dhe e humanizon atë. Singerisht i lutem Zotit, që të pranojë përpjekjen time modeste dhe të më ndihmojë, që edhe të tjerët të kuptojnë fenë islame, e cila u sjell dobi dhe është e vetmja rrugë për paqe dhe shpëtim".⁵¹⁵

⁵¹⁵ Ibid, f. 37-39.

Philip John Halford, (Abdul Ehad)

Prift protestant. Ky burrë anglez, kishte kryer Fakultetin Teologjik dhe kishte shërbyer si prift protestant, më se dyzet vjet! Në moshën 63 vjeçare, pranoi fenë islame. Ai mori emrin Abdul Ehad (robi i Zotit Një). Rreth asaj, se pse e pranoi Islamin, ai thotë:

“E kuptova se, Islami është fe e vërtetë dhe u bëra musliman. Në vitin 1988, për herë të parë, u njoha me fenë islame. Bëra analiza të thella për veçoritë e Krishterimit dhe të Islamit. Interesimi im u shtua kur dëgjoja ligjëratat me përmbajtje islame, të cilat i zhvillonin vëllezërit muslimanë. Unë, përmes tyre, u lidha me Qendrën Islame, në qytetin Birmingham të Anglisë. Fillova të studioj Kur'anin, me të vetmin qëllim, që të njihem për së afërmi, nga vetë burimi, me fenë islame dhe aty gjeta qetësinë shpirtërore!

Edhe pse isha i edukuar, që nga fëmijëria në frymën e krishterë, kurrë nuk munda të pranoja idenë se, Krishti është bir i Zotit. Mendoj se shumica e besimtarëve të krishterë, nuk janë asnjëherë të sigurt në besimin e tyre”.⁵¹⁶

Ibrahim Ismail

Ish-rabin çifut, pasi pranoi fenë islame, meqë kishte zë të bukur, të fuqishëm dhe kumbues, u caktua muezin në Xhaminë e Madhe, në qytetin Margelanu të Uzbekistanit. Këtë detyrë, sa të shenjtë aq edhe fisnike, ai vazhdon ta kryej edhe sot e kësaj dite, me përkushtim.⁵¹⁷

⁵¹⁶ Ibid, f. 40-41.

⁵¹⁷ Ibid, f. 41.

Amina Mosler

Nga Gjermania, thotë: “Një ditë, djali im me sy të përlotur më tha: Nuk dua të jem më i krishterë. Unë dëshiroj të bëhem musliman, të kaloj në fenë islame. Edhe ju, nëna ime e dashur, duhet t’i bashkoheni kësaj feje, bashkë me mua! Kaluan vite dhe erdha në përfundim se feja islame është fe e vërtetë! Për këtë fe, dëgjova së pari, kur djali erdhi i përlotur, e më tha: Nuk dua të jem i krishterë!

Pasi e pranova Islamin thellësisht, menjëherë e refuzova të rrëfyerit, pagëzimin, shenjtërinë e Papës! Besimi i krishterë në Trinitet (Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë) për mua ishte i papranueshëm, jobindës, madje qysh kur isha e re, që në moshën njëzetvjeçare. Me ndihmën dhe në praninë e Imamit të Xhamisë së Berlinit, e thashë fjalën e Dëshmisë:

‘S’ka Zot tjetër, përveç All-llahut dhe Muhammedi është i Dërguari i Tij’.

Kështu zyrtarisht u bëra muslimane... Jam tejet e gëzuar, fatlume që e kam qetësinë e duhur. Falënderoj All-llahun që më udhëzoi”.⁵¹⁸

Dr. Rolf Baron Ehrenfels, (Umer Ehrenfels)

Shkencëtar dhe antropolog nga Austria. Rrjedh nga një familje shumë e njohur austriake. Është djali i vetëm i shkencëtarit të madh Baron Hristian Ehrenfelsit, themeluesit të Psikologjisë Moderne strukturore, në Austri. Që në fëmijëri, Rolfi kishte simpati për Orientin, sidomos për botën islame! Në moshë të re, ai vizitoi Ballkanin dhe kudo që shkonte hynte edhe nëpër xhami.

⁵¹⁸ Ibid, f. 41-42.

“Ngado që shkoja, shkruan ai më vonë në kujtimet e tij, muslimanët e Ballkanit (ku përmend edhe shqiptarët) më bënë pritje të përzemërt. Kjo më la përshtypje dhe më shtoi edhe më tepër dashurinë për fenë islame dhe muslimanët. Nuk shkoi gjatë kohë dhe ai u bë musliman dhe mora emrin Umer.

Dr. Umer Ehrenfeli kthehet, pas disa vitesh, në Indi dhe vendoset në qytetin Hajdarabad, ku vazhdon kontributin e tij në fushën e antropologjisë, i ndihmuar në hulumtime të ndryshme nga Fondacioni “Werner- Gern Foundation”, nga Nju Jorku. Vite me radhë, ai qe drejtor i Departamentit Antropologjik në Universitetin e Madrasit, ku për veprimtarinë e tij origjinale, në fushën socialo-kulturoro-antropologjike, është shpërblyer me medalje të artë nga “Royal Asiatic Society of Bengali”.

Ka botuar dy vëllime të njohura, në rrethet shkencore “General Anthropology” Nju Delhi, 1941, po ashtu ka botuar edhe shumë vepra të tjera shkencore, dhe fetare islame. Për pranimin e Islamit, ai thotë:

“Mësimet islame janë vazhdimësi e zbulimeve hyjnore. Të gjitha religjionet e mëdha, rrjedhin prej një burimi. Pejgamberët e përgatitën njerëzimin për paqe dhe dëshmuar se mësimet dhe porositë e tyre ishin frymëzime hyjnore. Pranimi i tyre, do të thotë se je kërkues i dashurisë dhe gjurmues i së vërtetës hyjnore”.⁵¹⁹

Muhamed Sulejman Takeuchi

Profesor i etnologjisë, nga Tokio. Është anëtar i Shoqatës së Etnologëve Japonezë. Pasi pranoi Islamin, për mjetet e informimit, ai dha këtë deklaratë:

⁵¹⁹ Ibid, f. 43-44.

“Së pari falënderoj All-llahun, sepse me ndihmën dhe dashamirësinë e Tij, unë përqafova Islamin. Tani unë quhem Muhammed Sulejman Takeuchi. Feja islame më bëri për vete për këto arsye: Unë gjeta një vëllazërim të vërtetë, ndër-mjet besimtarëve. Feja islame ofron zgjidhje praktike, për të gjitha problemet e jetës. Balancimi i materiales dhe shpirtërores, pothuajse më detyroi që të pranoj këtë fe të përsosur! Vëllazëria islame nuk njeh dhe nuk pranon pengesa, kufij kombëtarë, gjuhësorë, racorë, etnologjikë, etj. Aq më tepër, feja islame nuk i takon vetëm një grupi të veçantë, por është një fe për mbarë njerëzimin, qoftë nga Pakistani, India, Afganistani, Kina, Japonia apo nga vendet arabe... Shkurt, është një besim ndërkombëtar, ku të gjithë do të gjejnë shpëtim!

Feja islame është e pastër dhe natyrore. Islami që prej 14 shekujsh, qysh kur filloi t’i shpallet Pejgamberit, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] plotëson çdo nevojë, në çdo vend, në çdo kohë, për çdo bashkësi, për çdo gjeneratë. Historia është dëshmitare për kontributin madhështor, që ka dhënë Feja Islame në zhvillimin dhe përparimin e njerëzimit, në shumë sfera të jetës... Ndryshe nga besimet e tjera, në fenë islame, rruga për në shpëtim kalon nëpërmjet jetës shoqërore, duke nxitur bashkëpunim dhe mirëkuptim për të mirën e përbashkët.

Unë disponoj njohuri edhe rreth religjioneve të tjera, si Budizmi dhe Krishterizmi. Këto dy religjione, na porosisin, veç të tjerash, që jetën shoqërore, jetën e kësaj bote të përkohshme, mos ta përfillim fare! Disa sekte budiste, i kanë ndërtuar tempujt e tyre fetarë, nëpër vende malore, ku mund të shkohet me shumë vështirësi. Por, edhe shumë të krishterë, i kanë themeluar manastiret e tyre në vende të vetmuara, larg vendbanimeve.

Ndërkaq, në fenë islame, nuk kanë ndodhur veprime të tilla, meqë xhamia është kudo, në mes të fshatit, në zemër të çdo lagjeje, në mesin e tregut, në çdo qytet! Të gjithë besimtarët muslimanë, e ndiejnë gëzimin e kënaqësinë e namazit, pesë herë në ditë, që është një nga shtyllat kryesore të fesë. Sot, jeta në Japoni, edhe përkundër faktit se është vendi më i zhvilluar dhe më i përparuar, po keqësohet vazhdimisht dhe po shkon drejt varfërimit shpirtëror. Ne këtu, në Japoni, po ecim gjurmëve të Evropës materialiste. Si rezultat i kësaj, jeta jonë është gjithnjë më e pakuptim, më e pakënaqshme, ndihemi më të shqetësuar e më të dëshpëruar!

Falënderoj All-llahun e Madhëruar, që unë gjeta shpëtimin në fenë islame. Jam një besimtar i ri, që e pranova këtë fe... Vërtet jam i kënaqur! Dëshmoj se s'ka Zot tjetër, përveç All-llahut dhe se Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] është i Dërguari i Tij".⁵²⁰

Alexandër Russel Webb

Diplomat amerikan. U lind në qytetin Hadson, të shtetit Nju Jork. Pas diplomimit, merret me krijimtari letrare-artistike, duke shkruar ese dhe tregime të ndryshme. Më vonë, filloi të merrej edhe me gazetari dhe qe mjaft i suksesshëm. Arriti të udhëheqë dy gazeta të njohura "Saint Joseph Gazzette" dhe "Missouri Republican". Më vonë e la gazetarinë dhe kaloi në diplomaci. U emërua konsull dhe u caktua të shërbejë në Manilë, të Filipineve. Gjatë kësaj kohe, filloi të interesohej për Islamin. Një ditë, e pranoi Islamin me zemër dhe shpirt! Ai mori emrin e lavdëruar Muhammed. Ai thotë: "Përse unë, një amerikan i lindur në një vend, kryesisht të krishterë, që jam edukuar dhe rritur në një vend, në të cilin

⁵²⁰ Ibid, f. 46-48.

dominon Kisha Protestante Presbiteriane, e pranova fenë islame si të vetmen udhërrëfyese të jetës?

Mund t'ju them menjëherë, me krenari, sinqeritet e vërtetësi, se këtë fe e pranove sepse në të zbulova, pas studimeve serioze e të thella, se është feja më e përsosur dhe i vetmi sistem jete, që u përshtatet nevojave shpirtërore. Që në moshën njëzetvjeçare, isha aq i mërzhitur, i pranguar, i kufizuar dhe i zhgënjyer nga kisha Protestante Presbiteriane, sa që u detyrova të braktisja e të largohem njëherë e përgjithmonë, për të mos u kthyer më kurrë tek ajo...

Unë dëshiroja shpjegime për pyetjet që i shtroja, por, mjerisht asnjëri, qoftë nga kleri ose laikët, nuk ishin në gjendje të më shpjegonin në mënyrë racionale fenë krishtere. Në vend të përgjigjeve, ata më thoshin: Këto gjëra janë të shenjta, janë misterioze, ose kinse, pakuptueshmëria ime, s'mund t'i përfshijë ato...

Para rreth një dekade, filloi të zgjohet tek unë dëshira dhe interesimi për studime orientale, në veçanti, për religjionet e Lindjes. Shkrimtarët e mëdhenj dhe dijetarët e njohur si Mili, Loku, Kanti, Hegeli, Fihte, Hakslej dhe shumë të tjerë, ligjëronin me shumë urtësi, rreth çështjeve të ndryshme e më delikate, kush më pak e kush më shumë, por asnjëri prej tyre nuk që në gjendje të shpjegojë se: Ç'është thelbi i së Vërtetës?

Thelbi i së Vërtetës, pa dyshim, është bindja ndaj Vullnetit të All-llahut dhe baza e saj është namazi. Namazi me përkushtim, sjell vëllazërimin e përgjithshëm, dashurinë universale dhe sjell mirësi të shumta: pastërtinë e mendjes, të zemrës dhe të shpirtit. Pra, ai sjell pastrim të përgjithshëm dhe të përsosur. Feja islame është, pa dyshim, feja më e

thjeshtë, më e lehtë dhe më e lartë, prej të gjitha feve qiellore..."⁵²¹

Xhefri Langu, (Jeffery Lang)

Dijetar amerikan, në librin e tij "Struggling to Surrender", (Luftë deri në dorëzim ose luftë për shkak të besimit), tregon mbi pakënaqësitë e tij, ndaj besimit të krishterë. Më në fund, lumturinë të cilën e kërkonte, nuk e gjeti gjetiu, veçse në Islam. Ai thotë:

"Kur e pranova Islamin dhe pasi u njoha me bindjet dhe vendimet e tij, isha i kujdesshëm që mos të falja pesë kohët e namazit, veçse me xhemat, dhe sidomos, ato në të cilat lexohet me zë. Një ditë, njëri prej kureshtarëve më tha: Pse je aq i vëmendshëm, që t'i kryesh namazet, në të cilat lexohet me zë me xhemat, kur ti nuk e njeh gjuhën arabe?! I thashë: Pse foshnja e vogël, e cila vazhdon të ushqehet nga gjiri i nënës, qetësohet dhe i vjen mirë, kur e dëgjon zërin e nënës së saj, ndonëse, ajo nuk kupton asgjë nga fjalët e saj? Unë e ndjej të njëjtën gjë, mes meje dhe fjalëve (kur'anore) që i dëgjoj".⁵²²

Literatura:

⁵²¹ Ibid, f. 52-53.

⁵²² Dr. Muhammed Seid Ramadan El Buti, *Evropa prej teknologjisë drejt spiritualizmit*, Shkup, 1421/2000, f. 44.

1. Abdul Mexhid Ez-Zendani, *Mrekullitë shkencore të Kur'anit*, Prishtinë, 2002.
2. Abdul Vehid Hamid, *Islamizmi rruga e natyrshme*, pa vit botimi.
3. Ahmed Dedat, *Kur'ani mrekullia më e përsosur*, Prishtinë, 2001.
4. Ahmed Hamdi, *Mësime Feje*, Tiranë, 2003.
5. Sulltan Ahmed Kureshi, *Letrat e Muhammedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]*, Prishtinë, 2004.
6. Ahmed Muhamed el Hufi, *Toleranca islame*, Prishtinë, boton shtëpia botuese Dituria Islame, (pa vit botimi).
7. Avdi Berisha, *Shtatëzania e një mashtrimi*, pa vit botimi
8. Beqir Topallogllu, *Gruaja në Islam*, Stamboll, 2000.
9. Christian H. Hoffman, *I shtrirë nga të gjitha anët, (një gjerman bëhet musliman)*, Tetovë, 2003.
10. Didie Zhylia, *Fjalori i filozofisë*, Tiranë, 1994.
11. *Dijalog islamskih i evropskih učenjaka*, Sarajevë, 1979.
12. Dituria Islame, Prishtinë: nr. 25, nr. 22-23, nr. 26, nr. 37, nr. 47, nr. 51, nr. 53, nr. 46, nr. 62, nr. 73, nr. 75, nr. 79, nr. 81-82, nr. 84, nr. 28, nr. 45, nr. 24.
13. Dr. Muhammed A. Jemani, *Edukoni fëmijët tuaj me dashuri për profetin Muhammed a.s.* Shkodër, 1996.
14. Drita Islame, Tiranë: nr. 63, nr. 130, nr. 121, nr. 45, nr. 168, nr. 151, nr. 90, nr. 94, nr. 47, nr. 65.
15. Ebul Hasen Ali en Nedevijj, *Islami, ndikimi i tij në civilizim dhe merita e tij për njerëzimin*, Shkup, 1421/2000.
16. Edukata Islame, Prishtinë: 1971, nr. 3, Edukata, 1972, nr. 4.
17. Glasnik, Sarajevë: nr. 1-2/ 1965, nr. 4-6/1961, nr. 1-2/1967, nr. 11-12/1966, nr. 7-8/1968, nr. 9-10/1970.
18. Hamza Mustafa Njazi, *Burimet e Kur'anit*, Tiranë, 1993.

19. Hani El Mubarek dhe dr. Shukri Ebu Halil, *Roli i civilizimit arabo-islam në renesansën evropiane*, Shkup, 1420/1999.
20. Hasan Baxhi, *Dialogu Kristiani dhe Muslimani*, Tiranë, 1993.
21. Hëna e Re, Shkup, 15 korrik, 1993
22. Imadudin Halil, *Kalu anil Islam*, Rijad, 1412/1992.
23. Imam Vehbi Ismaili, *Muhammedi Pejgamber i Islamit*, Michigan, 1987.
24. Islamska Misao, Sarajevë: nr. 48/1982, nr. 51/1983.
25. Jacques Le Goff, *Mesjeta në zanafillat e identitetit evropian*, Shtëpia e Librit & Komunikimit, Qendra ndërkombëtare e Kulturës, Tiranë, pa vit botimi.
26. Jusuf el Kardavi, *Islamsko pravo*, Sarajevë, 1989.
27. *Letërkëmbimi mes Merjem Xhemiles dhe El Mevdudit*, Shkup, 1992.
28. Lois Lamya al Faruqi, *Women Muslim Society and Islam*, Indianapolis, 1991.
29. Maurice Bucaille, *Bibla, Kur'ani dhe Shkenca*, Gjakovë.
30. Mevdudi, *Të kuptuarit e drejt të Islamit*, Shkup, 1999/1420.
31. Muhammed Asad, *Rruga për në Mekë*, Shkup, 2003.
32. Muhammed Seid Ramadan El Buti, *Evropa prej teknologjisë drejt spiritualizmit*, Shkup, 1421/2000.
33. Murad Hofmann, *Islami si alternativë*, Shkup, 1421/2000.
34. Nexhat S. Ibrahim, *Paragjykimet ndaj Islamit gjatë shekujve*, Zëri Islam, Prizren, 2000.
35. Osman Nuri Haxhiq, *Muhammed a.s. i Kur'an, osvrt na historiju islamske kulture*, Zagreb, 1986.
36. Osman Nuri Topbash, *Fllade Mëshironjëse nga Pejgamberi Mëshirues*, Stamboll, 1999.
37. Pamfleti: *Ç'thonë të tjerët për Muhammedin a.s.*
38. Pamfleti: *A e njihni këtë njeri.*

39. Pamfleti: *Ç'thonë të tjerët për Islamizmin*.
40. Pamfleti: *Ç'thonë të tjerët për Kur'anin*.
41. Pamfleti: *Shpata e Islamit*, botues Rinia dhe Kultura Islame, Tiranë, 1992
42. Paul Frindley, *Mjaft me heshtje, përballë imazhit të gabuar të Amerikës mbi Islamin*, Shkup, 2004.
43. *Përse e pranuan fenë islame*, përgatiti Mexhid Yvejsi (rrëfime të vërteta), grup autorësh, Prishtinë 2002.
44. Preporodi, Sarajevë, 1982, nr. 3/1986.
45. *Rreth përhapjes së Islamit ndër shqiptarët*, përmbledhje studimesh, përgatit Muhidin Ahmeti, Shkodër, 1997.
46. Revista Nur, Beograd, gusht, 1993.
47. Rinia Islame, Shkodër, 23, dhjetor, 1998
48. Rinia Islame, Shkodër, nr. 10, nëntor, 1997
49. Rinia Islame, Shkodër, nr. 12, janar, 1998
50. Robert L. Gulick, Jr., *Muhammedi edukator*, Istanbul, 1992
51. Rozhe Garodi, *Gjallërimi islamik*, Gjakovë, 1991
52. Seid Ramadan, *E drejta islame*, Gjilan 2000.
53. Sejjid Muxhteba Musavi Llari, *Islami dhe civilizimi perëndimor*, Gjilan, 2004
54. Shejh Abdulkadir Al Murabit, *Johann Wolfgang Von Goethe dhe marrëdhëniet e tij me fenë islame*, Tiranë, 2000.
55. Shkëlqimi Islam, viti II, Tiranë, 18 Janar, 1992, nr. 1.
56. Takvimi, Prishtinë, 1993, 1996.
57. Takvimi, Sarajevë, 1970, 1975, 1976, 1983.
58. Triumfi Islam, Shkodër, Maj, 1994, nr. 15.
59. Thirrja Islame, viti I. Nr. 1. revistë fetare, boton Komuniteti Musliman Shqiptar në SHBA dhe Kanada.
60. Thomas W. Arnold, *Historia e përhapjes së Islamit*, Prishtinë, 2004.
61. *Udhërrëfyes i shkurtër i Islamit*, Prishtinë, 2000/1421.
62. Ulfe Aziz-us-Samed, *Islami dhe Krishterizmi*, Prizren, 1412/1992.

63. Vepra, Shkup, nëntor, 2001
64. Zhane Hersh, *Habia Filozofike*, Tiranë, pa vit botimi.

Përmbajtja:

KAPITULLI I	21
PËR ISLAMIN	21
KAPITULLI II	64
PËR KUR'ANIN.....	64
KAPITULLI III	120
PËR MUHAMMEDIN [SAL-LALL-LLAHU ALEJHI VE SEL-LEM]	120
KAPITULLI IV	177
CIVILIZIMI ISLAM	177
KAPITULLI V	227
TOLERANCA ISLAME.....	227
KAPITULLI VI	256
PËR ÇËSHTJEN E FEMRAVE	256
KAPITULLI VII	265
PSE PRANOVA ISLAMIN	265

mbNë kopertinën e jashtme të mbrapme të librit, le të vendosen këto thënie:

“Nëse Islam do të thotë nënshtrim ndaj Zotit, atëherë ne jetojmë dhe vdesim në Islam”.

Johan Wolfgang von Gëte

“Kur’ani është simfoni unike, tingujt e së cilës i kanë shtyrë njerëzit deri në lotderdhje dhe ekstazë”.

Muhamed Marmadjuk Pitkal

“Nëse madhështia e qëllimit, thjeshtësia e mendimit dhe rezultatet e arritura, janë tri kritere të gjenialitetit njerëzor, kush mund të marrë guximin të krahasojë, cilindo njeri të madh, në historinë njerëzore, me Muhammedin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]?”

Lamartini

“Islami ka nxitur frymën shkencore nga më të mrekullueshmet, çfarë s’ka parë bota ndonjëherë, që nga matematika e deri te mjekësia, nga astronomia e deri te fizika. Kultura islame, ka shndritur me shkëlqimin e saj, shekuj me radhë”.

Rozhe Garodi

“Mbase, pikërisht ndjenja, se çdo gjë në mësimet dhe postulatet e Islamit ‘është në vendin e vet’ më ka impresionuar tejet fuqishëm... Islami ka hyrë tek unë heshturazi dhe fshehtazi, por përgjithmonë

Muhammed Asad